



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Prrenjas**

# **RAPORT PËRFUNDIMTAR**

**Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë**

**të ushtruar në**

## **BASHKINË PRRENJAS**

## PËRMBAJTJA

<b>SHKURTIME.....</b>	<b>3</b>
<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>4</b>
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	4
2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore .....	4
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit .....	21
<b>II. HYRJE.....</b>	<b>24</b>
1. Objekti i Auditimit.....	24
2. Qëllimi i auditimit.....	24
3. Identifikimi i çështjes.....	24
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	24
5. Përgjegjësitë e audituesve .....	24
6. Kriteret e vlerësimit .....	25
7. Standardet e auditimit .....	27
8. Metodat e auditimit .....	27
9. Dokumentimi i auditimit.....	28
<b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT .....</b>	<b>30</b>
1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Prenjas.....	30
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit .....	31
2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik .....	31
2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit .....	51
2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar.....	61
2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik .....	83
2.5. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.....	127
2.6. Mbi Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).....	132
2.7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm .....	134
2.8. Të ndryshme, të dala gjatë auditimit .....	145
<b>IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET .....</b>	<b>148</b>
A. MASA ORGANIZATIVE.....	148
B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI .....	156
C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR .....	158

## SHKURTIME

<b>AAJM</b>	Aktive Afatgjata Jo Materiale
<b>AAM</b>	Aktive Afatgjata Materiale
<b>AK</b>	Autoritet Kontraktor
<b>AQT</b>	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
<b>ASHK</b>	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
<b>BOE</b>	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
<b>FZHR</b>	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
<b>GMS</b>	Grupi i Menaxhimit Strategjik
<b>IFAC</b>	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
<b>INOTSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>IPSAS</b>	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
<b>ISA</b>	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
<b>ISSAI</b>	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>IT</b>	Teknologjia e Informacionit
<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>KPP</b>	Komisioni i Prokurimit Publik
<b>KVO</b>	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
<b>LPP</b>	Ligji i Prokurimit Publik
<b>MFK</b>	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
<b>MAB</b>	Manuali i Auditimit të Brendshëm
<b>NA</b>	Nëpunës Autorizues
<b>NJA</b>	Njësi Administrative
<b>NJAB</b>	Njësia e Auditimit të Brendshëm
<b>NJP</b>	Njësia e Prokurimit
<b>NZ</b>	Nëpunës Zbatues
<b>OE</b>	Operator Ekonomik
<b>PF</b>	Pasqyrat Financiare
<b>QKB</b>	Qendra Kombëtare e Biznesit
<b>SHA</b>	Shoqëri Anonime
<b>SHPK</b>	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
<b>SKK</b>	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
<b>UMF</b>	Udhëzim i Ministrisë së Financave
<b>VKB</b>	Vendim i Këshillit Bashkiak
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga auditimi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet për një qeverisje të mirë, në përmbushje të objektivave të institucionit të Bashkisë Prrenjas dhe Ligjit nr. 139/15 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe të kontratave të lidhura. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt-rakordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga baza e të dhënave të thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, 600 “paga”, 602 “shpenzime operative” dhe 230-231 “investime”, u audituan prokurimet publike të zhvilluara nga Bashkia Prrenjas nga data 01.01.2018 deri në datën 31.12.2022, etj.

Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 16 Akte Konstatimi dhe 3 Akte Verifikimi, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit të audituar brenda afatit të përfundimit të auditimit.

### 2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nga auditimi, u konstatua se:</p> <p><b>1.</b> Gjendja e llogarisë 210 “<i>Toka, Troje, Terrene</i>”, në datën 31.12.2022, paraqitet në vlerën 4,918,360 lekë, e pandryshuar nga viti ushtrimor paraardhës. Nga Bashkia Prrenjas nuk është marrë asnjë masë për të inventarizuar, kontabilizuar dhe regjistruar në kadastër tokat, trojet dhe terrenet të cilat i janë transferuar me VKM-të përkatëse ish-komunave, në kuadër të inventarizimit dhe transferimit të pasurive publike. Për sa më sipër, llogaria 210 “<i>Toka, Troje, Terrene</i>”, në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë.</p> <p><b>2.</b> Gjendja e llogarisë 211 “<i>Pyje, Plantacione</i>” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 22,928,105 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 24,118,659 lekë, me një shtesë në vlerën 1,190,554 lekë. Në analizën e kësaj llogarie janë paraqitur edhe disa zëra, të cilët i përkasin llogarisë 202 “<i>Studime dhe kërkime</i>”, në vlerën 6,701,384 lekë dhe disa zëra, të cilët i përkasin llogarisë 218 “<i>Inventar ekonomik</i>”, në vlerën 6,969,028 lekë. Për sa më sipër, llogaria 211 “<i>Pyje kullota plantacione</i>” në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë dhe është mbivlerësuar për shumën 13,670,412 lekë.</p> <p><b>3.</b> Gjendja e llogarisë 212 “<i>Ndërtime e konstruksione</i>”, në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 599,502,327 lekë, e pandryshuar nga viti ushtrimor parardhës. Në analitikun e kësaj llogarie, u konstatua se vlera është 637,614,096 lekë. Nga Bashkia Prrenjas nuk është marrë asnjë masë për të inventarizuar, kontabilizuar dhe regjistruar në</p>	<p><i>Pika 2.3., faqe 61-83</i></p>	E lartë	<p>1. Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrave të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.</p> <p>2. Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painedarizuar deri më sot, si dhe saktësimin e aseteve të inventarizuara, përkatësisht për zërat: 210 “<i>Toka, troje terrene</i>”; 211 “<i>Pyje, Kullota, Plantacione</i>”; 212 “<i>Ndërtime e konstruksione</i>”; 213 “<i>Rrugë, rrjete, vepra ujore</i>”; 214 “<i>Instalime teknike, makineri e pajisje</i>” dhe 215 “<i>Mjete transporti</i>”. Në llogaritjen e vlerës së</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>kadastër ndërtimet dhe konstruktonet të cilat i janë transferuar me VKM-të përkatëse ish-komunave, në kuadër të inventarizimit dhe transferimit të pasurive publike. Për sa më sipër, llogaria 212 “Ndërtime e konstrukcione”, në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë.</p> <p><b>4.</b> Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 962,639,497 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 916,482,044 lekë, me një pakësim në vlerën 46,157,453 lekë. Në analizën e kësaj llogarie janë paraqitur edhe disa zëra, të cilët i përkasin llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 6,701,384 lekë. Gjithashtu, u konstatua se në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”, ka 40 zëra asetesh, në vlerën totale 717,837,015 lekë, të cilat duhet të kalojnë në administrim të shoqërive aksionare përkatëse për furnizimin me ujë të pijshëm. Nga Bashkia Prrenjas nuk është marrë asnjë masë për të inventarizuar, kontabilizuar dhe regjistruar në kadastër rrugët, rrjetet dhe veprat ujore të cilat i janë transferuar me VKM-të përkatëse ish-komunave, në kuadër të inventarizimit dhe transferimit të pasurive publike. Për sa më sipër, llogaria 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore” në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë dhe është e mbivlerësuar për shumën 10,064,005 lekë.</p> <p><b>5.</b> Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 14,099,639 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 10,168,721 lekë, me një pakësim në vlerën 3,930,918 lekë nga amortizimi dhe nxjerrjet jashtë përdorimit. Shtesat në këtë llogari kanë qenë 124,480 lekë, të cilat paraqesin vlerën e investimeve të kryera për instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës. Nga Bashkia Prrenjas, për këtë llogari nuk disponohet analizë dhe një pjesë e zërave përkatës të kësaj llogarie janë kontabilizuar gabim në llogarinë 215 “Mjete transporti”, duke e nënvlerësuar këtë llogari për vlerën 23,827,196 lekë. Për sa më sipër, llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë dhe është e nënvlerësuar për shumën 23,827,196 lekë.</p> <p><b>6.</b> Gjendja e llogarisë 215 “Mjete transporti”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 54,196,396 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 45,266,396 lekë, me një pakësim në vlerën 10,310,000 lekë. Në analizën e kësaj llogarie janë paraqitur edhe disa zëra, të cilët i përkasin llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla</p>			<p>këtyre aktiveve të merret në konsideratë vlera fillestare dhe kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivitetit përkatës, sipas rastit.</p> <p>3. Nga Bashkia Prrenjas, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të merren masa për të sistemuar llogaritë 210 “Toka, Troje, Terrene”, 211 “Pyje, Plantacione”, 212 “Ndërtime e konstrukcione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 215 “Mjete transporti”, sipas vlerave të specifikuara më sipër.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p><i>pune</i>”, në vlerën 23,827,196 lekë, të cilat nuk janë mjete transporti, por makineri. Për sa më sipër, llogaria 215 “<i>Mjete transporti</i>”, në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë dhe është e mbivlerësuar për shumën 23,827,196 lekë.</p> <p>7. Nga auditimi dhe testimi i Aktiveve Afatgjata Materiale, u konstatua se në regjistrat/librat e kontabilitetit të këtyre llogarive, për një pjesë të konsiderueshme të zërave nuk është pasqyruar vlera fillestare e aktiveve, por vetëm vlera e shpenzimeve të mëpasshme, për rikonstruksione ose përmirësimin e gjendjes së këtyre aktiveve. Kryesisht, kjo ka ndodhur për shkak se shumica e këtyre AAM nuk është pajisur me titull pronësie dhe ende nuk janë në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. Gjithashtu, paraqiten problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar e amortizimit, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar e shpenzimeve të mirëmbajtjes, data e daljes nga pronësia, etj. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivitetit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “<i>Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i>”.</p> <p>Këto llogari janë mbajtur në bilancin kontabël pa pasur një analizë të detajuar, ku të përcaktohet origjina e vlerës së asetëve. Nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës disponohet informacion vetëm për shtesat vjetore të llogarive 210, 211, 212, 213, 214 dhe 215. Gjithashtu, fakti që nuk ka një regjistër konlabël për AAM, e vështirëson më tej njohjen dhe verifikimin e saktësisë së vlerave kontabël të këtyre llogarive.</p> <p>Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “<i>Për menaxhimin financiar dhe kontrollin</i>” neni 6; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “<i>Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre</i>” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “<i>Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik</i>”, pika 30; UMF nr. 8, datë 9.3.2018 “<i>Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në</i></p>			

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p><i>njësitë e qeverisjes së përgjithshme</i>”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, Aneksi 1, Pika 2, Klasa 2; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “<i>Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial</i>”, Kreu VI “<i>Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme</i>”, etj.</p>			
2	<p>Nga auditimi i dokumenteve financiare dhe verifikimi në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe QKB-së, u konstatua se Bashkia Prrenjas, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2022 paraqitet si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Aksionare me 42.08% të aksioneve të Shoqërisë U.K.L.P. Sh.A., me NUIS J...V e cila është shoqëri aksionare me objekt “<i>Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm, etj.</i>”. Numri i aksioneve është 415,720 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 415,720,167 lekë, nga e cila vlera 82,652,660 lekë përbën kapitalin e shlyer. Kjo shoqëri është themeluar në datën 16.08.2022. Bashkia Prrenjas zotëron 174,947 aksione, me vlerë nominale 174,947,000 lekë. Këto të drejta, Bashkia Prrenjas i ka trashëguar nga reforma territoriale, në datën 30.05.2016, si përfituese e pasurisë së ish-komunave të cilat janë konsoliduar në Bashkinë e re të Prrenjasit.</li> <li>- Aksionare me 12.9% të aksioneve të Shoqërisë U.K.P. Sh.A., me NUIS M...U e cila është shoqëri aksionare me objekt “<i>Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm, etj.</i>”. Numri i aksioneve është 100,000 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 10,000,000 lekë, nga e cila vlera 5,100,000 lekë përbën kapitalin e shlyer. Kjo shoqëri është themeluar në datën 26.07.2022. Bashkia Prrenjas zotëron 12,900 aksione, me vlerë nominale 1,290,000 lekë.</li> <li>- Aksionare me 8% të aksioneve të Shoqërisë E.E. Sh.A., me NUIS M....T e cila është shoqëri aksionare me objekt “<i>Grumbullimi, rehabilitimi dhe përpunimi i mbetjeve të ndryshme, organike, të ngurta, të gjelbërta,..etj.</i>”. Numri i aksioneve është 7 me vlerë nominale 500,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 3,500,000 lekë, e cila përbën kapital të shlyer. Kjo shoqëri është themeluar në datën 18.11.2021. Bashkia Prrenjas zotëron 1 aksion, me vlerë nominale 500,000 lekë.</li> </ul> <p>Vlera totale 176,737,000 lekë nuk është paraqitur në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël për vitin ushtrimor 2022, konkretisht në llogarinë 26 “<i>Pjesëmarrje në kapitalin e veta</i>”.</p>	Pika 2.3., faqe 61-83	E lartë	<p>Nga Bashkia Prrenjas, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të shoqërive: <b>1.</b> “<i>U.K.L.P. Sh.A.</i>”, me NUIS J...V, për 42.08% të aksioneve, gjithsej 174,947 aksione, me vlerë nominale 174,947,000 lekë; <b>2.</b> “<i>U.K.P. Sh.A.</i>”, me NUIS M...U, për 12.9% të aksioneve, gjithsej 12,900 aksione, me vlerë nominale 1,290,000 lekë; <b>3.</b> “<i>E.E. Sh.A.</i>”, me NUIS M....T, për 8% të aksioneve, gjithsej 1 aksion, me vlerë nominale 500,000 lekë, si dhe regjistrimin e kapitalit aksionar të këtyre shoqërive në shumën totale 176,737,000 lekë në debi të llogarisë 26 “<i>Pjesëmarrje në kapitalin e vet</i>” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>Për sa më sipër, llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” nuk paraqet vlerën reale për shumën 176,737,000 lekë (174,947,000 lekë nga Shoqëria U.K.L.P. Sh.A., 1,290,000 lekë nga Shoqëria U.K.P. Sh.A. dhe 500,000 lekë nga Shoqëria E.E. Sh.A.). Gjithashtu, u konstatua se në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”, ka 40 zëra asetesh, në vlerën totale 717,837,015 lekë, të cilat duhet të kalojnë në administrim të shoqërive aksionare përkatëse për furnizimin me ujë të pijshëm. Këto zëra asetesh janë paraqitur në Aneksin PF25, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.</p> <p>Sa më sipër, është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj.</p>			
3	<p>Gjendja e llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2021 paraqitet përkatësisht 142,534,635 lekë për llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe 0 lekë për llogarinë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale”. Në datën 31.12.2022 paraqitet përkatësisht 190,742,803 lekë për llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe 0 lekë për llogarinë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale”, me një rritje prej 48,208,168 lekë nga viti i kaluar. Vlera e prokuruar për investimet gjatë vitit 2022 ka qenë 429,060,344 lekë, nga të cilat 337,346,089 lekë me fonde të deleguara dhe 91,714,244 lekë nga të ardhurat e veta.</p> <p>Për sa më sipër, zëri “Investime në proces”, i përbërë nga llogaritë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën reale, është nënvlerësuar për shumën 238,317,541 lekë, pasi duhet të pasqyrohet vlerën 429,060,344 lekë, e cila përbëhet nga shuma e kontratave të lidhura, të cilat nuk kanë përfunduar dhe nuk janë marrë në dorëzim nga Bashkia Prrenjas.</p> <p>Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të</p>	Pika 2.3., faqe 61-83	E lartë	Drejtoria Ekonomike dhe Financës në Bashkinë Prrenjas, në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktive afatgjata materiale dhe jo materiale, të mbajë në konsideratë që pagesat e vlerave pjesore të AQT, duhet t'i evidentojë në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në vlerën e plotë dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave, t'i kontabilizojë ato në llogaritë e klasave 20-21, sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.



Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p><i>pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme</i>”, kreu II, pikat 6 dhe 15-18, kreu III, pika 33, 36, Aneksi 1, pika 2, “Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël)”, “Aktive afatgjata materiale”, etj.</p>			
4	<p>Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” (nënlogaria 4662104) në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 44,736,876 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 45,539,778 lekë ose me rritje në vlerën 802,902 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Nga auditimi u konstatua se për objektet e përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Prrenjas, nuk është bërë zhbllokimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuara në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria Ekonomike dhe e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.</p> <p>Veprimet dhe mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.</p>	<p>Pika 2.3., faqe 61-83</p>	E lartë	<p>Kryetari i Bashkisë Prrenjas në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejojë likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zhbllokimin e fondeve të ngurtësuara.</p>
5	<p>Për vitin 2022, janë kryer investime në total për 20 objekte, për vlerën totale të kontraktuar 429,060,344 lekë. Likuidimi në periudhat e mëparshme ka qenë në vlerën 229,442,021 lekë. Planifikimi për t’u likuiduar gjatë vitit 2022 ka qenë 190,618,323 lekë. Me fonde të deleguara nga Qeveria kanë qenë gjithsej 6 objekte, në vlerën totale të kontraktuar 337,346,089 lekë. Likuidimi në periudhat e mëparshme ka qenë për vlerën 239,955,355 lekë dhe realizuar për gjatë vitit 2022 në vlerën 97,390,734 lekë.</p> <p>Me fondet e veta kanë qenë gjithsej 14 objekte, për vlerë totale të kontraktuar 91,714,255 lekë. Likuidimi në vitin 2022 është realizuar në vlerën 89,160,441 lekë. Vlera e mbetur për t’u financuar ka qenë 2,553,814 lekë.</p> <p>Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve</p>	<p>Pika 2.3., faqe 61-83</p>	E lartë	<p><b>Me çeljen e fondeve/mbërritjen e shkresës</b> së dërguar nga MFE për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve, të kryhet veprimi kontabël për shumat përkatëse në debi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe në kredi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”.</p> <p><b>Me konstatimin e shpenzimit</b>, (mbërritja e faturës shoqëruar me situacion) të bëhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të llogarisë 404 “Furnitorë për investime”.</p> <p><b>Në momentin e pagesave</b> të faturave, të kryhet kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 “Furnitorë për</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>ekonomike të kryera, nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizimit të aktivitetit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2021 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, ku vlera e tyre e mbetur e palikuiduar nuk është evidentuar në kontabilitet në llogarinë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”.</p> <p>Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Kreu I, “Të përgjithshme”, pika 8, Kreu II, “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pikat 15/a, b, c, 18/a, b dhe Kreu III, “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 32.</p>			<p><i>investime</i>” dhe në kredi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”.</p> <p><b>Në fund të vitit ushtrimor</b>, për fondet e përdorura për <b>investimet e papërfunduara/në proces</b>, të kryhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”, në kredi të llogarisë 720 “Grant korrent i brendshëm” dhe në kredi të llogarisë 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.</p> <p><b>Me përfundimin e investimit</b>, të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës të bëhet kapitalizimi i aktivitetit (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhet prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”.</p> <p><b>Me kapitalizimin e aktivitetit</b>, (për aktivitet e marra në dorëzim), të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”, në kredi llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për fondet buxhetore të përdorura për investime, në kredi të llogarisë 1011 “Shtesa të fondit bazë” dhe në debi të llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për vlerën e aktiveve të blera.</p>
6	<p>1. Nga auditimi i 36 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2018-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 16 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar.</p> <p>2. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për punë publike, u konstatua se në shumicën e tyre është vendosur si kriter për punonjësit, dëshmia e sigurimit teknik, bazuar në Ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike” i ndryshuar, ndërkohë që objekti i punëve publike dhe stafi i nevojshëm për kryerjen e këtyre punimeve, nuk është në kushtet për</p>	Pika 2.4., faqe 83-127	E lartë	<p>1. Kryetari i Bashkisë Prrrenjas, në cilësinë e Titullari të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.</p> <p>2. Specialisti i fushës në Njësinë e Prokurimit të Bashkisë Prrrenjas, të marrë masa për shmangien e kriterëve të paargumentuara dhe të pa lidhura me objektin e kontratës, të cilat kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	të qenë i pajisur me këtë dëshmi, pasi nuk ka zëra punimesh që lidhen me objektin e këtij ligji. Pra ky kriter rezulton i paargumentuar dhe nuk lidhet me objektin e kontratës. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, neni 1, 2, 20, si dhe neni 26, pika 5 të VKM-së nr. 914, datë 24.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, të shfuqizuara përkatësisht me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.			ekonomik në procedurat e prokurimit publik.
7	Nga auditimi i 36 procedurave të prokurimit publik, të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2018-31.12.202, u konstatua se në 14 raste, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, shkronjat a), b), d) dhe dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” shkronjat (a), b) dhe c), neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” pika 1 dhe neni 55 “Shqyrtimi i ofertave” pika 3 dhe VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik”, të shfuqizuara përkatësisht me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.	Pika 2.4., faqe 83-127	E lartë	Kryetari i Bashkisë Prrrenjas, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.
8	Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të kontratave për punë publike, përkatësisht: - “Rikonstruksion rrjeti shpërndarës i ujësjellësit Prrrenjas”, - “Rikonstruksion dhe riveshje me asfaltim i pjesëve të dëmtuara të rrugës “Lapidari Qukës Shkumbin, Mulliri i Belbës, asfaltimi i rrugës në lagjen e Kryeziut, asfaltimi i rrugës në lagjen e Shytit dhe rikonceptimi i qendrës së fshatit Qukës, NjA Qukës”, - “Rikonstruksion i rrugës Qukës Shkumbin-Stroskë”, - “Rikonstruksion i rrugës Qukës-Skënderbe”, - “Ujësjellësi Dritaj-Fanjë - Karkavec (Vazhdim, faza II)”, - “Ujësjellësi Dritaj-Fanjë-Karkavec (Vazhdim, faza III), FV matësa familjarë”, - “Rihabilitimi i Skemës Ujitëse Radigoz-Stranik-Bërzeshë”, rezultoi se: Autoriteti Kontraktor Bashkia Prrrenjas nuk ka kryer oponentin teknik për projektet e zbatimit, për të gjitha ndërtimet publike dhe ndërtimet jopublike. Veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi”, i ndryshuar, neni 6.	Pika 2.4., faqe 83-127	E lartë	Bashkia Prrrenjas të marrë masa për të pajisur me Oponentin Teknik të gjitha ndërtimet publike dhe ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar mbi 100 milionë lekë, si dhe objektet me akses publik sipas legjislacionit në fuqi.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
9	<p>Nga auditimi i shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në 2 raste, personat përgjegjës të cilët administrojnë procesin në sistemin “e-leje”, i kanë miratuar ato në mospërmbushje të dokumentacionit sektorial të kërkuar për ndërtimin, pasi janë evidentuar mangësi që lidhen me treguesit e lartësisë, distancat ndërmjet ndërtimeve, mosllogaritje e saktë e sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit në 1 rast, si dhe mos respektim i KSHT-së dhe intensitetit të ndërtimit, veprime në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, nenet 34, pika 2, 35, 37, 38 pika 2 dhe 39, pika 1, Planin e përgjithshëm vendor të Bashkisë Prrenjës, miratuar me Vendimin nr. 3, datë 14.04.2017 nga Këshilli Kombëtar i Territorit, Pasaporta teknike e njëjësive strukturore 1/31 dhe 1/36 të kësaj bashkie.</p>	<p>Pika 2.5., faqe 127-132</p>	<p>E lartë</p>	<p>Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Prrenjës, të marra masa për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, ku të respektohet legjislacioni sektorial në fuqi dhe Plani Rregullues i Bashkisë Prrenjës. Të respektohen parametrat teknikë të ndërtimit lidhur me lartësinë e objekteve si dhe distancat ndërmjet ndërtimeve dhe pronave, kjo për të mundësuar trajtim të barabartë në të ardhmen për secilin subjekt zhvillues, të cilit mund t'i kufizohet e drejta e zhvillimit të pronës për shkak të vendimmarrjeve të gabuara.</p>
10	<p>Nga auditimi për veprimtarinë e kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e paligjshme, rezultuan mangësi në lidhje me aktivitetin e kësaj njësie, e cila për vitet objekt auditimi, në shumicën e rasteve nuk ka aplikuar masën administrative dënim me gjobë për subjektet kundërvajtëse, nuk ka nxjerrë aktet e pezullimit si dhe vendimet e prishjes për këto ndërtime. Nuk disponohej asnjë akt kontrolli për objektet e ndërtuara me leje ndërtimi, si dhe mungonte korrespondenca me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Veprimet e mësipërme, janë në kundërshtim me nenet 4 dhe 5, gjerat a, b, ç, d, f, të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51, “Inspektimi”.</p>	<p>Pika 2.6., faqe 132-135</p>	<p>E lartë</p>	<p>1. Kryeinspektori i IMTV Bashkia Prrenjës, të marrë masa që në të ardhmen, të nxjerrë vendimet e gjobave për të gjitha rastet e konstatimit të ndërtimeve pa leje ose në shkelje të lejes, të kryhet pezullimi i punimeve me aktin përkatës si dhe të nxirren vendimet për prishjen e tyre. 2. IMTV Bashkia Prrenjës, të mbajë akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse, me qëllim zbatimin e ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës, si dhe çdo 3 muaj, të përgatitet në mënyrë periodike informacioni drejtuar IKMT.</p>
11	<p>Në mbështetje të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, neni 15, “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronjat “a” dhe “b”, rikërkohet marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pazbatuara. Bashkia Prrenjës ka detyrimin për zbatimin e tyre si më poshtë vijon: <b>a.</b> Janë lënë 18 Rekomandime për “Masa Organizative”, të cilat janë pranuar nga subjekti, për të cilat rikërkohet zbatimi për 4 masa të zbatuara pjesërisht dhe për 6 masa në proces zbatimi; <b>b.</b> Janë lënë 11 rekomandime në vlerën totale 102,288,902 lekë për “Masa për eliminimin e subjekteve lidhur me llogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore me efekte në të ardhurat e munguara”, të cilat janë pranuar nga subjekti dhe mbeten për t'u zbatuar, pasi deri tani janë zbatuar</p>	<p>Pika 2.7., faqe 135-149</p>	<p>E lartë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë Prrenjës të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 518/18 prot., datë 08.09.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, të hartojë plan pune të veçantë dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	pjesërisht 5 masa, në vlerën 14,540,624 lekë, janë në proces zbatimi 3 masa, në vlerën 61,055,249 lekë dhe janë të pazbatuara 3 masa, në vlerën 26,695,029 lekë;			
12	<p>Nga auditimi i kërkesës së Operatorit Ekonomik “D.B./M.”, Person Fizik, me NUIS L.....K, datë 23.01.2023, protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr. 81, datë 23.01.2023, për përmbushjen e detyrimit kontraktor nga Bashkia Prrrenjas, konkretisht për likuidimin e faturës tatimore me numër serial 53468950 dhe numër rendor 50, datë 15.01.2019, në vlerën 1,100,560 lekë pa TVSh, u konstatua se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shërbimi i kontraktuar është realizuar;</li> <li>2. Dokumentacioni autorizues është i plotë;</li> <li>3. Dokumentacioni vërtetues është i plotë;</li> <li>4. Mungon dokumentacioni i kontabilitetit, i cili ka ardhur si pasojë e ndryshimeve të administratës së Bashkisë Prrrenjas.</li> <li>5. Operatori Ekonomik ka bashkëlidhur ankesës kopje të noterizuara të faturës dhe procesverbalit përkatës;</li> <li>6. Personat përgjegjës nga intervistat e zhvilluara kanë pranuar që shërbimi është kryer dhe kanë nënshkruar rregullisht faturën dhe procesverbalin përkatës.</li> </ol> <p>Bashkia Prrrenjas, pavarësisht se problemet kanë ndodhur gjatë ndryshimit të titullarit, nuk ka zbatuar UMF nr. 30, datë 07.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, nënkapitulli “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”, pika 35, germa a. “Dokumenta autorizues”, germa b. “Dokumenta vërtetues”, duke rrezikuar të përballet me procedura gjyqësore të cilat mund të lindin për këtë rast dhe rrjedhimisht mund të përballet edhe me kamatëvonesat përkatëse, sipas dispozitave të ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”.</p>	Pika 2.8., faqe 149-152	E lartë	Nga Bashkia Prrrenjas duhet të kontabilizohet detyrimi ndaj subjektit “D.B./ M.2012” person fizik, me NUIS L....K, si dhe të vazhdohet me shlyerjen e plotë të tij, sipas mundësive financiare të Bashkisë Prrrenjas.
13	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion rrjeti shpërndarës i ujësjellësit Prrrenjas”, me vlerë 213,998,884.34 lekë me TVSH, fituar nga OE “C.” ShPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera për zërat e punëve: “Furnizimi dhe instalimi i pusetës së shkarkimit të dhomës së klonimit duke përfshirë furnizimin dhe instalimin e tubacioneve dhe materialeve ndihmëse”; “Kit portativ për matje klori” dhe “Furnizimi dhe instalimi i analizatorit të klorit në rrjetin kryesor, duke përfshirë tubacionet ndihmëse, bateritë, transmetuesin dhe kabinën plastike me themele betoni”, në vlerën <b>547,304.39 lekë pa TVSH.</b></p>	Pika 2.4., faqe 83-127	E lartë	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Bashkia Prrrenjas të arkëtojë vlerën <b>184,133.17 lekë pa TVSh</b> nga OE “C.” ShPK për punime të pakryera, parashikuar në kontratën nr. 1075 prot., datë 19.03.2020, me objekt “Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit Prrrenjas”.</li> <li>2. Bashkia Prrrenjas, të marrë masa për të ngritur një grup pune me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin; kolaudatorin e punimeve si dhe Ndërmarrjen e Ujësjetës Kanalizimeve Prrrenjas, në cilësinë e administratorit të investimit,</li> </ol>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1075 prot., datë 19.03.2020, të lidhur ndërmjet Bashkisë Prrenjas dhe OE "C." ShPK.			për të vlerësuar dhe analizuar situatën, bazuar nga fakti i auditimit në terren ku rezultuan pajisje të pavendosura në objekt. Dalja e përgjegjësive, realizimi i zërave të punimeve sipas PZ dhe ST në shumën <b>363,171.22 lekë</b> , të konfirmohet zyrtarisht nga palët, Autoriteti Kontraktor Bashkia Prrenjas, Ndërmarrja e Ujësjetillësit Kanalizimeve Sh.A Prrenjas, Sipërmarrësi i punimeve, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit brenda periudhës së garancisë me datë 25.07.2023. Në rast të kundërt, mosvendosja e pajisjeve në objekt, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga personat përgjegjës.
14	Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt "Rikonstruksion dhe riveshje me asfaltim i pjesëve të dëmtuar të rrugës Lapidari Qukës Shkumbin, Mulliri i Belbës, asfaltimi i rrugës në lagjen e Kryeziut, asfaltimi i rrugës në lagjen e Shytit dhe rikonceptimi i qendrës së fshatit Qukës", me vlerë 95,540,069 lekë me TVSh, fituar nga BOE "M." ShPK & "Sh." ShPK, rezultuan punë të pakryera për zërin e punimeve: "Zëri: 6 (3.353) Mbushje me material shkëmbor pas mureve", në vlerën <b>299,500 lekë pa TVSh</b> . Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3954 prot., datë 24.11.2020 të lidhur ndërmjet Bashkisë Prrenjas dhe BOE "M." ShPK & "Sh." ShPK.	Pika 2.4., faqe 83-127	E lartë	Bashkia Prrenjas të arkëtojë vlerën prej <b>299,500 lekë pa TVSh</b> nga shoqëria BOE "M." ShPK & "Sh." ShPK, për punime të pakryera, sipas kontratës nr. 3954 prot., datë 24.11.2020, me objekt "Rikonstruksion dhe riveshje me asfaltim i pjesëve të dëmtuar të rrugës Lapidari Qukës Shkumbin, Mulliri i Belbës, asfaltimi i rrugës në lagjen e Kryeziut, asfaltimi i rrugës në lagjen e Shytit dhe rikonceptimi i qendrës së fshatit Qukës".
15	Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt "Rikonstruksion i rrugës Qukës Shkumbin-Stroskë", me vlerë 95,540,069 lekë me TVSh, fituar nga BOE "M." ShPK & "Sh." ShPK, rezultuan punë të pakryera për zërin e punimeve: "(An-8/M3). Mbushje me çakëll pas mureve", "(3.183/a). Shtresë zhavorr lumi t=10 cm, për themelin", "(3.653). F.V Tub plastmasi Ø150 mm", "(An-31/M3). Gjeotekstil me gramaturë 180 g/m <sup>2</sup> ", në vlerën <b>218,650 lekë pa TVSh</b> . Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3029 prot., datë 04.11.2022, të lidhur ndërmjet Bashkisë Prrenjas dhe BOE "M." & "Sh.".	Pika 2.4., faqe 83-127	E lartë	Bashkia Prrenjas të arkëtojë vlerën prej <b>218,650 lekë pa TVSh</b> nga shoqëria BOE "M." ShPK & "Sh." ShPK, për punime të pakryera, sipas kontratës nr. 3029 prot., datë 04.11.2022 me objekt "Rikonstruksion i rrugës Qukës Shkumbin-Stroskë".
16	Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt "Rikonstruksioni i rrugës Qukës Skënderbe", me vlerë 43,200,000 lekë me TVSh, fituar nga OE "Sh." ShPK, rezultuan punime të kryera me cilësi të dobët	Pika 2.4., faqe 83-127	E lartë	Bashkia Prrenjas, t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve OE "Sh." ShPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që në objekt të realizohen punimet të cilat

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	për shtresat asfaltike në vlerën <b>260,610 lekë pa TVSh</b> . Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3273 prot., datë 07.12.2021, të lidhur ndërmjet Bashkisë Prrrenjas dhe OE "Sh." ShPK.			i përkasin shumës prej <b>260,610 lekë pa TVSh</b> , brenda periudhës së garancisë (datë 07.07.2023), për të garantuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e rrugës. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Prrrenjas dhe Mbikëqyrësi i punimeve të objektit. Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve.
17	Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt "Rehabilitimi Skemës Ujitëse Radigoz-Stranik-Bërzeshtë", me vlerë 71,120,899.972 lekë me TVSh, fituar nga OE "E.A." ShPK, rezultuan punë të pakryera për zërin e punimeve: "(3.46/1) Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krah, me seksion deri 0.75", në vlerën <b>182,828 lekë pa TVSh</b> . Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3623 prot., datë 03.11.2020, të lidhur ndërmjet Bashkisë Prrrenjas dhe OE "E.A." ShPK.	<i>Pika 2.4., faqe 83-127</i>	E lartë	Bashkia Prrrenjas të arkëtojë vlerën prej <b>182,828 lekë pa TVSh</b> nga shoqëria OE "E.A." ShPK, për punime të pakryera, sipas kontratës me nr. 3623 prot., datë 03.11.2020 me objekt "Rehabilitimi Skemës Ujitëse Radigoz-Stranik-Bërzeshtë".
18	1. Nga auditimi i lejes së ndërtimit për subjektin L.B. dhe E.B., taksa e ndikimit në infrastrukturë është llogaritur gabim. Vlera e TNI-së së llogaritur sipas legjislacionit, duhet të jetë 5,456,784 lekë dhe jo 1,286,014 lekë, sa është llogaritur nga punonjësit e Bashkisë Prrrenjas sipas autorizimit për pagesë lëshuar për subjektin zhvillues. Në llogaritjen e TNI-së është përdorur metoda e gabuar e llogaritjes mbi bazë preventivi, në kundërshtim me Ligjin nr. 95/2018, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore"", i ndryshuar, neni 9, pika 2, pasi llogaritja bëhet mbi bazën e çmimit të shitjes, e cila në paketën fiskale për vitin 2022 është 4% për ambientet për banim dhe 6% për ambientet e dedikuara për biznes. Sipërfaqet e objektit llogariten njëkohësisht me koeficientin e përcaktuar në VKM nr. 168, datë 27.03.2019 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 7.3.2018 të Këshillit të Ministrave", për të nxjerrë vlerën përfundimtare të taksës që duhet të paguajë zhvilluesi. Sa më sipër, konstatohet një diferencë prej 4,170,770 lekë, e pallogaritur në mënyrë të saktë, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Prrrenjas.	<i>Pika 2.6., faqe 132-135</i>	E lartë	1. Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, personit të ngarkuar për llogaritjen e TNI-së për objektet e reja që kanë tipologjinë e mësipërme, taksa të përlllogaritet bazuar në çmimin e shitjes. 2. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa për arkëtimin e vlerës prej 10,047,964 lekë ndaj 2 subjekteve për llogaritje të gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë, nga të cilat 4,170,770 lekë për subjektin L.B. dhe E.B., si dhe 5,877,194 lekë për subjektin M.P..

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>2. Nga auditimi i lejes së ndërtimit për subjektin M.P., Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë është llogaritur gabim.</p> <p>Vlera e TNI-së së llogaritur sipas legjislacionit duhet të jetë 8,056,645 lekë dhe jo 2,179,451 lekë e llogaritur nga punonjësit e Bashkisë Prrrenjas sipas autorizimit për pagesë lëshuar për subjektin zhvillues.</p> <p>Në llogaritjen e TNI-së është përdorur metoda e gabuar e llogaritjes mbi bazë preventivi, në kundërshtim Ligjin nr. 95/2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore””, i ndryshuar, neni 9, pika 2, pasi llogaritja bëhet mbi bazën e çmimit të shitjes, e cila në paketën fiskale për vitin 2022 është 4% për ambientet për banim dhe 6% për ambientet e dedikuara për biznes. Sipërfaqet e objektit llogariten njëkohësisht me koeficientin e përcaktuar në VKM nr. 168, datë 27.03.2019 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 7.3.2018 të Këshillit të Ministrave”, për të nxjerrë vlerën përfundimtare të taksës që duhet të paguajë zhvilluesi.</p> <p>Sa më sipër, konstatohet një diferencë prej 5,877,194 lekë, e pallogaritur në mënyrë të saktë, e cila përbën të ardhur të paarkëtuar për Bashkinë Prrrenjas.</p>			
19	<p>Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion për vitin 2022, u konstatua se janë krijuar detyrime debitore progresive të palikuiduara për subjektet fizike/juridike në vlerën 18,312,760 lekë dhe për taksat dhe tarifave familjare në vlerën 45,078,816 lekë, në total 63,391,576 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Prrrenjas. Mosarkëtimi i detyrimeve për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, përveçse është mospërputhje me detyrën funksionale nga punonjësit e Drejtorisë së Taksave e Tarifave Vendore, njëkohësisht krijon mungesë financiare në treguesit buxhetorë, me pasojë uljen e nivelit të investimeve dhe të shpenzimeve të tjera që njësia vendore ka parashikuar në shërbim të komunitetit. Këto veprime janë në mospërputhje me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 4, 26, 32 dhe 34; Ligjin nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XI, “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore”, nenet 70 dhe 91, Ligjin nr. 10926, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, etj.</p>	Pika 2.2., faqe 51-61	E lartë	Titullari i Bashkisë Prrrenjas dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për arkëtimin e detyrimeve të palikuiduara nga debitorët progresivë për vitin 2022, nga mospagesa e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara në paketën fiskale nga subjektet ekonomike që ushtrojnë aktivitet për qëllime biznesi, si dhe nga subjektet familjare, në vlerën totale 63,391,576 lekë.
20	<p>Nga auditimi, u konstatua se është keqmenaxhuar taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale, për qytetarët të cilët përfitojnë</p>	Pika 2.2., faqe 51-	E lartë	Drejtoria e Urbanistikës të përcjellë listën me subjektet debitore për taksën e ndikimit në infrastrukturë, si dhe në



Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit. Për vitin 2022 janë 59 qytetarë debitorë për vlerën 1,790,459 lekë dhe nga vitet e mëparshme deri në vitin 2021 për vlerën 736,441 lekë, në total 2,526,900 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Prrrenjas.	61		vijim Bashkia Prrrenjas të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë prej 2,526,900 lekë.
21	Nga auditimi, rezultoi se nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Prrrenjas, nuk është përllogaritur dhe aplikuar niveli i penalitetit në masën 0.1%, por jo më shumë se 10% për subjektet të cilat kanë lidhur kontrata qiraje me bashkinë dhe janë debitorë në Bashkinë Prrrenjas, nga ku detyrimi pa penalitet për kontratat e qerasë për të cila nuk është paguar detyrimi deri në datën 31.12.2022 rezulton në vlerën 4,566,925 lekë dhe detyrimi me penalitet për kontratat e qerasë për të cilat nuk është paguar deri në datën 31.12.2022, rezulton në vlerën 5,023,618 lekë. Vlera e penalitetit nga kontratat e qerasë për vitin 2022 është 456,693 lekë.	Pika 2.2., faqe 51-61	E lartë	Titullari i Bashkisë Prrrenjas, Drejtoria e të Ardhurave e Drejtoria e Financës të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të përllogaritur sa më saktë nivelin e detyrimit me penalitet për kontratat e qerasë për të cila nuk janë paguar deri në datën 31.12.2022, si dhe mbledhjen e detyrimeve e konsideruar e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Prrrenjas për vlerën 5,023,618 lekë.
22	Nga auditimi u konstatua se në territorin e Bashkisë Prrrenjas kryejnë aktivitet tregtar në fushën minerare subjekte të cilat kanë marrë në përdorim sipërfaqe nga fondi pyjor/kullor. Nga të dhënat e vëna në dispozicion, rezultoi se Bashkia Prrrenjas administron 19 dosje kontratash qeraje të lidhura me subjekte të ndryshme, ku në raportin teknik të vlerësimit (pjesë përbërëse e kontratës) është përllogaritur vlera e qerasë, sipas rastit. Deri në datën 30.12.2022, rezultoi se tarifat e papaguara për Bashkinë Prrrenjas nga moszbatimi i kontratave të qerave, përllogaritet në shumën 20,488,050 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Prrrenjas, nga subjektet të cilat operojnë në shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullorë (karriera).	Pika 2.2., faqe 51-61	E lartë	Titullari i Bashkisë Prrrenjas, Sektori Juridik, Drejtoria e Monitorimit të Pyjeve e Kullorëve dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të kërkuar likuidimin nga subjektet të cilat ushtrojnë aktivitet për qëllime biznesi në fushën e mineraleve, të pajisur me leje minerare brenda territorit të Bashkisë Prrrenjas, për detyrimin e qirasë së papaguar nga kontratat e lidhura për sipërfaqen në përdorim nga fondi pyjor/kullor, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Prrrenjas në vlerën 20,488,050 lekë, si dhe të verifikojnë në terren dhe të administrojnë të gjithë sipërfaqen e fondit pyjor/kullor, sipas të dhënave në regjistrin e AKBN-së.
23	Nga informacioni dhe dokumentacioni i disponueshëm në Bashkinë Prrrenjas, u konstatua se ushtrojnë aktivitet me autorizim për tregëtimin e lëndëve djegëse me pakicë 4 subjekte. Nga mospagesa e plotë e tarifave nga tre subjekte është krijuar një efekt financiar negativ në vlerën 2,221,083 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Prrrenjas, në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.	Pika 2.2., faqe 51-61	E lartë	Titullari i Bashkisë Prrrenjas dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për mbledhjen e detyrimeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa paguar plotësisht tarifën për pajisjen me autorizimin e tregëtimin të hidrokarbureve, për vlerën totale 2,221,083 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar në buxhetin e Bashkisë Prrrenjas.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
24	<p>Bashkia Prrenjas nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke moshartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Për periudhën objekt auditimi, nuk ka takime të dokumentuara të GMS, nuk janë hartuar dhe miratuar gjurmët standarde të auditimit, nuk është hartuar lista (harta)/manuali i proceseve të punës, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar edhe programe trajnimesh në njësinë vendore për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit; Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se 5 vjet, plane dhe raporte vjetore mbi problematikat e hasura dhe zgjidhjen që iu është dhënë gjatë veprimtarisë së njësisë publike. Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, 20, 21, 22, nenin 32 të ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, etj.</p>	<p>Pika 2.1., faqe 31-51</p>	<p>E mesme</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kryetari i Bashkisë Prrenjas, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen nga menaxhimi dhe nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, të rritjes dhe forcimit të aktivitetit GMS, të koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut, të hartojë dhe të miratojë gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe monitorimit në bashki.</li> <li>2. GMS të marrë masa për hartimin dhe miratimin e planit strategjik dhe planit vjetor për aktivitetet dhe çështjet që duhet të analizojë dhe grafikun e takimeve që do realizojë, për hartimin e raporteve vjetore, si një rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie, për të arritur objektivat institucionale në shërbim të komunitetit.</li> <li>3. Nëpunësi Autorizues, Nëpunësi Zbatues dhe GMS të marrin masa për miratimin e një strategjie për menaxhimin e risqeve dhe masave konkrete për minimizimin e tyre për aktivet afatgjata, miratimin e një rregulloreje me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e aktiveve afatgjata të njësisë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të akteve ligjore në fuqi.</li> <li>4. Drejtoria Ligjore, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore, të marrë masa për të hartuar programe trajnime për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë, të plotësojë dosjet e personelit sipas kërkesave ligjore/nënligjore, të kontribuojë në krijimin e një strukture organizative/organigramën e saj sa më efektive, plotësimin me personel të saj, për të rritur efektivitetin e</li> </ol>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
				shërbimeve dhe funksioneve që i atribuon ligji në dobi të komunitetit.
25	<p>Nga auditimi mbi vlerësimin e aktivitetit të Njesisë së auditimit të brendshëm në Bashkinë Prrenjas u konstatua se:</p> <p><b>1.</b> Bashkia Prrenjas ka krijuar NJAB, e cila e ushtron funksionin e vet me dy auditues (1 përgjegjës dhe 1 auditues) në strukturën organizative të saj dhe me një vend vakant, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, “Mbi auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, pika 3, “Manualin e procedurave të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, VKM-në nr. 83 datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, pikat 3 dhe 6, si dhe Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Prrenjas “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Prrenjas dhe institucioneve në varësi, bazuar në numrin maksimal dhe kategorinë e pagave të miratuara nga Këshilli Bashkiak për vitin 2022”, miratuar edhe me Vendim të Këshillit Bashkiak;</p> <p><b>2.</b> Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se NJAB nuk ka realizuar numrin e auditimeve të planifikuara në planet strategjike dhe vjetorë për 2 vite radhazi (2020 dhe 2021), ndërsa për vitin 2022 ka ndryshim të planit fillestar; Gjithashtu rezultoi se në planifikimin e misioneve audituese strategjike dhe vjetorë, nuk është respektuar raporti 60% me 40% mes sistemeve/fushave me risk të lartë dhe sistemeve/fushave me risk të mesëm/ulët, në moszbatim të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe “Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, Kapitulli III, paragrafi 3, pikat 1.6; 1.7; 3.2; 3.4; 3.5.</p> <p><b>3.</b> Nga auditimi mbi rekomandimet e lëna nga NJAB në misionet audituese të realizuara në 3 vitet e fundit, rezulton se numri i tyre vjen në rritje dhe ai i atyre të zbatuara në rënie; ndërsa rekomandimet e shprehura në vlerë mbeten në statusin “pa zbatuar”.</p> <p><b>4.</b> Nga verifikimet e dokumentacionit, analiza e informacionit të pasqyruar në tabela si dhe auditimi i raporteve vjetore të hartuara dhe të miratuara, që NJAB ka dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm rezultoi se: numri i auditimeve të planifikuara për periudhën nën auditim vjen në rënie; nuk është realizuar numri i auditimeve të planifikuara për vitet 2020 e 2021; nuk janë përfshirë në planet strategjike dhe ato vjetore të gjitha njësitë e strukturës së bashkisë me referim koeficientin e riskut, ku ato me risk të lartë auditohen çdo vit, me</p>	Pika 2.1., faqe 31-51	E mesme	<p>1. Kryetari i Bashkisë Prrenjas, të marrë masa për plotësimin e Njesisë së auditimit të brendshëm me 3 auditues, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin, VKM-ve dhe Manualeve, për të përmbushur misionin e saj në arritjen e objektivave.</p> <p>2. Njësia e auditimit të brendshëm të bëjë një vlerësim real të koeficientit të riskut për fushat/sistemet objekt i misioneve audituese, për të përfshirë në planet strategjike dhe vjetorë sektorët e fushave me risk, siç janë: zbatimimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, etj., duke respektuar raportin 60/40 mes sistemeve/fushave me koeficient të lartë risku ndaj atyre me koeficient të mesëm/ulët risku në hartimin e planeve strategjike e vjetorë të njësisë.</p> <p>3. Njësia e auditimit të brendshëm, të ndjekë me korrektësi çdo fazë të misionit auditues, duke e plotësuar me praktikën dokumentare përkatëse. Pas dërgimit të Raportit Përfundimtar në subjektin e audituar, t’i kërkojë menaxherit të tij të reagojë në lidhje me rekomandimet e lëna dhe të raportojë periodikisht Njësinë e auditimit të brendshëm sipas afateve të përcaktuara në planin e veprimit.</p> <p>4. Drejtuesi i Njesisë së auditimit të brendshëm duhet të krijojë dhe mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të rekomanduara për t’ia përcjellë menaxhimit, nëpërmjet raporteve informuese të dhëna mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, sipas Manualit të auditimit të brendshëm.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>risk të mesëm në çdo 3 vjet dhe ato me risk të ulët në çdo 5 vjet, të gjitha këto në moszbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe “Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, Kapitulli III, pika 3.1.2;</p> <p>5. Nga auditimi, rezultoi se dosjet e misioneve audituese kanë mangësi me dokumentet standarde, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe “Manualin e auditimit të brendshëm në sektorin publik”, Kapitulli VI dhe Formatin standard nr. 1;</p> <p>6. Nga ana e subjekteve të audituara nuk janë hartuar planet e veprimit, të cilat i dërgohen NJAB jo më vonë se 30 ditë pune pas dërgimit të Raportit Përfundimtar, duke mospërbushur detyrimin nr. 5 të skemës finale të auditimit, në moszbatim të kreut 4.1.12, hapi 11 të “Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”;</p> <p>7. Njësia e auditimit të brendshëm nuk ka ndjekur hapat e procesit të monitorimit, për zbatimin e rekomandimeve nga ana e subjekteve të audituara brenda afateve të përcaktuara, në moszbatim kjo të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe “Manualit për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, Kapitulli 4.1, pikat 13/1, 2, 3; Por nga ana e saj, NJAB në moszbatim të kësaj procedure, ka planifikuar dy misione audituese “për zbatimin e rekomandimeve të lëna në subjektet e audituara” dhe “zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH”, duke mos përdorur me efikasitet burimet (njerëzore, financiare dhe kohën) për ushtrimin e aktivitetit të saj në ato njësi të paaudituar, të audituara shumë herët apo asnjëherë, në mos zbatim të përcaktimeve në kreun 4.1.13.1 dhe 2 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit” paragrafi 3 dhe “Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve”, paragrafi 4, të “Manualit për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Përgjegjësi për mosraportim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga misioni auditues i NJAB, kanë edhe subjektet e audituara, në moszbatim të kreut 4.1.13.3 “Përgjegjësitë e njësive për të zbatuar rekomandimet e auditimit të brendshëm”.</p>			

### 3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

#### **I. Opinion i Modifikuar (Kualifikuar) mbi Pasqyrat Financiare:**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të Bashkisë Prrenjas, për periudhën ushtrimore 01.01.2022-31.12.2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në to, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të **modifikuar/kualifikuar** për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Prrenjas, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2022, të shprehura në bazën për opinion (trajtuar më poshtë).

#### **Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:**

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik” apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000 “Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare, Udhëzues për SAI-n”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të kualifikuar të auditimit. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2022 ka marrë në konsideratë vlerën e precizionit **15,615,225** lekë për shpenzimet dhe **14,437,879** lekë për të ardhurat, sipas Aneksit PF3, bashkëlidhur.

#### **Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:**

**1.** Gjendja e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene”, në datën 31.12.2022, paraqitet në vlerën 4,918,360 lekë, e pandryshuar nga viti ushtrimor paraardhës. Nga Bashkia Prrenjas nuk është marrë asnjë masë për të inventarizuar, kontabilizuar dhe regjistruar në kadastër tokat, trojet dhe terrenet të cilat i janë transferuar me VKM-të përkatëse ish-komunave, në kuadër të inventarizimit dhe transferimit të pasurive publike. Për sa më sipër, llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene”, në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë.

**2.** Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 22,928,105 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 24,118,659 lekë, me një shtesë në vlerën 1,190,554 lekë. Në analizën e kësaj llogarie janë paraqitur edhe disa zëra, të cilët i përkasin llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 6,701,384 lekë dhe disa zëra, të cilët i përkasin llogarisë 218 “Inventar ekonomik”, në vlerën 6,969,028 lekë. Për sa më sipër, llogaria 211 “Pyje kullota plantacione” në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë dhe është mbivlerësuar për shumën 13,670,412 lekë.

**3.** Gjendja e llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione”, në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 599,502,327 lekë, e pandryshuar nga viti ushtrimor paraardhës. Në analitikun e kësaj llogarie, u konstatua se vlera është 637,614,096 lekë. Nga Bashkia Prrenjas nuk është marrë asnjë masë për të inventarizuar, kontabilizuar dhe regjistruar në kadastër ndërtimet dhe konstruksionet të cilat i janë transferuar me VKM-të përkatëse ish-komunave, në kuadër të inventarizimit dhe transferimit të pasurive publike. Për sa më sipër, llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”, në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë.

4. Gjendja e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 962,639,497 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 916,482,044 lekë, me një pakësim në vlerën 46,157,453 lekë. Në analizën e kësaj llogarie janë paraqitur edhe disa zëra, të cilët i përkasin llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*”, në vlerën 6,701,384 lekë. Gjithashtu, u konstatua se në llogarinë 213 “*Rrugë, rrjete vepra ujore*”, ka 40 zëra asetesh, në vlerën totale 717,837,015 lekë, të cilat duhet të kalojnë në administrim të shoqërive aksionare përkatëse për furnizimin me ujë të pijshëm. Nga Bashkia Prrenjas nuk është marrë asnjë masë për të inventarizuar, kontabilizuar dhe regjistruar në kadastër rrugët, rrjetet dhe veprat ujore të cilat i janë transferuar me VKM-të përkatëse ish-komunave, në kuadër të inventarizimit dhe transferimit të pasurive publike. Për sa më sipër, llogaria 213 “*Rrugë, rrjete vepra ujore*” në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë dhe është e mbivlerësuar për shumën 10,064,005 lekë.

5. Gjendja e llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 14,099,639 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 10,168,721 lekë, me një pakësim në vlerën 3,930,918 lekë nga amortizimi dhe nxjerrjet jashtë përdorimit. Shtesat në këtë llogari kanë qenë 124,480 lekë, të cilat paraqesin vlerën e investimeve të kryera për instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës. Nga Bashkia Prrenjas, për këtë llogari nuk disponohet analizë dhe një pjesë e zërave përkatës të kësaj llogarie janë kontabilizuar gabim në llogarinë 215 “*Mjete transporti*”, duke e nënvlerësuar këtë llogari për vlerën 23,827,196 lekë. Për sa më sipër, llogaria 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*”, në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë dhe është e nënvlerësuar për shumën 23,827,196 lekë.

6. Gjendja e llogarisë 215 “*Mjete transporti*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 54,196,396 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 45,266,396 lekë, me një pakësim në vlerën 10,310,000 lekë. Në analizën e kësaj llogarie janë paraqitur edhe disa zëra, të cilët i përkasin llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*”, në vlerën 23,827,196 lekë, të cilat nuk janë mjete transporti, por makineri. Për sa më sipër, llogaria 215 “*Mjete transporti*”, në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë dhe është e mbivlerësuar për shumën 23,827,196 lekë.

7. Nga auditimi dhe testimi i Aktiveve Afatgjata Materiale, u konstatua se në regjistrat/librat e kontabilitetit të këtyre llogarive, për një pjesë të konsiderueshme të zërave nuk është pasqyruar vlera fillestare e aktiveve, por vetëm vlera e shpenzimeve të mëpasshme, për rikonstruksione ose përmirësimin e gjendjes së këtyre aktiveve. Kryesisht, kjo ka ndodhur për shkak se shumica e këtyre AAM nuk është pajisur me titull pronësie dhe ende nuk janë në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. Gjithashtu, paraqiten problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshtkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar e amortizimit, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar e shpenzimeve të mirëmbajtjes, data e daljes nga pronësia, etj. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivitetit nuk përbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Këto llogari janë mbajtur në bilancin kontabël pa pasur një analizë të detajuar, ku të përcaktohet origjina e vlerës së asetëve. Nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës disponohet informacion vetëm për shtesat vjetore të llogarive 210, 211, 212, 213, 214 dhe 215. Gjithashtu, fakti që nuk ka një regjistër konlabël për AAM, e vështirëson më tej njohjen dhe verifikimin e saktësisë së vlerave kontabël të këtyre llogarive.

## **II. Opinion i Modifikuar (Kualifikuar) për përputhshmërinë:**

Në audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Prrenjas, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Bashkisë Prrenjas, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës për periudhën 01.01.2018-31.12.2022.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Prrenjas, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin “*Baza për Opinionin*”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar për përputhshmërinë.

### **Baza për opinionin mbi përputhshmërinë:**

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë, (ISSAI 400 & ISSAI 4000) si më poshtë:

1. Nga auditimi, u konstatua se në përcaktimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike për kualifikim, nga 36 procedura të audituara, në 16 raste kishte anomali në hartimin e kriterëve të veçanta të DT në procedurat e prokurimit publik, pasi janë vendosur kriterë të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me natyrën dhe madhësinë e kontratës dhe në shpalljen fitues të operatorëve ekonomikë, 13 raste nuk ishin në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve për kualifikim, të cilat nën gjykimin e audituesve nuk janë të përhapura.

2. Nga auditimi, u konstatua se në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, kishte mangësi në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë, e cila për 2 objekte është llogaritur gabim në vlerën totale 10,047 mijë lekë.

### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Prrenjas:**

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të Njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe këto çështje përshkruhen në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## **II. HYRJE**

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1173/1, datë 09.01.2023 “*Auditim financiar dhe Përputhshmërie në Bashkinë Prrenjas*”, i ndryshuar me shkresën nr. 1173/2, datë 28.02.2023, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin “*Bashkia Prrenjas*”, nga data 09.01.2023 deri në datën 10.03.2023, u krye “*Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë*”, për periudhën nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022 për auditimin financiar dhe nga data 01.01.2018 deri në datën 31.12.2022 për auditimin e përputhshmërisë nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. J.P., *Përgjegjës Grupi*;
2. S.J.;
3. SH.H.;
4. K.F. dhe
5. S.M., *anëtarë*.

### **1. Objekti i Auditimit**

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2022, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me veprimtarinë e subjektit.

### **2. Qëllimi i auditimit**

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve. Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

### **3. Identifikimi i çështjes**

Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Prrenjas, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

### **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Kryetari i Bashkisë, z. N.B., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj. S.K., Drejtore e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për Vetëqeverisjen Vendore*”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, etj.

### **5. Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit



sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar. Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohet bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo legjislacioni financiar, tatimor dhe vendor në fuqi, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, ankesat, etj.).
- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, si dhe rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor. Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Prrenjas, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

## **6. Kriteret e vlerësimit**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
  - Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:**
- Ligjet përkatëse “Për buxhetin vjetor” dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje.
  - Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”
  - Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Per pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar;
  - VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”;
  - Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 35, datë 5.11.2008 “Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”;
  - Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;
  - UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, etj.;
  - Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;
  - Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022;
  - Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.
  - Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”;
  - Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”,

- Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”,
- Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, dhe pikat 116-117, “Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore”.
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë Financave dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Radiotelevizionit Shqiptar nr. 29, datë 18.12.2014 (Agjenti tatimor OSSHE faqe 4, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive”), Fletore zyrtare 196/2014;

**Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:**

- VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;
- Udhëzimi i MF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj;
- Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

**Në fushën e prokurimeve publike:**

- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, i Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar;
- UMF nr. 57, datë 12.06.2014, “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

**Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:**

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”;
- Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar
- VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

**Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit:**

- Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;

- Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”;
- Ligji nr. 107-2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- VKM nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve të ndërtimit”;
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e përditësuar;
- VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”;
- Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me gira të tokave bujqësore të pandara” dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

**Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:**

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152-2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë”, i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”;
- Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLS-së”;
- Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.
- Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;
- Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

**7. Standardet e auditimit**

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”;
- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

**8. Metodatat e auditimit**

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është

metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Pështetë specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

#### Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin:

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

#### ▪ Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

#### ▪ Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.

#### ▪ Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

#### ▪ Kontrolli i vlerësimeve

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

#### ▪ Konfirmimi nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtuar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

#### ▪ Kontrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", të cilat përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

#### ▪ Intervista

#### ▪ Raportet dhe Informacionet

#### ▪ Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK

### 9. Dokumentimi i auditimit

Mbi bazën e Pyetësorëve dhe Testeve përkatëse të miratuara në manualin e auditimit financiar

dhe përputhshmërisë, nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u hartuan Akt-Konstatimet dhe Akt-Verifikimet, si dhe pas shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili është materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Opinionit të Audituesit të Jashtëm Publik. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u morrën në konsideratë parimet e mëposhtme të auditimit financiar:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë;
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre;
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

▪ **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim**

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

▪ **Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivët, pasivët dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

▪ **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

#### 1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Prrenjas

##### Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

**Zona Gjeografike:** Prrenjasi kufizohet në veri me Bashkinë Librazhd, në lindje me Republikën e Maqedonisë, në jug me Bashkinë Pogradec dhe në perëndim me Bashkinë Elbasan. Kryeqendra e Bashkisë Prrenjas është qyteti i Prrenjasit.

**Popullsia:** Sipas Censurit të vitit 2011, Përrenjasi ka një popullsi prej 24,906 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki ka 33,031 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 322.95 km<sup>2</sup>. Sipas censurit, densiteti i popullsisë është 77 banorë/km<sup>2</sup> ndërsa sipas regjistrimit civil densiteti është 102.279 banorë/km<sup>2</sup>.

**Të dhëna të tjera:** Bashkia e re e Prrenjasit përfshin sipërfaqe të shumta pyjore dhe burime të bollshme hidrike si dhe një fushë pjellore. Nëntoka është e pasur me krom, ndërkohë që ky mineral shfrytëzohet aktualisht në dy prej fshatrave të bashkisë së re.



Zonat e Rrajcës, Qukësit dhe Stravajt kanë sipërfaqen më të madhe të pyjeve në këtë zonë. Megjithatë, shfrytëzimi pa kriter gjatë dy dekadave të fundit i ka dëmtuar pyjet në një masë të gjerë.

Bashkia e re e Prrenjasit ka një pozicion të favorshëm gjeografik, pasi gjendet fare pranë dy pikave doganore me Maqedoninë. Përgjatë tranzicionit, në këtë zonë kanë munguar strategjitë e zhvillimit. E megjithatë, emigracioni në zonën e Prrenjasit nuk ka qenë i lartë. Kjo pasi shumë banorë të zonës kanë zgjedhur punësimin sezonal në Maqedoninë fqinje, me të ardhurat e të cilëve mbijeton një pjesë e mirë e popullatës.

Bashkia e Prrenjasit ka potenciale të pashfrytëzuara për turizëm natyror. Me historinë e pasur të zonës së Rrajcës, ku ndodhet shkëmbi i Skënderbeut dhe legjenda për Sofrën e tij si dhe me bukuritë natyrore të Sopotit, zona mund të kthehej në një destinacion për vizitorë vendas dhe të huaj.<sup>1</sup>

##### Forma dhe mënyra e organizimit:

Struktura organizative aktuale është miratuar me VKB nr. 69 datë 30.12.2021 dhe Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 04, datë 20.01.2022, i miratuar nga Prefekti Elbasan me shkresën nr. 1450/1, datë 05.01.2022 dhe ka në përbërje të saj 332 punonjës duke përfshirë edhe funksionet e deleguara.

##### Njësitë Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat

Emri i Njësitë	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
<b>Prrenjas</b>	Qyteti: Prrenjas, Fshatrat: Prrenjas-Fshat, Rrashtan
<b>Qukës</b>	Fshatrat: Qukës Shkumbin, Qukës Skënderbej, Skroskë, Mënik, Gurrë, Bërzeshhtë, Fanjë, Karkavec, Dritaj, Pishkash, Pishkash Veri
<b>Rrajcë</b>	Fshatrat: Rrajcë, Sutaj, Skënderbej, Bardhaj, Katjel, Kotodesh, Urakë
<b>Stravaj</b>	Fshatrat: Stravaj, Stranik, Farret, Shqiponjë, Sopot

##### Kuadri ligjor:

Bashkia Prrenjas e ushtron aktivitetin e saj mbështetur në dispozitat ligjore/nënligjore për secilën fushë të aktivitetit të saj, të cilat janë të specifikuara në programin e auditimit dhe në aneksin bashkëlidhur.

Kryetar i Bashkisë Prrenjas është z. N.B. dhe Këshilli Bashkiak i Prrenjasit përbëhet nga 31 anëtarë, të cilët janë mandatuar në shtator 2019.

<sup>1</sup> Burimi: <https://portavendore.al/bashkia-prrenjas/pasaporta-e-bashkise-prrenjas/>

## **2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit**

### **2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik**

#### ***2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.***

Bazuar në misionin e vetëqeverisjes vendore “për të siguruar qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve” nëpërmjet zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore; realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative; për të rritur cilësinë e jetës si dhe shtuar aktivitetet për t’i shërbyer popullsisë së Bashkisë Prrenjas; referuar dhe Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010, kreu III “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, neni 19, Bashkia Prrenjas, për çdo vit ka përgatitur “Deklaratën dhe pyetësonin e vetëvlerësimit” dhe i ka dërguar në MFE/Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar/Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit, për vitin 2021 me shkresën nr. 679 prot., datë 25.02.2022; për vitin 2022 me shkresën nr. 576 datë 23.02.2023. Më poshtë po i analizojmë në mënyrë të detajuar, duke përcaktuar mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

#### **1. Mjedisi i Kontrollit:**

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxherial dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve. Referuar nenit 20 të Ligjit nr. 10296 “Menaxhimi financiar dhe kontrolli”, titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit. Nga auditimi u konstatua se, bazuar në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, Kreu II, neni 8, pika 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”; neni 9, pika 4/a “Përgjegjshmëria menaxheriale e Nëpunësit autorizues”, në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu IV “Zbatimi i MFK”, pikat 4, 2, 10/a “Roli i nëpunësit autorizues të njësisë”, rezulton se janë hartuar/miratuar: “Plani i përgjithshëm vendor”, me fokus Strategjia e zhvillimit vendor, Analiza & Vlerësimi i territorit, Parashikimet e planit, Vlerësimi strategjik mjedisor, Materiali hartografik si dhe “Rregullore e planit vendor”, të cilat hartohen si bashkëpunim i bashkisë me KKT dhe miratuar me VKB Prrenjas nr. 18 datë 23.03.2017; Gjithashtu, Bashkia Prrenjas ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e zhvillimit vendor, ku paraqiten synimet kryesore për çdo fushë përgjegjësie dhe identifikohen veprimet që njësia duhet të ndërmarrë për realizimin e tyre, duke parashikuar edhe kostot përkatëse, në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu VI, neni 32 pika 2/a, b, c.

Plani i përgjithshëm vendor përmban: objektivat strategjikë dhe rregullat e zhvillimit me instrumentet për zbatueshmërinë e tyre për periudhën 2017<sup>2</sup> e në vazhdim; për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të territorit, respektim dhe mbrojtje të tokës me vlera natyrore, bujqësore, kulturore, të krijojnë vende pune, të nxisin zhvillimin ekonomik dhe, me përdorimin e kujdesshëm të instrumenteve financiare, të sigurojnë të ardhura të drejtpërdrejta dhe përfitime për projekte investimi publik në nivel vendor.

### **1.1. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues:**

Bashkia Prrenjas ushtron funksionet e veta me Rregulloren e brendshme “*Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe procedurat për zbatimin e kompetencave vendore në administratën dhe njësitë administrative të Bashkisë Prrenjas*”, hartimi dhe miratimi i të cilës është mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” neni 9 pika 1/1 germa b, në Ligjin nr. 7961 datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit Bashkiak të çdo viti “*Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të bashkisë, institucioneve në varësi dhe njësite administrative*” si dhe në Vendimin e Kryetarit “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Prrenjas*”. Kjo Rregullore është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 52 datë 24.05.2022 dhe nr. 4346 prot., datë 24.05.2022, e cila i përket Strukturës organizative miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 04 datë 20.01.2022 “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Prrenjas për vitin 2022*” me nr. 150 prot., datë 20.01.2022. Ndërsa Këshilli Bashkiak ka miratuar numrin e përgjithshëm të punonjësve: për vitin 2020 me VKB nr. 13, datë 26.12.2019, me nr. 57 prot., datë 07.01.2020 “*Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Prrenjas për vitin 2020*”; për vitin 2021 me VKB nr. 108, datë 30.12.2020, me nr. 34 prot., datë 06.01.2021; për vitin 2022 me VKB nr. 69 datë 30.12.2021 dhe me nr. 85 prot., datë 30.12.2021. Për periudhën nën auditim e në vijim, ndryshimet në strukturën organizative të miratuara me VKB, janë konfirmuar edhe nga Prefekti i Qarkut Elbasan, si dhe janë pasqyruar në Rregulloren e brendshme të njësisë.

Mbi respektimin e etikës nga punonjësit e institucionit, Bashkia Prrenjas ka hartuar dhe miratuar me Urdhër të Kryetarit nr. 134 datë 17.02.2022 “*Kodin e etikës së Bashkisë Prrenjas*” dhe me nr. 554 prot., datë 17.02.2022; me Urdhër nr. 292 datë 12.05.2022 dhe nr. 1415 prot., datë 12.05.2022 “*Për zbatimin e parimeve të etikës gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike*”; konform Ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003 “*Për rregullat e etikës në administratën publike*”, Ligjit nr. 139/2015 “*Për Vetëqeverisjen Vendore*”, neni 9, pika 1/1 germa ‘b’, VKM nr. 306 datë 13.06.2000 “*Për disiplinën në shërbimin civil*”;

Bashkia Prrenjas ka hartuar dhe miratuar “*Rregulloren e posaçme për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike*” me nr. 1612 prot., datë 24.01.2022, konform Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*” i ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” neni 9, pika 1/1 germa b, neni 46; Ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*” i ndryshuar. Kjo Rregullore përcakton rastet e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejta ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike dhe ka si qëllim parandalimin e tyre.

“*Kodi i etikës*” dhe “*Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesit*” përcaktojnë rregullat e sjelljes së nëpunësve të administratës publike, sipas standardeve të kërkuara, i ndihmon ata për arritjen e këtyre standardeve si dhe vë në dijeni publikun për sjelljen që duhet të ketë

<sup>2</sup> Në vitin 2017 u miratua PPV i Bashkisë Prrenjas për periudhën 2017-2030



nëpunësi i administratës publike. Kjo ndikon në mbarëvajtjen e funksionimit të institucionit, duke mos lejuar cenimin e aktivitetit të tij në çdo aspekt.

## **1.2. Politika menaxheriale dhe stili i punës:**

Punësimi në Bashkinë Prrenjas bëhet në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 152/2013 “Për nënpunësin civil”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 243/2015 i ndryshuar me VKM nr. 746/2018 Kreu I pikat 1 dhe 2. Kjo procedurë rregullohet nga Strukturat e Bashkisë Prrenjas:

- Drejtoria ligjore, e prokurimeve dhe burimeve njerëzore është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit nr. 152/2013 “Për nënpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM nr. 243/2015 i ndryshuar Kreu II;
- Komiteti i Përhershëm i Pranimit në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr. 243/2015 i ndryshuar;
- Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pikat e, ë, f dhe g të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Për vitin 2020, Komiteti i përhershëm i pranimit në Bashkinë Prrenjas është ngritur me Urdhërin e Kryetarit nr. 27 datë 06.02.2020 me nr. 451 prot., datë 06.02.2020; Urdhërin nr. 213 datë 29.06.2020 me nr. 2171 prot., datë 29.06.2020; Urdhërin nr. 214 datë 29.06.2020 dhe me nr. 2172 prot., datë 29.06.2020; për vitin 2021 është ngritur me Urdhërin nr. 45 datë 09.03.2021 me nr. 712 prot., datë 09.03.2021; për vitin 2022 është ngritur me Urdhërin nr. 549 datë 13.10.2022 me nr. 2820 prot., datë 13.10.2022, konform VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar me VKM nr. 746/2018, Kreu III pikat 2 dhe 3.

Struktura përgjegjëse e bashkisë harton në fillim të çdo viti “Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” në zbatim të Ligjit nr. 152/2015 “Për nënpunësin civil” neni 18 dhe 69, VKM nr. 108/2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, si edhe të atyre me kontratë pune konform Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKB “Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyre” si dhe Vendimeve të Kryetarit “Për miratimin e strukturave organizative të Bashkisë Prrenjas”. Nga verifikimi i dokumentacionit që iu vu në dispozicion grupit të auditimit, rezultoi se për vitin 2022 struktura organizative është miratuar me Vendim të Kryetarit të bashkisë nr. 04 datë 20.01.2022 dhe nr. 130 prot., datë 20.01.2022; gjithashtu është hartuar Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil, i cili bazohet mbi nevojat e institucionit për vitin e ri ushtrimor, duke detajuar emërtimin e pozicionit dhe të njësive përbërëse në strukturë. Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil për vitin 2022 në Bashkinë Prrenjas është miratuar me VKB nr. 36 datë 04.05.2022 dhe nr. 1438 prot., datë 13.05.2022 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan nr. 616/1 datë 18.05.2022. Publikimi i vendeve vakante nga ana e Bashkisë Prrenjas, bëhet në faqen zyrtare të saj<sup>3</sup> si dhe në Portalin Kombëtar të Punësimit të Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, konform Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 19, pika 1, 2; VKM nr. 108/2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” pika 13; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar Kreu II, pika 6.

**Konstatim:** Bashkia Prrenjas ka miratuar me VKB “Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2022” në tejkallim të afateve, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 152/2015 “Për nënpunësin civil”, neni 18; VKM nr. 108/2014 pika 11; Përshkrimi i punës të çdo pozicioni si dhe kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët, duhet të jenë të përshkruara në Formularin e përshkrimit të pozicionit të punës. Ato janë pjesë e rëndësishme e politikave dhe praktikave

<sup>3</sup> Trajtuar edhe te Komponenti 3 i MFK “Aktivitetet e Kontrollit”

që lidhen me burimet njerëzore. Si të tilla, politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë kriteret dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit. Për këto arsye, kriteret duhet të jenë pjesë në Rregulloren e brendshme të bashkisë, neni “Përshkrimet e punës” si dhe e dosjes së personelit. Drejtoria Ligjore, e Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore nga ana e saj pasi harton planin vjetor të punësimit, ndjek procedurën nga shpallja e njoftimit deri në përfundimin e saj, praktikë e cila në përfundim bëhet pjesë e dosjes së personelit; Kjo procedurë realizohet në zbatim të përcaktimit ligjor në fuqi, Ligjit nr. 152/2015 “Për nënpunësin civil”, i ndryshuar; Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM nr. 108/2014 “Për planin vjetor të pranimin në shërbimin civil”; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar. Gjithashtu, Drejtoria Ligjore, e Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore harton Formularët e përshkrimit të pozicionit të punës të çdo pozicioni në strukturë sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 152/2013 “Për nënpunësin civil” i ndryshuar, Ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, miratohet nga Departamenti i Administratës Publike, duke e bërë pjesë të dosjes, në zbatim të VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar. Ky formular është pjesë përbërëse e manualit të procedurave të njësisë publike. Duke qenë se Bashkia Prrrenjas funksionon me Rregullore të Brendshme të përditësuar, në përputhje me strukturën e re të miratuar me Vendim të Kryetarit nr. 04 datë 20.01.2022, ka në përbërjen e saj përshkrimet e punës: kompetencat, funksionet dhe të drejtat e çdo njësie e pozicioni të strukturës organizative, kriteret e veçanta për çdo pozicion etj.

**Konstatim:** Nga auditimi rezultoi se “Formularët e përshkrimit të pozicioneve të punës” nuk janë bërë pjesë e dosjes së personelit, apo shtojcë në Kontratën e punës për ata punonjës që marrëdhëniet e punës me bashkinë iu rregullohen me Ligjin nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në kundërshtim kjo me VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

- Në Bashkinë Prrrenjas struktura organizative ka pësuar ndryshime, të cilat janë miratuar me Vendim të Kryetarit së Bashkisë, pasqyruar edhe në Rregulloren e brendshme të funksionimit të saj. Drejtoria ligjore, e prokurimeve dhe burimeve njerëzore si struktura përgjegjëse për personelin, harton çdo fillim viti Planin vjetor të pranimin në shërbimin civil për Bashkinë Prrrenjas, mbështetur në nevojat që pasqyrohen në Strukturat organizative të çdo viti, të miratuara nga Kryetari i Bashkisë, me emërtimet e pozicioneve përkatëse. Vendimet janë konfirmuar edhe nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

- Për vitin 2022 nga Bashkia Prrrenjas është hartuar dhe miratuar plani vjetor i pranimin në shërbimin civil me vendimin nr. 36 datë 04.05.2022 dhe me nr. 1438 prot., datë 13.05.2022 për 11 vende vakante në fillim të vitit dhe që nga auditimi rezultoi se në fund të vitit 2022 kanë mbetur 7 vende vakante.

- Struktura organizative e Bashkisë Prrrenjas për tre vitet 2020, 2021 dhe 2022 ka përbërjen sipas Aneksit MFK1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Shpërndarja e pozicioneve në strukturën organizative për vitin 2022 sipas ligjit që rregullon marrëdhëniet e punës, është sipas Aneksit MFK2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Nga auditimi i informacionit shkresor të vënë në dispozicion për strukturat organizative të Bashkisë Prrrenjas dhe i planit vjetor për pranimin në shërbimin civil, rezultoi se për periudhën nën auditim, ka patur largime të punonjësve nga puna për arsye të ndryshme. Një pasqyrim më i detajuar i numrit me arsyen e largimeve, është paraqitur në Aneksin MFK3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Numri i përgjithshëm i punonjësve në Bashkinë Prrenjas, referuar strukturave organizative në planifikim është i njëjtë për dy vite të njëpasnjëshme 2021 dhe 2022 prej 332 punonjësish;

- Nga punonjësit e larguar nga puna me motivacion shkarkim me masë disiplinore apo largim nga detyra, për vitin 2022 nuk ka asnjë padi dorëzuar në Komisionerin e Nëpunësit Civil apo në Gjykatë; në proces gjyqësor janë çështjet e punonjësve të larguar nga puna para vitit 2022; Shpërndarja e punonjësve në strukturën organizative sipas njësive përbërëse të saj, është paraqitur në Aneksin MFK4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi rezultoi se 10 punonjës janë me kontratë të përkohshme (punonjës provizorë) dhe 4 punonjës me kohë të pjesshme në Drejtorinë e Shërbimeve Publike/Spektori Mirëmbajtjes së Ujësjellsave;

- Në Bashkinë Prrenjas janë punësuar 18 punonjës në pozicione të ndryshme, nga “grupi i veçantë” në zbatim të Ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”; Ligjit nr. 15/2019 datë 13.03.2019 “Për nxitjen e punësimit”. Klasifikimi dhe numri/gjinia për çdo kategori, paraqitur në Aneksin MFK5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga Bashkia Prrenjas janë dërguar çdo vit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë/Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik/Drejtoria e Harmonizimit dhe Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit në përgjigje të shkresave që kjo e fundit u dërgon bashkive: Pyetësorët e Vetëvlerësimit dhe Deklaratën për Cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2021 me nr. 679 prot., datë dhe 25.02.2021; për vitin 2022 me nr. 576 prot., datë 23.02.2023; Bashkia Prrenjas nuk shpreh qartë mangësitë në aktivitetet e kontrollit, në moszbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

### **1.3. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit:**

Nga auditimi konstatohet se Bashkia Prrenjas funksionon me një strukturë të bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Nga auditimi rezulton se Strukturat Organizative nuk shoqërohen edhe me organigramën përkatëse për t’u miratuar nga Këshilli Bashkiak, por janë miratuar pa to.

- Gjatë periudhës 2 vjeçare 2021 e 2022, struktura organizative e Bashkisë Prrenjas ka pësuar ndryshime nga ajo e mëparshme, të cilat miratohen me Vendim të Këshillit Bashkiak dhe të Kryetarit të Bashkisë, sipas Aneksit MFK6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Një pasqyrim i kompozimit të Strukturës organizative të Bashkisë Prrenjas për vitin 2022, për çdo njësi bazë të miratuara nga Kryetari i Bashkisë, është paraqitur në Aneksin MFK7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Në Vendimet e Kryetarit të Bashkisë Prrenjas janë miratuar Struktura organizative në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8 pika 1. 1/c. Struktura organizative për vitin 2022 është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 04 datë 20.01.2022 dhe me nr. 150 prot., datë 20.01.2022. Strukturat organizative janë shoqëruar me Organigramën përkatëse. Organigrama si një paraqitje grafike e strukturës organizative, pasqyron një informacion të qartë dhe të kuptueshëm për të gjithë, mbi pozicionet, klasifikimin por edhe mbi numrin e personelit të planifikuar dhe atë faktik. Organigrama është një mjet informues dhe administrativ, pasi përfaqëson njësitë e strukturës (departamente, drejtori e sektorët e tyre) shpërndarjen e tyre, kompetencat, funksionet dhe kompetencat, si dhe informacionin në lidhje me atributet relacionale dhe strukturat hierarkike të njësisë publike. Organigrama institucionale, paraqet një informacion statistikor në kohë reale mbi kategoritë e proceseve të punës, por edhe numrin e personelit (faktik apo vakant) që u përket. Përsa më lart në zbatim të “Manualit të MFK-së” të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave, nr. 8980, datë

15.07.2010 dhe atë nr. 108/2016; Ligjin nr. 152/2013 “Për nënpunësin civil”; Ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 21 pika 1,2.

- Referuar Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” mbi funksionet e bashkive, në Aneksin MFK8, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit është paraqitur një pasqyrim se si është kompozuar Struktura e Bashkisë Prrenjas për vitin 2022, në zbatim të funksioneve që i jep ligji.

- Nga verifikimet e dokumentacionit dhe analiza e informacionit të pasqyruar, rezultoi se për funksionin “Mbrotjtja e mjedisit” neni 26, në strukturën e Bashkisë Prrenjas, nuk mbulohet nga një njësi e veçantë, por njësi Inspektoratit Vendor të Mbrotjtjes së Territorit dhe Mjedisit përmban në strukturën e saj 1 “Inspektor mjedisi”, i cili mbulon këtë funksion. Nga auditimi, u konstatua se nga struktura përgjegjëse nuk janë hartuar plane masash parandaluese dhe edukuese në veçanti, për mbrotjtjen e mjedisit. Pra Bashkia Prrenjas në fillim të vitit 2022 e në vijim ka funksionuar me një strukturë që i mbulon të gjitha funksionet për të ofruar shërbimet komunitetit, duke ushtruar kompetencat që i atribuon Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Kreu VII, nenet 23-30.

#### **1.4. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore:**

Bashkia Prrenjas aktivitetin e saj funksional e mbështet në Rregulloren e Brendshme, e miratuar me Vendim të Kryetarit nr. 52 datë 24.05.2022 me nr. 1546 prot., datë 24.05.2022 dhe i përket Strukturës organizative miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 04 datë 20.01.2022 dhe me nr. 150 prot., datë 20.01.2022. “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Prrenjas dhe njësisive në varësi për vitin 2022”. Rregullorja e Brendshme përmban bazën ligjore dhe fushën e zbatimit, strukturën organizative, funksionet menaxheriale, rregulla të përgjithshme, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e çdo njësie dhe pozicioni, të drejtat dhe detyrat e personelit, trajnimet, shkeljet disiplinore, orarin dhe kohën e punës, etj. Bashkia Prrenjas deri më sot nuk disponon “Listën (Hartën) e proceseve/Manualin e Procedurave”, ku të jenë pasqyruar të gjitha proceset e punës dhe “Gjurmet e auditimit” për njësitë kryesore të Strukturës.

#### **1.5. Aftësitë profesionale të punonjësve:**

Për të audituar dosjet e personelit, përzgjedhëm dosjet e të punësuarve për vitet 2021 në aparatin e bashkisë dhe në ndërmarrjet e varësisë për kategoritë: ngritje në detyrë, praninë në shërbimin civil, me Kod pune; si dhe dosjet e punonjësve të larguar nga Bashkia Prrenjas. Emërimet/largimet i janë nënshtruar, Ligjit nr. 152/2013 “Për nënpunësin civil” dhe Ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”.

**Mbi rregullsinë dhe plotësinë e dosjeve të personelit,** kërkua dosjet e punonjësve të emëruar në bashkinë Prrenjas për vitin 2022 për të gjitha kategoritë, lëvizjeve të personelit/ngritjet në detyrë si dhe të punonjësve të larguar të periudhës nën auditim.

**Konstatim:** Nga testimi me zgjedhje i dosjeve të personelit, (kampioni që përzgjedhëm), emëruar/larguar në vitin 2022, rezultoi se përgjithësisht dosjet e personelit përmbanin dokumentacionin përkatës të dosjeve, por u konstatuan:

- Në dosjet e personelit mungonin praktika e plotë e punësimit nga shpallja e pozicionit deri në emërimin e tij; vlerësimi 6 dhe 12 mujor; vërtetimi i prokurorisë dhe gjykatës;

- Dosjet e punonjësve të larguar nuk kishin praktikën e plotë të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nga njoftimi deri në vendimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, përfshirë dhe procesverbalin e dorëzimit të bazës materiale që ka patur punonjësi në ngarkim;

Për të gjitha këto konstatime, nuk janë zbatuar: Ligji nr. 152/2013 i ndryshuar “Për nënpunësin civil” neni 17 pika 1,4; VKM nr. 117, datë 5.3.2014, Lidhja 1 e 2; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar; Ligji nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” Kreu VII, XIV.

*Mbi trajnimin e punonjësve në Bashkinë Prrenjas:* Stafi administrativ ka zhvilluar trajnime sipas programeve të detyrueshëm ofruar nga ASPA pjesë e procedurës për përfitim të statusit të nëpunësit civil. Nga auditimi rezultoi se nga Bashkia Prrenjas, struktura përgjegjëse e saj (DLPBNJ) ka hartuar Plane vjetore trajnimesh për punonjësit e saj, por tematika përbërëse e saj nuk përfshinte të gjithë stafin dhe të gjitha njësitë e strukturës, me qëllim njohja nga ana e tyre me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Manualin për MFK. Kjo pasi nuk ka një studim dhe analizë të mirëfilltë mbi nevojat që ka njëzia. Trajnimi i punonjësve është i nevojshëm për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe për të kuptuar se direktivat e dhëna prej menaxherëve të njësisë kuptohen dhe arrihen nga punonjësit.

Përgjegjësia e menaxhimit në garantimin e profesionalizmit të punonjësve të tij fillon me miratimin e politikave dhe praktikave të duhura që lidhen me burimet njerëzore dhe që reflektojnë angazhimin për:

- Caktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive që kërkohen për çdo pozicion pune;
- Verifikimin e kualifikimeve të kandidatëve për vendet e punës;
- Marrjen në punë dhe ngritjen në detyrë vetëm të atyre personave që kanë njohuritë dhe aftësitë në nivelet më të larta;
- Futjen e programeve të trajnimit që ndihmojnë punonjësit të zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre;
- Kryerjen e analizave periodike për njohuritë dhe aftësitë e kërkuesit për çdo pozicion pune dhe mbështetur në këto analiza, hartimin e planeve periodike për trajnimin e punonjësve;
- Zhvillimin e profesionalizmit menaxherial nëpërmjet trajnimeve dhe marrjes në konsideratë të aftësive menaxhuese gjatë procesit.

**Konstatim:** Nëpunësi Autorizues dhe struktura përgjegjëse e Bashkisë Prrenjas (DLPBNJ), nuk kanë hartuar dhe miratuar plane dhe programe vjetore efektive për trajnimin e detyrueshëm të të gjithë punonjësve, në zgjerimin e njohurive të tyre për proceset e punës dhe të aftësive për t'i kryer me efikasitet ato dhe kryesisht për njohjen nga stafi dhe menaxherët e njësisë mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, në moszbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 64, pika h, Ligjit nr. 10296 /2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kapitulli III, pika 3.1.

## **2. Menaxhimi i riskut:**

**2.1. Regjistri i Riskut:** Grupi i auditimit lidhur me menaxhimin e riskut, kërkoi t'i vihet në dispozicion Regjistri i riskut, ku jepet një pasqyrim i identifikimit të risqeve të çdo njësie të strukturës dhe masat që duhen marrë për parandalimin apo minimizimin e pasojave. Bashkia Prrenjas ka hartuar dhe miratuar Regjistrin e riskut, ku është bërë i mundur identifikimi i risqeve që vijnë nga burime të brendshme dhe atyre që vijnë nga burime të jashtme, në zbatim të Ligjit 10296 datë 08.07.2010, Kreu III, neni 10 ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 si dhe Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

Regjistri i riskut është i bazuar në analizën e riskut të çdo drejtorie dhe ka si Synim “Planifikimin dhe Përdorimin me efikasitet, efikasitet dhe transparencë të fondeve buxhetore në përputhje me misionin e Bashkisë, për arritjen e objektivave”. Ky regjistër përmban përshkrimin e risqeve për çdo drejtori/sector, nivelin e risqeve, kontrollet ekzistuese, veprimet e ndërmarra për të adresuar risqet, zotëruesi i riskut si dhe situatën e riskut pas detyrës së fundit, si dhe mënyrën apo rrugëzgjdhjen e situatës në rastin e ndodhjes apo konstatimit të dukurisë.

- Bashkia Prrenjas ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik, por nga auditimi rezultoi se nuk ka takime të dokumentuara të aktivitetit të tij, që tregon për mosfunksionim të tij në zbatim të përcaktimeve në Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu II, neni

8, pika 8/b; nenit 27 pika 1,2; dhe “Manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollin”, Kapitulli II, pika 2.2.6.

**Konstatim:** Bashkia Prrenjas deri më 31.12.2022 nuk ka takime të dokumentuara të GMS, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Kreu II, neni 8, pika 8/b; nenit 27 pika 1,2; dhe “Manualin e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, Kapitulli II, pika 2.2.6.

**2.2. Strategjia e riskut** përcakton mënyrën se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre.

Duhet theksuar se në procesin e miratimit të planeve vjetore të punës, duhet të merren parasysh risqet më të rëndësishme që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara. Gjithashtu e rëndësishme është që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike. Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut

Nga auditimi rezulton se në lidhje me komponentin “identifikimi i riskut, vlerësimi i riskut, adresimi i riskut dhe shqyrtimi i riskut” është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut.

**2.3. Gjurmët e Auditimit** janë një instrument mbështetës për menaxhimin e njësisë. Gjurmët e Auditimit përfshijnë operacione të cilat nisin dhe përfundojnë brenda një strukture organizative, por që mund të përshkojnë gjatë rrugës së tyre disa struktura organizative dhe madje disa njësi. Gjurma e Auditimit informon mbi: Përshkrimin e qartë të ecurisë së operacionit; Gjurmimin e operacionit prej fillimit në fund; Të gjithë dokumentet që janë marrë ose janë gjeneruar gjatë procesit; Aktivitetet e rëndësishme të kontrollit, që garantojnë ecurinë e duhur të operacionit; Kush e merr një vendim të caktuar gjatë ecurisë së operacionit; Sistemet e IT-së që mbështesin operacionin; Kush mban përgjegjësinë finale për procesin, veçanërisht në rastet kur në kryerjen e një operacioni marrin pjesë disa njësi organizative.

Nga sa më sipër, nga ana e Bashkisë Prrenjas, grupit të auditimit nuk iu vunë në dispozicion Gjurmët e auditimit, kjo pasi Titullari i Bashkisë në cilësinë e NA, nuk ka miratuar gjurmët e auditimit.

**Konstatim:** Nga auditimi, rezultoi se gjurmët standarde të auditimit nuk janë hartuar dhe miratuar nga titullari i njësisë, si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e Bashkisë Prrenjas, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 10296/2010 i ndryshuar, neni 16, pika 2; “Manualin e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, Kapitulli V; Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, nenet 121 dhe 122.

Lidhur me “Menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve IT”, grupi i auditimit referuar informacionit të dhënë nga specialisti IT si dhe verifikimeve në “Deklaratën, Raportin dhe Formularin e Vetëvlerësimit”, që dërgohet çdo fillim viti në MFE/Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për vitin ushtrimor 2022, rezultoi se Bashkia Prrenjas për të gjitha shërbimet që u ofron qytetarëve, si edhe të gjitha Bashkitë e tjera, operojnë në sisteme kombëtare online dhe që administrohen në zbatim të VKM nr. 673/2017 nga AKSHI; emërtimet e këtyre sistemeve dhe drejtoria/sektori përkatës janë paraqitur në Aneksin MFK9, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Sistemet mbështeten nga 1 specialist IT, i pozicionuar në DLBNJP/në Sektorin e burimeve njerëzore dhe arkiv/protokollit. Nga auditimi, u konstatua se nga ana e Burimeve njerëzore për vitin 2022 mungon analiza mbi nevojat vjetore për trajnim, nuk është bërë pjesë e planit vjetor të trajnimeve lidhur me zhvillimet më të fundit IT për trajnim të specialistit IT në veçanti dhe

nuk ka hartuar plane/programe për të gjithë përdoruesit e sistemeve, gjë që cenon sigurinë e informacionit.

Lista (Harta) e Proceseve/Manuali i Procedurave të punës: Pamja e përgjithshme e procesit përmban një vështrim të përgjithshëm të aktiviteteve dhe procedurave që parashikojnë mënyrën e realizimit të proceseve të veçanta, sikurse dhe dokumentacionin që përdoret gjatë ecurisë së tyre. Ajo garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit, që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të procesit; shkresat/ formularët tip si dhe disa Seksione të tjera plotësuese të tyre (procedurave).

**Konstatim:** Bashkia Prrenjas nuk ka hartuar listën (hartën)/manualin e proceseve të punës, në moszbatim të Ligjit nr. 10296 /2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” dhe “*Manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*”, Kapitulli III pika 3.3.

### **3. Veprimtaritë e Kontrollit:**

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme, ku në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave.

Për të qenë efektive, aktivitetet e kontrollit duhet të jenë të përshtatshme; efektive nga pikëpamja e kostos; të gjithanshme; të dokumentuara qartë etj.

- Në Bashkinë Prrenjas për realizimin e objektivave me efikasitet, ekzistojnë dhe përdoren manuale për proceset kryesore operacionale dhe financiare, të cilët specifikojnë qarkullimin e dokumentacionit, të cilët janë paraqitur në Aneksin MFK10, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llojet e Kontrollit që duhet të zbatohet në një njësi janë: parandalues dhe pas faktit. Në Bashkinë Prrenjas kontrollet pas faktit realizohen nga NJAB të Bashkisë etj., pra jo nga personat përgjegjës apo personat që marrin pjesë në kontrollet para faktit; ndërsa ato parandaluese janë dhe paraqiten si më poshtë vijon:

- Kontrole në shqyrtimin e dokumentacionit që nënshkruhet, praktika e saj dhe verifikohet saktësia e materialit;

- Ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person (NA-NZ);

- Të gjitha angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA & NZ (sistemi i 2 firmave);

- Çdo dalje e Aktiveve afatgjata autorizohet dhe monitorohet nga NA; kontroll i dokumenteve të inventarëve, regjistrave financiarë, librat e kontabilitetit etj.;

- Bashkia Prrenjas nuk disponon rregullore për menaxhimin e aktiveve të saj;

- Rregulloret për Sistemet IT i vihen në dispozicion çdo përdoruesi, por nuk janë hartuar plane vjetore për trajnimin e specialistit IT dhe të përdoruesve të sistemeve IT;

- Parashikuar procedura të qarta mbi komunikimin e shkresave brenda dhe jashtë Bashkisë: hyrja, trajtimi, mbajtja e dokumentacionit lidhur me depozitimin e protokollimin, komunikimin shkresor e elektronik;

- Komunikimi dhe trajtimi i Urdhërave të brendshëm dhe udhëzimeve përshtatur sipas përgjegjësi individuale të çdo pozicioni;

- Ndarja e detyrave i referohet strukturës organizative institucionale, ku secili punonjës kryen detyrën sipas akt emërimit dhe Formularit të përshkrimit të punës;

- Institucioni përgjithësisht zbaton rregullat e përcaktuara në “*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor*” për ruajtjen e dokumenteve, për trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin gjatë punës, por nuk ka një rregullore të veçantë dhe një plan

veprimesh për mirëfunksionimin e arkivit dhe të shërbimeve që ajo ofron, të miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë;

- Bashkia Prrenjas ka ngritur Njësinë e Sinjalizuesit, ka miratuar Rregullore “Për hetimin administrativ të sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nga njësia e sinjalizimit”, “Rregullore për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja nga njësia e sinjalizimit” shoqëruar me regjistrin, formulari tip I dhe tip II, me nr. 3591 prot., datë 28.12.2019, në zbatim këto të Ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”;

- Për periudhën nën auditimi grupit të auditimit iu vu në dispozicion raporti vjetor me nr. 3592 Prot., datë 28.12.2022 si dhe rezultoi pa raste sinjalizimi të brendshëm, për pasojë dhe asnjë rast për mbrojtje të sinjalizuesit; Ky informacion shkresor është dërguar në ILDKPKI me shkresën nr. 3592/1 datë 28.12.2022. Deri më 31.12.2022 në bashkinë Prrenjas nuk ka patur raste informacioni nga njësia e sinjalizimit.

- Bashkia Prrenjas ka faqen e saj zyrtare në web me adresë <https://www.bashkiaPrrenjas.gov.al/> dhe pasaportën e Bashkisë në Portalin Porta Vendore, me adresë <https://portavendore.al/bashkia-Prrenjas/pasaporta-e-bashkise-Prrenjas/>, të cilat përdorin një lidhje të sigurt (connection security) HTTPS (Hyper Text Transfer Protocol Secure), që do të thotë se serveri i faqes së internetit përdor një certifikatë sigurie, për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletuesit e ndryshëm;

Plani i kontrollit të brendshëm është një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh) me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen. Mungesa e planeve të kontrollit kanë ndikuar dhe në mos monitorimin e detyrave që menaxherët i ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përmbushjes së tyre;

Veprimtaritë e kontrollit, përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

**Konstatim:** Nga Bashkia Prrenjas nuk është hartuar/miratuar një Plan i Kontrollit të Brendshëm periodik apo vjetor, kjo në moszbatim të nenit 22, pika 1 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

#### **4. Informacioni dhe Komunikimi:**

Drejtuesit e institucionit kanë informacion të pamjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit; si dhe nuk kanë kryer trajnime mbi Ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të organizuar nga ASPA. Mungesa e realizimit të takimeve të GMS dhe e trajnimeve të stafit për njohjen dhe zbatimin e Ligjit “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ka riskuar harmonizimin në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e detyrave gjatë procedurave apo proceseve brenda sektorëve/drejtorive si dhe ndërmjet sektorëve/drejtorive me drejtorinë ligjore, me qëllim ruajtjen e komunikimit ndërmjet njësite brenda strukturës së Bashkisë, Bashkisë me ndërmarrjet në varësi të saj dhe Bashkisë me institucione të tjera publike dhe jo vetëm. Informacioni shkëmbehet në nivel horizontal dhe vertikal. Bashkia Prrenjas disponon një Rregullore të Brendshme hartuar dhe miratuar mbështetur në strukturën organizative me të cilën funksionon bashkia sipas VKB-ve përkatëse.

- Në Bashkinë Prrenjas është emëruar Koordinatorin për Informim dhe Koordinatorin i Transparencës, konform Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 15, 16 dhe Ligjit nr. 119/2014, “Për informimin publik”. Koordinatorin për Informim dhe Koordinatorin i Transparencës sipas nenit 10 ka për detyrë: Trajtimin e kërkesave të qytetarëve; Krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve; Bashkërendimin e përpjekjeve për të koordinuar të drejtën e informimit. Koordinatorin për Informim ka përpiluar raporte periodike 6



mujore dhe i ka përcjellë te titullari. Pra një detyrim i vërtetë i Koordinatorit është se ai krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve sipas shkronjës b, pika 2 e nenit 10. Çdo informacion dhe njoftim publikohet në WEB-in e Bashkisë Prrenjas. Lidhur me funksionin koordinues të Koordinatorit për informim dhe transparencës, nga auditimi u konstatua se raportimet 6 mujore dhe vjetore te titullari, nuk janë hartuar plotësisht sipas kërkesave ku përfshihen: gjendja e nivelit të transparencës në organin publik në formën e raportit që deklaron gjendjen e punëve në organin publik (niveli i transparencës në internet, statistikën mbi kërkesat dhe vendimet, duke përfshirë ankesat para Komisionerit, sfidat e zbatimit dhe ndoshta propozime për përmirësime. Klasifikimi sipas natyrës së kërkesave dhe njësia përgjegjëse në strukturën e bashkisë për dhënien e informacionit të kërkuar, nuk është praktikuar në raportimet e bëra, duke mos dhënë një pasqyrim të detajuar mbi problematikat ekzistuese dhe në kontributin për hartimin e planit të masave në minimizimin e tyre apo parandalimin e krijimit të atyre të reja.

Moshartimi dhe mosmiratimi i manualit të procedurave dhe i gjurmëve të auditimit, mungesa e raportimeve me informacion të plotë e të detajuar, riskon të pasurit e një komunikimi jo shumë efektiv e harmonik, si dhe paqartësi në ndarjen e detyrave dhe monitorimin e zbatimit të tyre;

- Buxheti diskutohet në të gjitha nivelet e Institucionit (edhe ato të varësisë);
- Zhvillohen analiza vjetore të arritjeve të objektivave të Bashkisë Prrenjas;
- Drejtoria ligjore, e prokurimeve dhe burimeve njerëzore, është përgjegjëse për komunikimin me Subjektet kryesore të jashtme (ka korrespondencë shkresore zyrtare dhe elektronike sipas rastit) si dhe e çdo dokumenti administrativ (operacional e financiar) në institucion; ajo përzgjedh formën e komunikimit (shkresor të protokolluar apo elektronik) sipas rastit. Duhet të aplikohet rregullisht komunikimi elektronik ose shkresor (komunikim i brendshëm), duke evituar komunikimin verbal me qëllim forcimin e gjurmës së auditimit;
- Çdo muaj bëhet akt rakodimi me Degën e Thesarit dhe raportimi i bëhet Titullarit të Bashkisë (NA);
- Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për çdo problem apo paqartësi, në rrugë shkresore të protokolluar dhe elektronike.

## **5. Monitorimi:**

Mungesa e emërimit të një menaxheri në cilësinë e Koordinatorit të Riskut, moshartimi i gjurmëve të auditimit, mungesa e rregullores së menaxhimit të aktiveve të njësisë, ka sjellë mosefektivitet në procesin e monitorimit, pasqyruar kjo në moshartimin e raporteve vjetore nga GMS, të raporteve periodike të menaxherëve të nivelit të ulët, të mesëm mbi ecurinë dhe realizimin e produkteve të njësisë publike (bashkisë), si dhe identifikimin e fushave të cilat nuk janë realizuar në masën e pritshme, duke analizuar dhe shkaqet përkatëse. Ky raportim bëhet nga personeli përgjegjës i çdo drejtorie tek eprori dhe eprorët ia përcjellin titullarit, në cilësinë e NA dhe Kryetarit të GMS. Raportimi mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë, përmban informacione dhe evidenca të ndryshme, ku bazohet dhe Raporti 4 mujor dhe vjetor i monitorimit, i cili i dërgohet Ministrisë së Financave.

Ky raportim bëhet në zbatim të nenit 48 të Ligjit nr. 68 /2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenit 65 të Ligjit nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22/2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore” dhe dërgohet në Këshillin Bashkiak dhe MFE: për vitin 2022 është dërguar me shkresën nr. 1518 prot., datë 23.05.2022 “Mbi raportimin e zbatimit të buxhetit për 4 mujorin e I (janar-prill)”; për 4 mujorin e II (janar-gusht) me shkresën nr. 2551 prot., datë 20.09.2022 dhe atë vjetor me shkresën nr. 360/1 prot., datë 15.02.2022. Raportet për në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të sistemeve të kontrollit të cilat përmbajnë: Pyetësozin e vetëvlerësimit, deklaratën për cilësinë e

sistemit të kontrollit të brendshëm dhe regjistrin e menaxhimit të riskut, raporti për funksionimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm, plani i veprimit për MFK; Gjithashtu nga ana e Bashkisë Prrenjas: Inspektori i Mjedisit dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, raportojnë çdo vit te Agjencia Kombëtare e Mjedisit (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit), në zbatim të Ligjit nr. 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, Ligjit nr. 10463/2011 “Për Menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar si dhe VKM nr. 687/2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”. Çdo akt administrativ i Bashkisë Prrenjas publikohet në faqen zyrtare të saj, konform Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Kreu VI, neni 15 dhe Programit të transparencës konform ligjit nr. 119/2014 “Për informimin publik”. Duke analizuar me kujdes të gjitha procedurat që ndiqen në funksion të arritjes së objektivave të Bashkisë, konstatojam se baza rregullatore mbi të cilën mbështetet aktiviteti funksional i saj, është e paplotë për rrugët që duhen ndjekur në konturimin dhe forcimin e sistemeve të kontrollit, duke e parë si sistem dinamik (të jetë koherent me çdo akt ligjor apo nënligjor që miratohet). Kjo arrihet duke forcuar aktivitetin e GMS që është rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie dhe atë të koordinatorit të MFK dhe të riskut, në zbatim të Ligjit nr. 10296 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Manualit MFK, Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të riskut”, me qëllim që të mund të kontrollojnë, të konstatojnë dhe të sistemojnë në kohë reale edhe parregullsinë më të vogël të procedurave të përditshme, duke minimizuar riskun e kthimit të tyre në fenomen.

**Titulli i gjetjes:** Mbi implementimin dhe zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

**Situata:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm u konstata se gjendja aktuale e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera në Bashkinë Prrenjas, është si vijon:

**Mjedisi i kontrollit:** 1. Bashkia Prrenjas ka miratuar me VKB “Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2022” në tejkalim të afateve, në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2015 “Për nënpunësin civil”, neni 18 dhe VKM nr. 108/2014, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, pika 11;

2. Nga auditimi rezultoi se formularët e përshkrimit të pozicioneve të punës për punonjësit që marrëdhëniet e punës me bashkinë iu rregullohen me “Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë”, nuk janë bërë pjesë e dosjes së personelit apo si shtojcë e Kontratës së punës, në kundërshtim me VKM-në nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

3. Nga verifikimet e dokumentacionit dhe analiza e informacionit të pasqyruar në tabelën e strukturës organizative sipas funksioneve të Bashkisë Prrenjas, rezultoi se funksioni “Mbrojtja e mjedisit”, nuk mbulohet nga një njësi e veçantë, por nga një Inspektor mjedisi, i cili është pjesë e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit dhe Mjedisit; Nga auditimi, u konstata se nga struktura përgjegjëse nuk janë hartuar plane masash parandaluese dhe edukuese për mbrojtjen e mjedisit.

4. Nga testimi me zgjedhje i dosjeve të personelit për emërimet dhe largimet gjatë vitit 2022, rezultoi se përgjithësisht dosjet e personelit përmbanin dokumentacionin përkatës të dosjeve, por u konstatauan:

- Në dosjet e personelit mungonte praktika e plotë e punësimit nga shpallja e pozicionit deri në emërimin e punonjësve; vlerësimi 6 dhe 12 mujor; vërtetimi i prokurorisë dhe gjykatës;

- Dosjet e punonjësve të larguar nuk kishin praktikën e plotë të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nga njoftimi deri në vendimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, përfshirë procesverbalin e dorëzimit të bazës materiale që ka patur punonjësi në ngarkim;

Sa më sipër, është në mospërputhje me Ligjin nr. 152/2013, “Për nënpunësin civil”, i ndryshuar, neni 17, pika 1,4; VKM nr. 117, datë 5.3.2014, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit dhe të regjistrit qendror të personelit”, Lidhja 1 dhe 2; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar; Ligji nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, Kreu VII dhe XIV.

**5.** Nëpunësi Autorizues dhe struktura përgjegjëse e Bashkisë Prrrenjas (Drejtoria Ligjore/Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore), nuk kanë hartuar dhe miratuar plane dhe programe vjetore efektive për trajnimin e detyrueshëm të të gjithë punonjësve, në zgjerimin e njohurive të tyre për proceset e punës dhe të aftësive për t’i kryer me efikasitet ato, dhe kryesisht për njohjen nga stafi dhe menaxherët e njësisë mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, në moszbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, pika h, Ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kapitulli III, pika 3.1;

**Menaxhimi i riskut: 6** Bashkia Prrrenjas deri më 31.12.2022 nuk ka takime të dokumentuara të GMS, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Kreu II, neni 8, pika 8/b; neni 27, pika 1,2; dhe “Manualin e menaxhimit financiar dhe kontrollin”, Kapitulli II, pika 2.2.6;

**7.** Nga auditimi, rezultoi se gjurmët standarde të auditimit nuk janë hartuar dhe miratuar nga titullari i njësisë, si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e Bashkisë Prrrenjas, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 16, pika 2; “Manualin e menaxhimit financiar dhe kontrollit” kapitulli V; UMF nr. 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, nenet 121 dhe 122;

**8.** Bashkia Prrrenjas nuk ka hartuar listën (hartën)/manualin e proceseve të punës, në moszbatim të Ligjit nr. 10296 /2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe “Manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit”, Kapitulli III, pika 3.3;

**Veprimtaritë e kontrollit: 9.** Nga Bashkia Prrrenjas nuk është hartuar/miratuar një Plan i Kontrollit të Brendshëm periodik apo vjetor, kjo në moszbatim të nenit 22, pika 1 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, (sipas Aneksit nr. 11).

**10.** Mungesa e aktivitetit të GMS në Bashkinë Prrrenjas ka bërë që njësi të ushtrorë funksionet e veta pa hartuar/miratuar një strategji dhe një rregullore për menxhimin dhe ruajtjen e aktiveve afatgjata materiale si dhe për minimizimin e risqeve ndaj tyre, në moszbatim të Ligjit nr. 10296/2011 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 27, Manuali i MFK pika 2.2.6; Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”;

**Informimi dhe komunikimi: 11.** Lidhur me funksionin e Koordinatorit për informim dhe transparencë, nga auditimi u konstatua se raportimet 6 mujore dhe vjetore të titullari nuk janë hartuar plotësisht sipas kërkesave, ku përfshihen: gjendja e nivelit të transparencës në organin publik në formën e raportit që deklarohet gjendjen e punëve në organin publik për nivelin e transparencës në internet, statistikën mbi kërkesat dhe vendimet, duke përfshirë ankesat para Komisionerit, sfidat e zbatimit dhe propozime për përmirësime. Klasifikimi sipas natyrës së kërkesave dhe njësi përgjegjëse në strukturën e bashkisë për dhënien e informacionit të kërkuar, nuk është praktikuar në raportimet e bëra, duke mos dhënë një pasqyrim të detajuar mbi problematikat ekzistuese duke mos dhënë kontribut për hartimin e planit të masave në minimizimin e tyre apo parandalimin e krijimit të problematikave të reja.

**12.** Drejtuesit e institucionit kanë informacion të pamjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollit; si dhe nuk kanë kryer trajnimet e organizuara nga ASPA mbi Ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Mungesa e realizimit të takimeve të GMS dhe e trajnimeve të stafit për njohjen dhe zbatimin e ligjit “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ka riskuar harmonizimin në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e detyrave gjatë procedurave apo proceseve brenda sektorëve/drejtorive si dhe ndërmjet sektorëve/

drejtorive me drejtorinë ligjore, me qëllim vendosjen dhe ruajtjen e një komunikimi me efektivitet, ndërmjet njësive brenda strukturës së bashkisë, bashkisë me ndërmarrjet në varësi të saj dhe bashkisë me institucione të tjera publike dhe jo vetëm.

**Monitorimi: 13.** Duke analizuar me kujdes të gjitha procedurat që ndiqen në funksion të arritjes së objektivave të bashkisë, u konstatua se baza rregullatore mbi të cilën mbështetet aktiviteti funksional i saj është e paplotë për rrugët që duhen ndjekur në konturimin dhe forcimin e sistemeve të kontrollit, duke e parë si sistem dinamik (të jetë koherent me çdo akt ligjor apo nënligjor që miratohet). Kjo arrihet duke forcuar aktivitetin e GMS që është rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie dhe atë të koordinatorit të MFK dhe të riskut, në zbatim të Ligjit nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Manualit MFK, Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të riskut”;

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.1., faqe 12-32.

**Kriteri:** Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Udhëzimi nr. 21/2016 “Për menaxherët e të gjitha niveleve”; Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu VI, neni 32, pika 2/a, b, c; Ligji nr. 152, datë 30.05.2013 “Për nënpunësin civil në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 9, pikat 3, 4 dhe 5; neni 11 pika 1/c, e, f; neni 12; neni 19/1,2,3; neni 20; Ligji nr. 10325/2010 “Për bazën e të dhënave shtetërore”; VKM nr. 117 datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, Lidhja 1 dhe 2; VKM nr. 243/2014 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar; VKM nr. 142 /2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”; Ligji nr. 119/2014 “Për informimin publik” dhe Udhëzimi i viti 2016 “Mbi detyrat e Koordinatorit të Informimit dhe Transparencës”.

**Ndikimi/Efekt:** Nga Bashkia Prrenjas nuk janë zbatuar rigorozisht elementët nga të cilët përbëhen pesë Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke riskuar sigurinë e arritjes së objektivave të bashkisë nëpërmjet përdorimit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore.

**Shkaku:** Gjatë periudhës nën auditim, Bashkia Prrenjas nuk ka treguar vëmendjen dhe përgjegjshmërinë e duhur për plotësimin e aktiviteteve të kontrollit me dokumentacionin përkatës (manuali i procedurave, gjurmët e auditimit, plani vjetor i kontrollit të brendshëm), si dhe hartimin e planeve vjetore për rritjen profesionale të stafit dhe njohjen nga ana e tij dhe e menaxherëve të njësisë me ligjin për MFK, miratimin e tyre nga NA/Kryetari i Bashkisë, të cilat orientojnë në zbatueshmërinë e procedurave të saj konform dispozitave ligjore në fuqi.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandimi 1:** Kryetari i Bashkisë Prrenjas, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen nga menaxhimi dhe nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, të rritjes dhe forcimit të aktivitetit GMS, të koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut, të hartojë dhe të miratojë gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe monitorimit në bashki.

**Rekomandimi 2:** GMS të marrë masa për hartimin dhe miratimin e planit strategjik dhe planit vjetor për aktivitetet dhe çështjet që duhet të analizojë dhe grafikun e takimeve që do realizojë, për hartimin e raporteve vjetore, si një rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të

punës për çdo drejtori dhe njësi varësie, për të arritur objektivat institucionale në shërbim të komunitetit.

**Rekomandimi 3:** Nëpunësi Autorizues, Nëpunësi Zbatues dhe GMS të marrin masa për miratimin e një strategjie për menaxhimin e risqeve dhe masave konkrete për minimizimin e tyre për aktivet afatgjata, miratimin e një rregulloreje me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e akrtiveve afatgjata të njësisë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të akteve ligjore në fuqi;

**Rekomandimi 4:** Drejtoria Ligjore, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore, të marrë masa për të hartuar programe trajnimi për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë, të plotësojë dosjet e personelit sipas kërkesave ligjore/nënligjore, të kontribuojë në krijimin e një strukture organizative/organigramën e saj sa më efektive, plotësimin me personel të saj, për të rritur efektivitetin e shërbimeve dhe funksioneve që i atribuon ligji në dobi të komunitetit.

### **2.1.2. Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm.**

a) Njësia e auditimit të brendshëm në Bashkinë Prrenjas, është e organizuar në nivel sektori që nga viti 2018 deri në fillim të vitit 2022, në përbërjen esë cilës ka dy pozicione për specialistë auditimi (auditues të brendshëm), pa pozicionin e përgjegjës të njësisë, si pjesë e strukturës së Bashkisë Prrenjas. Mospasja e një njësie të plotë të auditimit të brendshëm në strukturën e bashkisë, është në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, neni 10, pika 3 dhe pikat 3 dhe 6 të VKM-së nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*”, rëndësia e së cilës konsiston në faktin se “*Njësia e auditimit të brendshëm*”, ka funksion kryesor mbështetjen e menaxhimit të lartë në zbatimin e objektivave, sipas kërkesave të Ligjit nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, neni 10, germa “c” si dhe nenit 64, germa “a” të Ligjit nr. 139/2015, datë 22.10.2015, “*Për vetëqeverisjen vendore*”.

b) Plani vjetor 2021 dhe strategjik 2021-2023 i veprimtarisë së NJAB, është dërguar në Ministrinë e Financave/Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm me shkresën nr. 3227 prot., datë 15.10.2020;

Plani vjetor 2022 dhe strategjik 2022-2024 ai i veprimtarisë së NJAB, është dërguar në Ministrinë e Financave/Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm me shkresën nr. 2463 prot., datë 11.10.2021

Planet strategjike dhe vjetorë të NJAB të Bashkisë Prrenjas, janë dërguar në Ministrinë e Financave brenda afateve të përcaktuara në Ligjin 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, në “*Manualin e auditimit të brendshëm në sektorin publik*”.

c) Plani strategjik i auditimit në njësitë e sektorit publik/NJVQV, mbështetet në programet dhe objektivat e NJQV-së (bashkisë dhe ndërmarrjeve të varësisë) ku ushtron veprimtarinë audituese, si dhe në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve që ndikojnë në (mos)realizimin e objektivave të këtyre njësive. NJAB mbi bazën e njohjes dhe të studimit të objektivave strategjike dhe të risqeve të njësisë publike, evidenton jo vetëm subjektet dhe fushat e auditimit që do të realizohen në programin strategjik afatmesëm, por edhe frekuencën e realizimit të këtyre auditimeve. Planifikimi i auditimit bëhet duke patur parasysh anën funksionale e organizative të subjekteve që janë objekt auditimi, raportet vjetore të institucionit, raportet e mëparshme të auditimit të brendshëm, rekomandimet e auditimit të jashtëm (KLSH), regjistrat e riskut dhe këshillat/opinionet e drejtuesve të njësive respektive në strukturë. Nga NJAB janë hartuar raportet vjetore të aktivitetit të saj ose dokumentet e sigurimit të cilësisë dhe regjistri i riskut: për vitin 2021 miratuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresën nr. 5311, datë 11.02.2022; për vitin 2022 miratuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresën nr. 2324, datë 06.02.2023, të cilat

janë dorëzuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm brenda afatit të përcaktuar në *“Manualin e auditimit të brendshëm në sektorin publik”* miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100/2016, datë 25.10.2016 .

d) Struktura e njësisë së auditimit të brendshëm në Bashkinë Prrenjas nga data 01.01.2019 deri më 31.12.2021 është paraqitur në Aneksin AB1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Referuar ligjit nr. 114/2015 *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*, në çdo institucion bazuar në kriteret e përcaktuara në VKM nr. 83, datë 03.02.2016, *“Mbi miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”* me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 25 dhe nr. 495 prot., datë 10.02.2020, *“Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Prrenjas për vitin 2020”*; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 372 datë 10.11.2020, *“Për miratimin e strukturës së Bashkisë Prrenjas dhe institucioneve në varësi bazuar në numrin maksimal dhe kategorinë e pagave të miratuara nga Këshilli Bashkiak për vitin 2020”*; Urdhërit të Kryetarit nr. 19 dhe me nr. 229 prot., datë 25.01.2021, *“Për disa ndryshime në Vendimin nr. 372 datë 10.11.2020 në strukturën e Bashkisë Prrenjas dhe institucioneve në varësi të saj”*; Urdhërit të Kryetarit nr. 04 dhe nr. 150 prot., datë 30.01.2022, *“Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Prrenjas dhe institucioneve në varësi bazuar në numrin maksimal dhe kategorinë e pagave të miratuara nga Këshilli Bashkiak për vitin 2022”*. NJAB gjatë periudhës së auditimit, ka funksionuar me personelin sipas Aneksit AB2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga verifikimi i strukturave organizative dhe tabela përmbledhëse rezulton se NJAB në Bashkinë Prrenjas është krijuar dhe miratuar me VKB nr. 472 datë 09.10.2018 me dy auditues dhe ka funksionuar si e tillë deri në fund të vitit 2021. Me Urdhërin e Kryetarit nr. 04 datë 20.01.2022 struktura e NJAB u kompozua konform Ligjit nr. 114/2015 *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”* neni 10 pika 3 dhe VKM nr. 83 datë 03.02.2016 *“Mbi miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”* pika 3 e 6; Të dy audituesit janë të pajisur me certifikatën e *“Audituesit të brendshëm”* në përputhje me aktet ligjore/nënligjore. Gjatë periudhës në auditim, NJAB ka funksionuar dhe vazhdon të funksionojë me personelin sipas Aneksit AB3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Konstatim:** Bashkia Prrenjas ka krijuar NJAB, e cila e ushtron funksionin e vet me dy auditues (1 përgjegjës dhe 1 auditues) në strukturën organizative të saj dhe me një vend vakant, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 *“Mbi auditimin e brendshëm në sektorin publik”* neni 10 pika 3, *“Manualin e procedurave të auditimit të brendshëm në sektorin publik”* miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 100/2016, pikat 3 dhe 6 të VKM-së nr. 83 datë 03.02.2016, *“Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”* i ndryshuar, si dhe Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Prrenjas *“Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Prrenjas dhe institucioneve në varësi, bazuar në numrin maksimal dhe kategorinë e pagave të miratuara nga Këshilli Bashkiak për vitin 2022”* miratuar edhe me Vendim të Këshillit Bashkiak;

e) Referuar Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* dhe *“Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, Ligjit nr. 114/2015 *“Mbi auditimin e brendshëm në sektorin publik”* dhe *“Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”*, nga Bashkia Prrenjas është hartuar një plan vjetor trajnimesh për audituesit e NJAB, referuar planit vjetor të Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, të miratuar me Urdhërin nr. 248, datë 31.12.2021; Për vitin 2022 NJAB ka kryer trajnimet sipas Aneksit AB4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Trajnimi i audituesve të brendshëm duhet të përmbushë planin vjetor prej 40 orëve në vit për çdo auditues (80 orë në 2 vjet), përcaktuar dhe programuar nga Drejtoria e Harmonizimit të

Auditimit të Brendshëm dhe realizuar nga ASPA.

Aa më sipër, rezulton se audituesit e NJAB të Bashkisë Prrenjas, kanë zhvilluar orët e plota të trajnimit të detyrueshëm të Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE, sipas vërtetimit/shkresës nga MFE nr. 23075 prot., datë 16.12.2022, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në aktet ligjore/nënligjore në fuqi.

### **2.1.3. Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.**

a) Planifikimi dhe realizimi i auditimeve: NJAB e Bashkisë Prrenjas ka hartuar planet strategjike dhe vjetore respektive, të miratuara nga Kryetari i Bashkisë, konform përcaktimeve ligjore, të cilat i ka dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në MFE/Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, brenda afatit kohor 20 Tetor. Çdo plan strategjik (2020-2022, 2021-2023, 2022-2024), përmban pesë pasqyrat e mëposhtme:

Pasqyra nr. 1: Plani strategjik i subjekteve të synuara për t'u audituar për vitet 2020-2022, 2021-2023 dhe 2022-2024;

Pasqyra nr. 2: Plani i angazhimeve të NJAB për vitet, 2020, 2021 dhe 2022;

Pasqyra nr. 3: Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitet 2020, 2021 dhe 2022;

Pasqyra nr. 4: Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitet 2020, 2021 dhe 2022;

Pasqyra nr. 5: Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet që auditohen, për vitet 2020, 2021 dhe 2022.

Referuar planeve strategjike dhe vjetore, planifikimi dhe grafiku i shpërndarjes së misioneve audituese për t'u realizuar nga NJAB me vlerësimin e riskut, është bërë sipas Aneksit AB5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga Aneksi AB5, rezulton se për dy vitet 2021 dhe 2022, njësitë e Strukturës Organizative/Fushat/Sistemet e Bashkisë Prrenjas, janë vlerësuar me koeficientin e riskut "i lartë" dhe "i mesëm", plotësia dhe saktësia e të cilave e orienton NJAB për të hartuar një plan strategjik dhe plan vjetor sa më real dhe në shërbim të institucionit, për përmbushjen e detyrave të tij funksionale që i atribuon ligji.

b) Planifikimi dhe grafiku i shpërndarjes së misioneve audituese është bërë mbi bazë risku dhe paraqiten në Aneksin AB6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Konstatim:** Nga auditimi i informacionit shkresor pasqyruar edhe në tabelat përkatëse, rezulton se NJAB nuk ka realizuar numrin e auditimeve të planifikuara në planet strategjike dhe vjetore për 2 vite radhazi, për 2020 dhe 2021, ndërsa për vitin 2022 ka ndryshim të planit fillestar; gjithashtu, rezultoi se në planifikimin e misioneve audituese strategjike dhe vjetore, nuk është respektuar raporti 60% me 40% mes sistemeve/fushave me risk të lartë dhe sistemeve/fushave me risk të mesëm/ulët, në moszbatim të Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe "Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik", Kapitulli III, paragrafi 3, pikat 1.6; 1.7; 3.2; 3.4; 3.5.

c) Auditimet e planifikuara dhe realizuar nga NJAB e Bashkisë Prrenjas, të klasifikuara sipas llojit, janë paraqitur në Aneksin AB7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi i raportimeve vjetore hartuar nga NJAB mbi aktivitetin e saj për çdo vit ushtrimor, të dhënat mbi gjetjet/rekomandimet dhe statusin e zbatimit të tyre, janë paraqitur në Aneksin AB8, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Konstatim:** Nga auditimi mbi rekomandimet e lëna nga NJAB në misionet audituese të realizuara në 3 vitet e fundit, rezulton se numri i tyre vjen në rritje dhe ai i atyre të zbatuara në rënie; ndërsa rekomandimet e shprehura në vlerë mbeten në statusin "pa zbatuar".

Realizimi i auditimeve nga NJAB, Bashkia Prrenjas për periudhën 2020-2021-2022, është paraqitur në Aneksin AB9, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi rezultoi se NJAB nuk ka realizuar numrin e angazhimeve audituese të miratuara

në “Planin vjetor dhe strategjik” për vitet 2020, 2021; Në Raportin vjetor që NJAB në Bashkinë Prrrenjas ka paraqitur në Drejtorinë e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar/Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar në MFE, ka dhënë sqarime mbi arsyet e mosrealizimit të planit vjetor si dhe ka hartuar dhe miratuar nga kryetari i bashkisë programin e ndryshuar vjetor;

**Konstatim:** Nga auditimi, rezultoi se numri i auditimeve të planifikuara për periudhën në auditim vjen në rënie; nuk është realizuar numri i auditimeve të planifikuara dhe nuk janë përfshirë në planet strategjike dhe vjetore të gjitha njësitë në strukturë, me referim koeficientin e riskut, ku ato me risk të lartë auditohen çdo vit, me risk të mesëm në çdo 3 vjet dhe ato me risk të ulët në çdo 5 vjet, në moszbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe “Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, Kapitulli III, pika 3.1.2;

**d)** Nga auditimi i shtatë dosjeve të subjekteve që NJAB ka audituar për vitin 2022, rezultoi si më poshtë:

1. Fletë inventari të dosjes: 3 mungonin, 1 pa nënshkrimin e anëtarëve të NJAB;
2. Autorizimi i Kryetarit të Bashkisë për fillim auditimi kishte mangësi në përmbajtje, pasi mungon plani vjetor i miratuar si referencë;
3. Takimi fillestar me subjektin është realizuar, e përmban dosja;
4. Evidencat/dokumentacioni/testet janë realizuar, i përmban dosja;
5. Projekt Raporti është realizuar, e përmban dosja;
6. Observacione janë realizuar, i përmban dosja;
7. Raporti Përfundimtar është realizuar, e përmban dosja;
8. Memo Kryetarit është realizuar, e përmban dosja;
9. Plani i veprimit nga subjekti i audituar është realizuar, e përmban dosja.

**e)** Nga auditimi i dosjeve të auditimit, rezultoi se nga ana e subjekteve të audituara, nuk janë hartuar planet e veprimit brenda afatit 30 ditor nga marrja në dorëzim e Raportit Përfundimtar të Auditimit, me anë të të cilit vihet në dijeni NJAB mbi pranimin ose jo të rekomandimeve të lëna dhe personat përgjegjës për zbatimin e tyre, në moszbatim të kreut 4.1.13.3 “Përgjegjësitë e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB” të “Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”; gjithashtu mungesa e planeve të veprimit ka sjellë mungesën e monitorimit të NJAB për zbatimin e rekomandimeve nga ana e subjekteve të audituara brenda afateve të përcaktuara, në moszbatim të përcaktimeve në kreun 4.1.13.1. dhe 2 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit”, paragrafi 3 dhe “Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve” paragrafi 4, të “Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

**Konstatim:** Nga auditimi rezultoi se dosjet e misioneve audituese kanë mangësi me dokumentet standarde, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe “Manualin e auditimit të brendshëm në sektorin publik”, Kapitulli VI dhe Formati standard nr. 1;

**Konstatim:** Nga ana e subjekteve të audituara nuk janë hartuar planet e veprimit, të cilat i dërgohen NJAB jo më vonë se 30 ditë pune pas dërgimit të Raportit Përfundimtar, duke mospërmbushur detyrimin nr. 5 të skemës finale të auditimit, në moszbatim të kreut 4.1.12, hapi 11 të “Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

**Konstatim:** Mungesa e planeve të veprimit ka sjellë mungesën e monitorimit nga NJAB për zbatimin e rekomandimeve nga ana e subjekteve të audituara brenda afateve të përcaktuara, në moszbatim të përcaktimeve të kreut 4.1.13.1 dhe 4.1.13.2 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit”, paragrafi 3, si dhe “Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve”, paragrafi 4; mosraportimit të subjekteve të audituara në moszbatim të Kreut 4.1.13.3 “Përgjegjësitë e njësisë për të zbatuar rekomandimet e auditimit të brendshëm” të “Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

**ë)** Në Bashkinë Prrrenjas, sigurimi i cilësisë në të gjitha angazhimet e auditimit të brendshëm të



kryera gjatë periudhës objekt auditimi, është kryer nga grupi i punës i cili ka kryer auditimin, pra nga NJAB në Bashkinë Prrenjas.

Për periudhën 2020, 2021 dhe 2022, nga NJAB në Bashkinë Prrenjas janë lënë 123 rekomandime, nga të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht 28 rekomandime, në proces zbatimi 86 rekomandime dhe 9 rekomandime pa zbatuar; në vitin 2022 janë lënë 45 rekomandime, të cilat rezultojnë të gjitha në proces zbatimi.

Nga sa më lart, grupi i auditimit thekson se mungesa e personelit në strukturën e NJAB përbën pengesë për mirëfunksionimin dhe performancën e NJAB të Bashkisë Prrenjas. Kjo rezultoi në numrin në rënie nga viti 2020 e në vijim të planifikimit të misioneve audituese, në përzgjedhjen e sektorëve/fushave në planifikimin pa bërë një vlerësim real për çdo fushë, si dhe në moszbatimin e plotë të misioneve audituese; në mospërmbushjen dhe mosrealizimin e plotë të skemës së procesit të auditimit, Hapi 4, “*Ndjekja e Rekomandimeve*”, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” dhe “*Manualin e auditimit të brendshëm në sektorin publik*”.

**Titulli i gjetjes:** Mbi vlerësimin e aktivitetit të Njesisë së auditimit të brendshëm.

**Situata:** Nga auditimi mbi vlerësimin e veprimtarisë të Njesisë së auditimit të brendshëm në Bashkinë Prrenjas, për periudhën e audituar 2020, 2021 dhe 2022 u konstatua se:

1. Bashkia Prrenjas ka krijuar NJAB, e cila e ushtron funksionin e vet me dy auditues (1 përgjegjës dhe 1 auditues) në strukturën organizative të saj dhe me një vend vakant, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, “*Mbi auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, neni 10, pika 3, “*Manualin e procedurave të auditimit të brendshëm në sektorin publik*”, VKM-në nr. 83 datë 03.02.2016, “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*”, i ndryshuar, pikat 3 dhe 6, si dhe Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Prrenjas “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Prrenjas dhe institucioneve në varësi, bazuar në numrin maksimal dhe kategorinë e pagave të miratuara nga Këshilli Bashkiak për vitin 2022*”, miratuar edhe me Vendim të Këshillit Bashkiak;

2. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se NJAB nuk ka realizuar numrin e auditimeve të planifikuara në planet strategjike dhe vjetore për 2 vite radhazi (2020 dhe 2021), ndërsa për vitin 2022 ka ndryshim të planit fillestar; Gjithashtu rezultoi se në planifikimin e misioneve audituese strategjike dhe vjetore, nuk është respektuar raporti 60% me 40% mes sistemeve/fushave me risk të lartë dhe sistemeve/fushave me risk të mesëm/ulët, në moszbatim të Ligjit nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” dhe “*Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik*”, Kapitulli III, paragrafi 3, pikat 1.6; 1.7; 3.2; 3.4; 3.5.

3. Nga auditimi mbi rekomandimet e lëna nga NJAB në misionet audituese të realizuara në 3 vitet e fundit, rezultoi se numri i tyre vjen në rritje dhe ai i atyre të zbatuara në rënie; ndërsa rekomandimet e shprehura në vlerë mbeten në statusin “*pa zbatuar*”.

4. Nga verifikimet e dokumentacionit, analiza e informacionit të pasqyruar në tabela si dhe auditimi i raporteve vjetore të hartuara dhe të miratuara, që NJAB ka dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm rezultoi se: numri i auditimeve të planifikuara për periudhën nën auditim vjen në rënie; nuk është realizuar numri i auditimeve të planifikuara për vitet 2020 e 2021; nuk janë përfshirë në planet strategjike dhe ato vjetore të gjitha njësitë e strukturës së bashkisë me referim koeficientin e riskut, ku ato me risk të lartë auditohen çdo vit, me risk të mesëm në çdo 3 vjet dhe ato me risk të ulët në çdo 5 vjet, të gjitha këto në moszbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*” dhe “*Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik*”, Kapitulli III, pika 3.1.2;

5. Nga auditimi, rezultoi se dosjet e misioneve audituese kanë mangësi me dokumentet standarde, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin*

publik” dhe “Manualin e auditimit të brendshëm në sektorin publik”, Kapitulli VI dhe Formati standard nr. 1;

**6.** Nga ana e subjekteve të audituara nuk janë hartuar planet e veprimit, të cilat i dërgohen NJAB jo më vonë se 30 ditë pune pas dërgimit të Raportit Përfundimtar, duke mospërbushur detyrimin nr. 5 të skemës finale të auditimit, në moszbatim të kreut 4.1.12, hapi 11 të “Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”;

**7.** Njësia e auditimit të brendshëm nuk ka ndjekur hapat e procesit të monitorimit, për zbatimin e rekomandimeve nga ana e subjekteve të audituara brenda afateve të përcaktuara, në moszbatim kjo të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe “Manualit për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, Kapitulli 4.1, pikat 13/1, 2, 3; Por nga ana e saj, NJAB në moszbatim të kësaj procedure, ka planifikuar dy misione audituese “për zbatimin e rekomandimeve të lëna në subjektet e audituara” dhe “zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH”, duke mos përdorur me efikasitet burimet (njerëzore, financiare dhe kohën) për ushtrimin e aktivitetit të saj në ato njësi të paaudituar, të audituara shumë herët apo asnjëherë, në mos zbatim të përcaktimeve në kreun 4.1.13.1 dhe 2 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit” paragrafi 3 dhe “Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve”, paragrafi 4, të “Manualit për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Përgjegjësi për mosraportim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga misioni auditues i NJAB, kanë edhe subjektet e audituara, në moszbatim të kreut 4.1.13.3 “Përgjegjësitë e njësive për të zbatuar rekomandimet e auditimit të brendshëm”.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.1., faqe 12-32.

**Kriteri:** Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe “Manuali i auditimit të brendshëm në sektorin publik”; Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 83/2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”; Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, etj.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e një njësie të plotë të auditimit të brendshëm në strukturën e Bashkisë Prrenjas, përbën pengesë për mirëfunksionimin dhe performancën e Njesisë së auditimit të brendshëm të bashkisë, si dhe në dhënien e sigurisë titullarit të saj për përmbushjen e objektivave të bashkisë.

**Shkaku:** Moszbatimi i bazës ligjore në fuqi, e cila rregullon aktivitetin e Njesisë së auditimit të brendshëm në Bashkinë Prrenjas.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandimi 1:** Kryetari i Bashkisë Prrenjas, të marrë masa për plotësimin e Njesisë së auditimit të brendshëm me 3 auditues, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin, VKM-ve dhe Manualeve, për të përmbushur misionin e saj në arritjen e objektivave.

**Rekomandimi 2:** Njësia e auditimit të brendshëm të bëjë një vlerësim real të koeficientit të riskut për fushat/sistemet objekt i misioneve audituese, për të përfshirë në planet strategjike dhe vjetorë sektorët e fushave me risk, siç janë: zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, etj., duke respektuar raportin 60/40 mes sistemeve/fushave me koeficient të lartë risku ndaj atyre me koeficient të mesëm/ulët risku në hartimin e planeve strategjike e vjetor të njësive.

**Rekomandimi 3:** Njësia e auditimit të brendshëm, të ndjekë me korrektësi çdo fazë të misionit auditues, duke e plotësuar me praktikën dokumentare përkatëse. Pas dërgimit të Raportit Përfundimtar në subjektin e audituar, t’i kërkojë menaxherit të tij të reagojë në lidhje me rekomandimet e lëna dhe të raportojë periodikisht Njësinë e auditimit të brendshëm sipas afateve të përcaktuara në planin e veprimit.

**Rekomandimi 4:** Drejtuesi i Njesisë së auditimit të brendshëm duhet të krijojë dhe mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të rekomanduara për t’ia përcjellë

menaxhimit, nëpërmjet raporteve informuese të dhëna mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, sipas Manualit të auditimit të brendshëm.

## **2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit**

### **2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.**

Për hartimin e PBA-së 2022-2024, nga Bashkia Prrenjas janë ndjekur dhe zbatuar hapat e mëposhtëm:

- Në zbatim të Urdhërit nr. 45 datë 16.02.2021 “Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të riskut dhe krijimin e grupit të menaxhimit strategjik në Bashkinë Prrenjas”;
- Udhëzimi i brendshëm nr. 83 datë 06.04.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”;
- VKB nr. 99 datë 30.12.2020, “Kalendari orientues për menaxhimin e shpenzimeve vendore”; konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 23/1 prot datë 14.01.2021.
- VKB nr. 45, datë 29.09.2021, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024”; konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1110/1 datë 11.10.2021.
- Shkresë dërguar MFE nr. 2484, datë 13.09.2021, “Dërguar Projekt Buxheti Afatmesëm 2022-2024”, bashkëlidhur dhe relacioni.

Nga auditimi, u konstatua se për hartimin e PBA-së për periudhën 2022-2024, nga strukturat e Bashkisë Prrenjas janë ndjekur të gjithë hapat ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 33, 34, 35, 36, 37, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/015, datë 15.10.2015, neni 12, si dhe udhëzimet e MFE nr. 23, datë 22.11.2016, nr. 22, datë 30.07.2018, nr. 7, datë 27.02.2019 dhe nr. 27 datë 10.07.2020; për të hartuar PBA-të, përkatësisht:

- Këshilli Bashkiak ka miratuar draftin e parë të programit buxhetor afatmesëm, dhe ka dhënë opinionin e tij në lidhje me rekomandimet e Ministrisë së Financave;
- Nga Kryetari i Bashkisë Prrenjas janë marrë masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm të miratuar, brenda datës 5 korrik;
- Kryetari i Bashkisë Prrenjas ka miratuar udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të bashkisë.

Në të gjithë verifikimet më lart vihet re që nga Bashkia Prrenjas është zbatuar çdo kërkesë e Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 33, 34, 35, 36, 37, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/015, datë 15.10.2015, neni 12, si dhe Udhëzimet e MFE nr. 23, datë 22.11.2016, nr. 22, datë 30.07.2018, nr. 7, datë 27.02.2019 dhe nr. 27 datë 10.07.2020, në hartimin, zbatimin dhe dërgimin e PBA-së 2022-2024 në institucionet përkatëse.

### **2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.**

Për vitin 2022 në Bashkinë Prrenjas, buxheti është hartuar kryesisht mbi bazën e 14 programeve, përkatësisht: Organet ekzekutive dhe legjislativë, për çështjet financiare dhe fiskale, çështje të brendshme, Shërbime policore, Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri, marrëdhëniet me komunitetin, çështjet e përgjithshme ekonomike tregtare dhe të punës, Bujqësia, Pyjet, peshkimi dhe gjuetia, Transporti, Industri të tjera, Menaxhimi i mbetjeve, etj. Buxheti i vitit 2022, është miratuar me VKB nr. 72, datë 24.12.2021, me shkresën nr. 1474/1 Prot., datë 10.01.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Nga auditimi, u verifikua se buxheti i viteve 2022-2024 është miratuar sipas procedurave dhe kërkesave të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor

në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 624, datë 22.10.2021, “Për projekt ligjin për buxhetin e vitit 2022”. Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2022, është paraqitur në Aneksin B1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, me ndryshimet e buxhetit për vitin 2022, është paraqitur në Aneksin B2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2022:

Për vitin 2022, planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën 1,084,777 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 962,517 mijë lekë, ose në masën 89%. Realizimi i buxhetit sipas zërave, është paraqitur në Aneksin B3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga Bashkia Prrenjas, ndarja e plan-buxhetit dhe detajimi në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli, është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të grandeve, të vëna në dispozicion nga pushteti qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së pakushtëzuar sektoriale, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuara nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve. Gjatë këtij viti, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar dhe rialokimeve të kryera nga vetë bashkia, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, me VKB nr. 3, datë 28.02.2022, VKB nr. 18, datë 31.03.2022, VKB nr. 41, datë 04.05.2022, VKB nr. 56, datë 25.07.2022, VKB nr. 83, datë 28.09.2022, “Mbi një ndryshim në Vendimin nr. 72, datë 24.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Prrenjas për vitin 2022””, VKB nr. 82, datë 28.09.2022, “Për një ndryshim të pagës minimale”, VKB nr. 80, datë 28.09.2022, “Për miratimin e fondit të rritjes së pagave për arsimin parashkollor”, VKB nr. 84, datë 28.09.2022, “Për përdorimin e fondit rezervë për familjet në nevojë, për vitin 2022”.

Nga auditimi, u konstatua se nga ndryshimet e bëra në buxhetin e vitit 2022, rezulton:

- Ndryshimet janë shoqëruar me relacion shpjegues lidhur me arsyet e ndryshimit;
- Ka një analizë se si ndikon ky ndryshim në realizimin e objektivave të synuar të bashkisë;
- Janë respektuar afatet ligjore për rishikimin e buxhetit vendor;
- Kryetari i Bashkisë Prrenjas për vitin 2022, ka paraqitur brenda datës 31 mars të vitit pasardhës raport me shkrim pranë Këshillit Bashkiak për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Këto veprime janë konform Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 47, Ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 44, Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore” shtojca 4, pika c, etj.

### **2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.**

Buxheti për vitin 2022, është planifikuar në shumën 1,084,777 mijë lekë prej të cilit janë realizuar 962,517 mijë lekë ose i shprehur në përqindje plani është realizuar në masën 89%, nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 97,549 mijë lekë ose në masën 10.1% të buxhetit faktik.

Nga Drejtoria e Financës është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Librazhd, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull, sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht

ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me VKB, ose të diktuar nga grandet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore pasqyruar në anekset bashkëlidhur.

Në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e zbatimit të buxhetit, Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 44 dhe Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, Bashkia Prrenjas ka përgatitur vetëm Raportin vjetor të monitorimit të buxhetit për vitin 2022 dhe e ka dërguar me MFE me shkresë nr. 360 Prot., datë 27.01.2023.

Nga auditimi, u konstatua se nga Bashkia Prrenjas janë hartuar raportet periodike të monitorimit për vitin 2022. Kryetari i Bashkisë Prrenjas i ka paraqitur në këshill raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48. Kryetari i Bashkisë Prrenjas ka miratuar rregullat specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Raportet e monitorimit janë hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 “Përmbajtja e raportit të monitorimit” dhe Shtojcës 5 “Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë”, të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore”. Raportet e monitorimit janë të plota dhe të gjitha anekset janë plotësuar sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore”, pikat 10, 12, 28, 29, 48.

#### **2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.**

#### **2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.**

Në bilancin e Bashkisë Prrenjas, vlera e detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2022 është paraqitur 24,828,425 lekë. kjo shumë përputhet me të dhënat e rakorduara me Degën e Thesarit dhe raportimin në MFE me shkresën nr. 360/1. Prot., datë 15.02.2023, konfirmuar me shkresën nr. 140/1 Prot., datë 06.02.2023, për të njëjtën vlerë, ndërkohë që edhe në dokumentet analitike që Bashkia Prrenjas disponon, vlera e detyrimeve të prapambetura paraqitet e njëjtë. Gjithashtu rakordon vlera totale e detyrimeve të prapambetura sipas zërave specifike të tyre. Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, Bashkia Prrenjas ka hartuar një plan, i cili është paraqitur në raportimin e monitorimit vjetor të buxhetit dërguar në MFE me shkresën nr. 360 Prot., datë 27.01.2023, ku parashikon që për vitin 2023 të likuidohen 1,582,615 lekë, këto detyrime janë nga OSHEE ndërsa shuma prej 23,245,810 lekë janë detyrime nga FSHZH, shkresat nga ana e bashkisë kanë qënë të vazhdueshme për rialokim fondi, por nga FSHZH nuk ka pasur asnjë përgjigje.

Në mënyrë të përmbledhur, të dhënat që grupi i auditimit analizoi lidhur me detyrimet e prapambetura, gjenden të grupuara në Anekset B4, B5 dhe B6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, referuar dokumentacionit si bilanceve, akt rakordimeve me degën e thesarit, raportimeve në MFE dhe listave analitike që disponon Bashkia Prrenjas.

Nga auditimi, u konstatua se nga ana e Bashkisë Prrenjas janë bërë përpjekje për të saktësuar dhe evidentuar kontratat dhe faturat të cilat nuk ishin pasqyruar më parë në tabelat e raportimeve të detyrimeve.

Veprimet e mësipërme janë në përputhje me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 34, pika 1, neni 40, pika 3, Udhëzimi i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 101, etj.

Vështirësia Financiare e Bashkisë Prrenjas:

Për Bashkinë Prrenjas, totali i shpenzimeve të miratuara me VKB nga të ardhurat e veta për vitin 2022 ka qenë 499,267,517 lekë, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2022, ka qenë 24,828,425 lekë, sipas raportimit në MFE dhe sipas rakordimit me bilancin, dokumentet analitike të Bashkisë Prrenjas dhe PBA-së. Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 0.32%, shifër që e klasifikon Bashkinë Prrenjas në njësi të qeverisjes me situatë normale të gjendjes financiare, në përputhje me UMFE nr. 26, datë 27.09.2019 “*Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore*” dhe Ligjin nr. 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, datë 27.04.2017, kreu XI, “*Vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre*”, neni 55, “*Problemet financiare*”, pika 1.

#### Mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore në Bashkinë Prrenjas:

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Lidhur me detyrimet e konstatuara nga Bashkia Prrenjas, rezulton se është bërë planifikimi i likuidimit të tyre për çdo vit buxhetor dhe ato janë raportuar periodikisht në Këshillin Bashkiak dhe MFE. Me fondet buxhetore të vitit 2022, përgjithësisht janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, ku veçanërisht është kryer likuidimi i vendimeve gjyqësore të viteve të mëparshme, sipas paraqitjes në Aneksin B7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### Nga auditimi, u konstatua se:

1. Vlera e detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore të prapambetura nga dokumentet analitike të Bashkisë Prrenjas, gjatë vitit 2022 ka qenë 977,650 lekë, të cilat janë likuiduar dhe për vitin 2022, detyrimet e prapambetura për vendimet gjyqësore rezultojnë në vlerë 0 lekë.
2. Bashkia Prrenjas në likuidimin e detyrimeve nuk respekton radhën e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese, veprim ky në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1, datë 04.06.2014 “*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit*”, pika 5 dhe pika 8.

#### **2.2.6. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve tatimore të paarkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.**

Nga auditimi, u konstatua se rregullshmëria e veprimeve të kryera nga sektori i të ardhurave, për vjeljen e taksave, tatimeve dhe të ardhurave të tjera, paraqitet si më poshtë: Me urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 30.12.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 32/1, datë 15.01.2021, ku është miratuar struktura, orga.N. dhe numri i punonjësve për funksionimin dhe ushtrimin e aktivitetit të Administratës së Bashkisë dhe shërbimeve mbështetëse të cilat janë paraqitur dhe konfirmuar brenda afateve ligjore, është përfshirë edhe struktura e Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Licensave. Aktualisht, kjo drejtori ka në përbërje 8 punonjës, të ndarë konkretisht: 1 drejtor, 1 përgjegjës i zyrës së taksave dhe 6 specialistë, sipas Aneksit A1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

##### **➤ Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:**

Për vitin 2022, paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Prrenjas është miratuar me VKB-në nr. 71, datë 24.12.2021 “*Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022*”.

Parashikimi për të ardhurat vendore është pjesë e parashikimeve buxhetore, duke u përgatitur fillimisht në formë relacioni nga Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licensave.

Realizimi i të ardhurave është në shumën totale 94,054,850 lekë. Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më poshtë për periudhën në auditim, realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Prrenjas paraqitet si vijon:

Të ardhurat janë realizuar në masën 96%. Nga 97,549 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar 94,054 mijë lekë. Gjatë vitit 2022 nuk është përdorur shuma 3,494,150 lekë, e cila është

mbartur në buxhetin e vitit pasardhës.

Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave në Bashkinë Prrenjas është paraqitur në Aneksin A2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi, u konstatua se nuk ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit të bashkisë për sa i takon pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve. Niveli i realizimit të të ardhurave ka ndikuar në realizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të bashkisë dhe marrjen e angazhimeve buxhetore pa patur burime financimi reale. Këto veprime janë në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe rregullator për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, përkatësisht:

- Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar;
- Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Udhëzimit të MFE nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”.
- Udhëzimit të MFE nr. 7, datë 27.02.2019 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022”.

➤ **Administrimi i taksave dhe tarifave vendore:**

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizike/juridike dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e palikuiduara etj.

Bizneset që ushtrojnë aktivitetet në Bashkinë Prrenjas për vitin 2022, janë paraqitur në Aneksin A3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku konstatohet se numri total i bizneseve në Bashkinë Prrenjas ka ardhur në zbritje nga viti 2021, që rezultojnë 426 ndërsa në vitin 2022 rezultojnë 398 biznese gjithsej. Edhe në vitin 2021 ka patur një ulje të bizneseve ku në fillim të vitit numri ka qënë 433 biznese dhe është mbyllur me një numër prej 426 biznesesh.

➤ **Menaxhimi i borxhit:**

Nga auditimi i dokumentacionit të Drejtorisë së Taksave Vendore u konstatua se gjendja progresive e debitorëve për subjektet fizike/juridike në datën 31.12.2022 paraqitet në vlerën 18,312,760 lekë. Detyrimet e debitorëve nga biznesi për taksat dhe tatimet janë paraqitur në Aneksin A4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ **Taksat dhe Tarifat nga familjarët:**

Në Bashkinë Prrenjas familjarët ngarkohen me detyrime vendore për taksën e tokës, taksën e ndërtesës, tarifin e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit, të cilat për vitin 2022 janë paraqitur në Aneksin A5 dhe A6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Titulli i gjetjes:** Të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Prrenjas në shumën debitore progresive 18,312,760 lekë nga subjektet fizike/juridike dhe shuma 45,078,816 lekë nga taksat dhe tarifin e familjarëve.

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të Sektorit të Tatim Taksave, vlera totale e borxhit tatimor në Bashkinë Prrenjas, në datën 31.12.2022, në mënyrë progressive paraqitet:

Detyrimet nga taksat dhe tarifin familjare janë 45,078,816 lekë;

Detyrimet nga taksat dhe tarifin e bizneseve në janë 18,312,760 lekë;

Në total, borxhi tatimor në fund të vitit 2022 është 63,391,576 lekë, vlerë e cila duhet të kontabilizohet dhe t’u njoftohet subjekteve përkatëse nga ana e administratës të Bashkisë Prrenjas.

Në totalin e detyrimeve, konstatohet se peshën kryesore e zënë detyrimet nga abonentët familjarë, të cilat janë 64% e totalit të detyrimit. Vlera totale 63,391,576 lekë, përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Prrenjas.

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 32-42.*

**Kriteri:** Ligji nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 4, 26, 32 dhe 34; Ligji nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore”, nenet 70 dhe 91; Ligji nr. 10926, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, UMF nr. 24, datë 02.09.2008 dhe UMF nr. 01, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, neni 12.

**Ndikimi/Efekti:** Të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Prrenjas.

**Shkaku:** Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Prrenjas dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për arkëtimin e detyrimeve të palikuiduara nga debitorët progresivë për vitin 2022, nga mospagesa e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara në paketën fiskale nga subjektet ekonomike që ushtrojnë aktivitetet për qëllime biznesi, si dhe nga subjektet familjare, në vlerën totale 63,391,576 lekë.

➤ **Masat e marra për uljen e borxhit:**

Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Prrenjas është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93 dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijnë duke u përshkallëzuar, si: Njoftimi dhe kërkesa për të paguar; Urdhëri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit; Masa e sigurimit të detyrimit tatimor.

Nga auditimi, u konstatua se Bashkia Prrenjas ka ndërmarrë hapat për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, por përsëri ka një numër të konsiderueshëm debitorësh.

Për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore, Bashkia Prrenjas nuk ka lidhur aktmarrëveshje me ndërmarrjen/shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Sh.A. dhe menaxhimi bëhet nga vetë bashkia nëpërmjet postës (shpërndarja e njoftim detyrimit), ndërsa për zonat e largëta nga punonjësit e taksave. Një menaxhim i tillë është jo frytdhënës për bashkinë, pasi niveli i detyrimeve debitore vjen në rritje nga njëra periudhë në tjetrën, ku për vitin 2021 kemi një rritje për vlerën 22,260,537 lekë, pasi nga vlera 17,445,619 lekë në vitin 2020 në vitin 2021 paraqitet në vlerën 39,706,156 lekë. Bashkia Prrenjas deri në dhjetor të vitit 2022 e menaxhonte vetë sektorin e ujësjiellësit vetëm për fshatrat e njësisive dhe gjendja debitore deri në 31.12.2022 rezulton në vlerën 16,938,876 lekë. Nga gjendja debitore e vitit 2020,2021 dhe 2022 totali i saj në fund të vitit 2022 rezulton të jetë në vlerën 56,645,032 lekë.

Theksojmë që në janar të vitit 2023, ndërmarrja/shoqëria Ujësjiellës Kanalizime, është transferuar në shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Pogradec, Sh.A.

Debitorët progresivë të cilët kanë kontrata me ujësjiellësin, për vitin 2022 janë paraqitur në Aneksin A7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Arkëtimi i detyrimeve nga abonentët familjarë bëhet nga administrata e bashkisë vetëm për ata persona të cilët paraqiten në bashki për kryerjen e veprimeve të ndryshme, ndërsa pjesa tjetër vetëm ju është ngarkuar si detyrim, por nuk është zbatuar asnjë procedurë për arkëtimin e tyre. Debitorë progresivë për kopshtet & çerdhet, për vitin 2022 janë paraqitur në Aneksin A8, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjobat dhe procedurat e mbajtura nga I.M.T.V. pranë Bashkisë Prrenjas për personat fizikë dhe juridikë, nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022 “Vendim për dënim me gjobë”, janë dy, njëra për objektin njësi+banesë në vlerën 100,000 lekë dhe tjetra për objektin njësi në vlerën 20,000



lekë, vlera këto të kontabilizuara dhe të arkëtuara, sipas Aneksit A9, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ **Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet:**

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5.

Në Bashkinë Prrenjas, struktura që administron dokumentacionin dhe përlllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë referuar kërkesave ligjore të sipërcituara për subjektet dhe qytetarët që pajisen me certifikatën e pronësisë, është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

**Titulli i gjetjes:** Të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Prrenjas nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, në total 2,526,900 lekë, nga të cilat për vitin 2022 janë 59 qytetarë debitorë me vlerë totale 1,790,459 lekë dhe deri në datën 31.12.2021 në vlerën totale 736,441 lekë.

**Situata:** Bazuar në shkresat që ASHK dërgon në Bashkinë Prrenjas, për vitin 2022 janë legalizuar 133 objekte me detyrim për taksën e ndikimit në infrastrukturë, në shumën 3,872,029 lekë. Kanë paguar detyrimin 74 qytetarë në shumën 2,081,570 lekë. Janë debitorë 59 qytetarë në shumën 1,790,459 lekë. Pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitin 2022 është paraqitur në Aneksin A10, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi, u konstatua se lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët të cilët përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë, për vitin 2022 janë debitorë 59 qytetarë me vlerë totale 1,790,459 lekë dhe nga vitet e mëparshme deri në vitin 2021 në vlerë totale 736,441 lekë, në total 2,526,900 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Prrenjas.

Sipas të dhënave, të ardhurat nga ky zë janë realizuar për vitin 2022 në masën 118% ose nga 9,500 mijë lekë të planifikuara është arkëtuar vlera 11,216 mijë lekë. Ky tejkalim vjen nga bashkëpunimi midis drejtorive mbi mundësinë e lejeve të ndërtimit që Drejtoria e PZHT ka parashikuar për vitin ushtrimor 2022. Në këtë zë bën pjesë dhe taksa nga ndërtimet e reja (nga legalizimet), ku referuar të dhënave, detyrimi për këtë taksë në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 2,526,900 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Prrenjas, ku në mënyrë analitike, pasqyra në Drejtorinë e Taksave e tarifave vendore. Nga dokumentacioni i paraqitur, u evidentuan që Bashkia Prrenjas i është drejtuar ASHK Dega Elbasan, për bllokimin e pasurisë dhe moskryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes së lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, me shkresën nr. 362 prot., datë 04.02.2022, në zbatim të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, duke përjashtuar faktin se gjatë vitit 2022 sipas rekomandimit të lënë nga KLSH në auditimet e saj është bërë shkresë për bllokim pasurie me shkresën nr. 2601 prot. datë 23.09.2022.

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 32-42.*

**Kriteri:** Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5.

**Ndikimi/Efekti:** Të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Prrenjas.

**Shkaku:** Mungesa e marrjes së masave shtrënguese në mënyrë shteruese për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Drejtoria e Urbanistikës të përcjellë listën me subjektet debitorë për taksën e ndikimit në infrastrukturë, si dhe në vijim Bashkia Prrenjas të marrë masa dhe të ndjekë të

gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitoare prej 2,526,900 lekë.

➤ **Taksa mbi ndërtesat:**

Nga të dhënat e paraqitura, rezulton se taksa mbi ndërtesat për vitin 2022 është realizuar në masën 91%, ose nga 6,500 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 5,926 mijë lekë në total. Ndikim në mosrealizimin e kësaj takse vjen nga abonentët familjarë. Duhet të theksojmë se edhe planifikimi është bërë mbi bazën e sipërfaqeve reale të ndërtesave, por ne rastin ku nuk ka informacion për sipërfaqet e banesave, bashkia ka aplikuar taksën në masën 70 dhe 100 m<sup>2</sup>. Megjithëse nga Drejtoria e të Ardhurave është vijuar me grup pune për evidentimin në terren të sipërfaqeve të banimit për efekt taksë pasurie (taksë ndërtese), dokumentacioni është i paplotë, pasi nuk evidentohet gjenplani për sipërfaqen e matur, ku në grupin e punës ka të përfshirë edhe specialist me profil inxhinier për kryerjen e matjeve faktike, ku të evidentohet sipërfaqja gjithësej, numri i kateve, llojet e aktivitetit ose destinacioni sipas kateve, etj.

➤ **Të ardhurat nga qiratë:**

**Titulli i gjetjes:** Mosllogaritje e penaliteteve në masën 0.1%, por jo më shumë se 10% për subjektet të cilat janë debitorë nga Bashkia Prrenjas (personat përgjegjës).

**Situata:** Sipas evidencës së të ardhurave për vitin 2022, rezulton se të ardhurat nga qiratë janë realizuar në masën 88%, ku nga vlera e planifikuar prej 6,200,00 lekë është arkëtuar vlera 5,951,687 lekë. Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se në Bashkinë Prrenjas operojnë gjithsej 20 subjekte të cilat kanë lidhur kontrata qiraje për HEC, gurore, objekte, veprimtari ekonomike, telefoni, duke përllogaritur një detyrim vjetor në vlerën 7,180,822 lekë, nga e cila është likuiduar vlera 5,951,687 lekë, duke mbetur pa likuiduar vlera 4,566,925 lekë. Të dhënat janë paraqitur në Anekset A11 dhe A12, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në Bashkinë Prrenjas kanë lidhur kontratë qiraje 20 subjekte, si vijon:

- 7 subjekte për HEC, me vlerë kontrate vjetore 5,218,905 lekë.
- 2 subjekte shfrytëzim karriere (miniëre dhe gurore), me vlerë kontrate 45,525 lekë.
- 3 subjekte veprimtarie ekonomie (pikë tranziti, rritje peshku, vepër turistike), me vlerë kontrate 164,972 lekë.
- 4 subjekte me veprimtari telefonisë celulare, me vlerë kontrate vjetore 906,510 lekë
- 3 subjekte për kullota, me vlerë kontrate 123,950 lekë.
- 1 subjekt për ndërtim linje tensioni, me vlerë kontrate 720,960 lekë.

Nga auditimi, u konstatua se referuar nenit 5, pika 5.5 e kontratave, për subjektet të cilat janë debitorë nga Bashkia Prrenjas (personat përgjegjës), nuk janë llogaritur penalitetet në masën 0.1%, por jo më shumë se 10%. Nga ku detyrimi pa penalitet për kontratat e qerasë për të cila nuk është paguar detyrimi deri në datën 31.12.2022 rezulton në vlerën 4,566,925 lekë. Detyrimi me penalitet për kontratat e qerasë për të cila nuk është paguar deri në datën 31.12.2022 rezulton në vlerën 5,023,618 lekë. Penaliteti i kontratave të qerasë është në vlerën 456,693 lekë.

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 32-42.*

**Kriteri:** VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, i ndryshuar, pika 2), lidhja 2), nenet 11 dhe 12.

**Ndikimi/Efekti:** Menaxhimi i të ardhurave është jashtë kontrollit të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullosor.

**Shkaku:** Mosrespektimi kuadrit ligjor nga Sektori i Taksave e Tarifave Vendore në lidhje me mosaplikimin e saktë të detyrimit me penalitet për kontratat e qirasë të asetit nga fondi pyjor/kullosor, pronë publike në territorin e Bashkisë Prrenjas.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Prrenjas, Drejtoria e të Ardhurave e Drejtoria e Financës të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të përllogaritur sa më saktë

nivelin e detyrimit me penalitet për kontratat e qerasë për të cilat nuk janë paguar deri në datën 31.12.2022, si dhe mbledhjen e detyrimeve e konsideruar e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Prrenjas për vlerën 5,023,618 lekë.

**Titulli i gjetjes:** Të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Prrenjas nga subjektet të cilat operojnë në shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore (karriera), në shumën 20,488,050 lekë.

**Situata:** Nga përpunimi i të dhënave, u konstatua se sipas kërkesës së bërë nga Bashkia Prrenjas në adresë të AKBN në lidhje me subjektet që operojnë në shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore (karriera), nga kjo e fundit është konfirmuar me shkresën nr. 1011/1, datë 24.2.2022 se në këtë njësi vendore ushtrojnë këtë lloj aktiviteti 19 subjekte, ku dy prej të cilave janë me pezullim, dy kanë kontratë me bashkinë dhe 15 subjekte ushtrojnë aktivitet duke shfrytëzuar sipërfaqe pyjore/kullimore pa lidhur kontratë qiraje me bashkinë ose ministrinë e linjës. Me shkresën nr. 569, datë 18.2.2022, Bashkia Prrenjas i ka kërkuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit që për 4 subjekte heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve sipas lejes minerale. Nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 2050/1, datë 28.2.2022 është kthyer përgjigje se mungon një pjesë e dokumentacionit për marrjen në shqyrtim të kërkesës dhe nga bashkia nuk është vijuar më tej. Detyrimi i munguar në buxhetin e Bashkisë Prrenjas nga moszbatimi i kuadrit ligjor në fuqi, përlllogaritet në shumën 20,488,050 lekë, e ardhur e munguar në buxhet.

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 32-42.*

**Kriteri:** VKM nr. 391, datë 21.06.2006, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”” pika 2, lidhja 2, pika 6/1 dhe pika 9/4.

**Ndikimi/Efekti:** Menaxhimi i të ardhurave është jashtë kontrollit të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullimosor.

**Shkaku:** Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Prrenjas, Sektori Juridik, Drejtoria e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të kërkuar likuidimin nga subjektet të cilat ushtrojnë aktivitet për qëllime biznesi në fushën e mineraleve, të pajisur me leje minerare brenda territorit të Bashkisë Prrenjas, për detyrimin e qirasë së papaguar nga kontratat e lidhura për sipërfaqen në përdorim nga fondi pyjor/kullimosor, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Prrenjas në vlerën 20,488,050 lekë, si dhe të verifikojnë në terren dhe të administrojnë të gjithë sipërfaqen e fondit pyjor/kullimosor, sipas të dhënave në regjistrin e AKBN-së.

Me shkresën nr. 1268 Prot., datë 05.05.2023, nga z. L.L., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve e Kullotave në Bashkinë Prrenjas, është paraqitur observacioni mbi Projekt Raportin, datë 13.04.2023; protokolluar në KLSH me nr. 1173/31 Prot., datë 08.05.2023.

**Pretendimi i subjektit:**

*Në përfundim për sa më sipër cituam: kërkojmë heqjen e detyrimit sipas Projekt Raportit, datë 13.04.2023 në shumën prej 20,448,050 Lekë si e ardhur e munguar në buxhet për 15 subjektet që ushtrojnë aktivitet duke shfrytëzuar sipërfaqe të fondit pyjor/kullimosor.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në lidhje me observacionin sa më sipër, Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, Bashkia Prrenjas, ka ngritur grupet e Akt Kontrollit, ku vë në dijeni subjektet përkatëse për marrjen e masave

për heqjen nga fondi pyjor/kullozor, por nuk paraqitet miratim zyrtar i Ministrisë së linjës lidhur me heqjen e subjekteve nga fondi kullozor/pyjor.  
Sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

➤ **Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve:**

Në territorin e Bashkisë Prrenjas për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 4 subjekte. Grupi i auditimit, auditori dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2022.

**Titulli i gjetjes:** Mbi të ardhurën e munguar në buxhetin e Bashkisë Prrenjas nga mospagesa e plotë e tarifës së autorizimit nga subjektet të cilat ushtrojnë aktivitet në tregtimin me pakicë të lëndëve djegëse, në vlerën 2,221,083 lekë.

**Situata:** Nga auditimi i dosjeve fizike të subjekteve të cilat ushtrojnë aktivitet në tregtimin me pakicë të lëndëve djegëse u konstatua:

1. Subjekti “K.” SHPK, me NUIS J...P, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj. Ky subjekt është pajisur me autorizim për periudhën 2019-2024, periudhë e mbuluar me autorizim për 5 vite në vlerën 1,100,000 lekë e arkëtuar në buxhetin e Bashkisë Prrenjas;

2. Subjekti “G.C.G.” SHPK, me NUIS K...T, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj. Ky subjekt është pajisur me autorizim për periudhën 2021-2026 periudhë e mbuluar me autorizim për 5 vite në vlerën 778,917 lekë e arkëtuar në buxhetin e Bashkisë Prrenjas dhe 321,083 lekë e ardhur e munguar.

3. Subjekti “K.” SHPK, me NUIS L...J, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj. Ky subjekt është pajisur me autorizim për periudhën 2018-2023 periudhë e mbuluar me autorizim për 5 vite në vlerën 200,000 lekë e arkëtuar në buxhetin e Bashkisë Prrenjas dhe 900,000 lekë e ardhur e munguar.

4. Subjekti “L.B.” SHPK, me NUIS J...M, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., ky subjekt është pajisur me autorizim për periudhën 2020-2025, periudhë e mbuluar me autorizim për 5 vite në vlerën 100,000 lekë, e arkëtuar në buxhetin e Bashkisë Prrenjas dhe 1,000,000 lekë e ardhur e munguar.

Nga auditimi, u konstatua se referuar dokumentacionit nga shqyrtimi i dosjeve përkatëse të subjekteve, autorizimi për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre është dhënë për një periudhë 5 vjeçare sipas Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar. Nga informacioni dhe dokumentacioni që bashkia disponon, u konstatua se nga subjektet që ushtrojnë aktivitet pa paguar plotësisht tarifën për pajisjen me autorizimin e tregtimit të hidrokarbureve ka një efekt financiar me vlerë totale 2,221,083 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar në buxhetin e Bashkisë Prrenjas.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore si vijon:

- Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar”, neni 4, neni 15, neni 20, “Autorizimet”, pika 2, “Autorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat “ç” dhe “d” të nenit 11, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje”;

- VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3 “Dhënia e

*licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga organet e qeverisjes vendore”.*

Informacion më i detajuar lidhur me subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e lëndëve djegëse është paraqitur në Aneksin A13, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 32-42.

**Kriteri:** Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar”, neni 4, neni 15, neni 20, pika 2; VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3.

**Ndikimi/Efekti:** Të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Prrrenjas.

**Shkaku:** Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Prrrenjas dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për mbledhjen e detyrimeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa paguar plotësisht tarifën për pajisjen me autorizimin e tregtimit të hidrokarbureve, për vlerën totale 2,221,083 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar në buxhetin e Bashkisë Prrrenjas.

#### ➤ **Zbatimi i Akt Marrëveshjeve:**

Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 77, Bashkia Prrrenjas ka lidhur marrëveshje për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura me me subjektin Përfundi SHPK, e cila është lidhur në datën 12.05.2022, për një periudhë 7 mujore, me 7 këste për vlerën 934,923 lekë. Nga auditimi rezultoi se nuk janë zbatuar kushtet sipas aktmarrëveshjes për pagesën e detyrimit nga subjekti. Nga ana e Drejtorisë se të Ardhurave janë marrë masa për subjektin debitor, duke vendosur barrë hipotekore, për bllokimin e pasurive të tij me shkresën nr. 2552 prot., datë 20.09.2022, si dhe bllokimin e mjetit me shkresën nr. 2375 prot., datë 01.09.2022 kurse bllokimin e llogarive ky subjekt e ka që prej vitit 2021.

Përmbledhja e gjendjes debitore të biznesit dhe familjarëve për taksat dhe tarifave vendore në datën 31.12.2022, për vlerën totale 83,400,910 lekë, është paraqitur në Aneksin A14, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

### **2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi**

#### **2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.**

#### **2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.**

#### ➤ **Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare 2021**

Në fund të periudhës ushtrimore, bilanci është plotësuar sipas formateve standard të miratuara me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 22.02.2022. Bilanci i vitit 2022 është përgatitur nga z. A.B., me detyrë përgjegjësi i sektorit të financës dhe znj. S.K., me detyrë drejtore e drejtorisë ekonomike dhe Nëpunës

Zbatues, është konfirmuar nga Kryetari i bashkisë Prrenjas, z. N.B., me detyrë Kryetar i Bashkisë Prrenjas, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues. Bilanci është depozituar në datën 23.02.2023 dhe është miratuar nga dega e thesarit Librazhd në datën 24.02.2023, brenda limiteve të përcaktuara me ligj. Nga dega e thesarit Librazhd, pasqyrat financiare janë nënshkruar nga znj. F.G..

Veprimet kontabile janë kaluar nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh, centralizator dhe më tej në bilanc. Janë mbajtur rregullisht ditarët e arkës, bankës, magazinës dhe veprimeve të ndryshme.

Janë mbajtur dhe përditësuar partitarët analitikë të të gjitha llogarive, si dhe i llogarive inventariale të magazinës për të cilat është bërë rakordimi llogari-magazinë.

Janë përgatitur formatet e mëposhtëm:

- Formati 1: Pasqyra e pozicionit financiar;
- Formati 2: Pasqyra e performancës financiare;
- Formati 3: Pasqyra e flukseve monetare;
- Formati 4: Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Formati 5: Pyetësor me shënimet shpjeguese;

Pasqyrat statistikore:

- Formati 6: Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre;
- Formati 7, a dhe b: - Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (a) dhe me vlerën neto (b);
- Formati 8: Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Bashkia Prrenjas nuk ka njësi shpenzuese në varësie dhe rrjedhimisht nuk harton pasqyra financiare të konsoliduara.

#### ➤ Qasja dhe metodologjia e auditimit

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të disponueshme dhe të siguruar nga vetë subjekti. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2022 ka marrë në konsideratë vlerën e materialitetit 15,615,225 lekë për shpenzimet dhe 14,437,879 lekë për të ardhurat, sipas Aneksit PF1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### ➤ Mbi vlerësimin e riskut

Nga grupi i auditimit janë ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit.

Më poshtë po citojmë disa ngjarje që mund të paraqesin një risk të gabimit material:

- Kontrolli i brendshëm:

Kontrolli i brendshëm në Bashkinë Prrenjas nuk ka funksionuar i plotë, nuk përfshin gjithë veprimtarinë e njësisë ekonomike, si rrjedhim nuk ndihmon në verifikimin e realizimit të detyrave dhe njësia ekonomike nuk mund ta dijë ku mund të ndodhin parregullsitë, shmangiet nga normat dhe kriteret e veprimtarisë ekonomike. Zbatimi i rregullt i procedurave të kontrollit të brendshëm shërben për ti siguruar menaxherët se pasuria e njësisë është e mbrojtur, të dhënat e përpunuara në kontabilitet janë të besueshme.

- Konfirmimet nga të tretët:

Subjekti që auditohet ka të konfirmuara (rakorduara) me të tretët (me dëgën e thesarit) informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

- Transaksionet:

*Janë kryer transaksione me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë në periudhën e fundit të vitit ushtrimor.*

Nisur nga ky fakt, bazuar në vlerën e materialitetit të përlogaritur (15,615,225 lekë) u filtruan të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës mbi këtë vlerë për muajt nëntor-dhjetor 2022, në vlerën 66,634,988 lekë për muajin nëntor dhe 233,167,904 lekë për muajin dhjetor.

Urdhër Shpenzimet e filtruara u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*” për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; Dokumentet autorizues, Dokumentet vërtetues, Dokumentet e kontabilitetit, etj.

➤ **TekN.t e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit**

1. Kontrolli aritmetik:

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4. Kontrolli i vlerësimit:

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët:

Subjekti që auditohet i ka të konfirmuara (rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, tepricave ose regjistrimeve të tjera.

6. Kontrolli sipas një treguesi:

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisive kontabile. Mund të përmendim nëse ka: *mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.*

➤ **Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021:**

Mbajtja e kontabilitetit:

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, ditari i arkës, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj.

Hartimi i pasqyrave financiare është bazuar në konceptet dhe rregullat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 “*Paraqitja e Pasqyrave Financiare*”), si dhe në UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 22.02.2022; nenit 3 dhe 6 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “*Menaxhimin e Sistemit*

*Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, nenit 6 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar, etj.

Nuk ka patur komunikim me MFE për aspekte të trajtimeve kontabile, apo mbyllje vjetore.

#### Bilanci kontabël:

Bilanci i hartuar paraqet informacionin mbi pozicionin financiar të Bashkisë Prrenjas në fund të periudhës kontabël, për vitin ushtrimor 2022.

Bilanci kontabël është ndërtuar nga tre pjesë: Aktivet, Detyrimet dhe Kapitali.

Klasifikimi i elementeve të mësipërm në nëngrupe dhe paraqitja e bilancit është bërë bazuar në parimin e materialitetit për të siguruar pamjen e vërtetë dhe të sigurtë të situatës financiare.

Kjo situatë financiare në bilancin kontabël paraqitet e krahasuar me atë të periudhës paraardhëse dhe përmban kolonat me shumat për periudhat përkatëse .

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzhërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejt në Aneksin e bilancit.

Në Bashkinë Prrenjas nuk ka njësi varësie, të cilat të funksionojnë si njësi shpenzuese të pavarura, pra, nuk ka pasqyra financiare të konsoliduara.

Në Bashkinë Prrenjas, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale, në programin kompjuterik EXCEL, gjë e cila paraqet risk të lartë përsa i përket sigurisë dhe saktësisë së informacionit të paraqitur nëpërmjet pasqyrave financiare.

Nga auditimi, u konstatua se në bilanc, totali i Aktivit është i barabartë me totalin e Pasivit, në vlerën 2,175,308,277 lekë.

Pasqyra e pozicionit financiar të Bashkisë Prrenjas në 31.12.2022, sipas formatit F1, është paraqitur në Aneksin PF2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2021, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u audituan referencat e llogarive të aktivit dhe të pasivit.

#### ➤ AKTIVET

Nga auditimi, u konstatua se në totalin e Aktivit në PF të Bashkisë Prrenjas, vlera është 2,175,308,277 lekë, e cila përbëhet nga Aktivet Qarkulluese/Afatshkurtra, në vlerën 366,977,224 lekë dhe Aktivet Afatgjata në vlerën 1,808,331,053 lekë.

#### I. Aktivet Afatshkurtra

Aktivt Afatshkurtra në datën 31.12.2022 paraqiten në vlerën 366,977,224 lekë, e cila përbëhet nga: 1. Llogaritë e klasës 3, “*Gjendje inventari qarkullues*”, në vlerën 40,080,928 lekë; 2. Llogaritë e klasës 4, “*Llogari të arkëtueshme*”, në vlerën 140,351,263 lekë; dhe 3. Llogaritë e klasës 5, “*Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre*”, në vlerën 161,716,608 lekë.

#### **1. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre:**

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre janë detajuar në Aneksin PF3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vlera e llogarisë 520 “*Disponibilitete në thesar*”, në datën 31.12.2022 ka qenë 161,716,608 lekë, me një rritje prej 14,883,788 lekë nga viti ushtrimor paraardhës dhe vlera e llogarisë 532 “*Vlera të tjera*” ka qenë 271,500 lekë, me një rritje prej 212,020 lekë nga viti ushtrimor paraardhës. Kjo vlerë sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, është e analizuar në Aneksin PF4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaritë e Klasës 5 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Nga Aneksi PF3, konstatohet se kjo llogari ka pësuar një rritje me 14,883,788 lekë. Nga verifikimi i zërave të bilancit, u konstatua se kjo llogari kuadraton me shumën e llogarive përkatëse 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*”, 85 “*Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit*” dhe 12 “*Rezultatet e mbartura*”, sipas aneksit PF4 bashkëlidhur, në përputhje me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare*



vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 22.02.2022, Kreu III, pikat 29, 30, 39, 50.

Nga auditimi i ditarit të bankës, u konstatua se në debi të llogarisë 520 janë paraqitur gjithsej 874 transaksione, për vlerën totale 962,517,189 lekë, ndërkohë që planifikimi ka qenë për vlerën totale 1,084,777,208 lekë sipas Aneksit PF5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi, u konstatua se është realizuar 89% e planit vjetor të shpenzimeve. Transaksionet gjatë vitit 2022 janë paraqitur në Aneksin PF5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

## **2. Gjendje Inventari qarkullues:**

Llogaritë e Klasës 3 paraqiten në vlerën totale 40,080,928 lekë, me një zbritje prej 2,161,793 lekë nga viti ushtrimor parardhës. Analiza e llogarive të klasës 3 është detajuar në Aneksin PF6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 31 “*Materiale*”, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2022 paraqitet në vlerën 13,463,338 lekë, me një zbritje prej 5,160,413 lekë nga viti ushtrimor paraardhës, ndërsa llogaria 32 “*Inventar i imët*”, paraqitet në vlerën 25,967,007 lekë, me një rritje prej 2,566,995 lekë nga viti ushtrimor parardhës. Nga rakordimi i urdhërit përkatës për nxjerrjen jashtë përdorimit, me kontabilitetin dhe Pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të Aktiveve të Qëndrueshme, nuk rezultuan diferenca përsa i përket llogarisë 32 “*Inventar i imët*” dhe llogarisë 31 “*Materiale*”.

Nga analiza e kryer për llogarinë 32 “*Inventar i imët*”, Bashkia Prrenjas dhe Njësitë Administrative përkatëse gjatë vitit 2022 kemi zbritje prej 2,161,793 lekë dhe materiale të nxjerra jashtë përdorimit në vlerën 2,063,750 lekë. Diferencat me pasqyrimin në bilanc i përkasin shtesave gjatë periudhës.

Vlerat e këtyre llogarive janë të barabarta me vlerat e dokumentuara në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës, si dhe me vlerat e paraqitura në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

## **3. Llogaritë e arkëtueshme:**

Llogaritë e Klasës 4 “*Llogari të arkëtueshme*” dhe “*Të tjera aktive afatshkurtra*” paraqiten përkatësisht në vlerën 140,351,263 lekë dhe 24,828,425 lekë, me zbritje prej 23,926,313 lekë dhe 10,725,579 lekë nga viti ushtrimor parardhës.

Llogaritë e Klasës 4 “*Llogari të arkëtueshme*” dhe “*Të tjera aktive afatshkurtra*” janë detajuar në Aneksin PF7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2022 paraqitet në vlerën debitorë 84,536,862 lekë. Nga analiza, rezultoi se kjo llogari është shtuar për vlerën 5,684,941 lekë, shumë e konstatuar nga debitorët për pagesat e tarifave të kopshtit dhe çerdhes. Kjo llogari përbëhet nga detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj bashkisë për taksa, tarifa vendore dhe detyrime të lëna nga aktet e kontrolleve të ndryshme të papaguara deri në 31.12.2022. Në mënyrë analitike kjo llogari është paraqitur e detajuar në Aneksin PF8, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për vlerën e paarkëtuar, Bashkia Prrenjas është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhërave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kërimit të dëmit, përcaktuar në nenin 115, të Kodit Civil në R.Sh. dhe nenit 203 të Kodit Punës në R.Sh. (prej 3 vjetësh) apo të parashkrimit të vendimeve (vlerave) të gjobave përcaktuar në nenin 46 të ligjit “*Për kundërvajtjet Administrative*” (brenda 2 vjetësh), sipas vendimeve administrative të dënimit me gjobë.

Në Bashkinë Prrenjas ka mangësi dokumentacioni vërtetues, gjë që e bën të pamundur kërkimin në rrugë zyrtare dhe ligjore të detyrimeve të papaguara në favor të saj.

Detyrimet e klientëve janë kërkesa afatshkurta dhe nëse nuk i mbledh subjekti, atëherë parimi

i vijimësisë (qëndrueshmërisë) vihet në pikëpyetje.

Bashkia Prrrenjas nuk ka bërë analizë për vlerësimin e llogarive të arkëtueshme dhe për vjetërsinë e tyre dhe nuk ka politika të shkruara rreth procedurave për njohjen e provizioneve. Mungesa e analizave të duhura rreth të arkëtueshmeve dhe politikave të duhura rreth procedurave për njohjen e provizioneve ndikon në besueshmërinë e vlerës së tyre.

Gjithashtu për vlerat mbi një vit, drejtimi nuk ka bërë zhvlerësimin për këto llogari të arkëtueshme.

Nga auditimi i të ardhurave dhe debitorëve nga taksat dhe tatimet, u konstatua se vlerat debitore të familjarëve, bizneseve, etj., janë kontabilizuar.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit ushtrimor 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 55,814,401 lekë, e cila përbëhet nga shuma e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën 37,880,065 lekë, llog. 42 “Detyrimet ndaj personelit” në vlerën 13,007,747 lekë, llogaria 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 581,377 lekë, llogaria 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 3,820,372 lekë, llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 524,840 lekë dhe llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, muaji dhjetor në vlerën 30,668,138 lekë. Nga auditimi nuk u konstatuan diferenca midis vlerave të pasqyruara në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruar në llogaritë e pasivit. Pra, vlera e kësaj llogarie në bilanc është pasqyruar në mënyrë të drejtë në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

#### **4. Të tjera aktive afatshkurtra**

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2022 paraqitet në vlerën 24,828,425 lekë. Nga analiza, rezultoi se kjo llogari është pakësuar për vlerën 10,725,579 lekë. Vlera e kësaj llogarie në bilanc është e barabartë me vlerën e paraqitur në PF të disponueshme në sistemin e thesarit.

Detyrimet e Bashkisë Prrrenjas, sipas natyrës janë paraqitur në Aneksin PF9, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Analiza e detajuar e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, është paraqitur në Aneksin PF10, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Përsa i përket detyrimeve të prapambetura, nga pasqyra e mësipërme vërehet se një pjesë e konsiderueshme e detyrimeve të prapambetura është e trashëguar nga periudha para reformës territoriale.

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se vlera debitore e kësaj llogarie në shumën 24,828,425 lekë, e mbledhur me shumën prej 5,839,713 lekë më pak në këtë llogari, **është e kuadruar** me shumën e llogarisë kreditore në pasiv të bilancit, përkatësisht me llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në shumën 30,668,138 lekë, në përputhje të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 22.02.2022, Kap. III, pika 42 dhe Aneksi 1, “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”.

Diferenca prej 5,839,713 lekë janë faturat e muajit dhjetor 2022, sipas Aneksit PF11, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

## **II. Aktivët Afatgjata**

### **1. Aktivët afatgjata jomateriale:**

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive jo materiale afatgjata sipas UMF nr. 8, datë 9.03.2018, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 22.02.2022, përfshirë primet e emisionit dhe rimbursimit të huave, studime dhe kërkime, koncesione, patenta, licenca dhe të ngjashme.

Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar. Përfshirja e tepricave të llogarive në vijim do të jepet sipas secilit prej nënzërave të këtij grupi të bilancit në Aneksin PF12, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi, u konstatua se Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” në Bashkinë Prrrenjas në

datën 31.12.2022 përbëhet nga 25 studime dhe kërkime, në vlerën 11,899,243 lekë, sipas Aneksit PF13, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se kjo llogari është pakësuar me vlerën e 2 projekteve në vlerën 2,476,240 lekë, të cilat janë shtuar investimeve të përfunduara nga të ardhurat e veta të Bashkisë Prrenjas, e cila ka prokuruar dhe lidhur kontratat për 2 projekte, sipas Aneksit PF13, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Detajet e llogarisë 202 “*Studime e kërkime*” janë paraqitur në Aneksin PF14 më poshtë:

Për këto asete njësia publike nuk ka përllogaritur norma amortizimi duke i qëndruar Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 05).

Në këto aktive nuk mund të amortizohen shpenzimet e projektimit. Për atë kohë sa objekti nuk ka filluar të ndërtohet, përfshirja në shpenzime në këtë periudhë nëpërmjet amortizimit është e gabuar.

## **2. Aktivët afatgjatë materiale, Inventarizimi i aktiveve:**

**Titulli i gjetjes:** Parregullsi dhe mangësi në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e Pasqyrave Financiare për vitin 2022.

**Situata:** Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive materiale afatgjatë sipas SKK 5, i përmirësuar. Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar. Përfshirja e tepërcave të llogarive në vijim do të jepet sipas secilit prej nënzërave të këtij grupi të bilancit:

Llogaritë e Klasës 21 “*Aktive Afatgjatë Materiale*”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2022, paraqiten në shumën 1,605,689,007 lekë. Në vitin ushtrimor paraardhës, vlera totale e AAM-ve ka qenë 1,678,957,253 lekë, me një pakësim të AAM-ve në shumën 73,268,246 lekë.

Shtesat në këtë nënrubrikë përfaqësojnë vlerën e investimeve të kryera ndër vite për ndërtime e rikonstruksione dhe shtesat gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë vetëm për vlerën e amortizimit. Detajet e nënrubrikës Aktive Materiale Afatgjatë janë paraqitur në Aneksin PF15, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në Bashkinë Prrenjas inventarizimi është kryer në bazë të urdhërave përkatës të titullarit, sipas të cilëve janë ngritur komisionet për inventarizimin fizik të aktiveve, në zbatim të pikave 73, 74 dhe pika 81 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Sipas pasqyrës së aktiveve, nxjerrjet jashtë përdorimit janë miratuar me VKB nr. 63 datë 30.12.2021, i konfirmuar nga prefektura me shkresën nr. 1444/1 datë 10.01.2022. Për vitin 2022, nga llogaria 218 “*Inventar ekonomik*”, janë nxjerrë jashtë përdorimit materiale në vlerën 828,280 lekë.

Nga rakordimi i urdhërit përkatës për nxjerrje jashtë përdorimit, me kontabilitetin dhe Aneksin e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve të qëndrueshme nuk rezultuan diferenca.

Llogaritë e inventareve paraqiten në vlerën totale 150,618,238 lekë, me shtesa gjatë vitit 2022 në vlerën 8,690,224 lekë, me një zbritje prej 5,002,464 lekë nga viti ushtrimor paraardhës, të cilat janë analizuar në vijim.

Llogaria 31 “*Materiale*”, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2022 paraqitet në vlerën 25,170,803 lekë, me një zbritje prej 2,938,714 lekë nga viti ushtrimor paraardhës dhe me shtesa në vlerën 4,709,504 lekë.

Llogaria 32 “*Inventar i imët*”, paraqitet në vlerën 25,170,803 lekë, me një zbritje prej 2,938,714 lekë nga viti ushtrimor paraardhës. Këto zbritje janë si rezultat i amortizimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të materialeve. Nga rakordimi i urdhërit përkatës për nxjerrjen jashtë përdorimit, me kontabilitetin dhe pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të Aktiveve të Qëndrueshme, nuk rezultuan diferenca përveçse i përket llogarisë 32 “*Inventar i imët*” dhe llogarisë 31 “*Materiale*”.

Nga analiza e kryer për llogarinë 32 “*Inventar i imët*”, në Bashkinë Prrenjas dhe Njësitë

Administrative përkatëse, gjatë vitit 2022 u konstatua një zbritje prej 5,002,464 lekë, e cila i përket materialeve të nxjerra jashtë përdorimit. Diferencat me pasqyrimin në bilanc i përkasin shtesave gjatë periudhës.

Vlerat e këtyre llogarive janë të barabarta me vlerat e dokumentuara në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës, si dhe me vlerat e paraqitura në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

#### **Nga auditimi, u konstatua se:**

**1.** Gjendja e llogarisë 210 “*Toka, Troje, Terrene*”, në datën 31.12.2022, paraqitet në vlerën 4,918,360 lekë, e pandryshuar nga viti ushtrimor paraardhës. Nga Bashkia Prrrenjas nuk është marrë asnjë masë për të inventarizuar, kontabilizuar dhe regjistruar në kadastër tokat, trojet dhe terrenet të cilat i janë transferuar me VKM-të përkatëse ish-komunave, në kuadër të inventarizimit dhe transferimit të pasurive publike. Për sa më sipër, llogaria 210 “*Toka, Troje, Terrene*”, në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë. Detajet e llogarisë 210 “*Toka, Troje, Terrene*” janë paraqitur në Aneksin PF16, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**2.** Gjendja e llogarisë 211 “*Pyje, Plantacione*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 22,928,105 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 24,118,659 lekë, me një shtesë në vlerën 1,190,554 lekë. Detajet e kësaj llogarie janë paraqitur në Aneksin PF17, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Në analizën e kësaj llogarie janë paraqitur edhe disa zëra, të cilët i përkasin llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*”, sipas Aneksit PF17/1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, në vlerën 6,701,384 lekë dhe disa zëra, sipas Aneksit PF17/2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, të cilët i përkasin llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*”, në vlerën 6,969,028 lekë. Për sa më sipër, llogaria 211 “*Pyje kullota plantacione*” në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë dhe është e mbivlerësuar për shumën 13,670,412 lekë. **3.** Gjendja e llogarisë 212 “*Ndërtime e konstruksione*”, në datën 31.12.2022, ka qenë 599,502,327 lekë, e pandryshuar nga viti ushtrimor parardhës. Në analitikun e kësaj llogarie, u konstatua se vlera është 637,614,096 lekë. Nga Bashkia Prrrenjas nuk është marrë asnjë masë për të inventarizuar, kontabilizuar dhe regjistruar në kadastër ndërtimet dhe konstruksionet të cilat i janë transferuar me VKM-të përkatëse ish-komunave, në kuadër të inventarizimit dhe transferimit të pasurive publike. Për sa më sipër, llogaria 212 “*Ndërtime e konstruksione*”, në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë. Detajet e llogarisë 212 “*Ndërtime e konstruksione*” janë paraqitur në Aneksin PF19, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**4.** Gjendja e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete vepra ujore*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 962,639,497 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 916,482,044 lekë, me një pakësim në vlerën 46,157,453 lekë. Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë vetëm për vlerën e amortizimit. Në analizën e kësaj llogarie janë paraqitur edhe disa zëra, të cilët i përkasin llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*”, sipas Aneksit PF20/1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, në vlerën 6,701,384 lekë. Gjithashtu, u konstatua se në llogarinë 213 “*Rrugë, rrjete vepra ujore*”, ka 40 zëra asetesh, në vlerën totale 717,837,015 lekë, të cilat duhet të kalojnë në administrim të shoqërive aksionare përkatëse për furnizimin me ujë të pijshëm. Këto zëra asetesh janë paraqitur në Aneksin PF23, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Nga Bashkia Prrrenjas nuk është marrë asnjë masë për të inventarizuar, kontabilizuar dhe regjistruar në kadastër rrugët, rrjetet dhe veprat ujore të cilat i janë transferuar me VKM-të përkatëse ish-komunave, në kuadër të inventarizimit dhe transferimit të pasurive publike. Detajet e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete vepra ujore*” janë paraqitur në Aneksin PF20, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për sa më sipër, llogaria 213 “*Rrugë, rrjete vepra ujore*” në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë dhe është e mbivlerësuar për shumën 10,064,005 lekë.

5. Gjendja e llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 14,099,639 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 10,168,721 lekë, me një pakësim në vlerën 3,930,918 lekë nga amortizimi dhe nxjerrjet jashtë përdorimit. Shtesat në këtë llogari kanë qenë 124,480 lekë, të cilat paraqesin vlerën e investimeve të kryera për instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës. Nga Bashkia Prrenjas, për këtë llogari nuk disponohet analizë dhe një pjesë e zërave përkatës të kësaj llogarie janë kontabilizuar gabim në llogarinë 215 “*Mjete transporti*”, duke e nënvlerësuar këtë llogari për vlerën 23,827,196 lekë. Për sa më sipër, llogaria 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*”, në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë dhe është e nënvlerësuar për shumën 23,827,196 lekë.

6. Gjendja e llogarisë 215 “*Mjete transporti*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 54,196,396 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 45,266,396 lekë, me një pakësim në vlerën 10,310,000 lekë. Me V.K.B nr. 55 datë 28.06.2022, e konfirmuar nga Prefektura Elbasan me shkresën nr. 840/1, datë 13.07.2022, janë nxjerrë jashtë përdorimit 4 automjete. Pakësimet në këtë llogari janë për vlerën e amortizimit, në shumën 23,452,942 lekë dhe shtesat në shumën 1,380,000 lekë janë për blerjen e një automjeti. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 21,813,454 lekë, duke zbritur vlerën e amortizimit 23,452,942 lekë. Vlera e paraqitur në bilanc është e barabartë me vlerën analitike. Nga auditimi i zërave të veçantë të kësaj llogarie, u konstatua se automjetet sipas Aneksit PF22, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, në vlerën 23,827,196 lekë, nuk janë mjete transporti, por makineri, të cilat duhet të regjistrohen në llogarinë përkatëse, 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*”. Për sa më sipër, llogaria 215 “*Mjete transporti*”, në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë dhe është e mbivlerësuar për shumën 23,827,196 lekë. Detajet e llogarisë 215 “*Mjete transporti*” janë paraqitur në Aneksin PF21, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

7. Gjendja e llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 52,433,140 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka është 51,604,860 lekë. Vlerat e pasqyruara në bilanc, përkatësisht 28,323,726 lekë për vitin 2022 dhe 36,440,007 lekë për vitin 2021, janë vlerat neto ku është zbritur amortizimi dhe nxjerrjet jashtë përdorimit. Vlerat përkatëse të llogarive inventariale, janë paraqitur në Aneksin PF18, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

8. Nga auditimi dhe testimi i Aktiveve Afatgjata Materiale, u konstatua se në regjistrat/librat e kontabilitetit të këtyre llogarive, për një pjesë të konsiderueshme të zërave nuk është pasqyruar vlera fillestare e aktiveve, por vetëm vlera e shpenzimeve të mëpasshme, për rikonstruksione ose përmirësimin e gjendjes së këtyre aktiveve. Kryesisht, kjo ka ndodhur për shkak se shumica e këtyre AAM nuk është pajisur me titull pronësie dhe ende nuk janë në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. Gjithashtu, paraqiten problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar e amortizimit, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar e shpenzimeve të mirëmbajtjes, data e daljes nga pronësia, etj. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivitetit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Këto llogari janë mbajtur në bilancin kontabël pa pasur një analizë të detajuar, ku të përcaktohet origjina e vlerës së aseteve. Nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës disponohet informacion vetëm për shtesat vjetore të llogarive 210, 211, 212, 213, 214 dhe 215. Fakti që nuk ka një regjistër konlabël për të gjitha AAM, e vështirëson më tej njohjen dhe verifikimin e

saktësisë së vlerave kontabël të këtyre llogarive.

Në kontabilizimin e këtyre aktiveve, nuk është marrë në konsideratë “Njohja fillestare”, por vetëm “Vlerësimi i mëpasshëm”, duke mos njohur origjinën e tyre. Mosnjohja e origjinës së aktiveve është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Pika 2, Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, etj.

Nga verifikimi i regjistrave të disponueshëm në Bashkinë Prrenjas, u konstatua se për llogaritë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 215 “Mjete transporti”, paraqiten problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar e amortizimit, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar e shpenzimeve të mirëmbajtjes, data e daljes nga pronësia, etj. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivitetit nuk përmbajnë të gjithë elementët e duhur, duke mospërmbushur kriteret e përcaktuara në pikën 30 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

➤ **Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Formati nr. 7/b) Viti 2022.**

Për vitin 2022, amortizimi i AQT-ve (Llogaria 219 “Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara”), nuk pasqyrohet në Aneksin e pozicionit financiar në bilanc, pasi AQT-të paraqiten me vlerën neto të tyre, por vlerat historike dhe vlerat neto janë paraqitur në formatin 7/a dhe 7/b (gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerë historike dhe vlerë neto, përkatësisht Anekset PF 24 dhe PF25). Llogaritja e amortizimit është bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pika 3.7 “Amortizimi”, si dhe UMFE nr. 08, datë 09.03.2019 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 22.02.2022. Nga auditimi i Bilancit, Formatit 7, a dhe b: “Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (a) dhe me vlerën neto (b)”, u konstatua se Amortizimi i Akumuluar në Bashkinë Prrenjas për Aktivet Afatgjata Materiale në fillim të vitit 2022 paraqitet për vlerën 321,872,094 lekë dhe në fund të vitit 2022 paraqitet për vlerën 571,033,153 lekë.

Amortizimi i aktiveve është llogaritur duke përdorur metodën e vlerës kontabël neto të kategorive përkatëse të aktiveve, të regjistruar në çelje të periudhë ushtrimore, shtesën e kostos së blerjes dhe zbritjen e vlerë kontabile neto të aktiveve të shitura, të dala jashtë përdorimit për kategoritë përkatëse të aktivitetit. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Normat e amortizimit të përdorura për vitin 2022 janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%

Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

Për aktivet në proces nuk është llogaritur amortizim, në përputhje me përcaktimet ligjore. Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata janë paraqitur përkatësisht në Aneksin PF23 sipas kostos historike dhe PF24 në vlerën neto.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe Buxhetit, z. A.B. dhe Drejtori i Financës dhe Buxhetit/Nënpunësi Zbatues, znj. S.K..

Me shkresën nr. 1293 prot., datë 09.05.2023 të Bashkisë Prrenjas, protokolluar në KLSH me nr. 1173/32 prot., datë 11.05.2023, janë përcjellë kundërshtitë për Projekt Raportin e Auditimit, dërguar në Bashkinë Prrenjas me shkresën nr. 1173/3, datë 13.04.2023, të nënshkruara nga z. A.B., me detyrë Përgjegjës i sektorit të financës dhe znj. S.K., me detyrë Drejtor i financës dhe buxhetit/Nënpunës zbatues në Bashkinë Prrenjas.

### **Pretendimi i Subjektit:**

#### ***I. Në lidhje me pikën 2 për aktivet afatgjata materiale ju informojmë se:***

*Të dhënat e llogarisë 211 “Pyje kullota plantacione” të marra nga Rregjistri i Aseteve të bashkisë Prrenjas duke shtuar Vendndodhjen dhe Vitin janë si më poshtë:*

*Pajisja me tituj pronësie është detyrë e Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, dhe Aplikimi i Projekteve, Sektori i Aseteve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave dhe janë në proces regjistrimi.*

*Të dhënat e llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione” duke shtuar vendndodhjen e aktivitetit dhe vitin e ndërtimit.*

*Në lidhje me llogarinë 212 “Ndërtime dhe konstruksione”, për vlerën e nënvlerësuar në shumën 38,111,769 lekë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit është në proces sistemimi, pasi problemet janë të trashëguara nga ish-komunat.*

*Detajet e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore” duke shtuar Vendndodhjen dhe Vitin e ndërtimit.*

*Në lidhje me analitikun e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore” ju informojmë se; vlera e dhënë në bilanc me shumë 402,907,632 lekë paraqet shumën e amortizimit të akumuluar për vitin 2021 dhe 2022 për këtë llogari.*

*Në lidhje me 40 zërat e asetëve në vlerë totale 717,837,015 lekë për të cila duhen të kalojnë në administrim të shoqërive aksionere përkatëse për fundizim me ujë të pijshëm.*

*Bashkia Prrenjas nuk disponon një raport përfundimtar për transferimin e asetëve për të bërë zbritjen nga llogaria 2013 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në pasqyrat financiare 2022 të 40 objekteve.*

*Në lidhje me llogarinë 215 “Mjete transporti” disponojmë të dhënat.*

*Për llogarinë 215 “Mjete transporti”, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit është në proces sistemimi.*

### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me kundërshtitë e paraqitura, nga grupi i auditimit konstatohet se observacionet/ kundërshtitë apo argumentet e paraqitura janë të njëjta me ato të paraqitura për aktet e konstatimit, duke mos vënë përpara grupit të auditimit asnjë dokument, fakt, shkresë apo gjë tjetër të panjohur nga grupi i auditimit gjatë zhvillimit të auditimit në terren.

Kragas kësaj, nga grupi i auditimit theksohet se në të gjitha rastet, për asetet duhet të fillojë vlerësimi, më pas të bëhet kontabilizimi dhe regjistrimi i tyre në kadasër.

Në një pjesë të madhe të asetëve, si vlerë figuron vetëm vlera e rikonstruksioneve të bëra gjatë viteve, por mungon vlera fillestare e asetëve.

**Për sa më sipër, kundërshtitë e paraqitura nuk merren në konsideratë.**

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.3., faqe 42-64.*

**Kriteri:** Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e

aktiveve në sektorin publik”; UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, UMF nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara”; SKK nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pikat 55, 56, 57; SNK nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35, etj.

**Ndikimi/Efekti:** Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve të Bashkisë Prrenjas.

**Shkaku:** Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi 1:** Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrave të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

**Rekomandimi 2:** Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e Urdhërave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara deri më sot, si dhe saktësimin e aseteve të inventarizuara, përkatësisht për zërat: 210 “*Toka, troje terrene*”; 211 “*Pyje, Kullota, Plantacione*”; 212 “*Ndërtime e konstruksione*”; 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”; 214 “*Instalime teknike, makineri e pajisje*” dhe 215 “*Mjete transporti*”. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë vlera fillestare dhe kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivitetit përkatës, sipas rastit.

**Rekomandimi 3:** Nga Bashkia Prrenjas, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të merren masa për të sistemuar llogaritë 210 “*Toka, Troje, Terrene*”, 211 “*Pyje, Plantacione*”, 212 “*Ndërtime e konstruksione*”, 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” dhe 215 “*Mjete transporti*”, sipas vlerave të specifikuara më sipër.

### **3. Aktivët Afatgjata Financiare:**

**Titulli i gjetjes:** Mangësi në kontabilizimin e aktiveve afatgjata financiare në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për periudhën e audituar.

**Situata:** Nga auditimi i dokumenteve financiare dhe verifikimi në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe QKB-së, u konstatua se Bashkia Prrenjas, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2022 paraqitet si:

- Aksionare me 42.08% të aksioneve të Shoqërisë U.K.L.P. Sh.A., me NUIS J...V e cila është shoqëri aksionare me objekt “*Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm, etj.*”. Numri i aksioneve është 415,720 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 415,720,167 lekë, nga e cila vlera 82,652,660 lekë përbën kapitalin e shlyer. Kjo shoqëri është themeluar në datën 16.08.2022. Bashkia Prrenjas zotëron 174,947 aksione, me vlerë nominale 174,947,000 lekë. Këto të drejta, Bashkia Prrenjas i ka trashëguar nga reforma territoriale, në datën 30.05.2016, si përfituese e pasurisë së ish-komunave të cilat janë konsoliduar në Bashkinë e re të Prrenjasit.
- Aksionare me 12.9% të aksioneve të Shoqërisë U.K.P. Sh.A., me NUIS M...U e cila është shoqëri aksionare me objekt “*Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm, etj.*”. Numri i aksioneve është 100,000 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 10,000,000 lekë, nga e cila vlera 5,100,000 lekë përbën kapitalin e shlyer. Kjo shoqëri është themeluar në datën 26.07.2022. Bashkia Prrenjas zotëron 12,900 aksione, me vlerë nominale 1,290,000 lekë.



- Aksionare me 8% të aksioneve të Shoqërisë E.E. Sh.A., me NUIS M...T e cila është shoqëri aksionare me objekt “Grumbullimi, rehabilitimi dhe perpunimi i mbetjeve të ndryshme, organike, të ngurta, të gjelberta,..etj.”. Numri i aksioneve është 7 me vlerë nominale 500,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 3,500,000 lekë, e cila përbën kapital të shlyer. Kjo shoqëri është themeluar në datën 18.11.2021. Bashkia Prrrenjas zotëron 1 aksion, me vlerë nominale 500,000 lekë.

Vlera totale 176,737,000 lekë nuk është paraqitur në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël për vitin ushtrimor 2022, konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”.

Për sa më sipër, llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” nuk paraqet vlerën reale për shumën 176,737,000 lekë (174,947,000 lekë nga Shoqëria U.K.L.P. Sh.A., 1,290,000 lekë nga Shoqëria U.K.P. Sh.A. dhe 500,000 lekë nga Shoqëria E.E. Sh.A.), në kundërshtim me UMF nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar”, me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe Aktivet afatgjata jo materiale” pikat 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”.

Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël për vlerën e aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje në shumën 176,737,000 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar dhe për këtë procedurë mban përgjegjësi, përgjegjësi i Sektorit të Financës z. A.B. dhe Drejtori i Financës dhe Buxhetit, znj. S.K.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.3., faqe 42-64.

**Kriteri:** Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”; UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, UMF nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar”; SKK nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pikat 55, 56, 57; SNK nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35, etj.

**Ndikimi/Efekti:** Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve financiare të Bashkisë Prrrenjas.

**Shkak:** Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e aktiveve financiare.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Nga Bashkia Prrrenjas, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të shoqërive: **1.** “U.K.L.P. Sh.A.”, me NUIS J...V, për 42.08% të aksioneve, gjithsej 174,947 aksione, me vlerë nominale 174,947,000 lekë; **2.** “U.K.P. Sh.A.”, me NUIS M...U, për 12.9% të aksioneve, gjithsej 12,900 aksione, me vlerë nominale 1,290,000 lekë; **3.** “E.E. Sh.A.”, me NUIS M...T, për 8% të aksioneve, gjithsej 1 aksion, me vlerë nominale 500,000 lekë, si dhe regjistrimin e kapitalit aksionar të këtyre shoqërive në shumën totale **176,737,000 lekë** në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**Titulli i gjetjes:** Mosparaqitje e saktë e vlerës së llogarive 230/231 “Investime”.

**Situata: 4. Investimet:** Gjendja e llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2021 paraqitet përkatësisht 142,534,635 lekë për llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe 0 lekë për

llogarinë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale”. Në datën 31.12.2022 paraqitet përkatësisht 190,742,803 lekë për llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe 0 lekë për llogarinë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale”, me një rritje prej 48,208,168 lekë nga viti i kaluar. Detajet e këtyre llogarive janë paraqitur në Aneksin PF26 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Vlera e prokuruar për investimet gjatë vitit 2022 ka qenë 429,060,344 lekë, nga të cilat 337,346,089 lekë me fonde të deleguara dhe 91,714,244 lekë nga të ardhurat e veta.

Si rregull, këto llogari paraqesin vlerën e investimeve në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 “Aktive afatgjata materiale”. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: Sektori i financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese në marrjen në dorëzim të objekteve sipas kontratave përkatëse, për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2022, sipas aneksit nr. 9 pika 2. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kreu II, pikat 6 dhe 15-18, kreu III, pika 33, 36, Aneksi 1, pika 2, “Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël)”, “Aktive afatgjata materiale”, etj.

Për sa më sipër, zëri “Investime në proces”, i përbërë nga llogaritë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën reale, është nënvlerësuar për shumën 238,317,541 lekë, pasi duhet të pasqyronte vlerën 429,060,344 lekë, e cila përbëhet nga shuma e kontratave të lidhura, të cilat nuk kanë përfunduar dhe nuk janë marrë në dorëzim nga Bashkia Prrenjas, sipas Aneksit PF27, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në periudhën raportuese 2022, vlera faktike e investimeve të realizuara sipas listës së mësipërme ka qenë 429,060,344 lekë. Për sa më sipër, llogaritë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, në datën 31.12.2022 nuk paraqesin vlerën reale, pasi janë nënvlerësuar për shumën totale 238,317,541 lekë.

Kjo procedurë mospasqyrimi në zërin “Investime në proces”, për shumën 238,317,541 lekë, përbën shtrembërim të informacionit financiar dhe për këtë procedurë mban përgjegjësi përgjegjësi i Sektorit të Financës z. A.B. dhe Drejtori i Financës dhe Buxhetit znj. S.K..

Me shkresën nr. 1293 prot., datë 09.05.2023 të Bashkisë Prrenjas, protokolluar në KLSH me nr. 1173/32 prot., datë 11.05.2023, janë përcjellë kundërshtitë për Projekt Raportin e Auditimit, dërguar në Bashkinë Prrenjas me shkresën nr. 1173/3, datë 13.04.2023, të nënshkruara nga z. A.B., me detyrë Përgjegjës i sektorit të financës dhe znj. S.K., me detyrë Drejtor i financës dhe buxhetit/Nënpunës zbatues në Bashkinë Prrenjas.

#### **Pretendimi i Subjektit:**

##### **Kontratat e lidhura në vitet 2020-2022:**

**Për vitin 2020-2022,** janë kryer investime në total për 20 objekte, për vlerën totale të kontraktuar 429,060,344 lekë. Likuidimi në periudhat e mëparshme ka qenë në vlerën 229,442,021 lekë. Planifikimi për t’u likuiduar gjatë vitit 2022 ka qenë 190,618,323 lekë.

Për 6 (gjashtë) objekte me investim nga fondet të deleguar me Ministri linje, 4 (katër) prej këtyr investimeve kanë përfunduar, marre në dorëzim nga Bashkia Prrenjas me Akt kolaudim, situacion përfundimtar, certifikat e përkoshme e marrjes në dorëzim dhe likuiduar. Për 2 investime jemi në process që brënda afatit të përfundojnë dhe të merren në dorëzim nga Bashkia Prrenjas.

Për investimet me vundet e veta, të ardhurat dhe transfertat e bashkisë, këto investime kanë pasur financime për disa faza për vitet 2020-2022 për të cilat janë mbyllur nga bashkia duke marrë në dorëzim me situacion përfundimtar, akt kolaudim, certifikat e përkoshme e marrjes në dorëzim nga Bashkia.

#### **4. Investimet:**

Gjendja e llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2021 paraqitet përkatësisht 142,534,635 lekë për llogarinë 231

*“Investime për aktive afatgjata materiale” dhe 0 lekë për llogarinë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale”.*

*Në datën 31.12.2022 paraqitet përkatësisht 190,742,803 lekë për llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe 0 lekë për llogarinë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale”.*

*Në periudhën raportuese 2022, vlera faktike e investimeve të realizuara sipas listës së mësipërme ka qenë 190,618,323 lekë.*

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me kundërshtitë e paraqitura, nga grupi i auditimit konstatohet se observacionet/ kundërshtitë apo argumentet e paraqitura janë të njëjta me ato të paraqitura për aktet e konstatimit, duke mos vënë përpara grupit të auditimit asnjë dokument, fakt, shkresë apo gjë tjetër të panjohur nga grupi i auditimit gjatë zhvillimit të auditimit në terren.

**Për sa më sipër, kundërshtitë e paraqitura nuk merren në konsideratë.**

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.3., faqe 42-64.*

**Kriteri:** Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”; UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, UMF nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara”; SKK nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jomateriale” pikat 55, 56, 57; SNK nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35, etj.

**Ndikimi/Efekti:** Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e investimeve të Bashkisë Prrenjas.

**Shkaku:** Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike dhe Financës në Bashkinë Prrenjas, të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet ti evidentojë ato në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në vlerën e plotë dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave, t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

### ➤ **PASIVET**

#### **I. Pasivet Afat shkurtra**

**1. Llogari të pagueshme:** Në këtë grup llogarish paraqiten të gjitha detyrimet e njësive ekonomike ndaj të tretëve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve me pagesë të mëvonshme.

Në datën 31.12.2022, shuma e llogarive 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, 42 “Detyrime ndaj personelit”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, 435 “Sigurime shoqërore”, të 436 “Sigurime shoqërore”, është e barabartë me gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” në vlerën 55,814,401 lekë. Analiza e grupit të llogarive të pagueshme për vitin 2021 është paraqitur në Aneksin PF28, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2022 për Llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në bilanc paraqiten në vlerën 37,880,065 lekë. Në këtë llogari paraqiten detyrimet e prapambetura për t’u likuiduar në vitin 2023.

Analiza e Llogarisë 401 “Furnitorë për mallra, produkte e shërbime”, është paraqitur në

Aneksin PF29, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 42 “*Personeli e llogari të lidhura me to*”, analizuar e kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 13,007,747 lekë, përfaqëson detyrimet ndaj punonjësve për pagat e personelit për muajin dhjetor 2022. Në fund të vitit 2021 ka qenë 11,930,507 lekë, me një rritje në vlerën 1,077,240 lekë.

Llogaria 431 “*Detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa*”, analizuar e kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 581,377 lekë përfaqëson detyrimet për tatimin mbi pagat e personelit në muajin dhjetor 2022. Kjo vlerë është likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2023.

Llogaria 435 “*Sigurime shoqërore*”, e analizuar dhe kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 3,820,372 lekë përfaqëson detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore në muajin dhjetor 2022. Kjo vlerë është likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2023.

Llogaria 436 “*Sigurime shëndetësore*”, e analizuar dhe kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 524,840 lekë, përfaqëson detyrimet për kontributet e sigurimet shëndetësore në muajin dhjetor 2022. Kjo vlerë është likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2023.

Në mbyllje të periudhës raportuese, llogaritë kreditore 42; 431; 435 dhe 436 në vlerën totale 15,651,099 lekë, përfaqësojnë detyrime të njësisë publike Bashkia Prrenjas për pagat e personelit, kontribute për sigurime shoqërore, shëndetësore si dhe tatimin mbi pagë, të përlllogaritura për pagesë në muajin dhjetor 2022, të cilat janë likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2023.

#### **Detyrime të tjera afatshkurtra:**

Në këtë grup të detyrimeve afatshkurtra paraqiten shpenzimet e kryera nga njësia ekonomike, dhe që në zbatim të parimit të përputhjes së të ardhurave me shpenzimet, ende nuk janë njohur si shpenzime nga njësia ekonomike.

Po kështu, njësia ekonomike përfshin në këtë grup edhe të gjitha detyrimet e llogaritura për të paguar interesat e maturuara ekonomikisht. Llogaritë për detyrime të tjera afatshkurtra janë paraqitur në Aneksin PF30, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Titulli i gjetjes:** Mosmarrja në dorëzim e kontratave të investimeve të mbyllura, mbajtja e garancisë përtej limiteve kohore.

**Situata:** Gjendja e llogarisë 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” (nënlllogaria 4662104) në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 44,736,876 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 45,539,778 lekë ose me rritje në vlerën 802,902 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Në mënyrë analitike, Llogaria 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” në fund të vitit 2021 është paraqitur në Aneksin PF31, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi u konstatua se për objektet e përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Prrenjas, nuk është bërë zhblllokimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuara në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria Ekonomike dhe e Financës, nuk janë marrë masa për zhblllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

Veprimet dhe mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.3., faqe 42-64.

**Kriteri:** Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*” i ndryshuar, Kap II “*Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, të VKM nr. 3, datë 15.2.2001 “*Për Mbikëqyrjen dhe*

*Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit*” i ndryshuar, UMF nr. 30, datë 27.12.2001 “*Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikë*” i ndryshuar pikat 42-50 të tij, UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

**Ndikimi/Efekti:** Mosmarrja në dorëzim e objekteve janë verime të cilat nuk garantojnë nëse objekti është zbatuar sipas kushteve teknike të projekt/preventivave, si është realizuar dhe nëse është realizuar brenda kushteve teknike. Gjithashtu, moskryerja e këtij veprimi bën që nga Bashkia Prrenjas të mos bëhet vlerësimi i subjekteve mbi cilësinë e punimeve dhe nëse këto subjekte janë shoqëri të besueshme për kryerjen e punimeve me cilësi dhe në afatet të caktuar, si dhe vënia në vështirësi ekonomike e OE, të cilëve iu nevojiten fondet e ngurtësuar për të vazhduar veprimtarinë e tyre ekonomike.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor nga personat përgjegjës.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Prrenjas në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejojë likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zhbllokimin e fondeve të ngurtësuar.

Gjendja e llogarisë 4341 “*Operacione me shtetin (detyrime)*” në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 0 lekë, e pandryshuar nga viti i mëparshëm. Paraqitja në gjendjen 0 (zero) e kësaj llogarie është e gabuar dhe në kundërshtim me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, Kapitulli III, pika 32, ku specifikohet se “*Detyrimet të evidentohen në pasqyrat financiare, duke mbajtur parasysh njohjen në çastin e ndodhjes si shpenzime, pavarësisht nga data e pagesës së tyre nga llogaritë financiare*”.

Gjendja e llogarisë 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” në datën 31.12.2021 ka qenë në vlerën 39,372,750 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 30,668,138 lekë ose me zbritje në vlerën 8,704,612 lekë. Në mënyrë analitike, Llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” në fund të vitit 2021 është paraqitur në Aneksin PF32 për detyrimet e prapambetura nga investimet e FSHZH dhe në Aneksin PF33 për detyrimet e prapambetura nga fondet e Bashkisë Prrenjas, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Detyrimet nga ish-komunat dhe Bashkia Prrenjas, për financime me FSHZH-në janë në vlerën 23,245,810 lekë, detyrimet nga OSHEE-ja, të krijuara para vitit 2020, janë në vlerën 1,582,615 lekë dhe detyrimet ndaj OSHEE, për faturat e muajit dhjetor 2022, janë 5,839,713 lekë, në total 30,668,138 lekë.

#### ➤ **KAPITALI**

Sipas përcaktimit të bërë në SKK, kapitali rezulton si diferencë e aktiveve me detyrimet e njësisë ekonomike. Në zbatim të SKK 2 (shtojca 4), njësia ekonomike duhet të pasqyrojë, bazuar në parimin e materialitetit, elementët përbërës të kapitaleve të veta.

Gjendja e llogarisë 101 “*Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar*” (Kapitali i nënshkruar) në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 1,952,388,431 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 1,927,380,630 lekë ose me zbritje në vlerën 25,007,801 lekë.

Gjendja e llogarisë 85 “*Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore*” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 101,612,424 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë

115,905,330 lekë ose me rritje në vlerën 14,292,906 lekë. Në këtë zë paraqitet rezultati i periudhës rrjedhëse ushtrimore të njësisë raportuese ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Llogaritë 105 “*Teprica e Granteve kapitale të brendshme*” dhe 106 “*Teprica e Granteve kapitale të huaja*”, si për periudhën ushtrimore paraardhëse, ashtu edhe për periudhën ushtrimore të mbyllur, janë me vlerën 0 (zero).

Grantet kapitale të brendshme mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces të institucioneve (të papërfunduara ose të pamarra në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e llogarive 23. Këto mbyllen (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim.

Të ardhurat dhe shpenzimet e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë Prrenjas në datën 31.12.2022, janë të kuadruara me Degën e Thesarit Librazhd. Pasqyra e performancës financiare në fund të vitit 2021 është paraqitur në Aneksin PF34, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Sipas SKK nr. 2, në pasqyrën e performancës duhet të përfshihen të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura në një periudhë kontabël.

Ky standard siguron trajtim të ndryshëm për rrethanat në vijim:

a. Efektet e korigjimeve të gabimeve dhe ndryshimet në politikat kontabël paraqiten si rregullime retrospektive të periudhave të mëparshme dhe jo si pjesë e fitimit ose humbjes në periudhën në të cilën ato lindin (*SKK 1 - Parimet e Përgjithshme për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare*);

b. Si pjesë e të ardhurave gjithëpërfshirëse, jashtë fitimit/ humbjes së vitit, njihen katër lloje të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse;

i. fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga përkthimi i pasqyrave financiare të një veprimtarie të huaj (*SKK 12 - Efekti i ndryshimit të kurseve të këmbimit*);

ii. fitimet që rrjedhin nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale në vlerë të drejtë sipas trajtimit alternativ të lejuar (*SKK 5 - Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale*);

iii. fitimet që rrjedhin nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje (*SKK 3 “Instrumentet Financiare”*);

iv. Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet

Emërtimet e zërave duhet të respektohen, megjithëse mund të shtohen zëra të tjerë ose nënkategori të zërave, nëse ato ndikojnë në përmirësimin e qartësisë dhe lexueshmërisë së pasqyrës së performancës.

Pasqyra e performancës tregon, minimalisht, zërat që paraqesin shumat të cilat përbëjnë fitimin ose humbjen. Fitimi ose humbja është rreshti i fundit i kësaj pasqyre.

#### ➤ **TË ARDHURAT**

##### **1. Të ardhura nga taksat dhe tatimet:**

Llogaria 70 “*Të ardhurat nga taksat e tatimet*”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 69,229,326 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 71,553,200 lekë ose me ulje në vlerën 22,260,874 lekë. Të ardhurat nga taksat e tatimet janë paraqitur të detajuara në Aneksin PF35, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 71 “*Të ardhura jotatimore*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 21,127,654 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 24,762,524 lekë ose me rritje në vlerën 3,634,870 lekë. Të ardhurat jotatimore janë paraqitur të detajuara në Aneksin PF36, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri.

## 2. Të ardhura të tjera:

Llogaria 72 “Grante korente”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 767,687,849 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 797,172,233 lekë ose me rritje në vlerën 29,484,384 lekë.

Grantet korente, të ardhurat e tjera dhe ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve janë paraqitur të detajuara në Aneksin PF37, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

### ➤ **SHPENZIMET**

#### **1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:**

Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 170,267,758 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 174,939,138 lekë ose me rritje në vlerën 4,671,380 lekë.

Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 28,454,158 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 29,167,213 lekë ose me rritje në vlerën 713,055 lekë.

Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Librazhd për të njëjtën vlerë. Shpenzimet për pagat dhe kontributet shoqërore e shëndetësore janë paraqitur në Aneksin PF38, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### ➤ **Testimi i llogarisë 600 “Paga dhe shpërblime”**

Për vitin 2022 numri i punonjësve është miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 04 datë 20.01.2022. Numri i miratuar i punonjësve të Bashkisë Prrrenjas, funksioneve të transferura dhe gjendjes civile ka qenë 332 punonjës. Sipas listëpagesave janë paguar në total mesatarisht 322 punonjës për Bashkinë Prrrenjas. Sa më sipër, nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve.

Numri i punonjësve sipas listëpagesave është paraqitur në Aneksin PF39, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Numri i punonjësve sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 69 datë 30.12.2021 është i ndarë si më poshtë:

Administrata e Bashkisë	183 punonjës
Arsimi Parashkollor	69 punonjës
Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin	14 punonjës
Mirëmbajtja e Rrugëve dhe Transporti	35 punonjës
Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	9 punonjës
Ujitja dhe Kullimi	2 punonjës
Gjendja Civile	4 punonjës
Punonjës me kontratë “Shtëpia e të moshuarve”	3 punonjës
Punonjës me kontratë(me afat/sezonale)	10 punonjës
Punonjës Projekti “Tungjatjeta Jetë”	3 punonjës

**Totali:** **332 punonjës**

Sipas listëpagesave të vitit 2022 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listëpagesat dhe përmbledhësja e listëpagesave janë nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe nga Kryetari i Bashkisë Prrrenjas.

#### **Auditimi me zgjedhje i disa dosjeve të personelit (me arsim të lartë).**

Në auditimin e dosjeve të personelit krahasuar me nivelin e klasave, kategorinë, pagën e grupit, shtesat për vjetërsi, vështirësitë, pozicionin, etj, u konstatua se janë në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore të VKM-së nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore si dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar dhe në dosjet personale të nëpunësve administrohet:

- Dokumenti i identifikimit (fotokopje letërnjoftimi); dokumenti mbi gjendjen civile (certifikata e gjendjes familjare); dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor në fushën e

studimeve (fotokopje e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave); dokumenti i gjendjes gjyqësore (dëshmi penalteti); raporti mjeko ligjor; librezë pune; fotografi; CV; letër motivimi; dëshmi të tjera kualifikimi. Disa nga dosjet që u audituan janë paraqitur në Aneksin PF40, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### ➤ **Hartimi i listëpagesave për vitin 2022**

Me përzgjedhje u audituan listëpagesat e muajve janar, shtator dhe dhjetor 2022, nga ku u konstatua se janë plotësuar konform rregullave të përcaktuara. Listëpagesat janë plotësuar mbi bazën e listëprezencave mujore.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Prrenjas, janë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 “*Për tatimin mbi të ardhurat*”, me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “*Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH*”.

Sipas listëpagesave të muajve janar, shtator dhe dhjetor 2022 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listëpagesat dhe përmbledhësja e listëpagesave janë nënshkruar nga Drejtori i Finances dhe Buxhetit znj. S.K. dhe nga Kryetari i Bashkisë Prrenjas.

Janë mbajtur listëprezencat, të cilat janë nënshkruar nga Përgjegjëse e sektorit të Burimeve Njerëzore, znj. S.D. nga Kryetari Bashkisë z. N.B.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Prrenjas, janë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 “*Për tatimin mbi të ardhurat*”, me ndryshime dhe Ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “*Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH*”.

## **2. Blerje mallra dhe shërbime:**

Përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

Llogaria 602 “*Blerje mallra dhe shërbime*”, në datën 31.12.2021 ka qenë në vlerën 77,805,288 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 83,517,746 lekë ose me rritje në vlerën 5,712,458 lekë.

Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Librazhd me të njëjtën vlerë. Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime janë paraqitur në Aneksin PF41, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### ➤ **Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës, në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara elektronikisht nga nëpunësi autorizues dhe zbatues, të konfirmuara nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura me vule elektronike nga të dyja palët.

Urdhër-shpenzimet janë përpiluar në bazë të dokumenteve vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit, si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesat, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzime përputhen me vlerat e dokumenteve financiare që mbështesin shpenzimin përkatës.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadron me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas



destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

➤ **Transaksionet financiare nëpërmjet arkës.**

Nga auditimi i dokumentacionit të veprimeve nëpërmjet arkës rezultoi se:

Me arkë janë kryer transaksione financiare, si arkëtim të ardhurash për detyrime nga taksa e tokës bujqësore, taksat e tarifave familjare, për të cilat janë prerë mandate arkëtimi të plotësuar me të gjitha ekstremitetet, sipas faturës për arkëtim e lëshuar nga sektori i taksave dhe tarifave vendore, arkëtim gjykoje të policisë Bashkiake. Nga arka nuk është kryer asnjë transaksion pagese. Për veprimet me arkë është mbajtur libri i arkës, i cili është mbyllur për çdo muaj dhe është nënshkruar nga personi përgjegjës për arkëtim dhe specialiste e financës e ngarkuar për mbajtjen e ditarit të arkës.

**Për vitin 2022,** janë prerë Mandat Arkëtime:

1. Bashkia Prrrenjas: Mandat arkëtimi fillon me nr. 1, datë 05.01.2022 dhe mbyllet me nr. 5633 datë 30.12.2022, në vlerën 26,464,989 lekë. Libri i arkës është mbyllur me mandat arkëtimi nr. 5633 datë 30.12.2022. Mandat pagesa fillon me nr. 1 dhe mbaron me nr. 170, në shumën 26,464,989 lekë.

2. Njësia Administrative Stravaj: Mandat arkëtimi fillon me nr. 1, datë 05.01.2022 dhe mbyllet me nr. 686, datë 30.12.2022, në vlerën 957,675 lekë. Libri i arkës është mbyllur me mandat arkëtimi nr. 686, datë 30.12.2022. Mandat pagesa fillon me nr. 1 dhe mbaron me nr. 12, në shumën 957,675 lekë.

3. Njësia Administrative Rrajcë: Mandat arkëtimi fillon me nr. 1, datë 05.01.2022 dhe mbyllet me nr. 1270, datë 30.12.2022, në vlerën 12,136,330 lekë. Libri i arkës është mbyllur me mandat arkëtimi nr. 1270, datë 30.12.2022. Mandat pagesa fillon me nr. 1 dhe mbaron me nr. 25 në shumën 12,136,330 lekë.

4. Njësia Administrative Qukës: Mandat arkëtimi fillon me nr. 1, datë 05.01.2022 dhe mbyllet me nr. 2406, datë 30.12.2022 në vlerën 6,282,437 lekë. Libri i arkës është mbyllur me mandat arkëtimi nr. 2406, datë 30.12.2022. Mandat pagesa fillon me nr. 1 dhe mbaron me nr. 20 në shumën 6,282,437 lekë.

Nga auditimi i librit të arkave dhe ditarit të arkës konstatohet se të ardhurat nga arkëtimet e kryera për vitin 2022 janë derdhur totalisht në mënyrë periodike në bankë dhe gjendja e arkës në fund të çdo muaji dhe në fund të çdo viti është 0 (zero) lekë. Gjithashtu, është mbajtur ditari i arkës në formën klasike kontabël, i cili rezulton i kuadruar. Përfshirja e shumës së të ardhurave në pasqyrat financiare është bërë duke u bazuar në vijueshmërinë kontabël dhe në përputhje me VKM-në nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, si dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pikat 63, 64. Nga Drejtoria e Financës janë kryer akt-rakordimet mujore dhe vjetore me Degën e Thesarit Librazhd për të ardhurat.

**3. Subvencionet:**

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Prrrenjas nuk ka pasur subvencione.

**4. Transferimet korente:**

Përfshihen transferimet për nivele të ndryshme të qeverisë për institucione të ndryshme qeveritare. Transferime korente, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 483,327,564 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 479,675,863 lekë ose me ulje në vlerën 3,651,701 lekë.

**5. Shpenzimet financiare:**

Përfshihen transferimet për nivele të ndryshme të qeverisë për institucione të ndryshme qeveritare. Shpenzime financiare, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 0 lekë edhe për vitin 2022 në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 0 (zero) lekë.

➤ **Kontratat e lidhura për vitin 2022**

**Titulli i gjetjes:** Probleme në lidhje me kryerjen e veprimeve kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizmit të aktivitetit.

**Situata:** Për vitin 2022, janë kryer investime në total për 20 objekte, për vlerën totale të kontraktuar 429,060,344 lekë. Likuidimi në periudhat e mëparshme ka qenë në vlerën 229,442,021 lekë. Planifikimi për t'u likuiduar gjatë vitit 2022 ka qenë 190,618,323 lekë.

Me fonde të deleguara nga Qeveria kanë qenë gjithsej 6 objekte, në vlerën totale të kontraktuar 337,346,089 lekë. Likuidimi në periudhat e mëparshme ka qenë për vlerën 239,955,355 lekë dhe realizuar për gjatë vitit 2022 në vlerën 97,390,734 lekë.

Me fondet e veta kanë qenë gjithsej 14 objekte, për vlerë totale të kontraktuar 91,714,255 lekë. Likuidimi në vitin 2022 është realizuar në vlerën 89,160,441 lekë. Vlera e mbetur për t'u financuar ka qenë 2,553,814 lekë.

Kontratat e lidhura për vitin 2022 janë paraqitur në Aneksin PF42, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera, nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizmit të aktivitetit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2021 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, ku vlera e tyre e mbetur e palikuiduar nuk është evidentuar në kontabilitet në llogarinë 476 "Të ardhura të caktuara për t'u përdorur".

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik", Kreu I, "Të përgjithshme", pika 8, Kreu II, "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pikat 15/a, b, c, 18/a, b dhe Kreu III, "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 32.

Për sa më sipër, përgjegjësia është e z. N.B., me funksion Kryetar i Bashkisë Prrenjas, znj. S.K., Drejtor i Financës dhe Buxhetit dhe z. A.B., me detyrë përgjegjës i zyrës së financës.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.3., faqe 42-64.

**Kriteri:** Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre" i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, UMF nr. 64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara"; SKK nr. 5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jomateriale" pikat 55, 56, 57; SNK nr. 28 "Investime në Pjesëmarrje" pika 35, etj.

**Ndikimi/Efekti:** Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve të Bashkisë Prrenjas.

**Shkaku:** Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Me çeljen e fondeve/mbërritjen e shkresës së dërguar nga MFE për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve, të kryhet veprimi kontabël për shumat përkatëse në debi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe në kredi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”.

**Me konstatimin e shpenzimit,** (mbërritja e faturës shoqëruar me situacion) të bëhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të llogarisë 404 “Furnitorë për investime”.

**Në momentin e pagesave** të faturave, të kryhet kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 “Furnitorë për investime” dhe në kredi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”.

**Në fund të vitit ushtrimor,** për fondet e përdorura për **investimet e papërfunduara/në proces,** të kryhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”, në kredi të llogarisë 720 “Grant korrent i brendshëm” dhe në kredi të llogarisë 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.

**Me përfundimin e investimit,** të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës të bëhet kapitalizmi i aktivitetit (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhet prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”.

**Me kapitalizmin e aktivitetit,** (për aktivitetin e marra në dorëzim), të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”, në kredi llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për fondet buxhetore të përdorura për investime, në kredi të llogarisë 1011 “Shtesa të fondit bazë” dhe në debi të llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për vlerën e aktiveve të blera.

## **2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve**

### **2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrimit të prokurimeve.**

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimor. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësi vendore për punë, shërbime dhe mallra, të cilat janë miratuar me Vendim të KB sipas viteve përkatëse, bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

### **2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.**

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe dokumentacionin elektronik të marrë nga sistemi SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Prrenjas (regjistrat e parashikimit dhe realizimit), për periudhën 01.01.2018-31.12.2022, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën më poshtë:

<b>Procedura 01.01.2018-31.12.2022</b>	<b>Nr.</b>	<b>Vlera e Fondit Limit</b>	<b>Vlera e Kontraktuar</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>94</b>	<b>968,088,891</b>	<b>836,644,250</b>
- Të hapura	15	711,067,367	612,544,145
- Kërkesë me propozim/E hapur e thjeshtuar	77	246,343,136	214,509,905
- Shërbim konsulence	2	10,678,388	9,590,200
<b>Sipas objekteve</b>	<b>94</b>	<b>968,088,891</b>	<b>836,644,250</b>
- Objekte në fushën e investimeve	38	743,942,512	639,245,288
- Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	56	224,146,379	197,398,962

**Burimi:** Hartuar nga grupi i KLSH-së, sipas të dhënave të Bashkisë Prrenjas

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme, për periudhën 01.01.2018-31.12.2022, janë realizuar gjithsej **94** procedura me fond limit 968,088 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 836,644 mijë lekë, me një diferencë për vlerën 131,444 mijë lekë ose 14%, nga e cila: **për vitin 2018** janë realizuar gjithsej **15** procedura me fond limit 86,579 mijë lekë dhe vlerë kontrate 82,785 mijë lekë, për **vitin 2019** janë realizuar **21** procedura me fond limit 307,330 mijë lekë dhe vlerë kontrate 284,451 mijë lekë, për **vitin 2020** janë realizuar **23** procedura me fond limit 258,219 mijë lekë dhe vlerë kontrate 226,365 mijë lekë, për **vitin 2021** janë realizuar **17** procedura me fond limit 161,548 mijë lekë dhe vlerë kontrate 109,098 mijë lekë, dhe për **vitin 2022** janë realizuar **18** procedura me fond limit 154,411 mijë lekë dhe vlerë kontrate 133,942 mijë lekë.

Në procedura kanë marrë pjesë **463** OE/BOE dhe janë Skualifikuar **187** OE/BOE ose 40%.

Sipas llojit të aktivitet, konstatohet se në fushën e ndërtimit (investime), janë **38** procedura me fond limit 743,942 mijë lekë ose 76.8% e kontratave të lidhura dhe në të tjera janë **56** procedura me fond limit 224,146 mijë lekë.

Procedura me 1 OE janë gjithsej **27** procedura ose 28% e procedurave të zhvilluara, ndërsa procedura me 1 OE të kualifikuar janë 49 procedura, ose 52% e tyre, veprime të cilat tregojnë se kriteret e aplikuara nga AK Bashkia Prrenjas janë të rënduara të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në uljen e numrit të operatorëve të kualifikuar.

Mbi bazën e materialitetit dhe riskut të llogaritur nga grupi i auditimit, nga **94** procedura me fond limit 968,088 mijë lekë janë vlerësuar për auditim **36** procedura me fond limit 838,495 mijë lekë ose 86.6% e fondit limit, ku shkeljet sipas procedurave dhe problematikave paraqiten më poshtë.

Prokurimet e zhvilluara nga Bashkia Prrenjas për periudhën 01.01.2018-31.12.2022, janë paraqitur në Aneksin P1, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

#### **Procedurat e periudhës 01.01.2018-31.12.2018**

Për periudhën 01.01.2018-31.12.2018, nga Bashkia Prrenjas referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve janë kryer gjithsej **15** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 86,579 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 82,785 mijë lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 3,793 mijë lekë pa TVSH ose 4.4%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën më poshtë:

<b>Procedura 01.01.2018-31.12.2018</b>	<b>Nr.</b>	<b>Vlera e Fondit Limit</b>	<b>Vlera e Kontraktuar</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>15</b>	<b>86,579,100</b>	<b>82,785,515</b>
- Të hapura	2	42,420,875	42,064,516
- Kërkesë me propozim	13	44,158,225	40,720,999
<b>Sipas objekteve</b>	<b>15</b>	<b>86,579,100</b>	<b>82,785,515</b>
- Objekte në fushën e investimeve	6	61,721,238	60,616,047
- Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	9	24,857,862	22,169,468

**Burimi:** Hartuar nga grupi i KLSH-së, sipas të dhënave të Bashkisë Prrenjas

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **50** OE/BOE, nga të cilat janë Skualifikuar **17** OE/BOE. Procedura me 1 OE janë gjithsej **5** ose 30% e procedurave të zhvilluara, ndërsa procedura me 1 OE të kualifikuar janë 10 ose 58% e tyre, veprime të cilat tregojnë se kriteret e aplikuara nga AK Bashkia Prrenjas janë të rënduara të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në uljen e numrit të operatorëve të kualifikuar.

### **Procedurat e periudhës 01.01.2019-31.12.2019**

Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, nga Bashkia Prrenjas referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve janë kryer gjithsej **20** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 307,330 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 284,451 mijë lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 22,879 mijë lekë pa TVSH ose 7.5%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënave janë në pasqyrën më poshtë:

<b>Procedura 01.01.2019-31.12.2019</b>	<b>Nr.</b>	<b>Vlera e Fondit Limit</b>	<b>Vlera e Kontraktuar</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>21</b>	<b>307,330,363</b>	<b>284,451,165</b>
- Të hapura	4	261,220,644	247,385,456
- Kërkesë me propozim	15	44,494,825	35,455,709
- Shërbim konsulence	1	1,614,894	1,610,000
<b>Sipas objekteve</b>	<b>21</b>	<b>307,330,363</b>	<b>284,451,165</b>
- Objekte në fushën e investimeve	8	206,800,749	199,380,012
- Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	13	100,529,614	85,071,153

**Burimi:** Hartuar nga grupi i KLSH-së, sipas të dhënave të Bashkisë Prrenjas

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **115** OE/BOE, nga të cilat janë Skualifikuar **63** OE/BOE. Procedura me 1 OE janë gjithsej **2** ose 9% e procedurave të zhvilluara, ndërsa procedura me 1 OE të kualifikuar janë 9 ose 43% e tyre, veprime të cilat tregojnë se kriteret e aplikuar nga AK Bashkia Prrenjas janë të rënduara të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në uljen e numrit të operatorëve të kualifikuar.

### **Procedurat e periudhës 01.01.2020-31.12.2020**

Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, nga Bashkia Prrenjas referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej **23** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 258,219 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 226,365 mijë lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 31,853 mijë lekë pa TVSH ose 13%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënave janë në pasqyrën si vijon:

<b>Procedura 01.01.2020-31.12.2020</b>	<b>Nr.</b>	<b>Vlera e Fondit Limit</b>	<b>Vlera e Kontraktuar</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>23</b>	<b>258,219,029</b>	<b>226,365,726</b>
- Të hapura	5	207,811,360	185,094,256
- Kërkesë me propozim	18	50,407,669	41,271,470
<b>Sipas objekteve</b>	<b>23</b>	<b>258,219,029</b>	<b>226,365,726</b>
- Objekte në fushën e investimeve	11	231,674,309	203,265,078
- Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	10	26,544,720	23,100,648

**Burimi:** Hartuar nga grupi i KLSH-së, sipas të dhënave të Bashkisë Prrenjas

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **117** OE/BOE, nga të cilat janë skualifikuar **43** OE/BOE. Procedura me 1 OE janë gjithsej **6** ose 26% e procedurave të zhvilluara, ndërsa procedura me 1 OE të kualifikuar janë 10 ose 43% e tyre, veprime të cilat tregojnë se kriteret e aplikuar nga AK Bashkia Prrenjas janë të rënduara të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në uljen e numrit të operatorëve të kualifikuar.

### **Procedurat e periudhës 01.01.2021-31.12.2021**

Për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, nga Bashkia Prrenjas referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve janë kryer gjithsej **17** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 161,548 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 109,098 mijë lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 52,153 mijë lekë pa TVSH ose 33%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënave janë në pasqyrën si vijon:

<b>Procedura 01.01.2021-31.12.2021</b>	<b>Nr.</b>	<b>Vlera e Fondit Limit</b>	<b>Vlera e Kontraktuar</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>17</b>	<b>161,548,855</b>	<b>109,098,963</b>
- Të hapura	2	96,303,728	52,936,091
- Kërkesë me propozim/E hapur e thjeshtuar/me lote	14	56,181,633	48,182,672
- Shërbim Konsulence me lote	1	9,063,494	7,980,200
<b>Sipas objekteve</b>	<b>17</b>	<b>161,548,855</b>	<b>109,098,963</b>
- Objekte në fushën e investimeve	7	127,010,248	78,216,651
- Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	10	34,538,607	30,882,312

**Burimi:** Hartuar nga grupi i KLSH-së, sipas të dhënave të Bashkisë Prrenjas

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **123** OE/BOE, nga të cilat janë Skualifikuar **45** OE/BOE. Procedura me 1 OE janë gjithsej **6** procedura ose 24% e procedurave të zhvilluara, ndërsa procedura me 1 OE të kualifikuar janë 7 ose 28% e tyre, veprime të cilat tregojnë se kriteret e aplikuar nga AK Bashkia Prrenjas janë të rënduara të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në uljen e numrit të operatorëve të kualifikuar.

#### **Procedurat e periudhës 01.01.2022-31.12.2022**

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, nga Bashkia Prrenjas referuar të dhënave të regjistrimit të prokurimeve janë kryer gjithsej **17** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 161,548 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 109,098 mijë lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 52,153 mijë lekë pa TVSH ose 33%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënave janë në pasqyrën si vijon:

<b>Procedura 01.01.2022-31.12.2022</b>	<b>Nr.</b>	<b>Vlera e Fondit Limit</b>	<b>Vlera e Kontraktuar</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>18</b>	<b>154,411,544</b>	<b>133,942,881</b>
- Të hapura	2	103,310,760	85,063,826
- E hapur e thjeshtuar	16	51,100,784	48,879,055
<b>Sipas objekteve</b>	<b>18</b>	<b>154,411,544</b>	<b>133,942,881</b>
- Objekte në fushën e investimeve	6	116,735,968	97,767,500
- Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	12	37,675,576	36,175,381

**Burimi:** Hartuar nga grupi i KLSH-së, sipas të dhënave të Bashkisë Prrenjas

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **58** OE/BOE, nga të cilat janë Skualifikuar **18** OE/BOE. Procedura me 1 OE janë gjithsej **9** procedura ose 45% e procedurave të zhvilluara, ndërsa procedura me 1 OE të kualifikuar janë 12 ose 60% e tyre, veprime të cilat tregojnë se kriteret e aplikuar nga AK Bashkia Prrenjas janë të rënduara të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në uljen e numrit të operatorëve të kualifikuar.

**Titulli i gjetjes:** Nga auditimi, u konstatua se në procedurat e zhvilluara për periudhën 01.01.2020-31.12.2021, janë konstatuar kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST, të miratuar nga AK-ja.

**Situata:** Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme, për periudhën 01.01.2020-31.12.2021, janë realizuar gjithsej **94** procedura me fond limit 968,088 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 836,644 mijë lekë pa TVSH, me një diferencë për vlerën 131,444 mijë lekë ose 14%, nga e cila: **për vitin 2018** janë realizuar gjithsej **15** procedura me fond limit 86,579 mijë lekë dhe vlerë kontrate 82,785 mijë lekë, për **vitin 2019** janë realizuar **21** procedura me fond limit 307,330 mijë lekë dhe vlerë kontrate 284,451 mijë lekë, për **vitin 2020** janë realizuar **23** procedura me fond limit 258,219 mijë lekë dhe vlerë kontrate 226,365 mijë lekë, për **vitin 2021** janë realizuar **17** procedura me fond limit 161,548 mijë lekë dhe vlerë kontrate 109,098 mijë lekë, dhe për **vitin 2022** janë realizuar **18** procedura me fond limit 154,411 mijë lekë dhe vlerë kontrate 133,942 mijë lekë.

Referuar vlerësimit të dhënave të materialitetit dhe riskut, grupi i auditimit, nga **94** procedura me fond limit 968,088 mijë lekë, vlerësoi për auditim **36** procedura me fond limit 838,495 mijë lekë ose 86.6% e fondit limit, nga të cilat: **për vitin 2018**, nga **15** procedura me fond limit 86,579 mijë lekë, u audituan **7** procedura me fond limit 71,745 mijë lekë ose 83% e vlerës së fondit limit; **për vitin 2019**, nga **21** procedura me fond limit 307,330 mijë lekë, u audituan **6** procedura me fond limit 277,986 mijë lekë ose 90% e vlerës së fondit limit, **për vitin 2020**, nga **23** procedura me fond limit 258,219 mijë lekë, u audituan **10** procedura me fond limit 231,681 mijë lekë ose 89% e vlerës së fondit limit, **për vitin 2021**, nga **17** procedura me fond limit 161,548 mijë lekë, u audituan **8** procedura me fond limit 130,182 mijë lekë ose 80% e vlerës së fondit limit dhe **për vitin 2022**, nga **18** procedura me fond limit 154,411 mijë lekë u audituan **5** procedura me fond limit 126,901 mijë lekë ose 82% e fondit limit të prokuruar.

Nga auditimi i **36** procedurave me fond limit **838,495** mijë lekë, janë konstatuar në shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, gjithsej **20** procedura, nga të cilat: në **16** procedura kriteret nuk janë në përputhje me llojin e procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në uljen e numrit të OE pjesëmarrës dhe në **13** procedura, OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK, në vlerën **221,199 mijë lekë** pa TVSH, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 2, 20, 23, 24, 46, 47, 53, 55, 58, Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet 26, 27, 28, 61; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht sipas periudhave:

**a. Për aktivitetin e vitit 2018**, nga auditimi i **7** procedurave me fond limit 71,745 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të LPP dhe akteve nënligjore **4** raste, ku kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE dhe në **2** raste, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Prrenjas, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre.

**b. Për aktivitetin e vitit 2019**, nga auditimi i **6** procedurave me fond limit 277,986 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, gjithsej **4** procedura, ku në **4** raste kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE, dhe në **2** raste, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Prrenjas, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre.

**c. Për aktivitetin e vitit 2020**, nga auditimi i **10** procedurave me fond limit 231,681 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, gjithsej **6** procedura, ku në **5** raste, kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE dhe në **4** raste, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Prrenjas, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre.

**d. Për aktivitetin e vitit 2021**, nga auditimi i **8** procedurave me fond limit 130,182 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, gjithsej **3** procedura, ku në **2** raste kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE dhe në **3** raste, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Prrenjas, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre.

**e. Për aktivitetin e vitit 2022**, nga auditimi i **5** procedurave me fond limit 126,901 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, gjithsej **2** procedura, ku në **1** rast kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE dhe në **2** raste, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Prrenjas, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.

**Kriteri:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”; neni 20, “Mosdiskriminimi”, neni 23, “Specifikimet teknike”, neni 24, “Anulimi i një procedure”, neni 46, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 53, “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”; VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 5, “Kontratat për punë publike”, neni 27, pika 3, “Kontratat e mallrave”, neni 28, pika 2, “Kontratat e shërbimeve”, neni 61, pika 2, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” neni 74, pika 3, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Shkaku:** Mosvlerësimi i drejtë i kritereve, kritere jo në përputhje me procedurën e zhvilluar dhe/ose aplikimi i kritereve të rënduara, të cilat çojnë direkt ose indirekt në uljen e numrit të OE pjesëmarrës.

**Ndikimi/Efekti:** Aplikimi i kritereve jo në mënyrë të argumentuar dhe jo në përputhje me procedurën, si dhe shpallja fitues e OE me mangësi në plotësimin e kritereve të DST për vlerën totale **221,199 mijë lekë**.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Prrenjas, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet, ndërsa në shpalljen e OE fitues të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën risk real për shpenzimet e njësisë publike.

**2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit, etj.), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.**

**Procedurat e periudhës 01.01.2018-31.12.2018**

<b>1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Prodhim, transport dhe stivim dru zjarri në fushën e bashkisë”</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 5, datë 30.03.2018	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 5, datë 30.03.2018	3. Komisioni Vlerësimi Ofertave: Nr. 128 datë 30.03.2018
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kërkesë për propozim”	M.B., Juriste Z.Ç., Juriste K.M., Ing. Pyjesh	1. A.T., Kryetar 2. I.B., Anëtar 3. Xh.Xh., Anëtar
5. Fondi Limit: 6,664,612 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese: OE “K.” SHPK me ofertë 5,807,523 lekë pa TVSH, kontrata datë 18.05.2018, me afat 8 muaj	7. Diferenca me fondin limit: 857,089 - lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 13/04/2018	9. Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar ska, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP/KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në aplikimin e kritereve të vendosura.

**Situata: Hartimi i Kritereve** 1. Kërkesa e pikës 3 e DST e cila kërkon nga OE të kenë punëtorë të certifikuar për përdorimin e mjeteve prerëse në pyjë, të certifikuar nga vetë subjektet nëpërmjet drejtuesve teknikë, është kërkesë jo konkurruese, kufizuese për OE, dhe jo e argumentuar ligjërisht. AK ka të drejtë të kërkojë staf të kualifikuar dhe të certifikuar për përdorimin e mjeteve prerëse, por kufizimi që certifikimi të lëshohet nga vetë subjektet nëpërmjet drejtuesve teknike përbën kufizim, pasi së pari punonjësit mund të certifikohen edhe nga subjekte tjera të licencuara për përdorimin e këtyre mjeteve. Gjithashtu, lëshimi i certifikatave nga vetë subjekti, nuk jep garanci që certifikatat lëshohen nga subjekti apo drejtues teknik të licencuar për lëshimin e këtyre certifikatave. Sa më sipër, kriteri nuk argumentohet ligjërisht, duke përbërë shkak për kufizim të pjesëmarrjes së OE.

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Ndikimi/Efekti:** Ul konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në hartimin e kritereve të veçanta, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP.

**Rëndësia:** E lartë.



**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

<b>2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i kanaleve vaditëse, njësitet administrative Qukës, Rrajcë, Sravaj Bashkia Prrenjas”</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 33, datë 11.07.2018	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 33, datë 11.07.2018	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 340 datë 20.07.2018
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kërkesë për propozim, Punë”	1. M.B., Juriste 2. Z.Ç., Juriste 3. A.A., Inxhinier 4. M.J., Inxhinier 5. I.B., Nënkyetar i Bashkisë	1. M.K., Kryetar 2. M.K., Anëtar 3. M.Z., Anëtar Ndryshim urdhri, Nr. 355 datë 06.08.2018 1. P.Ç. 2. A.B. 3. M.Z.
5. Fondi Limit: 4,583,283 lekë pa TVSH.	6. Oferta fituese: BOE “E.” SHPK dhe “Z.” SHPK me ofertë 4,499,178 lekë pa TVSH, kontrata datë 30.08.2018, me afat 49 ditë.	7. Diferenca me fondin limit: 84,105 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit 06.08.2018	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 BOE b) Skualifikuar Ska, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP/KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave.

**Situata: Hartimi i kritereve:** 1. Kërkesa e pikës **3 e DST** e cila kërkon një punësim mesatar prej të paktën **40 punonjës për periudhën janar 2017-qershor 2018**, është kërkesë jo në përputhje me rregullat e prokurimit publik, pasi periudha e kërkuar prej 18 muaj për stafin e nevojshëm është periudhë relativisht e gjatë, e cila nuk i shërben AK dhe nuk mbështetet ligjërisht. AK duhet të minimizonte periudhën e kërkuar pasi shtrirja e saj në 18 muaj mund të përbëjë kufizim për OE. Në pikën 8 të nenit 26 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, përcaktohet e drejta e AK për të kërkuar dëshmi për fuqinë punëtore për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar afate, të cilat në diskrecion të AK mund të vendosen, por në çdo rast të jenë të argumentuara dhe të tilla që ti shërbejnë konkurrencës dhe të mos jenë penguese për OE. Në rastin konkret, periudha 18 mujore ose 1 vit e gjysmë është relativisht e gjatë.

2. Kërkesa e pikës **6.4. e DST**, e cila kërkon nga OE 27 punonjës me IQT ose ekuivalent, nga të cilët kërkohen **11 (njëmbëdhjetë) punonjës grupi I, 8 (tetë) punonjës grupi II, 8 (tetë) punonjës grupi III**, është kërkesë e paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht, kërkesë e cila nuk i shërben AK, por përbën kufizim për OE. Së pari, kërkesa nuk specifikon llojin e stafin të nevojshëm me specialitetet përkatëse që kërkon për zbatimin e kësaj kontrate, duke e lenë evazive, çka potencialisht OE mund të sjellin çdo punonjës ku mjafton të ketë grupin përkatës për tu konsideruar i kualifikueshëm, pavarësisht nëse ky punonjës është i nevojshëm lidhur me objektin e prokurimit. Së dyti, kërkesa që stafi i mësipërm të jetë me dëshmi të sigurimit teknik, duke mos specifikuar profilin e specialistëve të kërkuar, vjen në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “*Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike*”, pasi edhe lloji i punës objekt prokurimi nuk përkon me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik (ose IQT të kërkuara në DST).

3. Kërkesa e pikës **8.1/b e DST** e cila kërkon nga OE që për mjetet e marra me qira, të specifikohet edhe objekti i kontratës, është kërkesë e tepërt dhe e pambështetur në ligj, pasi kontratat për mjetet mund të jenë të lidhura me një afat që tejkalon periudhën e kontratës dhe

disponohen nga OE, ndërkohë që përcaktimi se për mjetet e marra me qira të shtohet në to edhe objekti i prokurimit, nuk përbën tjetër veçse shtim kostosh për OE dhe jo kërkesë cilësore që mund t'i shërbejë procedurës.

4. Kërkesa e pikës **9.3 e DST** e cila kërkon nga OE Plan Organizimin e punimeve në objekt të shoqëruar dhe me një relacion shpjegues dhe legjendë, ku të reflektojë të gjitha masat tekniko-organizative dhe elementet e tjerë që kërkon një plan organizimi i mirëfilltë, është kërkesë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kapitulli I, Pika 4.

Sa më sipër, është detyrë e mbikëqyrësit plani i organizimit dhe jo i shoqërive ofertuese.

**Vlerësimi i ofertave:** 1. OE “Z.” SHPK, nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/ç të DST** për Deklaratën mbi kontratat e lidhura (Shtojca 10), pasi nuk ka paraqitur këtë deklaratë në kundërshtim me DST.

2. OE “E.” SHPK, nuk përmbush kriterin e pikës **3 të DST** e cila kërkon nga OE të kenë të punësuar mesatarisht 40 punonjës. OE “E.” SHPK, rezulton se ka në listëpagesë 21 punonjës, ndërkohë që ka marrë përsipër kryerjen 70% të punimeve dhe duhet të kishte mesatarisht 28 punonjës, numër të cilin nuk e disponon.

3. OE “Z.” SHPK, nuk përmbush kriterin e pikës **3.2 të DST**, e cila kërkon vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për pagimin e gjitha likuidimeve deri në ditën e hapjes së ofertave. Ky OE nuk ka paraqitur asnjë dokument që të provojë se ka likuiduar detyrimet vendore në vendet ku ushtron aktivitetin.

4. OE “E.” SHPK, i cili ka marrë përsipër 70% të punimeve, nuk përmbush kriterin e pikës **6.4 të DST**, e cila kërkon nga OE 27 punonjës me IQT të ndarë sipas Grupeve I, II dhe III. I gjithë stafi prej 27 punonjës janë të OE “Z.” SHPK, ndërkohë që OE “E.” nuk ka paraqitur asnjë të tillë, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 74 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Sa më sipër konstatohet se OE “E.” SHPK nuk përmbush kapacitetet profesionale që lidhen me stafin e kërkuar.

5. BOE nuk përmbush kriterin e pikës **8.5 të DST** pasi nuk janë paraqitur Raport testimet e kërkuara për materialet sipas metodave të kërkuara në DST.

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Ndikimi/Efekt:** Lidhja e kontratës me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **4,499 mijë lekë** pa TVSH.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

<b>3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërhyrje për stabilizimin e çarjeve në shkollën e mesme “Dilaver Nezha”, Qukës”</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 35, datë 18.07.2018	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 35, datë 18.07.2018	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 333 datë 18.07.2018
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”	1. M.B., Juriste 2. Z.Ç., Juriste 3. A.A., inxhinier 4. D.M., inxhinier 5. M.M., ekonomiste	1. P.Ç., Kryetar 2. G.Ç., Anëtar 3. E.A., Anëtar
5. Fondi Limit: 29,088,033 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese: OE “Z.” SHPK me ofertë 28,767,586 lekë pa TVSH, kontrata datë 18.09.2018, me afat 4 muaj	7. Diferenca me fondin limit: 320,447 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 27/08/2018	9. Burimi i Financimit:	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE

	Buxheti i Shtetit, Ministria e Financës, Ministria e Arsimit dhe Sportit.	b) Skualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP/KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në aplikimin e kriterëve të vendosura.

**Situata: Hartimi i kriterëve:** 1. Kërkesa e pikës **3 e DST** e cila kërkon një punësim mesatar prej të paktën **75 punonjës për periudhën janar 2017-qershor 2018**, është kërkesë jo në përputhje me rregullat e prokurimit publik, pasi periudha e kërkuar prej 30 muaj ose 2 vjet e gjysmë për stafin e nevojshëm është periudhë relativisht e gjatë, e cila nuk i shërben AK dhe nuk mbështetet ligjërisht. AK duhej të minimizonte periudhën e kërkuar pasi shtrirja e saj në 30 muaj mund të përbëjë kufizim për OE. Në pikën 8 të nenit 26 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet e drejta e AK për të kërkuar dëshmi për fuqinë punëtore për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar afate, të cilat në diskrecion të AK mund të vendosen, por në çdo rast të jenë të argumentuara dhe të tilla që ti shërbejnë konkurrencës dhe të mos jenë penguese për OE. Në rastin konkret, periudha 30 mujore ose 2 vite e gjysmë është relativisht e gjatë.

2. Kërkesa e pikës **6.3 në DST** e cila kërkon nga OE 3 manovratorë të cilët duhet të jenë në listëpagesa për periudhën Janar 2026 – Qershor 2018 është kërkesë e paargumentuar, pasi periudhë 30 mujore që kërkohet për manovratorët është e tepërt dhe nuk i shërben procedurës.

3. Kërkesa e pikës **6.4 e DST**, e cila kërkon nga OE 30 punonjës me IQT ose ekuivalent, nga të cilët kërkohen **11 (njëmbëshjetë) punonjës grupi I, 8 (tetë) punonjës grupi II, 8 (tetë) punonjës grupi III, 1 (një) punonjës grupi IV dhe 1 punonjës grupi V**, është kërkesë e paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht, kërkesë e cila nuk i shërben AK, por përbën kufizim për OE. Së pari, kërkesa nuk specifikon llojin e stafin të nevojshëm me specialitetet përkatëse që kërkon për zbatimin e kësaj kontrate, duke e lenë evazive, çka potencialisht OE mund të sjellin çdo punonjës ku mjafton të ketë grupin përkatës për t’u konsideruar i kualifikueshëm, pavarësisht nëse ky punonjës është i nevojshëm lidhur me objektin e prokurimit. Së dyti, kërkesa që stafi i mësiëprn të jetë me dëshmi të sigurimit teknik, duke mos specifikuar profilin e specialistëve të kërkuar, vjen në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”, pasi edhe lloji i punës objekt prokurimi nuk përkon me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik (ose IQT të kërkuara në DST).

4. Kërkesa e pikës **8.4 në DST** e cila kërkon nga OE:

Fabrik Betoni me QKL	1 cope	Pronesi ose me qera
Impiant Inertesh me QKL	1 cope	Pronesi ose me qera
Linje prodhimi elemente Betoni, me QKL	1 cope	Pronesi ose me qera
Linje prodhimi per dyer dhe dritare PVC & Duralumin	1 cope	Pronesi ose me qera

Kjo kërkesë është e tepërt pasi kemi të bëjmë me volume të vogla për materialet e mësipërme, dhe është e paargumentuar që OE të disponojnë në pronësi ose me qira linja të tilla, të cilat mund të sigurohen me kontrata furnizimi nga shoqëri që disponojnë linja/fabrika të tilla.

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Ndikimi/Efekti:** Ul konkurrencën ndërmjet Operatorëve Ekonomikë.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

<b>4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitim/Përforcim banesash ekzistuese”</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 41, datë 23.08.2018	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 41, datë 23.08.2018	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 401 datë 27.08.2018
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur-Punë”	1. M.B., Juriste 2. A.A., Inxhinier 3. M.M., Ekonomiste	1. M.Z., Kryetar 2. P.Ç., Anëtar 3. A.B., Anëtar
5. Fondi Limit: 13,332,842 lekë pa TVSH.	6. Oferta fituese: OE “Z.” SHPK me ofertë 13,296,931 lekë pa TVSH, kontrata datë 25.10.2018, me afat 3 muaj.	7. Diferenca me fondin limit: 35,911 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit 01/10/2018	9. Burimi i Financimit: Ministria e Financave dhe Ekonomisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP/KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në aplikimin e kriteve.

**Situata: Hartimi i kriteve:** 1. Kërkesa e pikës 3 e DST e cila kërkon një punësim mesatar prej të paktën **55 punonjës për periudhën janar 2016-qershor 2018**, është kërkesë jo në përputhje me rregullat e prokurimit publik, pasi periudha e kërkuar prej 30 muaj ose 2 vjet e gjysmë për stafin e nevojshëm është periudhë relativisht e gjatë, e cila nuk i shërben AK dhe nuk mbështetet ligjërisht. AK duhej të minimizonte periudhën e kërkuar pasi shtrirja e saj në 30 muaj mund të përbëjë kufizim për OE. Në pikën 8 të nenit 26 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet e drejta e AK për të kërkuar dëshmi për fuqinë punëtore për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar afate, të cilat në diskrecion të AK mund të vendosen, por në çdo rast të jenë të argumentuara dhe të tilla që ti shërbejnë konkurrencës dhe të mos jenë penguese për OE. Në rastin konkret, periudha 30 mujore ose 2 vite e gjysmë është relativisht e gjatë.

2. Kërkesa e pikës 6 në DST e cila kërkon ndër të tjera 1 inxhinier elektronik, 1 inxhinier hidroteknik, 2 inxhinier mjedisi, 1 inxhinier gjeolog dhe 1 inxhinier mekanik drejtues teknik në licencë, janë kërkesë jo në përputhje me zërat në preventiv, pasi nuk ka asnjë zë që lidhen me profilet e mësipërme të inxhinierëve, dhe aq me pak që të jenë edhe drejtues teknik. Kjo kërkesë përbën kufizim për OE, pasi nuk argumentohet teknikisht dhe ligjërisht nga NJP duke mos qenë në përputhje me vlerën, volumin dhe preventivin e punimeve.

3. Kërkesa e pikës 6.3 në DST e cila kërkon nga OE 3 manovratorë të cilët duhet të jenë në listëpagesa për periudhën Janar 2026-Qershor 2018 është kërkesë e paargumentuar, pasi periudhë 30 mujore që kërkohet për manovratorët është e tepërt dhe nuk i shërben procedurës por përbën pengesë për OE.

4. Kërkesa e pikës 6.4 e DST, e cila kërkon nga OE 30 punonjës me IQT ose ekuivalent, nga të cilët kërkohen **11 (njëmbëshjetë) punonjës grupi I, 8 (tetë) punonjës grupi II, 8 (tetë) punonjës grupi III, 1 (një) punonjës grupi IV dhe 1 punonjës grupi V**, është kërkesë e paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht, kërkesë e cila nuk i shërben AK, por përbën kufizim për OE. Së pari, kërkesa nuk specifikon llojin e stafin të nevojshëm me specialitetet përkatëse që kërkon për zbatimin e kësaj kontrate, duke e lenë evazive, çka potencialisht OE mund të sjellin çdo punonjës ku mjafton të ketë grupin përkatës për tu konsideruar i kualifikueshëm, pavarësisht nëse ky punonjës është i nevojshëm lidhur me objektin e prokurimit. Së dyti, kërkesa që stafi i mësipërm të jetë me dëshmi të sigurimit teknik, duke mos specifikuar profilin e specialistëve të kërkuar, vjen në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”, pasi edhe lloji i punës objekt prokurimi nuk përkon me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik (ose IQT të kërkuara në DST).

5. Kërkesa e pikës 8.3 në DST e cila kërkon nga OE:

Fabrikë Betoni me QKL	1 cope	Pronesi ose me qera
Impiant Inertesh me QKL	1 cope	Pronesi ose me qera
Linjë prodhimi elemente Betoni, me QKL	1 cope	Pronesi ose me qera
Linjë prodhimi per dyer dhe dritare PVC & Duralumin	1 cope	Pronesi ose me qera

Kjo kërkesë është e tepërt, pasi kemi të bëjmë me volume të vogla për materialet e mësipërme, dhe është e paargumentuar që OE të disponojnë në pronësi ose me qira linja të tilla, të cilat mund të sigurohen me kontrata shërbimi nga shoqëri që disponojnë linja/fabrika të tilla.

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Ndikimi/Efekti:** Ul numrin e OE pjesëmarrës.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJP.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

<b>5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Grumbullimi i vendburimeve ujore për furnizimin me ujë të fshatit Berzeshte, Bashkia Prrenjas”</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 49, datë 27.09.2018	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 49, datë 27.09.2018	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 455 datë 27.09.2018
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kërkesë për propozim”	1. M.B., Juriste 2. Z.Ç., Juriste 3. A.A., Inxhinier 4. M.J., Inxhinier 5. M.K., Ekonomiste	1. I.B., Kryetar 2. M.Z., Anëtar 3. P.Ç., Anëtar
5. Fondi Limit: 10,134,523 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese: OE “Z.” SHPK” me ofertë 10,106,439 lekë pa TVSH, kontrata datë 12.11.2018, me afat 2 muaj	7. Diferenca me fondin limit: 28,084 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 09.10.2018	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit+ të ardhura	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar ska c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP/KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

**Situata: Hartimi i kriterëve:** 1. Kërkesa e pikës 6 e DST e cila kërkon ndër të tjera 6 manovratorë, është kërkesë e tepërt dhe jo në përputhje me numrin e mjeteve të rënda për të cilat kërkohet manovratori, pasi rezulton se janë kërkuar 3 mjete të rënda. Sa më sipër, numri i kërkuar është i lartë dhe mund të përbëjë kufizim për OE.

2. Kërkesa e pikës 6 e DST e cila kërkon ndër të tjera 1 mjek, është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 “Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1.

3. Kërkesa e pikës 7 e DST, e cila kërkon nga OE 11 punonjës me IQT ose ekuivalent ndër të tjera kërkohet të disponohet IQT nga 1 mekanik, 1 teknik ndërtimi, 1 hidraulik, 2 karpentierë, 3 manovratorë dhe 2 muratorë, është kërkesë e paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht, kërkesë e cila nuk i shërben AK, por përbën kufizim për OE. Kërkesa që stafi i mësipërm të jetë me dëshmi të sigurimit teknik, vjen në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”, pasi edhe lloji i punës objekt prokurimi nuk përkon me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik (ose IQT të kërkuara në DST).

**Vlerësimi i kriterëve:** 1. OE nuk përmbush kriterin e pikës **4 në DST** e cila kërkon nga OE të përcaktojë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt. Në deklaratën e këtij OE, përcaktohet se drejtues teknik do jetë A.B., i cili do jetë i angazhuar vetëm në këtë objekt për gjithë kohën deri në përfundim të punimeve. Ky inxhinier rezultoi i angazhuar në kontrata të tjera të lidhura pranë të njëjtin AK.

2. OE nuk përmbush kriterin e pikës **8 të DST** për disa nga mjetet e kërkuara për zbatimin e kësaj kontrate dhe konkretisht:

a. Për betoniere kantiere 2.5m<sup>3</sup>, pasi për këtë mjet është paraqitur një kontratë blerje nga B.Ç., mjet i cili rezultoi me goma, vetëlëvizës për të cilin kërkohet të disponohen polica e sigurimit, leja e qarkullimit, akti i kolaudimit, etj. Njëkohësisht, ky mjet rezultoi i deklaruar në 3 kontrata tjera të lidhura nga i njëjti AK, në kundërshtim me pikën 8/c të DST.

b. Për 1 Fadromë, është paraqitur mjeti me targa AEMT17, mjet i cili rezultoi i deklaruar në kontrata tjera të lidhura nga i njëjti AK, në kundërshtim me pikën 8/c të DST.

c. Për 1 Minisekskavator 2.8 ton, është paraqitur mjeti me targa AA324NK, i cili figuron njëkohësisht i deklaruar në kontrata tjera pranë të njëjtin AK në kundërshtim me pikën 8/c të DST.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Ndikimi/Efekti:** Lidhja e kontratës me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **10,106 mijë lekë** pa TVSH.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP, si dhe anëtarët e KVO.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NjP & KVO, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1173/32 prot., datë 11.05.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

*Pretendimet e paraqitura nga anëtarët e NjP dhe KVO, janë të njëjta me atë të paraqitura mbi Akt Konstatimet të cilat janë trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, dhe nuk është paraqitur asnjë provë apo argument i ri.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në këto kushte kundërshtimet nuk pranohen.

**Procedurat e periudhës 01.01.2019-31.12.2019**

<b>6. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Trotuareve Unaza e qytetit Prrenjas”</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 6, datë 02.05.2019	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 6, datë 02.05.2019	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 128 datë 02.05.2019
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kërkesë për propozim”	1. M.B., Juriste 2. Z.Ç., Juriste 3. M.P., Ing.Topografe 4. A.B., Ekonomist 5. A.A., Ing. Topgraf	1. E.A., Kryetar 2. G.K., Anëtar 3. G.Ç., Anëtar
5. Fondi Limit: 10,099,897 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese: OE “M.” SHPK me ofertë 6,193,676 lekë pa TVSH, kontrata datë 05.07.2019, me afat 13 javë.	7. Diferenca me fondin limit: 3,906,221 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 28/05/2019	9. Burimi i Financimit: Buxheti i bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 12 OE b) Skualifikuar 7 OE,

		c) Kualifikuar 5 OE
11. Ankimime AK, OE "R." SHPK, për DST, datë 15.05.2019 nr. 1326 prot. OE "A." SHPK, për vleresimin e KVO, më datë 18.06.2019 me Nr. 1774 prot.	12. Përgjigje ankesës nga AK, Përgjigje ankesës nga AK per OE "R." SHPK me Nr. 1326/1 datë 17.05.2019. Përgjigje ankesës nga AK per OE "A." SHPK me Nr. 1774/1 datë 20.06.2019.	13. Përgjigje Ankesës nga APP/KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave.

**Situata: Hartimi i kritereve:** 1. Kërkesa e pikës **2.3.1/a/b e DST** e cila kërkon për punët e ngjashme për një objekt të vetëm që të jenë me vlerë 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës, si dhe për punët e ngjashme ku vlera monetare për 3 vitet e fundit të jetë **sa** dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, janë kritere të vendosura jo në përputhje me pikën 6, germa *a* dhe *b* të nenit 26 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, i cili nuk përcakton togfjalëshin **sa**, por punët e ngjashme kërkohet të jenë të përcaktuara me tog fjalëshin **jo më e madhe**, pasi është e pamundur që OE të kenë punët fiks sa 50% i kontratës që prokurohet. Mund të përbëjë shkak për skualifikim të padrejtë për OE.

2. Kërkesa e pikës **2.3.3 e DST** e cila kërkon nga OE të përcaktojë drejtuesin teknik të punimeve, i cili do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, është kërkesë në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*". Ky tender ka fond limit **10 milion lekë**, vlerë e cila është më e vogël se vlera e kërkuar për drejtuesin teknik të punimeve në kantier dhe të paangazhuar në kontrata të tjera.

**Vlerësimi i kritereve:** 1. OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.11 të DST** për kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 12-15 ton. 2 mjetet e paraqitur kanë mangësi, pasi mjeti me targa AA892CC i marrë me qira nga subjekti "K." SHPK, rezulton me kapacitet mbajtës 11.17 ton, që është poshtë kapacitetit të kërkuar, si dhe nuk disponon certifikatën e transportit. Mjeti tjetër me targa AA021IR i marrë me qira nga subjekti "Xh." SHPK, rezulton me kapacitet mbajtës 15.5 ton, që është më i lartë se kapaciteti i kërkuar në DST, ndërkohë rezulton se certifikatat e transportit është për vete, dhe jo për të tretë dhe me qira, në kundërshtim me nenin 41 të ligjit për transportet rrugore.

2. OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.11 të DST** për 2 kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5-7 ton. Mjeti i paraqitur me targa AA563AH ka kapacitet mbajtës 2.08 ton, që është poshtë kapaciteti të kërkuar në DST, ndërkohë mjeti me targa KO9513B i marrë me qira nga subjekti "Xh." SHPK, ka kapacitet mbajtës 2.2 ton që është poshtë kapacitetit të kërkuar, si dhe ka certifikatën e transportit për vete dhe jo për të tretë dhe me qira.

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Ndikimi/Efekti:** Lidhja e kontratës me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **6,193 mijë lekë** pa TVSH.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

**7. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Pastrim, grumbullimin dhe transportin e mbeturinave ne territorin administrativ të Bashkisë Prrenjas 5 vjeçar"**

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 41, datë 13.09.2019	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 41, datë 13.09.2019.	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 391 datë 27.09.2019
---	---	---

4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur"	1. M.B. Juriste 2. Z.Ç. Juriste 3. G.R. Ing.	1. E.A., Kryetar 2. E.D., Anëtar 3. M.P., Anëtar
5. Fondi Limit: 62,487,791 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese: OE "R." SHPK me ofertë 49,360,052.6 lekë pa TVSH, kontrata datë 30.12.2019, me afat 5 vjet.	7. Diferenca me fondin limit: 13,127,739 - lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 28.10.2019	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b) Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11. Ankimime AK, 1. OE "K.i" SHPK, Nr. 3952 prot, datë 14.11.2019 (Për KVO) OE "R." SHPK, Nr. 4010 prot, datë 18.11.2019 (për KVO)	12. Përgjigje ankesës nga AK, 1. Nr. 3952/1 prot, datë 20.11.2019 Nr. 4010/1 prot, datë 18.11.2019	13. Përgjigje Ankesës nga APP/KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në aplikimin e kritereve.

**Situata: Hartimi i kritereve:** 1. Kërkesa e pikës 8/a/b në DST e cila kërkon nga OE 2 makina teknologjike, dhe 1 autobot uji, është kërkuar ndër të tjera të jenë të vitit jo më poshtë se 2010. Pikërisht kërkesa që të jenë jo më poshtë se viti 2010, mund të përbëjë shkak për kufizim pjesëmarrjeje të OE, ndërkohë që subjektet mund të disponojnë mjete që përmbushin të gjitha specifikimet teknike të nevojshme, dhe janë të kolauduara për kryerjen e shërbimit të kërkuar. Përcaktimi i vitit 2010, potencialisht kufizon pjesëmarrjen, ose përbën shkak jo cilësor për skualifikimin e OE.

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Ndikimi/Efekti:** Ul numrin e OE pjesëmarrës.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

<b>8. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje makineri për nevojat e bashkisë"</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 52, Datë 30.10.2019	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 52, Datë 30.10.2019	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër Nr. 447 datë 30.10.2019
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur"	1. M.B. 2. N.B. 3. M.K.	1. A.B., Kryetar 2. E.A., Anëtar 3. E.B., Anëtar
5. Fondi Limit: 9,920,000 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese: OE "L.B." SHPK, me ofertë 9,870,000 lekë pa TVSH, kontrata datë 26.12.2019, me afat 20 ditë.	7. Diferenca me fondin limit: 50,000 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 10/12/2019	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit/bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP/KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave.

**Situata: Hartimi i kritereve:** 1. Kërkesa e pikës 2.3.2 e DST e cila kërkon nga OE të kenë të punësuar të paktën 1 inxhinier mekanik, është kërkesë në kundërshtim me llojin e procedurës, e cila është për blerje mallrash, dhe jo shërbimesh për të përcaktuar nevojën e inxhinierit mekanik.

**Vlerësimi i ofertave:** 1. OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.3 të DST e cila kërkon nga 1 inxhinier mekanik. Për të përmbushur këtë kriter, është paraqitur dokumentacion për



inxhinierin L. I., për të cilin është paraqitur kontrata e punës, diploma dhe dokumente të tjera, të cilat janë fotokopje të panoterizuara, në kundërshtim me paragrafin e fundit të DST, i cili përcakton se “Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre”.

2. OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** e cila kërkon nga OE të paraqesë certifikatat e regjistrimit (lejet e qarkullimit) për kamion treaksial, autokullë dhe fadromë. Janë paraqitur disa dokumente në gjuhë të huaj, të noteziruara, por në to nuk përcaktohet lidhja e mjetit me subjektin tregtues.

3. OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.8 të DST**, e cila kërkon nga OE të paraqesë katalogët për mjetet kamion treaksial, rrul ngjeshës, autokullë dhe fadromë, me qëllim verifikimin e specifikimeve teknike. Janë paraqitur katalogët për mjetet e kërkuara, katalogë të cilat nuk kanë asnjë të dhënë të prodhuesit.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Ndikimi/Efekt:** Lidhja e kontratës me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **9,870 mijë lekë** pa TVSH.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

<b>9. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion rrjeti shpërndarës i ujësjellësit Prrenjas”, me këto të dhëna:</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 51, datë 30.10.2019	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 51, datë 30.10.2019	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër Nr. 452 datë 05.11.2019
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”	1. Z.Ç., Juriste 2. M.B., Juriste 3. N.D., Inxhinier 4. G.R., Inxhinier 5. A.B., Ekonomist	1. O.A., Kryetar 2. J.Zh., Anëtar 2. E.A., Anëtar
5. Fondi Limit: 178,979,703 lekë pa TVSH.	6. Oferta fituese: OE “C.” SHPK, 178,332,403 lekë, kontrata datë 19.03.2020 me afat 18 muaj.	7. Diferenca me fondin limit: 647,299 - lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 17.12.2019	9. Burimi i Financimit: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve.	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 8 OE b) Skualifikuar 7 OE c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK, OE “I.” SHPK, nr. 3940 prot, 14.11.2019 (DST); OE “L.” SHPK, me nr. 3973 prot, datë 15.11.2019 (DST); OE “S.” SHPK, nr. 3996 prot, 18.11.2019(DST)	12. Përgjigje ankesës nga AK: OE “I.” SHPK, me nr. 3940/1 prot, 19.11.2019; OE “L.” SHPK, me nr. 3973/1 prot, 20.11.2019 dhe nr. 3996/1 prot, 21.11.2019.	13. Përgjigje Ankesës nga APP/KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në aplikimin e kriterëve.

**Situata: Hartimi i kriterëve:** 1. Kërkesa e pikës **2.3.1/a/b e DST** e cila kërkon për punët e ngjashme për një objekt të vetëm që të jenë me vlerë 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës, si dhe për punët e ngjashme ku vlera monetare për 3 vitet e fundit të jetë **sa** dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, janë kriterë të vendosura jo në përputhje me pikën 6, germa a dhe b të nenit 26 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili nuk përcakton togfjalëshin **sa**, por punët e ngjashme kërkohet të jenë të përcaktuara me togfjalëshin **jo më e madhe**, pasi është e pamundur që OE të kenë punët fiks **sa** 50% i kontratës që prokurohet. Mund të përbëjë shkak për skualifikim të padrejtë për OE.

2. Kërkesa e pikës **2.3.5 në DST** e cila kërkon *1 ekspert të auditimit të energjisë, 1 inxhinier nivel master ose ekuivalent për menaxhim projektesh, 1 inxhinier mjedisi, profili energjetikë, 1 inxhinier elektrik, si dhe 2 inxhinier ndërtimi (njëri i profilit rruga ura dhe tjetri strukturist)*, janë kërkesa të tepërta, të paargumentuara dhe jo në përputhje me natyrën e punës. Për ekspertin e auditimit të energjisë si dhe ekspertin e mbrojtjes kundër zjarrit, nuk ka zëra apo procese të përcaktuara në preventiv për të kërkuar ekspertizën e tyre. Për inxhinierin e nivelit master ose ekuivalent për menaxhim projektesh i cili të figurojë në listëpagesë, sqarohet se kjo kërkesë është e tepërt, pasi nuk argumentohet konkretisht se çfarë procesesh kërkohet të mbulohet nga ky inxhinier, ndërkohë që AK ka kërkuar që të përcaktohet drejtues teknik për zbatimin e punimeve gjatë gjithë procesit. Lidhur me inxhinierin elektrik dhe 2 inxhinierët e ndërtimit, AK rezulton se ka kërkuar njëkohësisht 1 inxhinier elektrik drejtues teknik në licencën e shoqërisë, dhe si e tillë kërkesa që shoqëria të disponojë edhe një inxhinier tjetër, nuk përbën asgjë tjetër veçse kërkesë të fryrë, pasi proceset e përcaktuara nuk janë të tilla që të kërkohet ky numër i lartë. E njëjta situatë edhe për 2 inxhinierët e ndërtimit, pasi është kërkuar njëkohësisht edhe 1 inxhinier ndërtimit drejtues teknik në licencë. Është e tepërt kërkesa për 3 në total. Gjithashtu, AK duhet të ketë në konsideratë që inxhinierë të caktuar mund të disponohen edhe nëpërmjet kontraktimit.

3. Kërkesa e pikës **2.3.5/1 e DST**, e cila kërkon nga OE 60 punonjës me IQT ose ekuivalent, sipas zërave të përcaktuar në preventiv, është kërkesë e pa plotë, evazive e cila nuk i shërben AK, por përbën kufizim për OE. Së pari numri 60 punonjës me dëshmi sigurimi, është kërkesë e lartë, dhe njëkohësisht duke mos përcaktuar profilin e punonjësit dhe numrin konkret sipas profilit, mund të sjellë punonjës që formalisht përmbushin kriterin e kërkuar, por nuk janë të nevojshëm për proceset e punës në raport me volumet konkrete. Së dyti, kërkesa që stafi i mësipërm të jetë me dëshmi të sigurimit teknik, duke mos specifikuar profilin e specialistëve të kërkuar, vjen në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “*Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike*”, pasi edhe lloji i punës objekt prokurimi nuk përkon me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik.

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Ndikimi/Efekti:** Pengon konkurrencën.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NjP & KVO, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1173/32 prot., datë 11.05.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

*Pretendimet e paraqitura nga anëtarët e NjP, janë të njëjta me atë të paraqitura mbi Akt Konstatimet të cilat janë trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, dhe nuk është paraqitur asnjë provë apo argument i ri.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në këto kushte kundërshtimet nuk pranohen.

## **Procedurat e periudhës 01.01.2020-31.12.2020**

<b>10. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i kanaleve vaditëse, Bashkia Prrenjas”</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 02, Datë 13.02.2020	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 02, Datë 13.02.2020	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër Nr. 20 datë 13.02.2020
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kërkesë për propozim”	1. M.K., Agronom 2. A.A., Ing 3. A.B., Ekonomist 4. Z.Ç., Jurist 5. M.B., Jurist	1. M.A., Kryetar 2. E.A., Anëtar 3. G.K., Anëtar
5. Fondi Limit: 4,333,328 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese: OE “L.B.” SHPK, me ofertë 3,195,463 lekë, kontrata Nr. 1136, datë 31.03.2020, me afat 3 muaj.	7. Diferenca me fondin limit: 1,137,865 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: 24.02.2020	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë/Të Ardhurat	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 12 OE b) Skualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 8 OE
11. Ankimime, AK- ska; APP-ska; KPP-ska.	12. Përgjigje ankesës nga AK, ska	13. Përgjigje Ankesës nga APP/KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në vlerësimin e ofertave.

**Situata: Vlerësimi i ofertave:** 1. OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për likuidimin e tarifave vendore për vitin 2019. Ky OE ka deklaruar në shtojcën nr. 10 për kontratat e lidhura ose në proces, kontratën e lidhur me Bashkinë Librazhd me objekt “Rikonstruksion i kanaleve vaditëse në Bashkinë Librazhd për vitin 2019”, ndërkohë nuk rezulton të ketë likuiduar detyrimet vendore pranë kësaj bashkie për këtë vit, në kundërshtim me DST.

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Ndikimi/Efekti:** Lidhja e kontratës me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **3,195 mijë lekë** pa TVSH.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e KVO.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

<b>11. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ujësjellësi Dritaj – Fanjë - Karkavec (vazhdim), Bashkia Prrenjas”</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 13, datë 24.03.2020	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 13, datë 24.03.2020	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr. 145 datë 20.05.2020
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedure e Hapur”	1. N.D. Ing.Ndertimi 2. Z.Ç. Jurist 3. M.B. Jurist	1. A.Ç.- Kryetar 2. M.A. - Anëtar 2. E.A. - Anëtar
5. Fondi Limit: 22,304,007 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese: OE “D.C.” SHPK, me ofertë 14,858,926.70 lekë, kontrata Nr. 1999, datë 18.06.2020 me afat 112 ditë.	7. Diferenca me fondin limit: 7,445,080 - lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 20.05.2020	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b) Skualifikuar 1 OE c) Kualifikuar 3 OE
11. Ankimime AK, 1.-Ankese nga OE “Sh.9.” SHPK, me nr. 1279prot, datë 21.04.2020 2. Ankese nga OE “K.C.” SHPK, me nr. 1280prot, datë 21.04.2020	12. Përgjigje ankesës nga AK, 1.Përgjigje Ankesës nga AK, per OE “Sh.9.” SHPK Nr. 1279/1 prot, dt 23.04.2020 2. Përgjigje Ankesës nga AK, për OE “K.C.” SHPK Nr. 1280/1 prot, datë 23.04.2020	13. Përgjigje Ankesës nga APP/KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në aplikimin e kriterëve të vendosura.

**Situata: Hartimi i Kriterëve:** 1. Kërkesa e pikës **6 në DST** e cila kërkon 1 mjek ndërmarrjeje apo të kontraktuar nga jashtë, është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 “Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1.

2. Kërkesa e pikës **7 e DST**, e cila kërkon ndër të tjera 1 punonjës specialist ekspert zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi i cili të figurojë në listëpagesë 3 muajt e fundit, është kërkesë jo në përputhje me objektin e kontratës pasi nuk ka zëra për të cilat të kërkohet nevoja për ekspertin zjarrfikës.

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Ndikimi/Efekti:** Ul konkurrencën.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në hartimin e kriterëve, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

<b>12. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ujësjetësi Dritaj-Fanjë-Karkavec, Bashkia Prrenjas, (vazhdim) F.V. matësa familjare”</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 43, datë 27.07.2020	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 43, datë 27.07.2020	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër Nr. 240 datë 27.07.2020, ndryshuar me urdhrin nr. 279 datë 01.09.2020. 1. M.A. Kryetar 2. G.R. Anëtar 3. E.D. Anëtar
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedure e Hapur”	1. N.D., Inxhinier 2. Z.Ç., Jurist 3. M.P., Ing. topograf 4. R.D. ekonomiste 5. A.K. Juriste	
5. Fondi Limit: 25,083,333 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese: OE “D.C.” SHPK, me ofertë 16,194,461 lekë, kontrata Nr. 3384 prot, datë 15.10.2020, me afat 202 ditë.	7. Diferenca me fondin limit: 8,888,872 - lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 02.09.2020	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK 1. OE “2.” SHPK, nr. 3130 prot, datë 22.09.2020 (KVO) 2. OE “B.N.” SHPK, me Nr. 3158 prot, datë 24.09.2020 (KVO)	12. Përgjigje ankesës nga AK, 1. Përgjigje Ankesës nga AK, per OE “2.” SHPK, nr. 3130 prot, datë 29.09.2020. 2. Përgjigje Ankesës nga AK, per OE “B.N.” SHPK, Nr. 3158/1 prot datë 01.10.2020	13. Përgjigje Ankesës nga APP/KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në aplikimin e kriterëve.

**Situata: Hartimi i Kriterëve:** 1. Kërkesa e pikës **6 në DST** e cila kërkon 1 mjek ndërmarrjeje apo të kontraktuar nga jashtë, është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 “Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1.

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Ndikimi/Efekti:** Lidhja e kontratës me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **16,194 mijë lekë** pa TVSH.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në hartimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJP dhe anëtarët e KVO.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP & KVO, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1173/32 prot., datë 11.05.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

*Pretendimet e paraqitura nga anëtarët e NJP, janë të njëjta me atë të paraqitura mbi Akt Konstatimet të cilat janë trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, dhe nuk është paraqitur asnjë provë apo argument i ri.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Lidhur me pretendimet e KVO se mangësia që lidhet me mbarimin e afatit të licencës së mjekut, e cila ka ardhur për shkak edhe të volumit të dokumentacionit ndërkohë që janë paraqitur të gjitha dokumentet tjera për mjekun, audituesit pranojnë observacionin tuaj, kjo duke e konsideruar njëkohësisht këtë mangësi të vetme si një shmangie apo devijim i vogël i cili në thelb nuk cenon zbatimin e kontratës, sipas përcaktimeve të pikës 4 të nenit 53 të LPP.

**13. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitimi Skemës Ujitëse Radigoz-Stranik-Bërzeshtë”**

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 45, Datë 30.07.2020	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 45, Datë 30.07.2020	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër Nr. 242 datë 30.07.2020
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedure e Hapur”	1. N.D. 2. A.K. 3. M.P.	1. M.K. – Kryetar, 2. J.Zh. – Anëtar 3. M.Z. – Anëtar
5. Fondi Limit: 61,304,125 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese: OE “E.A.” SHPK, me ofertë 59,267,417 lekë, kontrata Nr. 3623, datë 03.11.2020, me afat 8 muaj.	7. Diferenca me fondin limit: 2,036,708 - lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: 08.09.2020	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: 1. Nr. 2652 prot., datë 10.08.2020 – OE Z. SHPK (për kriteret)	12. Përgjigje ankesës nga AK, 1. 2652/1 prot., datë 14.08.2020 (pranuar pjesërisht ankesa)	13. Përgjigje Ankesës nga APP/KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave.

**Situata: Hartimi i Kriterëve:** 1. Kërkesa e pikës **2.3.4 në DST** e cila kërkon 1 mjek ndërmarrjeje apo të kontraktuar nga jashtë, është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 “Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1.

2. Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST**, e cila kërkon punonjës me dëshmi të sigurimit teknik nga ISHTI ose ekuivalent, konkretisht për 1 teknik ndërtimi, 3 automakinistë, 1 buldozerist, 4 ekskavatoristë, 3 shoferë, 3 muratorë, 2 mekanik, 4 hekurkthyes dhe 4 karpentier, është kërkesë e paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht, kërkesë e cila nuk i shërben AK, por përbën kufizim për OE. Kërkesa që stafi i mësiëprëm të jetë me dëshmi të sigurimit teknik, vjen në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë

01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”, pasi edhe lloji i punës objekt prokurimi nuk përkon me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik.

3. Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST** e cila kërkon nga OE të deklarojnë drejtuesit teknik të punimeve, ku të paktën duhet të jenë 1 inxhinier ndërtimi, 1 gjeodet dhe 1 inxhinier hidroteknik, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar ligjërisht. UKM nr. 2, datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

**Vlerësimi i ofertave:** 1. OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/c të DST** për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku OE ka zhvilluar veprimtarinë e tij për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

Ky OE, ka deklaruar punë të ngjashme në Bashkinë Shijak për vitet 2018, 2019 dhe në shtojcën 11 për vitin 2020, ndërkohë nuk ka paraqitur vërtetim për likuidimin e detyrimeve vendore pranë kësaj bashkie për vitin 2019 dhe 2020. Ka paraqitur punë të ngjashme për vitin 2019 në Bashkinë Vorë, ndërkohë nuk ka paraqitur dokumentacion për likuidimin e detyrimeve vendore pranë kësaj bashkie. Ka paraqitur punë të ngjashme në territorin e bashkisë Durrës për vitin 2018, ndërkohë nuk ka paraqitur dokumentacion për likuidimin e detyrimeve vendore. Ka paraqitur punë të ngjashme në Bashkinë Tiranë për vitin 2019, ndërkohë nuk ka paraqitur dokumentacion për likuidimin e detyrimeve vendore. Në shtojcën 11 ka deklaruar punë/kontrata në proces pranë bashkive Berat, Konispol, Gramsh dhe Lushnjë, ndërkohë nuk rezulton të ketë paraqitur vërtetimet për likuidimin e detyrimeve vendor përkatëse për vitin 2020 në kundërshtim me DST dhe deklaratën e dhënë nga administratori i shoqërisë në shtojcën përkatëse.

2. OE nuk përmbush kriterin për 1 minifadromë. Është paraqitur mjete i blerë nga subjekti M. SHPK, për të cilin mungon kontrata ose deklarata doganore sipas kërkesës në DST. Gjithashtu, ky mjet rezulton vetëlëvizës me goma, për të cilin duhej të pajisej me leje qarkullimi, policë sigurimi dhe akt kolaudimi.

3. OE nuk përmbush kriterin e vetëdeklarimit për kontratat në proces, ku njëkohësisht duhet të deklarojë edhe emrat e drejtuesve teknik të angazhuar në këto kontrata. Ky OE ka paraqitur ka paraqitur 8 kontrata të lidhura në të njëjtën kohë, ndërkohë nuk ka pasqyruar drejtuesin teknik në kundërshtim me DST.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Ndikimi/Efekti:** Lidhja e kontratës me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **59,267 mijë lekë** pa TVSH.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në hartimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

<b>14. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim i kanalizimeve të ujërave të zeza në Qukës Qendër Nj.Adm. Qukës Bashkia Prrenjas”</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 52, Datë 18.09.2020	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 52, Datë 18.09.2020	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër Nr. 295 datë.8.09.2020
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kërkesë për propozim”	1. M.P., Ing.topografe 2. M.R., Juriste 3. A.K., Juriste 4. A.B., Ekonomiste 5. A.B., Inxhinier	1. N.D., Kryetar 2. E.D., Anëtar 3. N.B., Anëtar
5. Fondi Limit: 3,287,787 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese: BOE “J.P.” SHPK & “R.G.K.” SHPK, me ofertë 2,657,957 lekë, kontrata Nr. 3950, datë 24.11.2020, me afat 68 ditë	7. Diferenca me fondin limit: 629,830 lekë pa TVSH

8. Data e hapjes së tenderit: 01.10.2020	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 8 OE b) Skualifikuar 6 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11. Ankimime: Ankesë /KVO OE "I." SHPK datë 16.10.2020, nr. 3392prot	12. Përgjigje Ankesës nga AK: OE "I." SHPK, datë 22.10.2020, nr. 3392/1prot	13. Përgjigje Ankesës nga APP/KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me vlerësimin e ofertave.

**Situata: Vlerësimi i ofertave:** 1. OE "R.G.K." SHPK, i cili ka marrë përsipër kryerjen 61.41% të punimeve, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.2 të DST** për kategorinë e licencës NS-18A.

2. BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.3 të DST** për 1 Teknik Topograf/Markshajder. Është paraqitur punonjësi F.P. nga OE J.P. SHPK, për të cilin është paraqitur dokumenti diplomë fotokopje e panoterizuar, në kundërshtim me DST.

3. BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.4 të DST** për 1 manovrator. Janë paraqitur 3 manovrator, punonjës të OE R.G.K. SHPK, konkretisht S.G. dhe K.Sh., të cilët kanë dëshminë e manovratorit jashtë afateve të vlefshmërisë, si dhe F.Sh. Për të tre këta manovratorë, nuk është paraqitur dëshmia e sigurimit teknik, në kundërshtim me DST.

4. BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.6 të DST** për 1 Autobetoniere. Është paraqitur mjeti me targa AA906XJ, për të cilin mungon leja e transportit.

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Ndikimi/Efekt:** Lidhja e kontratës me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik, për vlerën **2,657 mijë lekë** pa TVSH.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në hartimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e KVO.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

<b>15. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:</b> <i>"Rikonstruksion dhe riveshje me asfaltim i pjesëve të dëmtuara të rrugës Lapidari Qukës Shkumbin, Mulliri i Belbës, asfaltim i rrugës në lagjen e Kryeziut, asfaltimi rrugës në lagjen e Shytit dhe rikonceptimi i qendrës së fshatit Qukës, Nj.A Qukës Bashkia Prrenjas"</i>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 53, Datë 18.09.2020	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 53, Datë 18.09.2020	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër Nr. 297 datë 18.09.2020
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Procedure e Hapur"	1. N.D. 2. M.P. 3. A.K.	1. M.A., Kryetar 2. A.B., Anëtar 3. M.R., Anëtar
5. Fondi Limit: 81,243,482 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese: BOE "M." SHPK & "B.N." SHPK & Sh. SHPK, me ofertë 79,616,724 lekë, kontrata Nr. 3954, datë 24.11.2020, me afat 4 muaj.	7. Diferenca me fondin limit: 1,626,758 - lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: 26.10.2020	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime, AK: OE "H.N." SHPK datë 25.09.2020	12. Përgjigje ankesës nga AK, ska OE është tërhequr nga ankesa	13. Përgjigje Ankesës nga APP/KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në aplikimin e kriterëve.

**Situata: Hartimi i Kriterëve:** 1. Kërkesa e pikës **2.3.1/a/b e DST** e cila kërkon për punët e ngjashme për një objekt të vetëm që të jenë me vlerë sa 50% e vlerës së përlllogaritur të

kontratës, si dhe për punët e ngjashme ku vlera monetare për 3 vitet e fundit të jetë **sa** dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, janë kritere të vendosura jo në përputhje me pikën 6, germa a dhe b të nenit 26 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili nuk përcakton togfjalëshin **sa**, por punët e ngjashme kërkohet të jenë të përcaktuara me tog fjalëshin **jo më e madhe**, pasi është e pamundur që OE të kenë punët fix sa 50% i kontratës që prokurohet. Mund të përbëjë shkak për skualifikim të padrejtë për OE.

2. Kërkesa e pikës **4 në DST** e cila kërkon nga OE të kenë 2 inxhinier ndërtimi dhe 1 inxhinier ndërtimi profili transport drejtues teknik të shoqërisë, është kërkesë e paargumentuar. AK, në rast se e konsideron të nevojshme ekspertizën e 3 inxhinierëve të ndërtimit, do duhej që ta mundësonte edhe si punonjës jo domosdoshmërisht drejtues teknik, pasi potencialisht, kërkesa për 3 inxhinierë ndërtimi drejtues teknik pengon OE për paraqitje ofertash.

3. Kërkesa e pikës **8 në DST** e cila kërkon 1 mjek, është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 “Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1.

4. Kërkesa e pikës **11 të DST** e cila kërkon nga OE të disponojnë leje mjedisore Tipi C, Kodi III.1.A “Për stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme”, është kërkesë e tepërt për OE, pasi disponimi i këtyre lejeve për disponim Landfilli është i kufizuar, dhe si e tillë penalizon subjektet që përmbushin kriteret teknike për zbatimin e punimeve, por që nuk disponojnë stacion transferimi (landfill). AK, duhej të mundësojë që OE të disponojnë kontrata për depozitimin e këtyre mbetjeve si kusht kualifikues.

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Ndikimi/Efekti:** Ul numrin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në hartimin e kriterëve, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

<b>16. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve rurale”</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 58, Datë 12.10.2020	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 58, Datë 12.10.2020	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër Nr. 319 datë 12.10.2020
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kërkesë për propozim”	1. N.D., Inxhinier 2. E.D., Ekonomist 3. A.K., Jurist	1. M.R., Kryetar 2. M.P., Anëtar 3. A.B., Anëtar
5. Fondi Limit: 8,332,822.2 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese: BOE “L.B.” SHPK & “D.I.” SHPK, me ofertë 5,839,336 lekë, kontrata Nr. 4085, datë 07.12.2020, me afat 45 ditë.	7. Diferenca me fondin limit: 2,493,486.2 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 27.10.2020	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b) Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 3 OE
11. Ankimime, AK- ska; APP-ska; KPP-ska.	12. Përgjigje ankesës nga AK, ska	13. Përgjigje Ankesës nga APP/KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në aplikimin e kriterëve.

**Situata: Hartimi i Kriterëve:** 1. Kërkesa e pikës **2.3.6 e DST** e cila kërkon nga OE 1 rrul 8-10 ton, është kërkesë e cila ka vendosur një kufi të vogël mes kapacitetit minimal dhe maksimal për rrulin me 2 tonë. AK duhej të përcaktonte një kufi më të madh mes peshës minimale dhe



maksimale. Mund të pengojë OE që kanë kapacitetet e nevojshme por disponojnë rrula me kapacitet të tjera.

2. Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST**, e cila kërkon 2 manovrator dhe 2 shofer për mjetet e rënda, është kërkuar që OE të paraqesin si dokumentacion dëshmitë e sigurimit teknik. Sa më sipër, kërkesa që të paraqiten dëshmi sigurimi teknik për manovratorët nuk është në përputhje me objektin e kontratës që është për rikonstruksion rrugës, ndërkohë dëshmitë e sigurimit teknik lëshohen sipas kërkesave të ligjit me nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”. AK duhej të kërkonte për OE të paraqisnin Dëshmitë e Aftësisë Profesionale, si dokumente që provojnë se punonjësin përmbushin kushtet për drejtimin e mjeteve/ makinerive të rënda.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Ndikimi/Efekti:** Ul konkurrencën.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në hartimin e kriterëve, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJP.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP & KVO, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1173/32 prot., datë 11.05.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

*Pretendimet e paraqitura nga anëtarët e NJP dhe KVO, janë të njëjta me atë të paraqitura mbi Akt Konstatimet të cilat janë trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, dhe nuk është paraqitur asnjë provë apo argument i ri.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në këto kushte kundërshtimet nuk pranohen.

**Procedurat e periudhës 01.01.2021-31.12.2021**

<b>17. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstruksion shkollë Katjel”</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 01, datë 07.01.2021	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 01, datë 07.01.2021	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 05 datë 07.01.2021
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kërkesë për propozim”	1. N.D., Inxhinier 2. Z.Ç., Juriste 3. A.K., Juriste	1. M.R., Kryetar 2. J.B., Anëtar 3. M.B., Anëtar
5. Fondi Limit: 11,452,376 lekë pa TVSH.	6. Oferta fituese: OE “N.” SHPK me ofertë 9,567,036 lekë pa TVSH, kontrata datë 26.03.2021, me afat 54 ditë.	7. Diferenca me fondin limit: 1,885,340 lekë pa TVSH.
8. Data e hapjes së tenderit: 02.02.2021	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 10 OE b) Skualifikuar 5 OE c) Kualifikuar 5 OE
11. Ankimime AK, - OE “H.N.” SHPK me Nr. 110 prot. datë 14.01.2021, ankesë për DST - OE “2.” SHPK me Nr. 399 prot. datë 17.02.2021, ankesë për KVO	12. Përgjigje ankesës nga AK, - Kthim përgjigje drejtuar OE “H.N.” SHPK me Nr. 110/1 prot. datë 15.01.2021. - Kthim përgjigje drejtuar “2.” SHPK me Nr. 399/1 prot. datë 24.02.2021	13. Përgjigje Ankesës nga APP- KPP: Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

**Situata: Hartimi i Kriterëve:** 1. Kërkesa e pikës 3.1 në DST e cila kërkon 1 Arkitekt, është kërkesë jo në përputhje me objektin, pasi kemi të bëjmë me kontratë për punë publike, dhe jo kontratë projektimi për të pasur të nevojshëm ekspertizën e arkitektit, dhe aq më pak drejtues teknik në licencën e shoqërisë.

2. Kërkesa e pikës 5 në DST e cila kërkon 1 mjek ndërmarrjeje apo të kontraktuar nga jashtë, është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011, “Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1.

**Vlerësimi i ofertave:** 1.OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.2 të DST për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2019 dhe 2020. Ky OE, ka deklaruar punë të ngjashme kontratën e lidhur me bashkinë Kukës me objekt *Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Mamës, Bashkia Kukës*, ku sipas formularit të vlerësimit kontrata ka përfunduar me datë 10.07.2019, si dhe kontratën e lidhur me bashkinë Kamëz me objekt “*Ndërtim rrugët (Iliria + Burimi + Mbretëresha Suzanë)*”, ku sipas formularit të vlerësimit, ka përfunduar kontratën me datë 08.04.2019. Në asnjërën nga këto bashki, ky OE nuk ka paraqitur vërtetim për likuidimin e detyrimeve vendore për vitin 2019.

Ky OE njëkohësisht ka deklaruar kontrata të lidhura në proces në disa AK përgjatë vitit 2020, ndërkohë nuk ka paraqitur vërtetimet për likuidimin e detyrimeve vendore, konkretisht në Bashkinë Klos me objekt *Rikonstruksion kanali vaditës Cerujë*, kontratë e lidhur me datë 23.11.2020, kontrata e lidhur me Bashkinë Malësi e Madhe me objekt “*Ndërtim i ujësjellësit Bajzë*”, kontratë e lidhur me datë 27.10.2020, kontrata e lidhur me Bashkinë Mat me objekt “*Rehabilitim i digës së ujëmbledhësit Shoshaj*”, kontratë e lidhur me datë 08.10.2020, kontrata e lidhura me Bashkinë Kamëz me objekt “*Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara*”, kontratë e lidhur me datë 28.09.2020. Në asnjërin prej AK të cituara më sipër, nuk janë paraqitur vërtetime për likuidimin e detyrimeve vendore nga OE i shpallur fitues.

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Ndikimi/Efekti:** Lidhja e kontratës me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **9,567 mijë lekë** pa TVSH.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

<b>18. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Përmirësimin i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pafavorizuara”</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 39 datë 25.08.2021	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 39 datë 25.08.2021	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 205 datë 25.08.2021
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”	1. N.D., Ing. ndërtimi 2. A.K., Jurist 3. E.D., Ekonomist	1. M.A., Kryetar 2. E.C., Anëtar 3. M.B., Anëtar
5. Fondi Limit: 27,316,341 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese: “N.” SHPK, vlera 16,936,092 lekë pa TVSH, kontrata datë 21.10.2021, me afat 12 muaj.	7. Diferenca me fondin limit: 10,380.249 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: 23.09.2021	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 6 OE b) Skualifikuar 1 OE c) Kualifikuar 5 OE

11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP/KPP, Nuk ka
----------------------------	---	--

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

**Situata: Hartimi i Kriterëve:** 1. Kërkesa e pikës **2.6 e DST** e cila kërkon 1 mjek, është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 “Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1.

2. Kërkesa e pikës **4 në DST** e cila kërkon nga OE 2 kamionë me kapacitet mbajtës 10-12 ton, kamion me vinq 6-7 ton, kamionçinë 1-2 ton dhe 2 ekskavatorë, është kërkesë e paargumentuar teknikisht dhe jo në përputhje me rregullat e LPP. Së pari, kërkesa për 2 kamionët me kapacitet mbajtës 10-12 ton, kamioni me vinq 6-7 ton dhe kamionçina 1-2 ton, janë kërkesa të vendosura me kapacitet midis njësisë minimale dhe maksimale shumë të ngushtë ku varion nga 1 deri në 2 ton kapaciteti ndërmjet peshës minimale dhe maksimale. Ky kufi i ngushtë i vendosur nga NJP, nuk i shërben procedurës dhe nuk argumentohet nga AK, i cili duhet të përcaktonte kufij më të arsyeshëm mes peshës minimale dhe maksimale. Nuk është kriter që i shërben procesit por mund të përbëjë kufizim për OE.

Gjithashtu, kërkesa për 2 miniekskavatorë, është jo në përputhje me zërat e preventivit, në të cilët nuk përcaktohet nevoja për ekskavator.

3. Kërkesa e pikës **4.2 e DST** e cila kërkon nga OE që për makineritë dhe pajisjet me qira të shoqërohen me kontratë qiraje noteriale **me përdorim të përcaktuar për objektin e prokurimit**, është kërkesë e paargumentuar teknikisht dhe ligjërish, pasi kjo veçse shton kosto për OE të cilët kanë kontrata të ligjshme dhe brenda afateve të vlefshmërisë për mjetet në disponim, për të cilët kërkohet të bëjnë kontrata vetëm për shtimin e objektit të prokurimit. Kjo kërkesë nuk i shërben procedurës, dhe mund të përbëjë shkak për skualifikim të padrejtë për OE.

**Vlerësimi i ofertave:** 1. OE fitues nuk përmbush kriterin e pikës **2.2/3 të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar**, për vërtetimet e shlyerjes së taksave vendore për vitin 2021 (këstet e maturuara), të cilat duhet të plotësohen nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit. Në formularin e paraqitur, nuk është paraqitur vetëdeklarimi për likuidimin e detyrimeve vendore në kundërshtim me DST.

2. OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.8 të DST** e cila kërkon nga OE 2 teknik ndërtimi. Në shtojcën e deklarimit mbi stafin e kërkuar, është paraqitur dokumentacion vetëm për 1 teknik ndërtimi, ndërkohë në DST janë kërkuar 2 të tillë.

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Ndikimi/Efekt:** Lidhja e kontratës me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **16,936 mijë lekë** pa TVSH.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJP dhe anëtarët e KVO.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

**19. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion rrugëve të brendshme në Bashkinë Prrenjas: Rruga 1 Qershori/Rruga 5 Maji”**

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 41, datë 15.09. 2021	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 41, datë 15.09. 2021	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 219 datë 15.09.2021
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e thjeshtuar”	1. N.D., Inxhinier 2. Z.Ç., Juriste 3. M.K., Ekonomist	1. M.B., Kryetar 2. J.B., Anëtar 3. A.K., Anëtar

	4. E.C., Juriste 5. M.P., ing. topografe	
5. Fondi Limit: 10,553,660 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese: "S." SHPK, Vlera 8,007,627 lekë pa TVSH, kontrata datë 15.11.2021, me afat 6 javë	7. Diferenca me fondin limit: 2,546,033 - lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit:06.10.2021	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 6 OE b) Skualifikuar 3 OE c) Kualifikuar 3 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP/KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në vlerësimin e ofertave.

**Situata: Vlerësimi i ofertave:** 1. OE fitues nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/d të DST**, për vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike. Ky OE, rezulton se ka paraqitur vërtetimin me nr. 1064 prot., datë 20.09.2021, sipas të cilit ky OE ka likuiduar faturat deri më datë 20.09.2021, **pa përfshirë faturën koherente të muajit Gusht 2021.** Në kushtet kur data e zhvillimit të tenderit është 06.10.2021, ky OE, duhej të kishte likuiduar detyrimet e muajit Gusht për të përmbushur kriterin e kërkuar.

2. OE nuk përmbush kriterin e pikës **6 të DST** për 1 Autobot Uji dhe 1 Grejder. Nga dokumentacioni i paraqitur pranë AK, për mjetin Autobot është paraqitur një kamion i marrë me qira nga shtetasi B.M., dhe një depozitë uji e cila është në pronësi të OE "S." SHPK. Sa më sipër, nuk kemi të bëjmë me mjetin autobot uji, por me një kamion dhe një depozitë, në kundërshtim me DST. Në lidhje me mjetin Grejder, është paraqitur një deklaratë doganore me nr. R 378, ndërkohë mjeti rezulton me goma vetëlëvizës, dhe si i tillë duhet të pajiset me leje qarkullimi, akt kolaudimi, policë sigurimi dhe akt pronësie të cilat ky mjet nuk i disponon.

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Ndikimi/Efekt:** Lidhja e kontratës me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik, për vlerën **8,007 mijë lekë** pa TVSH.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NjP, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1173/32 prot., datë 11.05.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

1. Lidhur me kërkesën për 1 inxhinier elektrik drejtues teknik, sqarohet se kjo kërkesë është vendosur duke qenë se në preventiv janë të parashikuara punime elektrike dhe se këto punime elektrike kanë rëndësi për shkak edhe se rrugët të cilat janë rikonstruktuar janë të një rëndësie parësore për qytetarët, rrjedhimisht dhe ndriçimi i tyre ka një rëndësi thelbësore.

*Inxhinier Elektrik shfaqet i nevojshëm për drejtimin e punimeve elektrike, parashikuar si zë më vete në preventiv.*

2. Lidhur me faktin se s'janë kërkuar manovratorë, sqarohet se AK nuk ka kërkuar manovratorë për mjetet e kërkuara në DST, AK nuk ka kërkuar manovratorë pasi në shumë raste APP në rekomandimet e saj është shprehur se nuk është e nevojshme kërkesa për manovratorë ose shofer pasi OE mund të paraqesë edhe mjete me qira për të cilat s'ka pse të paraqesë punonjës në listë pagesa por mund ti ketë edhe me kontrate shërbimi.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1. Pranohen argumentimet e dhëna nga NjP, por audituesit sqarojnë se AK duhet të konsiderojë mundësinë që në procedurat në vijim, të mos kufizojnë mundësinë e disponimit të stafit inxhinierik domosdoshmërisht me drejtues teknik, por të mundësojnë gjithashtu që ky staf të jetë edhe me kontrata ose me staf në listëpagesa pa qenë detyrimisht drejtues teknik.
2. Lidhur me mos kërkimin e manovratorëve, audituesit pranojnë argumentimet e dhëna, por ky standard të synohet edhe në procedura tjera, dhe jo të veçohet rast pas rasti.

Lidhur me pretendimet tjera për procedurat e auditimit të trajtuara me mangësi përgjatë vitit 2021, sqarimet e dhëna janë të njëjta me ato të paraqitura mbi akt konstatimet, të cilat janë trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit.

**Procedurat e periudhës 01.01.2022-31.12.2022**

<b>20. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Qukës Shkumbin-Skroskë”.</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 29, datë 20.07.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 29, datë 20.07.2022	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër Nr. 418 datë 20.07.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur”	1. Z.Ç., Juriste 2. M.P., Ing.topgraf 3. J.B., Ekonomiste	1. M.R. - Kryetar, 2. A.B. - Anëtar 3. M.H. - Anëtar
5. Fondi Limit: 73,867,452 lekë pa TVSH.	6. Oferta fituese: BOE “M.” SHPK &”Sh.” SHPK me ofertë 61,281,150 lekë pa TVSH, kontrata datë 04.11.2022, me afat 4 muaj	7. Diferenca me fondin limit: 12,586,302 lekë pa TVSH.
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 23.08.2022	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë.	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 11 OE b) Skualifikuar 6 OE c) Kualifikuar 5 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP/KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

**Situata: Hartimi i Kriterëve:** 1. Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon ndër të tjera 2 kamionë me kapacitet mbajtës 10-12 ton, është kërkesë e cila ka përcaktuar një kapacitet të ngushtë mes kapacitetit minimal dhe maksimal të mjetit prej 2 tonësh, kapacitet i cili nuk argumentohet teknikisht, dhe mund të përbëjë shkak jo cilësor për kualifikimin ose e OE. AK duhej të përcaktonte një kufi më të madh mes kapacitetit minimal dhe maksimal, për të rritur mundësinë e përmbushjes së kriterit nga OE të cilët kanë mjetet e nevojshme për zbatimin e kontratave.

2. Kërkesa për rimorkiator, për të cilin është kërkuar të disponohet në pronësi apo me qira, AK duhet të mundësonte disponimin e këtij mjete edhe me kontratë shërbimi, pasi kemi të bëjmë me një mjet i cili nuk është i nevojshëm përgjatë proceseve të punës në vazhdim, dhe si i tillë nuk mund të kërkohej gjatë periudhës së zbatimit të kontratës.

**Vlerësimi i ofertave:** 1.OE “M.” SHPK, i cili ka marrë përsipër kryerjen e 80% të çdo zëri të punimeve, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.6 të DST** për 1 manovrator/ekskavatorist dhe 1 buldozerist, pasi nuk ka paraqitur asnjë punonjës manovrator i cili të kenë kualifikimet e mësipërme, në kundërshtim me me pikën 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Shkak:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

**Ndikimi/Efekt:** Lidhja e kontratës me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik, për vlerën **61,281 mijë lekë** pa TVSH.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP & KVO, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1173/32 prot., datë 11.05.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

Lidhur me pikën 1, sqarohet se kategoria e kërkuar NP—4B, është kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve të këtij objekti, konkretisht (Kategoria NP-4, rrugë autostrada, mbikalime, Seksioni 2-Punime për gjithë trupin e rrugës me të gjithë zërat e punimeve – vlera e të cilave është 45,851,456 lekë, që është brenda vlerës së kufirit të parashikuar sipas VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008 i ndryshuar.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Lidhur me pikën e mësipërme, pranohet observacioni juaj, duke qenë se NjP është udhëhequr në përcaktimin e kategorisë së licencës bazuar në vlerën konkrete të zërit të punimeve dhe jo vlerës së gjithë objektit.

Lidhur me pikat tjera, pretendimet janë të njëjta me ato të paraqitura mbi akt konstatimin dhe të trajtuara në Projekt Raportin e Auditimit. Nuk është paraqitur argument apo provë e re për të ndryshuar qëndrimin e audituesve.

Në këto kushte kundërshtimet nuk pranohen.

**21. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Përmirësimin e kushteve të banesave për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”**

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 36, datë 26.08.2022.	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 36, datë 26.08.2022	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 465 datë 26.08.2022.
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Procedurë e hapur, Punë	1. Z.C., Juriste 2. M.P., Inxhinere 3. R.D., Ekonomiste	1. M.R., Kryetar 2. G.K., Anëtar 3. E.D., Anëtar
5. Fondi Limit: 29,443,307.5 lekë pa TVSH.	6. Oferta fituese: “I.” SHPK 23,782,675.5 lekë pa TVSH Kontrata datë 12.10.2022., me afat 6 muaj	7. Diferenca me fondin limit: 5,660,632 (lekë pa TVSH )
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit :14.09.2022	9. Burimi i Financimit: 20% Financim nga Bashkia 80%Buxheti Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 6 OE b) Skualifikuar, 3 OE c) Kualifikuar 3 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP/KPP: Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me vlerësimin e ofertave.

**Situata: Vlerësimi i ofertave:** 1. OE fitues nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.6. të DST** për 2 kamionë me kapacitet mbajtës 7 ton. Janë paraqitur 2 mjete të marra me qira nga subjekti A. SHPK. Mjeti me targa AB083GB, rezulton se ka certifikatën e kontrollit teknik jashtë afatit të vlefshmërisë nga data 07.09.2022, ndërkohë data e tenderit është 14.09.2022. Për mjetin me targa AA431EL, rezulton se ka policën e sigurimit jashtë afatit të vlefshmërisë nga data 13.09.2022 dhe policën e sigurimit nga data 15.09.2022. Vlen të theksohet se dokumentet e tenderit të cilat janë paraqitur pranë AK janë noterizuar në datën 27.09.2022 dhe dokumentet e cituara më sipër janë 2 javë jashtë vlefshmërie.

2. OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.6. të DST** për 2 kamionçina. Mjeti me targa A....Y i marrë me qira nga subjekti K.Z. nuk ka certifikatën e transportit. Mjeti me targa A.....B, i deklaruar në shtojcën e vetëdeklarimit në pronësi të subjektit “I.” SHPK, rezulton sipas certifikatës së pronësisë së mjetit dhe lejes së qarkullimit në pronësi të subjektit G.L.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Ndikimi/Efekti:** Lidhja e kontratës me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **23,782 mijë lekë** pa TVSH.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJP dhe anëtarët e KVO.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP & KVO, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1173/32 prot., datë 11.05.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

*Pretendimet e paraqitura nga anëtarët e NJP dhe KVO, janë të njëjta me atë të paraqitura mbi Akt Konstatimet të cilat janë trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, dhe nuk është paraqitur asnjë provë apo argument i ri.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në këto kushte kundërshtimet nuk pranohen.

**2.4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues.**

Në zbatim të nënsaj nënpike të Programit të auditimit, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizua regjistri i realizimit të investimeve që i përket periudhës së auditimit të përputhshmërisë, nga data 01.01.2019 deri në datën 31.12.2022.

Nga grupi i auditimit, në bazë të nivelit të materialitetit, rishtit cilësor dhe kohës në dispozicion, u gjykuan për t’u audituar kontratat për punë publike, pasqyruar në Aneksin Z1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, me vlerë totale **445,551,082 lekë pa TVSH ose 534,661,298 lekë me TVSH**, mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit në investimet publike, përputhshmërinë me projektet e zbatimit, kushteve teknike të zbatimit, kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës, kolaudimin, zbatimin e afateve të kontratave si dhe marrjen në dorëzim të punimeve të kryera.

**Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave për punë publike, u konstatua si vijon:**

<b>1. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: “Rikonstrukcion rrjeti shpërndarës i ujësjellësit Prrenjas” Bashkia Prrenjas, me këto të dhëna:</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 1075 Prot., datë 19.03.2020 OE “C.” SHPK	<b>15. Vlera e kontratës</b> Vl e prev ofertues 213,998,884.34 lekë me TVSH	<b>16. Likuiduar:</b> Sit. 1 në vlerën 20,331,150.92lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 80,605,683.68 lekë me TVSH Sit. 3 në vlerën 37,728,146.37 lekë me TVSH Sit. 4 përfundimtar në vlerën 75,333,903 lekë me TVSH
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b> Vlera 213,998,884.34 lekë me TVSH.	<b>18. Afati i kontratës në ditë</b> Fillimi punimeve: 01.04.2020 Përfundimi punimeve: 24.09.2021	<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Nuk ka

<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “Z. & C.” SHPK	Licenca MK. 1208/14	Kontratë me nr. 1110 prot, datë 27.03.2020
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> “D.” SHPK	Licenca nr: MK. 1676/12	Kontratë nr. 2051 prot, datë 20.07.2022
<b>22. Akt Kolaudimi</b> Datë: 25.07.2022	<b>23. Akt i marrjes në dorëzim:</b> Me datë 25.07.2022 objekti është marrë në dorëzim përkohësisht nga Bashkia Prrenjas. Urdhër nr. 430, datë 25.07.2022 është ngritur grupi me përbërje: Y.A. Kryetar, E.B. dhe E.V. anëtarë.	

**Titulli i Gjetjes:** Punime ndërtimi të pakryera në objektin “Rikonstruksion rrjeti shpërndarës i ujësjellësit Prrenjas”.

**Situata:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion rrjeti shpërndarës i ujësjellësit Prrenjas”, me vlerë 213,998,884.34 lekë me TVSH, fituar nga OE “C.” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në vlerën **547,304.39 lekë pa TVSH**, argumentuar si vijon:

**Rehabilitimi i rezervuarit** (Furnizim dhe vendosje e materialeve të rezervuarit)

Përshkrimi i zërit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
<b>Burimi i ujit</b>				
Furnizimi dhe instalimi i pusëtës së shkarkimit të dhomës së klonimit duke përfshirë furnizimin dhe instalimin e tubacioneve dhe materialeve ndihmëse	Total	1.00	184,133.17	184,133.17
<b>Burimi i ujit</b>				
<b>Punime të sistemit të klorinimit</b>				
Kit portativ për matje klori	cope	1.00	118,000.00	118,000.00
Furnizimi dhe instalimi i analizatorit të klorit në rrjetin kryesor, duke përfshirë tubacionet ndihmëse, bateritë, transmetuesin dhe kabinën plastike me themele betoni	Total	1.00	245,171.22	245,171.22
<b>SHUMA</b>				<b>547,304.39</b>

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3; Kontrata e sipërmarrjes së punimeve, nr. 1075 prot., datë 19.03.2020; Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve, nr. 1110 prot., datë 27.03.2020.

**Ndikimi/Efekti:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Prrenjas.

**Shkaku:** Mosrealizim zëra punë ndërtimi.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi 1:** Bashkia Prrenjas të arkëtojë vlerën prej **184,133.17 lekë pa TVSH** nga shoqëria OE “C.” SHPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën nr. 1075 Prot., datë 19.03.2020, me objekt “Rikonstruksion rrjeti shpërndarës i ujësjellësit Prrenjas”.

**Rekomandimi 2:** Bashkia Prrenjas, të marrë masa për të ngritur një grup pune me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin; kolaudatorin e punimeve si dhe Ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime në cilësinë e administrimit të investimit, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, bazuar nga fakti i auditimit në terren ku rezultuan pajisje të pavendosura në objekt. Dalja e përgjegjëseve, realizimi i zërave të punimeve sipas PZ dhe ST në shumën **363,171.22 lekë**, të konfirmohet zyrtarisht nga palët, Autoriteti Kontraktor Bashkia Prrenjas, Ndërmarrja e Ujësjetllës Kanalizimeve, Sipërmarrësi i punimeve, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit brenda periudhës së garancisë me datë 25.07.2023. Në rast të kundërt, mosvendosja e pajisjeve në objekt, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga personat përgjegjës.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

- Z. A.P.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.
- Z. V.T.**, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve.



Për sa konstatuar më sipër, subjekti i audituar Bashkia Prrenjas, me shkresën nr. 1292, datë 09.05.2023 (protokolluar në KLSH me nr. 1173/32 prot., datë 11.05.2023) ka bërë komente dhe shpjegime për Nënplikën 2.4.4. të Projekt Raportit të Auditimit, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:

**Pretendimi i subjektit:**

- Për objektin “Rikonstruksion rrjeti shpërndarës i ujësjellësit Prrenjas”, është bërë opoenca teknike me nr. 87/4 datë 28.03.2019.

**Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Grupi i auditimit sqaron se: lidhur sa pretendoni, është shprehur në akt-konstatimin nr. 5, datë 10.03.2023, se për objektin “Rikonstruksion rrjeti shpërndarës i ujësjellësit Prrenjas”, është kryer opoenca teknike por gabimisht është shënuar në rekomandimin nr. 11 të Projektraportit të auditimit. Sa më sipër observacioni merret në konsideratë dhe për këtë do të reflektohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

**2. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: “Rikonstruksion dhe riveshje me asfaltim i pjesëve të dëmtuar të rrugës Lapidari Qukës Shkumbin, Mulliri i Belbës, asfaltimi i rrugës në lagjen e Kryeziut, asfaltimi i rrugës në lagjen e Shytit dhe rikonceptimi i qendrës së fshatit Qukës, NjA Qukës”, Bashkia Prrenjas, me këto të dhëna:**

<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 3954 Prot., datë 24.11.2020 OE “M.” SHPK	<b>15. Vlera e kontratës</b> Vl e prev ofertues 95,540,069 lekë me TVSH	<b>16. Likuiduar:</b> Sit. 1 në vlerën 15,000,000 lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 38,000,000 lekë me TVSH Sit. 3 në vlerën 11,785,098 lekë me TVSH Sit. 4, në vlerën 8,754,971 me TVSH Sit përfundimtar, në vlerën 20,892,452 lekë me TVSH
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b> Vlera 95,532,124 lekë me TVSH	<b>18. Afati i kontratës në ditë</b> Fillimi punimeve: 25.11.2020 Përfundimi punimeve: 19.03.2021	<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Nuk ka
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “A.M.” SHPK	Licenca MK. 2892/5	Kontratë me nr. 3953 prot, datë 24.11.2020
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> “G.L.C.” SHPK	Licenca Nr: MK. 2928/8	Kontratë nr. 1211 prot, datë 15.04.2022
<b>22. Akt Kolaudimi</b> Datë: 20.04.2022	<b>23. Akt i marrjes në dorëzim:</b> Me datë 04.05.2022 objekti është marrë në dorëzim përkohësisht nga Bashkia Prrenjas. Urdhër nr. 258, datë 27.04.2022 është ngritur grupi me përbërje: E.V., Kryetar, Y.K. dhe M.P. anëtarë.	

**Titulli i Gjetjes:** Zëra pune të pakryera në objektin “Rikonstruksion dhe riveshje me asfaltim i pjesëve të dëmtuar të rrugës Lapidari Qukës Shkumbin, Mulliri i Belbës, asfaltimi i rrugës në lagjen e Kryeziut, asfaltimi i rrugës në lagjen e Shytit dhe rikonceptimi i qendrës së fshatit Qukës, NjA Qukës”.

**Situata:**

**Segmenti i parë. Punime shtresash, vazhdim i pjesës së parë. Zëri: 6 (3.353) Mbushje me material shkëmbor pas mureve.**

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 258 m<sup>3</sup>, mbushje pas mureve me çmim 500 lekë.

Libreza e masave pasqyron sasinë 258 m<sup>3</sup>, mbushje pas mureve, trajtuar e detajuar.

Nga auditimi në objekt, u konstatua se nuk është realizuar ky zë pune.

Sa më sipër trajtuar, nga sipërmarrësi i punimeve është përfituar tepër volumi i këtij zëri në vlerën **129,000 lekë** (258 m<sup>3</sup> x 500 lekë).

**Segmenti i dytë. Zëri: 6 (3.353) Mbushje me material shkëmbor pas mureve.**

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 230 m<sup>3</sup>, mbushje pas mureve me çmim 500 lekë.

Libreza e masave pasqyron sasinë 230 m<sup>3</sup>, mbushje pas mureve, trajtuar e detajuar.

Nga auditimi në objekt, u konstatua se nuk është realizuar ky zë pune.

Sa më sipër trajtuar, nga sipërmarrësi i punimeve është përfituar tepër volumi i këtij zëri në vlerën **115,000 lekë** (230 m<sup>3</sup> x 500 lekë).

**Segmenti i tretë. Zëri: 6 (3.353) Mbushje me material shkëmbor pas mureve.**

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 87 m<sup>3</sup>, mbushje pas mureve me çmim 500 lekë.

Libreza e masave pasqyron sasinë 87 m<sup>3</sup>, mbushje pas mureve.

Nga auditimi në objekt, u konstatua se nuk është realizuar ky zë pune.

Sa më sipër trajtuar, nga sipërmarrësi i punimeve është përfituar tepër volumi i këtij zëri në vlerën **43,500 lekë** (87 m<sup>3</sup> x 500 lekë).

**Punime për sheshin. Zëri: 12 (3.An/et) FV Elektroda tokëzimi të xinguar 50x3 mm.**

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 12 copë elektroda me çmim 1,000 lekë.

Libreza e masave pasqyron sasinë 12 copë elektroda.

Nga auditimi në objekt, u konstatua se nuk është realizuar ky zë pune.

Sa më sipër trajtuar, nga sipërmarrësi i punimeve është përfituar tepër volumi i këtij zëri në vlerën **12,000 lekë** (12 copë x 1,000 lekë).

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3; Kontrata e sipërmarrjes së punimeve, nr. 3954 prot., datë 24.11.2020, Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve, nr. 1211 prot., datë 15.04.2022.

**Ndikimi/Efekti:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, janë librezuar dhe situacionuar volume pune të pa argumentuara si zë pune i maskuar.

**Shkaku:** Moskryerje punime ndërtimi nga sipërmarrësi.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Bashkia Prrrenjas të arkëtojë vlerën prej **299,500 lekë pa TVSH** nga shoqëria BOE “M.” SHPK & “Sh.” SHPK, për punime të pakryera, sipas kontratës me nr. 3954 prot., datë 24.11.2020 me objekt “Rikonstruksion dhe riveshje me asfaltim i pjesëve të dëmtuar të rrugës Lapidari Qukës Shkumbin, Mulliri i Belbës, asfaltimi i rrugës në lagjen e Kryeziut, asfaltimi i rrugës në lagjen e Shytit dhe rikonceptimi i qendrës së fshatit Qukës, NjA Qukës” Bashkia Prrrenjas.

**Titulli i Gjetjes:** Mosrealizim i Oponencës Teknike të projektit të zbatimit me objekt: “Rikonstruksion dhe riveshje me asfaltim i pjesëve të dëmtuar të rrugës Lapidari Qukës Shkumbin, Mulliri i Belbës, asfaltimi i rrugës në lagjen e Kryeziut, asfaltimi i rrugës në lagjen e Shytit dhe rikonceptimi i qendrës së fshatit Qukës, NjA Qukës” nga Bashkia Prrrenjas.

**Situata:** Për ndërtimin e investimit me objekt: “Rikonstruksion dhe riveshje me asfaltim i pjesëve të dëmtuar të rrugës Lapidari Qukës Shkumbin, Mulliri i Belbës, asfaltimi i rrugës në lagjen e Kryeziut, asfaltimi i rrugës në lagjen e Shytit dhe rikonceptimi i qendrës së fshatit Qukës, NjA Qukës” nga Titullari i Bashkisë Prrrenjas z. N.B. është lëshuar Leje Infrastrukturore me nr. 72, datë 25.11.2020.

Projekti i zbatimit është hartuar në vitin 2020 nga shoqëria “Z.C.” SHPK, përfaqësuar nga z. R.T. me Licencë N. 0433/16.

Për projektin e zbatimit të këtij objekti, nuk është kryer oponencë teknike nga Bashkia Prrrenjas. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 6 dhe ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë z. N.B..

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Ligji nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”, neni 6.

**Ndikimi/Efekti:** Realizimi i projektit të zbatimit pa oponencë teknike.

**Shkaku:** Neglizhencë e Bashkisë Prrrenjas.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Bashkia Prrenjas të marrë masa për pajisjen me oponencë teknike për të gjitha ndërtimet publike dhe jo publike, me vlerë të preventivuar mbi 100 milion lekë, si dhe për objektet me akses publik, sipas legjislacionit në fuqi.

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar Bashkia Prrenjas, me shkresën nr. 1292, datë 09.05.2023 (protokolluar në KLSH me nr. 1173/32 prot., datë 11.05.2023) ka bërë komente dhe shpjegime për Nënrikën 2.4.4. të Projekt Raportit të Auditimit, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:

**Pretendimi i subjektit:**

- Për objektin “Rikonstruksion dhe riveshje me asfaltim i pjesëve të dëmtuar të rrugës Lapidari Qukës Shkumbin, Mulliri i Belbës, asfaltimi i rrugës në lagjen e Kryeziut, asfaltimi i rrugës në lagjen e Shytit dhe rikonceptimi i qendrës së fshatit Qukës, NjA Qukës”, nuk ka qenë e nevojshme sepse vlera është nën 100 milion lekë.

**Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Grupi i auditimit sqaron, se, për rastin konkret, duhet të ishte kryer oponencë teknike, në zbatim të nenit 6, germa a “ndërtimet publike” të Ligjit nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”. Pra lidhur me vlerën mbi 100 milion lekë oponenca kryhet për objekt jopublik, sipas nenit 6, germa b “ndërtimet jopublike” të Ligjit nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”. Si përfundim, për ndërtimet publike, pavarësisht vlerës (ligji nuk përcakton vlerë) duhet patjetër të kryhet oponenca teknike për projektet e ndërtimit.

Sa më sipër trajtuar, observacioni **nuk merret në konsideratë.**

**3. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Qukës Shkumbin – Stroskë Bashkia Prrenjas”, Bashkia Prrenjas, me këto të dhëna:**

<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 3029 Prot., datë 04.11.2022 OE “M. & Sh.”SHPK	<b>15. Vlera e kontratës</b> Vl e prev ofertues 73,537,380 lekë me TVSH	<b>16. Likuiduar:</b> Sit. 1 në vlerën 12,000,000 lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 9,156,433 lekë me TVSH
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b> -Vlera ---- lekë me TVSH.	<b>18. Afati i kontratës në ditë</b> Fillimi punimeve: 04.11.2022 Përfundimi punimeve: ---	<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Punime në proces
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “A.M.” SHPK	Licenca MK.2892/5	Kontratë me nr. 3027 prot, datë 04.11.2022
<b>21. Kolaudatori i punimeve ----</b>	Licenca Nr: MK.-----	Kontratë nr. ---- prot, datë ----
<b>22. Akt Kolaudimi</b> Datë: ----	<b>23. Akt i marrjes në dorëzim:</b> -----	

**Titulli i Gjetjes:** Zëra pune të pakryera në objektin “Rikonstruksion i rrugës Qukës Shkumbin – Stroskë Bashkia Prrenjas”.

**Situata:**

**Segmenti i I-rë. Punime për struktura, mure dhe kanale. Zëri 1 (An-8/M3). Mbushje me çakëll pas mureve.**

Situacioni progresiv nr. 2 pasqyron volumin 85 m<sup>3</sup> mbushje me çakëll me çmim 900 lekë.

Nga auditimi i realizimit të këtij zëri pune në objekt, rezultoi se nuk është realizuar.

Sa më sipër trajtuar, nga sipërmarrësi i punimeve është përfituar tepër volumi në vlerën **76,500 lekë** (85 m<sup>3</sup> x 900 lekë).

**Zëri 2 (3.183/a). Shtresë zhavorr lumi t=10 cm, për themelin.**

Situacioni progresiv nr. 2 pasqyron volumin 134 m<sup>2</sup> shtresë zhavorri me çmim 200 lekë.

Nga auditimi i realizimit të këtij zëri pune në objekt, si dhe i dokumentacionit teknik në dosje rezultoi se, ky zë pune nuk është i argumentuar/justifikuar si zë pune i maskuar. Sa më sipër

është në kundërshtim me VKM nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Pika 8.3.

Sa më sipër trajtuar, nga sipërmarrësi i punimeve është përfituar tepër volumi në vlerën **26,800 lekë** (134 m<sup>2</sup> x 200 lekë).

**Zëri 4 (An-10/M3). Mbushje me argjilë pas mureve.**

Situacioni progresiv nr. 2 pasqyron volumin 11 m<sup>3</sup> mbushje me argjilë me çmim 600 lekë.

Nga auditimi i realizimit të këtij zëri pune në objekt, si dhe i dokumentacionit teknik në dosje rezultoi se, ky zë pune nuk është i argumentuar/justifikuar si zë pune i maskuar. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Pika 8.3.

Sa më sipër trajtuar, nga sipërmarrësi i punimeve është përfituar tepër volumi në vlerën **6,600 lekë** (11 m<sup>3</sup> x 600 lekë).

**Zëri 5 (3.653). F.V Tub plastmasi Ø150 mm.**

Situacioni progresiv nr. 2 pasqyron volumin 150 ml tub plastmasi me çmim 600 lekë.

Nga auditimi i realizimit të këtij zëri pune në objekt, si dhe i dokumentacionit teknik në dosje rezultoi se, ky zë pune nuk është i argumentuar/justifikuar si zë pune i maskuar. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Pika 8.3.

Sa më sipër trajtuar, nga sipërmarrësi i punimeve është përfituar tepër volumi në vlerën **90,000 lekë** (150 ml x 600 lekë).

**Zëri 6 (An-31/M<sup>3</sup>). Gjeotekstil me gramaturë 180 g/m<sup>2</sup>.**

Situacioni progresiv nr. 2 pasqyron volumin 75 m<sup>2</sup> gjeotekstil me çmim 250 lekë.

Nga auditimi i realizimit të këtij zëri pune në objekt, si dhe i dokumentacionit teknik në dosje rezultoi se, ky zë pune nuk është i argumentuar/justifikuar si zë pune i maskuar. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Pika 8.3.

Sa më sipër trajtuar, nga sipërmarrësi i punimeve është përfituar tepër volumi në vlerën **18,750 lekë** (750 m<sup>2</sup> x 250 lekë).

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3; Kontrata e sipërmarrjes së punimeve, nr. 3029 prot., datë 04.11.2022, Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve, nr. 3027 prot., datë 04.11.2022.

**Ndikimi/Efekti:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, janë libëruar dhe situacionuar volume pune të pakryera.

**Shkaku:** Mosargumentim i punimeve nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Bashkia Prrrenjas të arkëtojë vlerën prej **218,650 lekë pa TVSH** nga shoqëria BOE “M. “ SHPK & “Sh.” SHPK, për punime të pakryera, sipas kontratës me nr. 3029 prot., datë 04.11.2022 me objekt “Rikonstruksion i rrugës Qukës Shkumbin – Stroskë”.

**Titulli i Gjetjes:** Mosrealizim i Oponencës Teknike të projektit të zbatimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Qukës Shkumbin – Stroskë Bashkia Prrrenjas” nga Bashkia Prrrenjas.

**Situata:** Për ndërtimin e investimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Qukës Shkumbin – Stroskë Bashkia Prrrenjas” nga Titullari i Bashkisë Prrrenjas z. N.B. është lëshuar Leje Ndërtimi Infrastrukturore me nr. 41, datë 04.10.2022.

Projekti i zbatimit është hartuar në vitin 2022 nga shoqëria “Z.K.” SHPK përfaqësuar nga z. L.H. me Licencë N. 6907/1. Projektues Ing. Ndërtimi L.H. dhe Ing. Ndërtimi F.D.

Rruga ka një gjatësi prej 2920 ml dhe gjerësi të asfaltuar 3.5 m. Paketa e trupit të rrugës është 53 cm, specifikisht:

- Mbushje me çakëll e gur gurore në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri 15 cm
- Shtresë çakëlli mbeturinë kave t=20 cm
- Shtresë stabilizanti t=10 cm
- Shtresë binderi t= 5 cm
- Shtresë asfaltbetoni t=3 cm

Për projektin e zbatimit të këtij objekti, nuk është kryer oponentë teknike nga Bashkia Prrenjas. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 6 dhe ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë z. N.B..

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.

**Kriteri:** Ligji nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”, neni 6.

**Ndikimi/Efekti:** Realizimi i projektit të zbatimit pa oponentë teknike.

**Shkaku:** Neglizhencë e Bashkisë Prrenjas.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Bashkia Prrenjas të marrë masa për pajisjen me oponentë teknike për të gjitha ndërtimet publike dhe jo publike, me vlerë të preventivuar mbi 100 milion lekë, si dhe për objektet me akses publik, sipas legjislationit në fuqi.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. **Z. N.B.**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Prrenjas.

2. **Znj. N.M.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar Bashkia Prrenjas, me shkresën nr. 1292, datë 09.05.2023 (protokolluar në KLSH me nr. 1173/32 prot., datë 11.05.2023) ka bërë komente dhe shpjegime për Nën-pikën 2.4.4. të Projekt Raportit të Auditimit, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:

**Pretendimi i subjektit:**

- Për objektin “Rikonstruksioni i rrugës Qukës Skënderbe”, nuk ka qenë e nevojshme sepse vlera është nën 100 milion lekë.

**Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Grupi i auditimit sqaron, se, për rastin konkret, duhet të ishte kryer oponentë teknike, në zbatim të nenit 6, germa a “ndërtimet publike” të Ligjit nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”. Pra lidhur me vlerën mbi 100 milion lekë oponenta kryhet për objekte jopublike, sipas nenit 6, germa b “ndërtimet jopublike” të Ligjit nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”. Si përfundim, për ndërtimet publike, pavarësisht vlerës (ligji nuk përcakton vlerë) duhet patjetër të kryhet oponenta teknike për projektet e ndërtimit.

Sa më sipër trajtuar, observacioni **nuk merret në konsideratë**.

**4. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës Qukës Skënderbe”, Bashkia Prrenjas, me këto të dhëna:**

<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 3274 Prot., datë 07.12.2021 OE “Sh.” SHPK.	<b>15. Vlera e kontratës</b> VI e prev ofertues 43,200,000 lekë me TVSH	<b>16. Likuiduar:</b> Sit. 1 në vlerën 24,764,496lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 8,941,675 lekë me TVSH Sit. përfundimtar, në vlerën 9,493,829 lekë me TVSH
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në ditë</b> Fillimi punimeve: 07.12.2021	<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Nuk ka

-Vlera 43,200,000lekë me TVSH.	Përfundimi punimeve: 01.04.2022	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE "Z.K." SHPK	Licenca MK. 3360/2	Kontratë me nr. 3273 prot, datë 07.12.2021
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> "I." SHPK	Licenca Nr: MK. 3331/4	Kontratë nr. 1799 prot, datë 22.06.2022
<b>22. Akt Kolaudimi</b> Datë: 05.07.2022	<b>23. Akt i marrjes në dorëzim:</b> Me datë 07.07.2022 objekti është marrë në dorëzim përkohësisht nga Bashkia Prrenjas. Urdhër nr. 407., datë 07.07.2022 është ngritur grupi me përbërje: M.P., M.B. dhe Dashurije Çollaku.	

**Titulli i Gjetjes:** Zëra pune të pakryera në objektin "Rikonstruksioni i rrugës Qukës Skënderbe" Bashkia Prrenjas.

**Situata: Punime shtresash në rrugë.** Nga auditimi në terren mbi realizimin e punimeve të ndërtimit për objektin: "Rikonstruksion i rrugës Qukës Skënderbe, Bashkia Prrenjas", konkretisht punime shtresash në rrugë, në 4 (katër) raste, në progresivet (Prog SC 25 0+600 m; Prog SC 29 0+400 m; Prog SC 44 1+075 m dhe Prog SC 84 2+075 m) u konstatuan dëmtime të shtresave asfaltike (binder + asfaltobeton) si dhe nënshtresat, të argumentuara si vijon:

### 1. Progresivi SC 25 (0+600 m):

Në këtë progresiv u konstatuan dëmtime serioze të shtresave në sipërfaqen 4 ml gjatësi x 3.5 ml gjerësi = 14 m<sup>2</sup>.

#### Llogaritja në vlerë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Çmimi në lekë	Sasia/volum pune e dëmtuar m <sup>2</sup>	Vlera në lekë
1 (3.224/1)	Shtresë asfaltobeton me granil guri kave, 3 cm, me makineri.	m <sup>2</sup>	630	14	8,820
2 (3.222/1)	Shtresë binderi me gur kave, 5 cm, me makineri	m <sup>2</sup>	800	14	11,200
4 (3.212/b)	Shtresë stabilizanti t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri.	m <sup>2</sup>	190	14	2,660
5 (3.211)	Shtresë çakulli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri.	m <sup>2</sup>	300	14	4,200
6 (3.210)	Shtresë çakulli mbeturinë kave t=15 cm, përhapur e ngjeshur me makineri.	m <sup>2</sup>	270	14	3,780
<b>SHUMA</b>					<b>30,660</b>

### 2. Progresivi SC 29 (0+700 m):

Në këtë progresiv u konstatuan dëmtime serioze të shtresave në sipërfaqen 8 ml gjatësi x 3.5 ml gjerësi = 28 m<sup>2</sup>.

#### Llogaritja në vlerë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Çmimi në lekë	Sasia/volum pune e dëmtuar m <sup>2</sup>	Vlera në lekë
1 (3.224/1)	Shtresë asfaltobeton me granil guri kave, 3 cm, me makineri.	m <sup>2</sup>	630	28	17,640
2 (3.222/1)	Shtresë binderi me gur kave, 5 cm, me makineri	m <sup>2</sup>	800	28	22,400
4 (3.212/b)	Shtresë stabilizanti t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri.	m <sup>2</sup>	190	28	5,320
5 (3.211)	Shtresë çakulli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri.	m <sup>2</sup>	300	28	8,400
6 (3.210)	Shtresë çakulli mbeturinë kave t=15 cm, përhapur e ngjeshur me makineri.	m <sup>2</sup>	270	28	7,560
<b>SHUMA</b>					<b>61,320</b>

### 3. Progresivi SC 44 (1+075 m):

Në këtë progresiv u konstatuan dëmtime serioze të shtresave në sipërfaqen 10 ml gjatësi x 3.5 ml gjerësi = 35 m<sup>2</sup>.

#### Llogaritja në vlerë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Çmimi në lekë	Sasia/volum pune e dëmtuar m <sup>2</sup>	Vlera në lekë
1 (3.224/1)	Shtresë asfaltobeton me granil guri kave, 3 cm, me makineri.	m <sup>2</sup>	630	35	22,050
2 (3.222/1)	Shtresë binderi me gur kave, 5 cm, me makineri	m <sup>2</sup>	800	35	28,000

4 (3.212/b)	Shtresë stabilizanti t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri.	m <sup>2</sup>	190	35	6,650
5 (3.211)	Shtresë çakulli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri.	m <sup>2</sup>	300	35	10,500
6 (3.210)	Shtresë çakulli mbeturinë kave t=15 cm, përhapur e ngjeshur me makineri.	m <sup>2</sup>	270	35	9,450
<b>SHUMA</b>					<b>76,650</b>

#### 4. Progresivi SC 84 (2+075 m):

Në këtë progresiv u konstatuan dëmtime serioze të shtresave në sipërfaqen 12 ml gjatësi x 3.5 ml gjerësi = 42 m<sup>2</sup>.

#### Llogaritja në vlerë:

Nr.	Emertimi	Njësia	Çmimi në lekë	Sasia/volum pune e dëmtuar m <sup>2</sup>	Vlera në lekë
1 (3.224/1)	Shtresë asfaltbetoni me granil guri kave, 3 cm, me makineri.	m <sup>2</sup>	630	42	26,460
2 (3.222/1)	Shtresë binderi me gur kave, 5 cm, me makineri	m <sup>2</sup>	800	42	33,600
4 (3.212/b)	Shtresë stabilizanti t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri.	m <sup>2</sup>	190	42	7,980
5 (3.211)	Shtresë çakulli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri.	m <sup>2</sup>	300	42	12,600
6 (3.210)	Shtresë çakulli mbeturinë kave t=15 cm, përhapur e ngjeshur me makineri.	m <sup>2</sup>	270	42	11,340
<b>SHUMA</b>					<b>119,980</b>

- Sa më sipër trajtuar, sipërmarrësi i punimeve OE “Sh.” SHPK duhet të masa të menjëhershme për riparimin e sipërfaqes së dëmtuar në volumin prej **119 m<sup>2</sup>** në vlerë **260,610 lekë pa TVSH**, brenda periudhës së garancisë së punimeve me datë 07.07.2023, në rast të kundërt kjo vlerë do të konsiderohet dëm ekonomik.

- Riparimi i rrugës së dëmtuar për shkak të cilësisë së dobët të punimeve, të kryhet nga sipërmarrësi me shpenzimet e veta, duke zbatuar me përpikmëri standardet teknike për riparimin e shtresave asfaltike (binder dhe asfaltbeton) dhe shtresat me çakëll, si: prerje në forma të rregullta gjeometrike, ngjeshje të nënshtresave, hedhjen e binderit dhe të asfaltit në temperaturën e duhur dhe ngjeshjen e tij sipas specifikimeve teknike, për të siguruar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e rrugës.

- Sipërmarrësi i punimeve OE “Sh.” SHPK duhet të vërtetojë pranë Bashkisë Prrrenjas, realizimin e plotë të këtyre zërave punimesh, për të garantuar sigurinë dhe qëndrueshmërinë e rrugës. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me kontratën e nënshkruar dhe Dokumentet Standarde të Tenderit, si dhe me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe UKM nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, pika 3.2. Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.

**Kriteri:** Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3; Kontrata e sipërmarrjes së punimeve, nr. 3274 prot., datë 07.12.2021, Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve, nr. 3273 prot., datë 07.12.2021.

**Ndikimi/Efekti:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Prrrenjas.

**Shkaku:** Punime ndërtimi jo me cilësi nga sipërmarrësi.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Bashkia Prrrenjas, t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve OE “Sh.” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, që shuma prej **260,610 lekë pa TVSH** të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë me datë 07.07.2023 për të garantuar cilësinë, qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e rrugës. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Prrrenjas, Mbikëqyrësi i punimeve të objektit. Në

rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve.

**Titulli i Gjetjes:** Mosrealizim i Oponencës Teknike të projektit të zbatimit me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës Qukës Skënderbe” nga Bashkia Prrenjas.

**Situata:** Për ndërtimin e investimit me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës Qukës Skënderbe” nga Titullari i Bashkisë Prrenjas z. N.B. është lëshuar Leje Infrastrukturore me nr. 103, datë 24.11.2021.

Projekti i zbatimit është hartuar në vitin 2021 nga shoqëria “Z.C.” SHPK përfaqësuar nga z. A.P..

Raporti i ndikimit në mjedis si dhe relacioni topografik, është hartuar nga shoqëria “Z.C.” SHPK me administrator z. A.P. (Ekspert mjedisi: K.Gj. dhe Y.M.).

Për projektin e zbatimit të objektit: “Rikonstruksioni i rrugës Qukës Skënderbe” nuk është kryer oponencë teknike nga Bashkia Prrenjas. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 6 dhe ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë z. N.B..

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Ligji nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”, neni 6.

**Ndikimi/Efekti:** Realizimi i projektit të zbatimit pa oponencë teknike.

**Shkaku:** Neglizhencë e Bashkisë Prrenjas.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Bashkia Prrenjas të marrë masa për pajisjen me oponencë teknike për të gjitha ndërtimet publike dhe jo publike, me vlerë të preventivuar mbi 100 milion lekë, si dhe për objektet me akses publik, sipas legjislacionit në fuqi.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. **Z. N.B.**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Prrenjas.

2. **Z. L.H.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar Bashkia Prrenjas, me shkresën nr. 1292, datë 09.05.2023 (protokolluar në KLSH me nr. 1173/32 prot., datë 11.05.2023) ka bërë komente dhe shpjegime për Nën-pikën 2.4.4. të Projekt Raportit të Auditimit, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:

**Pretendimi i subjektit:**

- Për objektin “Ujësjellës Dritaj Fanje Karkavec në Bashkinë Prrenjas”, nuk ka qenë e nevojshme sepse vlera është nën 100 milion lekë.

**Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Grupi i auditimit sqaron, se, për rastin konkret, duhet të ishte kryer oponencë teknike, në zbatim të nenit 6, germa a “ndërtimet publike” të Ligjit nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”. Pra lidhur me vlerën mbi 100 milion lekë oponenca kryhet për objekte jopublike, sipas nenit 6, germa b “ndërtimet jopublike” të Ligjit nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”. Si përfundim, për ndërtimet publike, pavarësisht vlerës (ligji nuk përcakton vlerë) duhet patjetër të kryhet oponenca teknike për projektet e ndërtimit.

Sa më sipër trajtuar, observacioni **nuk merret në konsideratë**.



<b>5. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: “Ujësjetllësi Dritaj - Fanjë - Karkavec (Vazhdim)”, Bashkia Prrenjas, me këto të dhëna:</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 1999 Prot., datë 18.06.2020 OE “D.C.” SHPK	<b>15. Vlera e kontratës</b> Vl e prev ofertues 17,830,712 lekë me TVSH	<b>16. Likuiduar:</b> Sit. nr. 1, në vlerën 12,170,674.81 lekë me TVSH Sit. nr. 2, në vlerën 819,084 lekë me TVSH
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b> Vlera 17,798,882.9 lekë me TVSH	<b>18. Afati i kontratës në ditë</b> Fillimi punimeve: 08.07.2020 Përfundimi punimeve: 16.10.2020	<b>19. Zgjatja e kontratës</b> S’ka.
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “H.S.” SHPK	Licenca MK.2018/17	Kontratë me nr. 1592/1 prot, datë 27.05.2020
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> OE “M.C.” SHPK	Licenca Nr: MK.2928/8	Shkresa nr. 3857 prot, datë 17.11.2020
<b>22. Akt Kolaudimi</b> Datë: 20.11.2020	<b>23. Akt i marrjes në dorëzim:</b> Me datë 18.06.2020 investimi është marrë në dorëzim përkohësisht. Komisioni përbëhet nga: E.V., R.B. dhe M.H. sipas Urdhërit të Kryetarit nr. 302, datë 09.12.2021.	

**Titulli i Gjetjes:** Mosrealizim i Oponencës Teknike të projektit të zbatimit me objekt: “Ujësjetllësi Dritaj-Fanjë-Karkavec (Vazhdim faza II)” nga Bashkia Prrenjas.

**Situata:** Projekti i zbatimit është hartuar nga Ing. A.M., në vitin 2019 me nr. Licence Z. 1374/2. Rrjeti shpërndarës i ujësjetllësit përfshin 29,143 ml rrjet me tuba dhe rakorderi ujësjetllësi PE d=20 mm, t=2.0 mm, PN 10; me tuba dhe rakorderi ujësjetllësi PE d=25 mm, t=2.0 mm, PN 10; me tuba dhe rakorderi ujësjetllësi PE d=20 mm, t=2.3 mm, PN 10; me tuba dhe rakorderi ujësjetllësi PE d=20 mm, t=2.3 mm, PN 10 me tuba dhe rakorderi ujësjetllësi PE d=32 mm, t=2.4 mm, PN 10; me tuba dhe rakorderi ujësjetllësi PE d=32 mm, t=3.6.

Për Projektin e Zbatimit dhe ndërtimin e investimit me objekt: “Ujësjetllës Dritaj-Fanjë-Karkavec në Bashkinë Prrenjas” nga Titullari i Bashkisë z. N.B., është lëshuar Leje Ndërtimi Infrastrukturore nr. 44, datë 16.07.2020 me vlefshmëri për një periudhë 6 mujore nga data e fillimit të punimeve, referuar grafikut të punimeve.

Preventivi ka pësuar disa ndryshime të shoqëruara me relacionin përkatës dhe tabelë rakordimesh me volume që shtohen dhe volume që zbriten, pa kaluar vlerën fillestare të kontratës së sipërmarrjes.

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”, pika 1, neni 6 dhe ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë z. N.B..

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.

**Kriteri:** Ligji Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”, neni 6.

**Ndikimi/Efekti:** Realizimi i projektit të zbatimit pa oponencë teknike.

**Shkaku:** Neglizhencë e Bashkisë Prrenjas.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Bashkia Prrenjas të marrë masa për pajisjen me oponencë teknike për të gjitha ndërtimet publike dhe jo publike, me vlerë të preventivuar mbi 100 milion lekë, si dhe për objektet me akses publik, sipas legjislationit në fuqi.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

**I. Z. N.B., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Prrenjas,**

Për sa konstatuar nga grupi i auditimit, sipërmarrësi i punimeve “D.C.” SHPK dhe mbikëqyrësi i punimeve “HE & SK 11” SHPK, me shkresën nr. 1292, datë 09.05.2023 (protokolluar në KLSH me nr. 1173/32 prot., datë 11.05.2023) kanë bërë komente dhe shpjegime, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:

**Pretendimi i subjektit:**

- Për objektin “Ujësjetllësi Dritaj - Fanjë - Karkavec (Vazhdim)”, bashkëlidhur observacionit është përcjellë Libreza e masave e plotësuar dhe saktësuar lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit, për disa zëra pune sipas faktit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Grupi i auditimit sqaron se, pas verifikoi me kujdes Librezën e masave mbi pasqyrimin e volumeve për zërin “Zëri 1(2.15) Gërmim e mbushje dhe me krah për kanale kategoria III, h=1.5 m” dhe zërit “Vendosje e tubacioneve PE”, vëren se rezultoni e rakordon rrgjatësia e tubacioneve PE me gjatësitë e trasesë së gërmuar, konkretisht: (Puseta nr. 26 fshati Dritaj; Puseta nr. 21 fshati Dritaj; Puseta nr. 25 fshati Dritaj; Puseta nr. 1 fshati Dritaj). Pranohe argumentimi mbi lapsusin e bërë në pasqyrimin e volumeve në librezën e masave. Sa më sipër trajtuar, observacioni merret në konsideratë dhe, për këtë do të kryhen reflektimet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar Bashkia Prrenjas, me shkresën nr. 1292, datë 09.05.2023 (protokolluar në KLSH me nr. 1173/32 prot., datë 11.05.2023) ka bërë komente dhe shpjegime për Nënpiken 2.4.4. të Projekt Raportit të Auditimit, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:

**Pretendimi i subjektit:**

- Për objektin “Rehabilitimi Skemës Ujitëse Radigoz-Stranik-Bërzeshtë”, nuk ka qenë e nevojshme sepse vlera është nën 100 milion lekë.

**Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Grupi i auditimit sqaron se, për rastin konkret, duhet të ishte kryer oponencë teknike, në zbatim të nenit 6, germa a “ndërtimet publike” të Ligjit nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”. Pra, lidhur me vlerën mbi 100 milion lekë oponenca kryhet për objekte jopublike, sipas nenit 6, germa b “ndërtimet jopublike” të Ligjit nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”. Si përfundim, për ndërtimet publike, pavarësisht vlerës (ligji nuk përcakton vlerë) duhet patjetër të kryhet oponenca teknike për projektet e ndërtimit.

Sa më sipër trajtuar, observacioni **nuk merret në konsideratë**.

**6. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: “Ujësjetllësi Dritaj - Fanjë - Karkavec (Vazhdim faza III), FV matësa familjarë”, me këto të dhëna:**

<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 3384 Prot., datë 15.10.2020 OE “D.C.” SHPK	<b>15. Vlera e kontratës</b> Vl e prev ofertues 19,433,353 lekë me TVSH	<b>16. Likuiduar:</b> Sit. nr. 1 në vlerën 6,000,000 lekë me TVSH Sit. nr. 2.ë vlerën 10,015,275.60 lekë me TVSH
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b> -Vlera 19,428,834 lekë me TVSH	<b>18. Afati i kontratës në ditë</b> Fillimi punimeve: 19.10.2020 Përfundimi punimeve: 04.05.2021	<b>19. Zgjatja e kontratës</b> S’ka.
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “H.S.” SHPK	Licenca MK.2018/17	Kontratë me nr. 3383 prot, datë 15.10.2020
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> OE “M.C.” SHPK	Licenca Nr: MK.2928/8	Shkresa nr. 1893 prot, datë 10.06.2021
<b>22. Akt Kolaudimi</b> Datë: 15.06.2021	<b>23. Akt i marrjes në dorëzim:</b> Me datë 13.07.2021 investimi është marrë në dorëzim përkohësisht. Komisioni përbëhet nga: A.B., M.B. dhe E.V..	

**Titulli i Gjetjes:** Mosrealizim i Oponencës Teknike të projektit të zbatimit me objekt: “Ujësjetllësi Dritaj-Fanjë-Karkavec (Vazhdim faza III) FV matësa familjarë” nga Bashkia Prrenjas.

**Situata:** Projekti i zbatimit është hartuar nga Ing. A.M., në vitin 2019 me Nr. Licence Z.1374/2. Lidhjet e objekteve me matësa uji përfshijnë 41,427 ml rrjet dhe 535 matësa uji.

- Për Projektin e Zbatimit dhe ndërtimin e investimit me objekt: “Projekti i linjës së ujësjellësit për furnizimin me ujë të fshatit Kakrruk dhe Gjerbes në Bashkinë Prrenjas” nga Titullari i Bashkisë z. N.B., është lëshuar Leje Ndërtimi Infrastrukturore nr. 44, datë 16.07.2020.

Preventivi ka pësuar disa ndryshime të shoqëruara me relacionin përkatës dhe tabelë rakordimesh me volume që shtohen dhe volume që zbriten, pa kaluar vlerën fillestare të kontratës së sipërmarrjes.

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”, pika 1, neni 6. Sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi, Kryetari i Bashkisë Prrenjas, z. N.B..

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.

**Kriteri:** Ligji nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”, neni 6.

**Ndikimi/Efekti:** Realizimi i projektit të zbatimit pa oponencë teknike.

**Shkaku:** Neglizhencë e Bashkisë Prrenjas.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Bashkia Prrenjas të marrë masa për pajisjen me oponencë teknike për të gjitha ndërtimet publike dhe jo publike, me vlerë të preventivuar mbi 100 milion lekë, si dhe për objektet me akses publik, sipas legjislacionit në fuqi.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

**I. Z. N.B., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Prrenjas,**

Për sa konstatuar nga grupi i auditimit, sipërmarrësi i punimeve “D.C.” SHPK dhe mbikëqyrësi i punimeve “H.S.” SHPK, me shkresën nr. 1292, datë 09.05.2023 (protokolluar në KLSH me nr. 1173/32 prot., datë 11.05.2023) kanë bërë komente dhe shpjegime, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:

**Pretendimi i subjektit:**

- Për objektin “Ujësjellësi Dritaj - Fanjë - Karkavec (Vazhdim) F.V matësa familjarë”, bashkëlidhur observacionit është përcjellë Libreza e masave e plotësuar dhe saktësuar lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit, për disa zëra pune sipas faktit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Grupi i auditimit sqaron se, pas verifikoi me kujdes Librezen e masave mbi pasqyrimin e volumeve për zërin “Zëri 1(2.15) Gërmim e mbushje dheu me krah për kanale kategoria III, h=1.5 m” dhe zëri “Vendosje e tubacioneve PE”, vëren se rezultoni e rakordon gjatësia e tubacioneve PE me gjatësitë e trasesë së gërmuar, konkretisht: (Puseta nr. 5; Puseta 10; Puseta 15; Puseta 39). Pranohet argumentimi mbi lapsusin e bërë në pasqyrimin e volumeve në librezën e masave. Sa më sipër trajtuar, observacioni merret në konsideratë dhe, për këtë do të kryhen reflektimet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar Bashkia Prrenjas, me shkresën nr. 1292, datë 09.05.2023 (protokolluar në KLSH me nr. 1173/32 prot., datë 11.05.2023) ka bërë komente dhe shpjegime për Nën-pikën 2.4.4. të Projekt Raportit të Auditimit, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:

**Pretendimi i subjektit:**

- Për objektin “Projekti i linjës së ujësjellësit për furnizimin me ujë të fshatit Kakrruk dhe Gjerbes në Bashkinë Prrenjas”, nuk ka qenë e nevojshme sepse vlera është nën 100 milion lekë.

**Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Grupi i auditimit sqaron, se, për rastin konkret, duhet të ishte kryer oponentë teknike, në zbatim të nenit 6, germa a “ndërtimet publike” të Ligjit nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”. Pra, lidhur me vlerën mbi 100 milion lekë oponenta kryhet për objekte jopublike, sipas nenit 6, germa b “ndërtimet jopublike” të Ligjit nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”. Si përfundim, për ndërtimet publike, pavarësisht vlerës (ligji nuk përcakton vlerë) duhet patjetër të kryhet oponenta teknike për projektet e ndërtimit.

Sa më sipër trajtuar, observacioni **nuk merret në konsideratë**.

**7. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: “Rehabilitimi Skemës Ujitëse Radigoz-Stranik-Bërzeshtë”, me këto të dhëna:**

<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 3623 Prot., datë 03.11.2020 OE “E.A.” SHPK	<b>15. Vlera e kontratës</b> VI e prev ofertues 71,120,899,972 lekë me TVSH	<b>16. Likuiduar:</b> Sit nr. 1 + nr.2 + nr. 3, në vlerën 50,003,174.083 lekë Sit përfundimtar, në vlerën 71,120,899.972 lekë me TVSH
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b> Vlera 20,061,839.594 lekë me TVSH.	<b>18. Afati i kontratës në ditë</b> Fillimi punimeve: 03.11.2020 Përfundimi punimeve: 20.06.2022	<b>19. Zgjatja e kontratës</b> 2 amendime kontrate.
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “Z.K.” SHPK	Licenca MK.3360/2	Kontratë me nr. 3622 prot, datë 03.11.2020
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> “F.S.” SHPK	Licenca Nr: MK.3429/1	Kontratë nr. 3539 prot, datë 21.12.2022
<b>22. Akt Kolaudimi</b> Datë: 21.12.2022-23.12.2022	<b>23. Akt i marrjes në dorëzim:</b> Me datë 27.12.2022 objekti është marrë në dorëzim përkohësisht nga Bashkia Prrenjës. Urdhër nr. 667., datë 07.07.2022 është ngritur grupi me përbërje: M.A., M.K. dhe A.O.	

**Titulli i Gjetjes:** Zëra pune të pakryera në objektin “Rehabilitimi Skemës Ujitëse Radigoz-Stranik-Bërzeshtë”.

**Situata: Punime në kanal. Zëri: 3(3.46/1) Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krah, me seksion deri 0.75.** Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 7,564 m<sup>3</sup> gërmim dheu me çmim 1,214 lekë.

Nga auditimi në terren si dhe i pasqyrimin në librezën e masave të këtij zëri pune, konstatohet se në 41 raste (profile Tip) nga 130 profile Tip gjithsej, seksioni tërthor është në tejkallim të seksionit tërthor të parashikuar (0.75 m<sup>2</sup>) përcaktuar edhe në specifikimet teknike, ku seksionet tërthore të gërmimit variojnë nga 1.2 m<sup>2</sup> në 2.42 m<sup>2</sup>. Për seksione të tilla, gërmimi nuk parashikohet në specifikimet teknike dhe manualet e ndërtimit dhe nuk mund të realizohet me krahë.

Nga auditimi me zgjedhje mbi gërmimet për seksionet tërthore Tip 50, Tip 57, Tip 58, Tip 59, Tip 61, janë gërmuar volum pune më pak 150.6 m<sup>3</sup> duke analizuar volumet në raport me seksionet tërthore të gërmimit, referuar edhe projektit të zbatimit profileve tërthore, argumentuara si vijon:

**Llogaritja në sasi dhe vlerë:**

Nr.	Seksionet tërthore TIP	Njësia	Çmimi në lekë	Gjatësia (ml)	Sipërfaqe sipas librezës (m <sup>2</sup> )	Sipërfaqe sipas faktit (m <sup>2</sup> )	Volum sipas librezës	Sasia/volum pune, sipas faktit m <sup>3</sup>	Diferenca m <sup>3</sup>	Vlera në lekë
1	Profil TIP 50	m <sup>3</sup>	1214	141.33	1.21	1.03	171.01	146.01	25	30,350
2	Profil TIP 57	m <sup>3</sup>	1214	446.4	1.62	1.53	723.17	683.17	40	48,560
3	Profil TIP 58	m <sup>3</sup>	1214	500	1.2	1.1	600	550	50	60,700
4	Profil TIP 61	m <sup>3</sup>	1214	216	1.6	1.43	345.6	310	35.6	43,218
<b>SHUMA</b>				<b>1303.73</b>	<b>5.63</b>	<b>5.09</b>	<b>1839.78</b>	<b>1689.18</b>	<b>150.6</b>	<b>182,828</b>

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3; Kontrata e e

sipërmarrjes së punimeve, nr. 3623 prot., datë 03.11.2020, Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve, nr. 3622 prot., datë 03.11.2020.

**Ndikimi/Efekti:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Prrenjas.

**Shkaku:** Pasqyrim jo i saktë në librezën e masave nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Bashkia Prrenjas të arkëtojë vlerën prej **182,828** lekë pa TVSH nga shoqëria OE “E.A.” SHPK, për punime të pakryera, sipas kontratës me nr. 3623 prot., datë 03.11.2020 me objekt “Rehabilitimi Skemës Ujitëse Radigoz-Stranik-Bërzeshtë”.

**Titulli i Gjetjes 13:** Mosrealizim i Oponencës Teknike të projektit të zbatimit me objekt: “Rehabilitimi Skemës Ujitëse Radigoz-Stranik-Bërzeshtë” nga Bashkia Prrenjas.

**Situata:** Për ndërtimin e investimit me objekt: “Rehabilitimi Skemës Ujitëse Radigoz-Stranik-Bërzeshtë” mbi projektin e zbatimit në dosje nuk ndodhet leje teknologjike.

Projekti i zbatimit, relacioni teknik, specifikimet teknike janë hartuar në vitin 2020 nga shoqëria projektuese “Z.C.” SHPK përfaqësuar nga z. A.P.

Për projektin e zbatimit të objektit: “Rehabilitimi Skemës Ujitëse Radigoz-Stranik-Bërzeshtë” nuk është kryer oponencë teknike nga Bashkia Prrenjas. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 6 dhe ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë z. N.B..

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 64-137.*

**Kriteri:** Ligji nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”, neni 6.

**Ndikimi/Efekti:** Realizimi i projektit të zbatimit pa oponencë teknike.

**Shkaku:** Neglizhencë e Bashkisë Prrenjas.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Bashkia Prrenjas të marrë masa për pajisjen me oponencë teknike për të gjitha ndërtimet publike dhe jo publike, me vlerë të preventivuar mbi 100 milion lekë, si dhe për objektet me akses publik, sipas legjislacionit në fuqi.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

***1. Z. N.B., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Prrenjas.***

***2. Z. L.H., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.***

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar Bashkia Prrenjas, me shkresën nr. 1292, datë 09.05.2023 (protokolluar në KLSH me nr. 1173/32 prot., datë 11.05.2023) ka bërë komente dhe shpjegime për Nën-pikën 2.4.4. të Projekt Raportit të Auditimit, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:

**Pretendimi i subjektit:**

- Për objektin “Rehabilitimi Skemës Ujitëse Radigoz-Stranik-Bërzeshtë”, nuk ka qenë e nevojshme sepse vlera është nën 100 milion lekë.

**Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Grupi i auditimit sqaron, se, për rastin konkret, duhet të ishte kryer oponencë teknike, në zbatim të nenit 6, germa a “ndërtimet publike” të Ligjit nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar” Pra, lidhur me vlerën mbi 100 milion lekë oponenca kryhet për objekte jopublike, sipas nenit 6, germa b “ndërtimet jopublike” të Ligjit nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”. Si përfundim, për ndërtimet

publike, pavarësisht vlerës (ligji nuk përcakton vlerë) duhet patjetër të kryhet oponenta teknike për projektet e ndërtimit.

Sa më sipër trajtuar, observacioni **nuk merret në konsideratë**.

### **Konkluzion i përgjithshëm mbi zbatimin e kontratave për punë publike:**

**1. Nga auditimi i 7 (shtatë) kontratave për punë publike për periudhën e auditimit në vlerën totale 445,551,081.96 lekë pa TVSH ose 534,661,298.352 lekë me TVSH, rezultuan zëra pune të pakryera si dhe realizim zërash jo në përputhje me specifikimet teknike në vlerën 1,508,892.39 lekë pa TVSH, përkatësisht:**

- **Vlera 547,304.39 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të pakryera si dhe realizimin zëra pune jo sipas specifikimeve teknike në kontratën me nr. 1075 prot., datë 19.03.2020 me objekt *“Rikonstruksion rrjeti shpërndarës i ujësjellësit Prrenjas”* të lidhur ndërmjet Bashkisë Prrenjas dhe shoqërisë “C.” SHPK.

- **Vlera 299,500 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të pakryera sipas kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3954 prot., datë 24.11.2020 me objekt *“Rikonstruksion dhe riveshje me asfaltim i pjesëve të dëmtuar të rrugës Lapidari Qukës Shkumbin, Mulliri i Belbës, asfaltimi i rrugës në lagjen e Kryeziut, asfaltimi i rrugës në lagjen e Shytit dhe rikonceptimi i qendrës së fshatit Qukës, NjA Qukës”* të lidhur ndërmjet Bashkisë Prrenjas dhe BOE “M. “ SHPK & “Sh.” SHPK.

- **Vlera 218,650 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për diferenca në volume për zërat e punimeve në kontratën nr. 3029 prot., datë 04.11.2022 me objekt *“Rikonstruksion i rrugës Qukës Shkumbin-Stroskë Bashkia Prrenjas”* të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Prrenjas dhe BOE “M. “ SHPK & “Sh.” SHPK.

- **Vlera 260,610 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për punime me cilësi të dobët në kontratën nr. 3273 prot., datë 07.12.2021 me objekt *“Rikonstruksioni i rrugës Qukës Skënderbe”* të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Prrenjas dhe shoqërisë “Sh.” SHPK.

- **Vlera 182,828 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të pakryera në kontratën nr. 3623 prot., datë 03.11.2020 me objekt *“Rehabilitimi Skemës Ujitëse Radigoz-Stranik-Bërzeshtë”* të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Prrenjas dhe shoqërisë “E.A.” SHPK.

**2. Në 6 (gjashtë) raste**, nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve, respektivisht për kontratat:

- *“Rikonstruksion rrjeti shpërndarës i ujësjellësit Prrenjas”*,

- *“Rikonstruksion dhe riveshje me asfaltim i pjesëve të dëmtuar të rrugës Lapidari Qukës Shkumbin, Mulliri i Belbës, asfaltimi i rrugës në lagjen e Kryeziut, asfaltimi i rrugës në lagjen e Shytit dhe rikonceptimi i qendrës së fshatit Qukës, NjA Qukës”*,

- *“Rikonstruksion i rrugës Qukës Shkumbin-Stroskë Bashkia Prrenjas”*,

- *“Rikonstruksioni i rrugës Qukës Skënderbe”*,

- *“Ujësjellësi Dritaj-Fanjë-Karkavec (Vazhdim faza II), Bashkia Prrenjas”*,

- *“Ujësjellësi Dritaj-Fanjë- Karkavec (Vazhdim faza III), FVmatësa familjarë Bashkia Prrenjas”*,

- *“Rehabilitimi Skemës Ujitëse Radigoz-Stranik-Bërzeshtë”*,

rezultoi se Autoriteti Kontraktor Bashkia Prrenjas, nuk ka kryer oponenten teknike për projektin e zbatimit. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar, neni 6.

## 2.5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit

2.5.1. *Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit;*

2.5.2. *Auditimi mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përlllogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj;*

**1. Leja e ndërtimit** nr. 167 sipas regjistrimit elektronik në emër të zhvilluesit L.B. dhe E.B., me datë aplikimi 21.01.2022, për objektin “Objekt banimi dhe shërbimesh 5 kat me një kat nëntokë”.

**Titulli i Gjetjes:** Mosrespektim i parametrave teknikë në miratimin e lejes. Përlllogaritje e gabuar e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**Situata:** a. Nuk respektohet lartësia e objektit, i cili sipas projektit rezulton 20.25 m, ndërkohë sipas planit të përgjithshëm vendor, treguesi i lartësisë për nënnjësine 1/36 është 5 kat me lartësinë 15 m. Sa më sipër, objekti është ngritur me 5.25 metër mbi lartësinë e lejuar.

b. Nuk respektohen distancat me pronat dhe objektet kufitare, konkretisht në lindje të pronës e cila gjithashtu nuk paraqitet në planin e vendosjes së ndërtimit, në përfundim me objektin 3 kat, ku distanca është më e vogël 10 m, ndërkohë edhe matja e bërë nuk është në rregull, pasi distanca është matur nga fasada e pallatit, dhe jo nga ballkonet, si dhe distancat me rrugën në veri, në kundërshtim me nenin 34 “Distancat minimale midis ndërtimeve” dhe nenin 35 “Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës”, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

c. Leja e ndërtimit është miratuar për sipërfaqen 1593 m<sup>2</sup>, ndërkohë sipas projektit arkitektonik të paraqitur, rezulton se sipërfaqe ndërtimore është më e madhe, pasi nuk janë llogaritur sipërfaqet e ballkoneve.

Nga përlllogaritja, rezulton se nuk janë llogaritur sipërfaqe 66.25 m<sup>2</sup> për katin përdhe dhe katin e parë, shumatorja e të cilave është 132.5 m<sup>2</sup>, si dhe nuk janë përlllogaritur sipërfaqet 51.11 m<sup>2</sup> për katet 2, 3 dhe 4, sipërfaqja totale e të cilave është 153.33 m<sup>2</sup>. Sa më sipër, rezulton se janë 285.83 m<sup>2</sup> sipërfaqe të pallogaritura.

Lidhur me mangësinë e mësipërme, rezulton se kanë ndryshuar treguesit e zhvillimit si KSHT dhe intensiteti, të cilët sipas nënnjësive strukturore 1/36 janë 50% KSHA dhe 2.5 intensiteti.

Sipas përlllogaritjeve, sipërfaqe totale e gjurmës është 386,88 m<sup>2</sup> dhe jo 318.6 m<sup>2</sup>, çka ka ndryshuar KSHA nga 50% e lejuar në 60%. Intensiteti i përcaktuar 2.5%, rezulton të jetë më i madh, pasi sipërfaqe totale e ndërtimit nuk është 1,593 m<sup>2</sup>, pasi duke përlllogaritur sipërfaqet e pallogaritura prej 285.83 m<sup>2</sup>, intensiteti ndryshon në 2.94%. Sa më sipër, nuk janë respektuar treguesit e zhvillimit sipas pasaportës teknike të ndërtimit për nënnjësine strukturore 1/36.

d. Sipas përlllogaritjes së TNI, subjekti ka likuiduar vlerën prej 1,330,064 lekë, e cila përbëhet nga taksa e ndërtimit në vlerën 1,286,014 lekë, nga tarifa për mure të jashtme ndërtimi në vlerën 14,400 lekë dhe nga tarifa për akt piketimi në vlerën 29,650 lekë.

Për TNI, përlllogaritja është bërë mbi preventivin e punimeve. Bazuar në paketën fiskale, për ndërtimet për qëllime biznesi taksa është 2% dhe për efekt banimi është 1%.

Vlera e preventivit është 83,867,511 lekë. Është llogaritur ndërtim për efekt biznesi vlera 44,733,849 lekë x 2% = 894,677 lekë dhe për efekt banimi, 39,133,662 lekë x 1% = 391,337 lekë.

Lidhur me përlllogaritjet e mësipërme, ato rezulton se janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 28/2017 “Për disa ndryshimet dhe shtesa në Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit””, i ndryshuar, neni 46.

Përlllogaritja duhet të bëhet sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.06.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 7, pika 1, i ndryshuar me Ligjin nr. 95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr. 9632, datë 30.06.2006 “Për sistemin e taksave vendore””, neni 9, pika 2 dhe VKM nr. 168, datë 27.03.2019 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 7.3.2018 të Këshillit të Ministrave, “për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, Aneksi nr. 1, sipas të cilit çmimi referues për Bashkinë Prrenjas është 41,780 lekë. Në aneksin nr. 2 të këtij vendimi, në germën **a** përcaktohet se çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve, dhe germa b përcakton se çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

Sipas projektit dhe relacionit arkitektonik, 2 katet e para janë përcaktuar për shërbime dhe tregti dhe katet e tjera për banim.

Sipas paketës fiskale për vitin 2022, baza e taksës për objektet e reja për njësi tregtimi dhe shërbimi është 6% dhe për banim është 4%.

Përlllogaritja rezulton si më poshtë:

1. Kati në kuotën -3.15 (bodrum) sipërfaqe  $593 \text{ m}^2 \times 41,780 \times 4\% \times 0.7 = 693,715$  lekë;
2. Kati në kuotën 0.0 sipërfaqe reale  $386.88 \text{ m}^2 \times 41,780 \times 6\% \times 1.5 = 1,454,746$  lekë;
3. Kati I, sipërfaqe reale  $386.88 \text{ m}^2 \times 41,780 \times 6\% \times 1.5\% = 1,454,746$  lekë;
4. Kati II, sipërfaqe reale  $369.71 \times 41,780 \times 4\% = 617,859$  lekë;
5. Kati III, sipërfaqe reale  $369.71 \times 41,780 \times 4\% = 617,859$  lekë;
6. Kati IV, sipërfaqe reale  $369.71 \times 41,780 \times 4\% = 617,859$  lekë;

Sa më sipër, vlera e përlllogaritur nga TNI për ndërtimet e ri, është 5,456,784 lekë dhe jo 1,286,014 lekë sa është përlllogaritur nga personi përgjegjës. **Diferenca prej 4,170,770 lekë**, e pallogaritur në mënyrë të saktë, **përbën të ardhur të munguar** për Bashkinë Prrenjas.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N.D. me detyrë ish-Drejtor i Urbanistikës, znj. M.P., kontrolluese dhe z. A.B., Përgjegjës Finance.*

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.5., faqe 137-144.

**Kriteri:** VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 15, pika 1, germa g, neni 38 pika 2, neni 39 pika 1, Ligji nr. 28/2017 “Për disa ndryshimet dhe shtesa në Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit””, neni 46, Ligji nr. 95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9632, datë 30.06.2006 “Për sistemin e taksave vendore””, i ndryshuar, neni 7, pika 1 dhe Pasaporta teknike sipas njësisë strukturore nr. 1/36.

**Ndikimi/Efekti:** Nuk janë respektuar parametrat teknikë, duke shkelur intensitetin e ndërtimit si dhe KSHT. Mungesë të ardhurash për Bashkinë Prrenjas në vlerën 4,170,770 lekë nga përlllogaritja e gabuar e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPKZHT Prrenjas.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi 1:** Nga DPZHT në Bashkinë Prrenjas, të merren masa për llogaritjen e saktë të sipërfaqeve të ndërtimit, kjo për të respektuar parametrat teknikë sipas pasaportës së njësisë strukturore.

**Rekomandimi 2:** Nga DPZHT dhe Drejtoria e Taksave në Bashkinë Prrenjas, të bashkërendohet puna për nxjerrjen e njoftim detyrimit ndaj subjektit L.B. dhe E.B., për arkëtimin e shumës 4,170,770 lekë, detyrim që rrjedh nga përlllogaritja e gabuar e taksës së ndikimit në infrastrukturë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Prrenjas.



Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga përfaqësuesit e DPZHT Bashkia Prrenjas, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1173/32 prot., datë 11.05.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

*Bazuar në planvendosjen e përgatitur nga Ark. A.G. me nr. licence A.0073/3, gjurma e objektit të propozuar kufizohet në veri me rrugë dhe në jug me rrugën nacionale Prrenjas – Librazhd (ku është marrë edhe konfirmimi i ARRSH). Bashkia Prrenjas është mbështetur në rregulloren e PPV-së bashkia Prrenjas neni 57 “Treguesit e distancave), neni 8 ku thuhet shprehimisht:*

*Distanca e objektit/ndërtesës nga rruga, duhet të respektojë vijën e ndërtimit të ndërtimit të formuar. Në këto raste kjo distancë mund të jetë edhe 0 metër.*

*- Vetëm në anën perëndimore objekti i propozuar ka si kufizohet nga rruga dhe me pas objekt fqinj një objekt te formës 3 kat. Në këtë rast nuk është vepruar sipas nenit 34 pika 3 të VKM nr. 408 të ndryshuar, pasi midis dy objekteve ka pronë publike rrugë:*

*Në nënjësitë strukturore të urbanizuara, në proces konsolidimi urban, distanca minimale midis faqeve që shohin njëra-tjetrën, të dy strukturave që qëndrojnë përballë njëra-tjetrës është 10 (dhjetë) metra dhe jo më pak se 5 (pesë) metra nga kufiri i pronës, pavarësisht numrit të kateve. Kjo distancë aplikohet kur të paktën njëra nga faqet është me dritare ose çarje të çfarëdo lloji ose të dyja faqet janë me dritare dhe/ose çarje të llojeve të ndryshme. **Kjo distancë aplikohet kur midis dy faqeve të dy ndërtesave nuk ka rrugë, në të kundërt distanca është në përputhje me përcaktimin e nenit 36.***

*Por konform nenit 36 të VKM nr. 408 të ndryshuar:*

*a) për gjerësi rruge, me ose pa trotuare, më të vogël se 7 (shtatë) metra, distanca minimale është 2.5 (dy pikë pesë) metra;*

*3. Lidhur me pikën 4 sqarohet se - Sipas Rregullores së PPV, sipërfaqet konsol kur ato përbëjnë më pak se 50% të perimetrit të fasadës nuk llogariten si sipërfaqe në koeficientin e shfrytëzimit të territorit si edhe në intensitet e tregues distancash.*


*4. Lidhur me pikën 5, sqarohet se - Llogaritja e takës nga ana jonë është bërë duke u bazuar te Ligji Nr.107 datë 31.07.2014*

*“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar neni 46 pika 1 si dhe në vendimin të Këshillit Bashkiak nr.71 date 24.12.2021“Për miratimin e paketës fiskale te Bashkisë Prrenjas për vitin 2022” pika 2, niveli i taksës në infrastrukturë për ndërtimet e reja, ndërtim për efekt biznesi është 2% e vlerës së preventivit dhe për banim 1% . Nga ana e bashkisë Prrenjas kjo taksë është llogaritur të kostos së ndërtimi për qytetin e Prrenjasit e cila ka vlerën 32,395 leke/m<sup>2</sup>.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

**1.** Pretendimet e paraqitura nga punonjësit e DPZHT janë të njëjta me ato të paraqitura mbi Akt Konstatimin dhe janë trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit. Treguesit e distancave nuk janë respektuar dhe qëndrimet e mbajtura në këtë observacion nuk mbështeten ligjërisht. Plan vendosja e paraqitur në observacion është e ndryshme me atë të ngarkuar në sistemin e lejeve ku evidentohet qartë se nuk ka rrugë ndërmjet objektit që zhvillohet dhe atij 3 katësh në anën perëndimore.



- Lidhur me pretendimet tjera që kanë të bëjnë me mos respektimin e KSHT dhe intensitetit, observuesit japin sqarime të pa mbështetur në kriteret konkrete se ku bazohet këto pretendime.
- Lidhur me taksën e ndikimit në infrastrukturë, pretendimi nuk qëndron, pasi konkretisht në paketën fiskale të Bashkisë Prrrenjas, përcaktohet qartë se për tipologjinë e këtij ndërtimi, TNI është 4% deri 6%, dhe jo 1% deri 2% sa ç'është llogaritur nga ana juaj.

**2. Leja e ndërtimit** nr. 950 sipas regjistrimit elektronik, në emër të zhvilluesit M.P., me datë aplikimi 21.03.2022, për objektin “Objekt banimi dhe shërbimesh 3 kat me një kat nëntokë”.

**Titulli i Gjetjes:** Mosrespektim i parametrevave teknike në miratimin e lejes. Përlllogaritje e gabuar e Taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**Situata:** a. Nuk respektohet lartësia e objektit, i cili sipas projekt rezulton 14.5 m, ndërkohë sipas Planit të Përgjithshëm Vendor, treguesi i lartësisë për nënjesinë 1/31 është 3 kat me lartësinë 9 m. Sa më sipër, objekti është ngritur me 5.5 metër mbi lartësinë e duhur.

b. Nuk respektohen distancat me pronat dhe objektet kufitare, ndërkohë në planvendosje nuk përcaktohen katet e objekteve kufitare, mbi bazën e të cilës do përcaktohej distanca minimale midis ndërtimeve.

c. Sipas përlllogaritjes së TNI, subjekti ka likuiduar vlerën prej 2,262,451 lekë, e cila përbëhet nga taksa e ndërtimit në vlerën 2,179,451 lekë, nga tarifa për mure të jashtme ndërtimi në vlerën 20,250 lekë dhe nga tarifa për akt piketimi në vlerën 62,750 lekë.

Për TNI, përlllogaritja është bërë mbi preventivin e punimeve. Bazuar në paketën fiskale, për ndërtimet për qëllime biznesi taksa është 2% dhe për efekt banimi është 1%.

Vlera e preventivit është 147,260,227 lekë. Është llogaritur ndërtim për efekt biznesi vlera 70,684,909 lekë x 2% = 1,413,698 lekë, dhe për efekt banimi, 76,575,318 lekë x 1% = 765,753 lekë.

Lidhur me përlllogaritjet e mësipërme, ato rezulton se janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 28/2017 “Për disa ndryshimet dhe shtesa në Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit””, i ndryshuar, neni 46.

Përlllogaritja duhet të bëhet sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.06.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 7, pika 1, i ndryshuar me Ligjin nr. 95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr. 9632, datë 30.06.2006 “Për sistemin e taksave vendore””, neni 9, pika 2 dhe VKM nr. 168, datë 27.03.2019 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 7.3.2018 të Këshillit të Ministrave, “për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, Aneksi nr. 1, sipas të cilit çmimi referues për Bashkinë Prrenjas është 41,780 lekë. Në aneksin nr. 2 të këtij vendimi, në germën **a** përcaktohet se çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve, dhe germa b përcakton se çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

Sipas projektit dhe relacionit arkitektonik, kati i parë është përcaktuar për shërbime dhe tregti, dhe 2 katet tjera për banim.

Sipas paketës fiskale për vitin 2022, baza e taksës për objektet e reja për njësi tregtimi dhe shërbimi është 6% dhe për banim është 4%.

Përlllogaritja rezulton si më poshtë:

1. Kati në kuotën -3.06 (bodrum) sipërfaqe  $1255 \text{ m}^2 \times 41,780 \times 4\% \times 0.7 = 1,468,149$  lekë;
2. Kati në kuotën 0.0 sipërfaqe  $861.5 \text{ m}^2 \times 41,780 \times 6\% \times 1.5 = 3,239,412$  lekë;
3. Kati I, sipërfaqe  $1002 \text{ m}^2 \times 41,780 \times 6\% \times 1\% = 1,674,542$  lekë;
4. Kati II, sipërfaqe  $1002 \text{ m}^2 \times 41,780 \times 6\% \times 1\% = 1,674,542$  lekë;

Sa më sipër, vlera e përlllogaritur nga TNI për ndërtimet e ri, është 8,056,645 lekë dhe jo 2,179,451 lekë sa është përlllogaritur nga personi përgjegjës. **Diferenca prej 5,877,194 lekë**, e pallogaritur në mënyrë të saktë, **përbën të ardhur të munguar** për Bashkinë Prrenjas.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. M.P. me detyrë Drejtor i Urbanistikës, znj. M.B., kontrolluese dhe z. A.B., Përgjegjës Finance.*

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.5., faqe 137-144.

**Kriteri:** VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 15, pika 1, germa g, neni 38 pika 2, neni 39 pika 1, Ligji nr. 28/2017 “Për disa ndryshimet dhe shtesa në Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit””, neni 46, Ligji nr. 95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9632, datë 30.06.2006 “Për sistemin e taksave vendore””, i ndryshuar, neni 7, pika 1 dhe Pasaporta teknike sipas njësisë strukturore nr. 1/31.

**Ndikimi:** Nuk janë respektuar parametrat teknik sipas duke shkelur intensitetin e ndërtimit si dhe KSHT. Mungesë të ardhurash për Bashkinë Prrenjas në vlerën **5,877,194 lekë** nga përlllogaritja e gabuar e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Prrenjas.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi 1:** Nga DPZHT në Bashkinë Prrenjas, në miratimin e lejeve të ndërtimit, të merren masa për respektimin e distancave ndërmjet objekteve dhe pronave, si dhe respektimin e pasaportës teknike të njësisë strukturore.

**Rekomandimi 2:** Nga DPZHT dhe Drejtoria e Taksave në Bashkinë Prrenjas, të bashkërendohet puna për nxjerrjen e njoftim detyrimit ndaj subjektit M. shpk për arkëtimin e shumës 5,877,194 lekë, detyrim që rrjedh nga përlllogaritja e gabuar e taksës së ndikimit në infrastrukturë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Prrenjas.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga përfaqësuesit e DPZHT Bashkia Prrenjas, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1173/32 prot., datë 11.05.2023 si më poshtë:
---

**Pretendimet e subjektit:**

*Lidhur me pikën 1 sqarohet se: 1. Leja e ndërtimit është në përputhje me nenin 32, pika 1, rregulloren e PPV Bashkisë Prrenjas, ku shprehimisht thuhet:*

*Mbushja urbane nënkupton zhvillimin e parcalave bosh të pandërtuara me ndertime të reja, me tregues zhvillimi të ngjashëm me ato të gjithë zonës, që do të thotë se treguesit në nivel parcele ngelen të njëjtë me treguesit që mbizoterojnë në zonë, ndërsa treguesit në nivel njësie do të rriten si pasojë e dendësisimit.*

*2. Lidhur me pikën 2 sqarohet se - Në veri bazuar nga planvendosja distanca nga kufiri i pronës është 4 m, pra në përputhje me VKM 408 date 13.05.2015"Per miratimin e rregullores se zhvillimit te territorit" i ndryshuar, (3m +1 m =4 m). Me objekt kufizohet vetëm nga ana jugore njëri është i formës Ikat dhe tjetri i formës 3 kat. Në këtë rast jemi mbështetur në pikën 3 dhe 1, të nenit 34 të VKM-së 408: 1). Distanca minimale midis dy faqeve, ku të paktën njëra ka dritare, sipas këtij neni garantojnë kushtet minimale të standardeve të ndriçimit e mbrojtjes nga zjarri dhe përcaktohen si gjatësia e vijës pingule midis planeve më të afërta të faqeve që përballin njëra-tjetrën.*

*3). Në rast se ndërtimi përballlet me një objekt ekzistues, të ndërtuar në kundërshtim me kondicionet urbane të legjislacionit përkatës, atëherë ndërtimi i ri përjashtohet nga detyrimi për të respektuar distancat sipas pikës 2, të këtij neni, dhe mbart detyrimin e respektimit të distancës nga kufiri i pronës, sipas nenit 35. Për efekt të zbatimit të kësaj dispozite, nuk do të merren në konsideratë objektet ekzistuese të ndërtuara përpara viteve 1990, nga të cilat do të respektohen distancat minimale të përcaktuara në pikën 2.*

*3. Lidhur me pikën 4 sqarohet se – Lidhur me TNI është vepruar njëllor si në lejen e trajtuar më sipër.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1. Lidhur me observacionin e paraqitur, audituesit sqarojnë se pretendimet janë të njëjta me ato të paraqitura mbi akt konstatimin, të cilat janë trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit. Lidhur me pretendimin se leja është miratuar në përputhje me nenin 32 pika 1 të rregullores, audituesit sqarojnë se ky pretendimin nuk mbështetet njëkohësisht me treguesit e ngjashëm përreth parcelës në të cilët do ndërtohet. Siç është cituar edhe në gjetjen e mësipërme, mungojnë treguesit në planvendosjen e paraqitur, pasi nuk janë përcaktuar katet e objekteve që kufizohet prona ku do ndërtohet.

- Lidhur me TNI, sqarimi është i njëjtë me atë të paraqitur në rastin e mësipërm.

**2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)**

**2.6.1. Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.**

**2.6.2. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.**

**2.6.3. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmerinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit të Bashkisë sipas dispozitave ligjore të nenit 81-Inspektimi, pika 3, të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar.**

**Titulli i Gjetjes:** Mosaplikim i masave administrative për shkeljet e konstatuara.

**Situata:** Sipas dokumenteve të vëna në dispozicion në lidhje me organizimin e Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit Vendor, për periudhën 01.01.2018-31.12.2022, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT), është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4, të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”.

Për vitet 2018-2022, struktura e IMT përbëhet nga 3 punonjës, nga të cilët 1 Kryeinspektor dhe 2 Inspektorë. IMT është drejtuar për periudhën nën auditim nga G.C. me profesion inxhinier

gjeolog nga janari 2018 deri në korrik 2018. Nga gushti 2018 deri në tetor 2019 IMTV është drejtuar nga A.K. me profesion inxhinier miniere. Nga tetori 2019 deri më 31 janar 2022 është drejtuar nga R.B. me profesion inxhinier miniere, dhe nga data 1 shkurt 2022 deri më fund të periudhës nën auditim është drejtuar nga G.C.. Për periudhën nën auditim, edhe punonjësit që kanë kryer detyrën e inspektorëve, kanë arsimimin për inxhinieri.

Sa më sipër, konstatohet se arsimimi i tyre është në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”, i ndryshuar, i cili përcakton detyrimin për arsimimin e lartë të inspektorëve, dhe llojin e arsimit të kërkuar.

1. Për aktivitetin e vitit 2018, rezulton se janë mbajtur 19 procesverbale konstatimi, nga të cilat është mbajtur vetëm 1 vendim gjobe. Nuk ka vendime për pezullimin e punimeve dhe për prishjen e tyre. Janë mbajtur gjithashtu 3 vendimet për gjoba, por nuk administrohet procesverbali i kundërvajtjes së kryer.

Rezulton se nga 19 procesverbale konstatimi, Kryeinspektori i IMT në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “*Për inspektimin e ndërtimit*”, i ndryshuar, neni 5, germa b, ç dhe d të dhe Ligjin nr. 107/2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, neni 52, “*Kundërvajtjet administrative*”, pika e, nuk ka marrë masat e duhura për përmbushjen e detyrimeve ligjore, duke mos vendosur gjoba, duke mos pezulluar punimet si dhe duke mos prishur ndërtimet e kundërligjshme.

Aktet e mbajtura për vitin 2018 janë paraqitur në Aneksin IMTV1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2. Për aktivitetin e vitit 2019, rezulton se janë mbajtur 56 procesverbale konstatimi, nga të cilat është mbajtur vetëm 1 vendim gjobe. Nuk ka vendime për pezullimin e punimeve dhe për prishjen e tyre.

Rezulton se nga 56 procesverbale konstatimi, Kryeinspektori i IMT në kundërshtim me nenin 5, germa b, ç dhe d të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “*Për inspektimin e ndërtimit*” i ndryshuar dhe nenit 52 “*Kundërvajtjet administrative*” pika e të Ligjit nr. 107/2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, nuk ka marrë masat e duhura për përmbushjen e detyrimeve ligjore, duke mos vendosur gjoba, duke mos pezulluar punimet si dhe duke mos prishur ndërtimet e kundërligjshme.

Aktet e mbajtura për vitin 2019 janë paraqitur në Aneksin IMTV2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3. Për aktivitetin e vitit 2020, rezulton se janë mbajtur 14 procesverbale konstatimi, nga të cilat nuk është mbajtur asnjë vendim gjobe. Nuk ka vendime për pezullimin e punimeve dhe për prishjen e tyre. Janë mbajtur gjithashtu 2 vendimet për gjoba, por nuk administrohet procesverbali i kundërvajtjes së kryer.

Rezulton se nga 14 procesverbale konstatimi, Kryeinspektori i IMT në kundërshtim me nenin 5, germa b, ç dhe d të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “*Për inspektimin e ndërtimit*”, i ndryshuar dhe nenit 52, “*Kundërvajtjet administrative*”, pika e të Ligjit nr. 107/2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, nuk ka marrë masat e duhura për përmbushjen e detyrimeve ligjore, duke mos vendosur gjoba, duke mos pezulluar punimet si dhe duke mos prishur ndërtimet e kundërligjshme.

Aktet e mbajtura për vitin 2020 janë paraqitur në Aneksin IMTV3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

4. Për aktivitetin e vitit 2021, rezulton se janë mbajtur 26 procesverbale konstatimi, nga të cilat janë nxjerrë 5 vendime gjobe në vlerën 900,000 lekë. Janë 5 vendime për pezullimin e punimeve dhe 1 vendim për prishjen e tyre. Janë mbajtur gjithashtu 2 vendimet për gjoba, por nuk administrohet procesverbali i kundërvajtjes së kryer.

Rezulton se nga 26 procesverbale konstatimi, Kryeinspektori i IMT në kundërshtim me nenin 5, germa b, ç dhe d të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “*Për inspektimin e ndërtimit*”, i

ndryshuar dhe nenit 52 “Kundërvajtjet administrative”, pika e të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, nuk ka marrë masat e duhura për përmbushjen e detyrimeve ligjore, duke mos vendosur gjoba, duke mos pezulluar punimet si dhe duke mos prishur ndërtimet e kundërligjshme.

Aktet e mbajtura për vitin 2021 janë paraqitur në Aneksin IMTV4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

5. Për aktivitetin e vitit 2022, rezulton se janë mbajtur 7 procesverbale konstatimi, nga të cilat janë nxjerrë 2 vendime gjobe në vlerën 120,000 lekë. Janë 4 vendime për pezullimin e punimeve dhe asnjë vendim për prishjen e tyre. Janë mbajtur gjithashtu 2 vendimet për gjoba, por nuk administrohet procesverbali i kundërvajtjes së kryer.

Rezultoni se nga 7 procesverbale konstatimi, Kryeinspektori i IMT në kundërshtim me nenin 5, germa b, ç dhe d të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar dhe nenit 52 “Kundërvajtjet administrative”, pika e të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, nuk ka marrë masat e duhura për përmbushjen e detyrimeve ligjore, duke mos vendosur gjoba, duke mos pezulluar punimet si dhe duke mos prishur ndërtimet e kundërligjshme.

Aktet e mbajtura për vitin janë paraqitur në Aneksin IMTV5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

6. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori nuk ka miratuar asnjë akt kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprim në kundërshtim me nenin 4, nenin 5 germa a) të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar dhe nenin 51 “Inspektimi” të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

7. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori nuk ka përgatitur informacionin periodik 3 mujor për IKMT për masat e marra, veprim ky në kundërshtim me nenin 5, germa f) të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.6., faqe 144-147.

**Kriteri:** Ligji 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4, neni 5 germa a, b, ç, d dhe f; Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51 “Inspektimi”.

**Ndikimi:** Ndikon në ndërtimet e reja në mos përputhje të planit rregullues. Shmangen detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

**Shkaku:** Mospërmbushje e detyrave të ngarkuara me ligj nga kryeinspektorët.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim 1:** Kryeinspektori i IMTV-së Bashkia Prrrenjas, të marrë masa në të gjitha rastet në vijim, për nxjerrjen e vendimeve të gjobave për të gjitha rastet e konstatimit të ndërtimeve pa leje, ose në shkelje të lejes, të kryhet pezullimi i punimeve me aktin përkatës si dhe të nxirren vendimet për prishjen e tyre.

**Rekomandim 2:** IMT Bashkia Prrrenjas, të mbajë akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës, si dhe të përgatitet në mënyrë periodike çdo 3 muaj informacioni drejtuar IKMT.

## 2.7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

### 2.7.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Prrrenjas për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH,

miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 144, datë 07.09.2022 dhe dërguar në Bashkinë Prrenjas me shkresën nr. 515/18 prot., datë 08.09.2022, rezultoi si më poshtë vijon:

a. Janë lënë 18 “Masa Organizative”, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga masat e lëna, 8 masa janë zbatuar plotësisht, 4 pjesërisht dhe 6 në proces, 0 masa janë pa zbatuar;

b. Janë lënë 11 masa “Masa për eliminimin e subjekteve lidhur me llogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore me efekte në të ardhurat e munguara në Bashkinë Prrenjas”, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga masat e lëna, 5 masa janë zbatuar pjesërisht, 3 masa janë në proces dhe 3 masa janë pa zbatuar;

c. Masa disiplinore për tre kategori:

- Për punonjësit me statusin e nëpunësit civil, janë lënë 3 masa;
- Për punonjësit me Kod Pune, janë lënë 9 masa;
- Për një kategori të veçantë, janë lënë masa për 12 punonjës në vlerësimin e Kryetarit të Bashkisë, të cilat janë zbatuar.

Nga sa më sipër, rezulton se nga 30 rekomandime të lëna, janë pranuar të gjitha, nga të cilat: janë zbatuar 9 masa ose 30% e tyre; 9 masa janë zbatuar pjesërisht; 9 masa janë në proces zbatimi dhe 3 masa janë pa zbatuar; pra 21 masa mbeten për t’u zbatuar nga Bashkia Prrenjas për periudhën në vijim.

Grupi i auditimit duke analizuar Rekomandimet e pranuar dhe të zbatuara nga Bashkia Prrenjas (njësitë përgjegjëse të saj), arriti në konkluzionin që: për kategorinë “Masa Organizative”, Rekomandimet 3.3; 4.1; 4.2; 5.2; 7.1; 9.1; 10.1; 12.1 dhe Rekomandimet e lëna në seksionin “C, Masa disiplinore”, janë pranuar dhe zbatuar, prandaj nuk mund të qëndrojnë për periudhën në vijim.

#### **2.7.2. Realizimi i programit (Plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.**

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Bashkia Prrenjas ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 2443/1 prot., datë 17.10.2022, duke mos respektuar afatin 20 ditor nga marrja e shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit, afat i cili është përmbushur deri në datën 03.10.2021. Në këtë datë, KLSH duhet të ishte vënë në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së dhe nga Bashkia Prrenjas duhet të ishte dërguar “Plani i veprimeve”, duke shprehur qëndrimin e saj për pranimin e rekomandimeve të KLSH-së.

**Zbatuar pjesërisht**

Në zbatim të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, Bashkia Prrenjas duhet të kishte raportuar shkresërisht brenda afatit 6 mujor nga data e mbërritjes së RPA, të dërguar nga KLSH me shkresën nr. 515/18 prot., datë 08.09.2022, mbërritur dhe regjistruar në Bashkinë Prrenjas me nr. 2443 prot., datë 12.09.2022. Nga auditimi rezultoi se ky raportim nuk është bërë, pasi afati 6 mujor është përmbushur në datën 11.03.2023, periudhë e cila përkon me fazën në terren të grupit të auditimit për zbatimin e programit të auditimit nr. 1173/1 datë 09.01.2023. Gjatë zhvillimit të auditimit, Bashkia Prrenjas i është përgjigjur kërkesës së grupit të auditimit dërguar në rrugë elektronike për çdo rekomandim të lënë, duke bërë me dije statusin e zbatimit të tyre.

**Në Proces**

Bashkia Prrenjas, në lidhje me “Gjetjet dhe Rekomandimet e lëna nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të KLSH-së” dhe për masat e marra për zbatimin e tyre, ka raportuar në Këshillin Bashkiak me shkresën nr. 239 prot., datë 24.01.2023, me objekt: “Raportim mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 515/18 prot., datë 08.09.2022, “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit””.

**Zbatuar**

**Konkluzion:** Nga verifikimet e bëra mbi shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna nga auditimi mëparshëm i KLSH-së, rezulton se nga 30 rekomandime, janë pranuar 9 rekomandime ose 30% e tyre. Ky nivel i ulët realizimi ka ardhur pasi nga ana e Titullarit të Bashkisë Prrenjas si dhe për shkak të mosfunksionimit me efektivitet të GMS në Bashkinë Prrenjas, nuk janë marrë masat e duhura, që brenda afateve kohore të përcaktuara në aktet ligjore/nënligjore, të miratohej “*Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve*”, duke vënë në dijeni KLSH-në.

### **2.7.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.**

**Titulli i gjetjes:** Bashkia Prrenjas nuk ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

**Situata:** Në mbështetje të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, neni 15, “*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*”, shkronjat “a” dhe “b”, rikërkohet marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pazbatuara.

Bashkia Prrenjas ka detyrimin për zbatimin e tyre si më poshtë vijon:

**a.** Janë lënë 18 Rekomandime për “*Masa Organizative*”, të cilat janë pranuar nga subjekti, për të cilat rikërkohet zbatimi për 4 masa të zbatuara pjesërisht;

**b.** Janë lënë 11 rekomandime në vlerën totale 102,288,902 lekë për “*Masa për eliminimin e subjekteve lidhur me llogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore me efekte në të ardhurat e munguara*”, të cilat janë pranuar nga subjekti dhe mbeten për t’u zbatuar, pasi deri tani janë zbatuar pjesërisht 5 masa, në vlerën 14,540,624 lekë, janë në proces zbatimi 3 masa, në vlerën 61,055,249 lekë dhe janë të pazbatuara 3 masa, në vlerën 26,695,029 lekë;

*Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.7., faqe 147-161.*

**Kriteri:** Ligji nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, neni 15, gërma j; Ligji nr.139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”;

**Ndikimi/Efekti:** Moszbatimi i Rekomandimeve, ndikon në uljen e efektivitetit të shërbimeve institucionale dhe pengon për përmirësimin e tyre në dobi të komunitetit, në mospërdorimin me efikasitet të fondeve të saj si dhe në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Prrenjas.

**Shkaku:** Mosndjekja e gjitha procedurave nga ana e njësive përgjegjëse të Bashkisë Prrenjas, për të mundësuar zbatimin e rekomandimeve të lëna në përgjithësi dhe ato me arkëtimin të vlerës 102,288,902 lekë në veçanti.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Prrenjas të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 518/18 prot., datë 08.09.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, të hartojë plan pune të veçantë dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre.

Nga sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH-së, rikërkon si më poshtë vijon:

#### **B. Masa organizative**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në buxhetin e Bashkisë Prrenjas gjatë vitit 2021 kanë ndodhur 3 ndryshime me vlerë 17,803 mijë lekë, duke marrë angazhime buxhetore të vitit ushtrimor, por të paparashikuara në PBA 2000-2022, konkretisht:

- *Ndërtim i një këndi të ri lojërash me fond 1,500 mijë lekë.*
- *Rikonstruktion i rrugës lagjja Gega Rrajve – Sutaj (NJA Rrajcë) me fond 600 mijë lekë.*
- *Rikonstruktion i rrugëve të brendshme në Bashkinë Prrenjas me fond 560 mijë lekë.*
- *Rikonstruktion i rrugëve të brendshme, rruga 1 Qershori/rruga 5 Maji me fond 8,262 mijë lekë.*

Këto veprime tregojnë për planifikime jo optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e



kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përlogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.

Mos realizimet dhe ndryshimet në buxhet tregon se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme, veprime në kundërshtim me ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, me UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253 dhe 354.

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Administrimit Financiar dhe Shërbimi Social, në bashkëpunim sektorët e tjerë në Bashkinë Prrenjas, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

#### **Menjëherë dhe vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi** (zbatimi i rekomandimeve të auditimit të mëparshëm): KLSH-ja me shkresën e saj nr. 1117/17 prot, datë 17.01.2022 ka dërguar në Bashkinë Prrenjas rekomandimet e auditimit. Bashkia Prrenjas për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nuk ka kthyer përgjigje, duke mos respektuar afatin 20 ditor.

Bashkia Prrenjas duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 17.06.2022, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA me shkresën nr. 1117/17, datë 17.01.2022. Nga Bashkia Prrenjas nuk është bërë raportimi brenda 6 mujorit.

Bashkia Prrenjas ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve, por nuk ka raportuar në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak).

- Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 11 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë zbatuar 5 masa, janë në proces zbatimi 6 masa.

- Për masa mungesë të ardhurash janë rekomanduar **6 masa** me vlerë **58,782,491 lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë në proces zbatimi 5 masa me vlerë 58,190,294, nga e cila likujduar vlera 12,840,136 lekë dhe mbetur per likujdim vlera 45,350,158 lekë, si dhe nuk është zbatuar një masë në vlerën 592,197 lekë.

- Për masa disiplinore, janë rekomanduar gjithsej **15 masa** të cilat janë pranuar dhe zbatuar nga subjekti.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenet 15 dhe 30, si dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50-Auditimi i jashtëm.

**4.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Prrenjas të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces ose të pazbatuara, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 117/17, datë 17.01.2022 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Prrenjas”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre, *respektivisht për:*

- **6 masa** organizative.

- **6 masa** mungesë të ardhurash në vlerën **45,942,355 lekë**.

- Njoftimin e Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit të Shërbimit Civil, për masat e marra nga Komisioni Disiplinorë për 15 punonjësit e Bashkisë Prrenjas, referuar shkeljeve të evidentuara nga raportin përfundimtar të auditimit dhe përcjellë subjektit për zbatim me shkresën nr. 114/17, datë 17.01.2022. (Këto masa janë përfshirë për zbatim sipas klasifikimit respektiv në rekomandimet e lëna në RPA pasardhës).

#### **Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm sipas komponentëve u konstatua se në lidhje me:

Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Bashkia Prrenjas nuk ka Kod të Etikës, por në nenet 13 dhe 14 të Rregullores së Brendshme me vendim nr. 38 datë 04.03.2019 me nr. prot 697, ku në nenin 13 është përfshirë disiplina formale dhe administrative me 8 rregullat e saj dhe në nenin 14 është përfshirë etika për punonjësit e bashkisë Prrenjas dhe kodi i veshjes me 10 rregullat e saj. Njohja e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi, kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, por nuk ka trajnime për këto raste. Për procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, nuk janë hartuar rregullore. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen. Mungon dokumentimi i takimeve të menaxherëve me stafin e lartë menaxherial. Nga njësitet e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Ndërsa nga UK sha Librazhd Bashkia Prrenjas e cila është aksionere me 49% të aksioneve, mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat. Mungon një program strategjik institucional me prioritetet dhe objektivat dhe plan-veprimet e realizimit të tyre. Në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, por jo objektivat për secilin punonjës. Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune, por nuk janë rishikuar për çdo vit dhe nuk janë miratuar në DAP. Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, por nuk ka një plan vjetor rekrutimi. Nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

Komponenti “Menaxhimi i Riskut”:

Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla.

- Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut. Është përcaktuar koordinatori i riskut Kryetari i bashkisë z. N.B., por nuk është përcaktuar grupi i punës së riskut. Nuk është hartuar regjistri i riskut, ku të bëhet identifikimi dhe vlerësimi i risqeve dhe nuk janë përcaktuar veprime për të adresuar mangësitë në disa fusha kryesore si: në fushën e taksave dhe tarifave vendore, në fushën financiare për ndjekje e debi-kredive dhe akumulimi i borxhit dhe në fushën e prokurimeve publike, duke mos identifikuar e vlerësuar të gjitha risqet e mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”:

Bashkia Prrenjas nuk disponon një regjistër të aktiveve afatgjata materiale; Bashkia Prrenjas nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve;

Nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT si dhe mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të IT të miratuar nga Kryetari.

Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

Komponenti: “Monitorimi”:

Procedurat periodike të raportimit, që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

Në Bashkinë Prrrenjas mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Nuk ka asnjë dokumentim të raportimit të institucioneve të varësisë në Bashkinë Prrrenjas mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit të MFK. Në Bashkinë Prrrenjas aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave përshtatshëmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

**5.1. Rekomandimi:** Bashkia Prrrenjas, të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara dhe ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara; gjithashtu zhvillimin e programeve të trajnimeve nga punonjës brenda Bashkisë si dhe të punohet për plotësimin e kërkesave të komponentëve të MFK.

*Menjëherë*

**B. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrrenjas, rezulton se gjendja e debitorëve nga taksat/ tarifatat vendore më 31.12.2021 paraqitet në shumën **62,185,903 lekë**, të cilët nuk mund t'i paraqesim në formë tabelore për shkak të sasisë së madhe, e cila është në formë dixhitale, me CD.

Kjo vlerë vjen në rritje nga viti 2020 në shumën 14,287,806 lekë, pasi nga vlera 47,898,097 lekë në fund të vitit 2021 paraqitet vlera 62,185,903 lekë.

Referuar të dhënave të tabelës konstatohet se niveli i borxhit është 77.5% e planit të të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore dhe 16.2% e shpenzimeve buxhetore, gjë e cila tregon punën e pamjaftueshme të kësaj drejtorie në menaxhimin e borxhit fiskal.

Nga Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrrenjas janë llogaritur kamatëvonesa në vlerën 759,914 lekë, vlerë kjo shumë herë më e vogël se vlera reale e llogaritjes së tyre, pasi sipas dispozitave ligjore (0.06%), detyrimi për kamatëvonesën duhej të ishte në vlerën **4,562,475 lekë** ( $24,303,147 * 0.06\% \times 365 - 759,914$ ), më 31.12.2021.

Vlera totale e debisë (borxhit tatimor) prej **65,748,378 lekë** (**62,185,903 lekë detyrime të papaguara dhe 4,562,475 lekë kamatëvonesa**), duhet të kontabilizohet dhe t'u njoftohet subjekteve përkatëse nga ana e administratës së Bashkisë Prrrenjas **dhe përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Prrrenjas.**

Për një pjesë të subjekteve të cilat janë debitorë në vite, nuk janë zbatuar procedurat ligjore për arkëtimin e tyre sipas ligjit, duke bërë që këto subjekte të kthen në debitorë pa shpresë arkëtimi, **gjithsej 55 subjekte me vlerë 10,729,869 lekë 16% e totalit të detyrimeve.**

Në lidhje me masat e marra, konstatohet se nga bashkia është zbatuar vetëm bllokimi i llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe bllokimi në Drejtorinë Rajonale ASHK Elbasan, duke kërkuar arkëtimin e vlerës 11,254,342 lekë, *nga e cila arkëtua vlera 3,480,2756 lekë.*

Në krahasim me nivelin e detyrimeve në fund të periudhës, konstatohet se procedura për zbatimin e masave shtrëngese nuk është e plotë dhe në përputhje me kuadrin ligjorë në fuqi, ku një pjesë e masave nuk është zbatuar. Mungon bashkëpunimi me Policinë Bashkiake për arkëtimin e tyre. Gjithashtu dhe në rastet kur është zbatuar, evidentohet se vlera e zbatuar në

krahasim me nivelin e tyre është në masën 17.7%, gjë e cila tregon punën e pamjaftueshme të kësaj drejtorie.

Nga të dhënat evidentohet se një numër subjektësh me status pasiv/mbyllur paraqiten me situatë debitorë, gjithsej **5** me vlerë **566,397 lekë**, ku përgjegjësia është si Administratës së QKB Njësia Librazhd, po ashtu dhe Drejtorisë së të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas, e cila ka lejuar mbylljen e tyre subjekteve pa likuiduar detyrimet fiskale, duke u bërë premisë për kalimin e tyre në borxh **të paarkëtueshëm ose të keq**.

*Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nenet 15 dhe 181 - Mospagimi i taksave dhe tatimeve, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit “Për Kundërvajtjet Administrative” (brenda 2 viteve), ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve, me pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, me ndryshime.*

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifave vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **26,042,222 lekë**, si më poshtë vijon:

*a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.*

*b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),.*

*c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo ditë të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.*

*d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.*

**e-** Të bashkërendojë punën me QKB Dega Librazhd për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

**f-** Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të paarkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

**g-** Të bëhet llogaritja e saktë e kamatëvonesave për të gjithë subjektet të cilat nuk likuidojnë në afat detyrimet sipas njoftim detyrimit nga momenti i lindjes deri në datën e pagesës së detyrimit.

**1.2. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas të bashkëpunojë me QKB Dega Librazhd dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan për evidentimin e subjekteve me status pasiv/mbyllur nëse ushtrojnë ose jo aktivitet dhe të mos lejohen të mbyllin veprime pa bërë likuidimin e detyrimeve të prapambetura, për të shmangur fenomenin e krijimit të borxhit të keq dhe pamundësinë e gjetjes së tyre për arkëtim.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimit:** Në totalin e detyrimeve të prapambetura (62,185,903 lekë), konstatohet se peshën kryesore e zënë detyrimet nga abonentët familjarë, të cilat janë 64% e totalit të detyrimit ose me vlerë **39,706,156 lekë**.

Për menaxhimin e taksave e tarifave vendore, Bashkia Prrenjas nuk kishte aktmarrëveshje me Nd/ Ujësjiellës Kanalizime dhe menaxhimi bëhej nga vetë bashkia nëpërmjet postës

(shpërndarjen e njoftim detyrimit) dhe për njësitë e largëta nga punonjësit e taksave. Një menaxhim i tillë është jo frytdhënës për bashkinë, pasi niveli i detyrimeve debitore vjen në rritje nga njëra periudhë në tjetrën, ku për vitin 2021 kemi një rritje për vlerën 22,260,537 lekë, pasi nga vlera 17,445,619 lekë në vitin 2020 në vitin 2021 paraqitet në vlerën 39,706,156 lekë. Gjithashtu evidentohet fakti se nga Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas për abonentët familjare nuk është ndjekur asnjë procedurë ligjore për arkëtim e tyre. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05. i ndryshuar kreu IX pagesa dhe rimbursim i tatimit, Neni 74 “Afatet dhe mënyrat e pagesës së detyrimit tatimor”.

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Prrenjas në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve të marrë masa për lidhjen e aktmarrëveshjes si agjent tatimorë më Ndërmarrjet e Ujësjiellit Librazhd/Prrenjas, për një mirëmenaxhim më të mirë të detyrimeve nga abonentët familjarë dhe jo vetëm.

*Menjëherë*

**2.2. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Njësitë Administrative, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifatat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **39,706,156 lekë** nga abonentët familjarë.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi menaxhimin e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) dhe të ndërtimeve pa leje (ALUIZNI-t), rezulton se për vitin 2021 është realizuar në masën 134% ose nga vlera 7,000 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 9,367 mijë lekë. Ky tejkalim vjen nga mungesa e bashkëpunimit midis drejtorive mbi mundësinë e lejeve të ndërtimit që Drejtoria e PZHT ka parashikuar për vitin ushtrimor 2021.

Në këtë zë bën pjesë dhe taksa nga ndërtimet pa leje (ALUZNI-t)), ku referuar të dhënave, detyrimi për këtë taksë në fund të vitit 2021 paraqitet në shumën **1,597,190 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Prrenjas.

Nga dokumentacioni i paraqitur, nuk u evidentuan raste që Bashkia Prrenjas ti jetë drejtuar ASHK Dega Elbasan, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes e lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Veprime në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje, Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet.

**3.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Njësitë Administrative, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifatat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **1,597,190 lekë** nga abonentët familjarë.

*Menjëherë*

**3.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Prrenjas nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t'i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Elbasan, që të mos pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Në rastet kur nga ASHK është vijuar me dhënien e certifikatës së legalizimit të kërkohet bllokimi i pronës deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

*Menjëherë dhe vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i regjistrave të subjekteve fizik/juridik mbi ngarkesën fiskale të detyrimeve vjetore për taksat e tarifatat vendore në vitin 2021 (sipas ligjit dhe VKB), rezulton se për një pjesë të subjekteve me aktivitet *HEC, përpunimi i peshkut/mishit, karriere guri(gurore) Shfrytëzim karrierash lumore dhe malore, prodhim inertesh, shfrytëzim*

minierash, hekur nikeli, shfrytëzim pyjor dhe industri te tjera te cilat ndikojnë ne mjedis, nuk është bërë i mundur aplikimi dhe arkëtimi i tarifës për mbrojtjen dhe përpunimin e mjedisit, kjo për 7 subjekte me vlerë **1,850,000 lekë**, si mungesë të ardhurash ne buxhet, në kundërshtim me kapitullin B pika 16 *Tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit*, të Vendimit të KB nr. 97, datë 01.12.2020 “Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021”.

#### **4.1. Rekomandimi:**

Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve Bashkia Prrenjas, të marrë të gjitha masat duke zbatuar të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për nxjerrjen dhe kontabilizimin e detyrimeve për tarifën e mjedisit për 7 subjektet në vlerë **1,850,000 lekë**, respektivisht:

- vlera **350,000 lekë**, nga shoqëria “**G.E.**” SHPK, me administrator Sh.K.
- vlera **250,000 lekë**, nga shoqëria “**F.C.A.**” SHPK, me administrator A.G.
- vlera **250,000 lekë**, nga shoqëria “**A.**” SHPK, me administrator H.H.
- vlera **250,000 lekë**, nga shoqëria “**D.E.**” SHPK, me administrator L.K.
- vlera **250,000 lekë**, nga shoqëria “**J.P.**” SHPK, me administrator F.P.
- vlera **250,000 lekë**, nga shoqëria “**E.F.**” SHPK .
- vlera **250,000 lekë**, nga shoqëria “**V.C.**” SHPK, me administrator V.C.

#### ***Menjëherë***

**5. Gjetje nga auditimit:** Gjatë auditimit të tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se në këtë njësi vendore ushtrojnë aktivitetet 6 subjekte me destinacion tregtim karburanti.

Në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se aplikimi i taksës nuk është i saktë, po kështu dhe mënyra e arkëtimit nuk është zbatuar sipas ligjit.

Sipas bazës ligjore të mësipërme, të gjitha subjekteve që ju ka mbaruar afati 5 vjeçar i autorizimit pas datës të hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 970, datë 2.12.2015, për rinovimin e licencës duhet të paguajnë si më sipër.

Të dhënat për detyrimet për taksën e licencës për pikat e tregtimit me pakicë të karburanteve dhe njërive të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit për taksat dhe tarifave vendore deri në fund të vitit 2021 rezulton në vlerën 2,454,032 lekë, si e ardhur e munguar në buxhet e bashkisë Prrenjas, kjo për **4 subjekte**, respektivisht: shoqëria “L.B.” SHPK në vlerën 1,000,000 lekë, subjekti “L.” SHPK, e vlerë 900,000 lekë, subjekti “K.” SHPK me vlerë 232,949 lekë dhe subjekti “G.C.G.” SHPK me vlerë 321.083 lekë.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve bashkia Prrenjas, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej **2,121,083 lekë nga 3 subjektet**, respektivisht;

- vlera **1,000,000 lekë** nga subjekti “L.B.L” SHPK
- vlera **800,000 lekë** nga subjekti “K.” SHPK;
- vlera **321,083 lekë** nga subjekti “G.C.G.” SHPK

#### ***Menjëherë***

**6. Gjetje nga auditimit:** Sipas evidencës së të ardhurave për vitin 2021, rezulton se të ardhurat nga qiratë janë realizuar në masën 89%, ku nga vlera e planifikuar prej 6,200,00 lekë është arkëtuar vlera 5,533,081 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi kontratat e qirave të lidhura nga Bashkia Prrenjas, konstatohet se operojnë gjithsej 22 subjekte të cilat kanë lidhur kontratë qiraje me aktivitet HEC, Gurore, objekte, veprimtari ekonomike, telefoni, etj, duke përlllogaritur një detyrim vjetor në vlerën 8,792,005 lekë, nga e cila likujduar vlera 6,001,818 lekë dhe mbetur pa likujduar vlera **3,816,519 lekë**, respektivisht:

- a- 8 subjekte për HEC me vlerë kontrate vjetore 5,881,823 lekë.
- b- 2 subjekte shfrytëzim karrierë me vlerë kontrate 74,000 lekë.
- c- 2 subjekte veprimtari ekonomie me vlerë kontrate 41,202 lekë.
- d- 4 subjekte me veprimtari telefonisë celulare me vlerë kontrate vjetore 906,510 lekë.
- e- 6 subjekte për kullota me vlerë kontrate 80,300 lekë

Për subjektet të cilat kanë lidhur kontratë dhe nuk kanë likuaduar detyrimet kontraktuale, nga Bashkia Prrenjas (personat përgjegjës), referuar pikës 5.5 të nenit 5 të kontratës, nuk janë llogaritur penalitetet në masën 0.1% jo më shumë se 10%, **duke evidentuar një kamatëvonesë në vlerën 289,239 lekë, si e ardhur e munguar në buxhet.**

Sipas kërkesës së bërë nga Bashkia Prrenjas në adresë të AKBN në lidhje me subjektet që operojnë në shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore (karriera), nga kjo e fundit është konfirmuar me shkresën nr. 1011/1, datë 24.2.2022 se në këtë njësi vendore ushtrojnë këtë lloje aktiviteti **19 subjekte**, ku dy prej të cilave janë me pezullim, dy kanë kontratë me bashkinë dhe **15 subjekte** ushtrojnë aktivitet duke shfrytëzuar sipërfaqe pyjore/kullosore pa lidhur kontratë qiraje me bashkinë ose ministrinë e linjës.

Me shkresën nr. 569, datë 18.2.2022, Bashkia Prrenjas i ka kërkuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit që për 4 subjekte është kërkuar heqje nga fondi pyjore i sipërfaqeve sipas lejes minerale.

Nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 2050/1, datë 28.2.2022 është kthyer përgjigje se mungon një pjesë e dokumentacionit për marrjen në shqyrtim të kërkesës dhe nga bashkia nuk është vijuar me tej.

Detyrimi i munguar në buxhetin e bashkisë Prrenjas vetëm për një vit ushtrimorë nga Moszbatimi i kuadrit ligjor në fuqi përlllogaritet në **shumën 20,488,050 lekë, e ardhur e munguar në buxhet.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” nenin 24, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me pikën 6, neni 17, të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për Fondin Kullosor”, me pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016.

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas, të marrë masa për:

- Subjektet të cilat nuk kanë likuaduar detyrimet kontraktuale sipas afateve të përcaktuara në kontratë të llogaritit, kontabilizohet dhe arkëtohen **kamatëvonesat në vlerën 289,239 lek**), si e ardhur e munguar në buxhet.

- Për sipërfaqet e shfrytëzueshme nga **15 subjekte** që ushtrojnë aktivitet duke shfrytëzuar sipërfaqe pyjore/kullosore pa lidhur kontratë qiraje me bashkinë ose ministrinë e linjës deri më 31.12.2021, të kërkohet detyrimi në vlerën **20,488,050 lekë, për periudhën e shfrytëzimit të sipërfaqeve, si një e ardhur e munguar në buxhet**, sipas *Aneks 2.3.6 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*), duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, si dhe kërkohet ripyllëzimi i sipërfaqeve sipas raportit teknik të miratuar me marrjen e lejes minerale.

- Sipërfaqen rrugë kalimi dhe vend depozitimit që subjektet shfrytëzojnë deri në sipërfaqen e miratuar sipas lejes minerale, të bëhet saktësimi dhe përlllogaritjen e detyrimeve për qiranë nga Bashkia Prrenjas.

- 15 shoqëritë që shfrytëzojnë sipërfaqet pyjore/kullosore pa kontratë me Bashkinë Prrrenjas, duke vijuar me shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore pronë e Bashkisë Prrrenjas, të bëhet bllokimi i aktivitetit deri në marrjen e vendimit nga Ministria e linjës për sipërfaqet nën 1 ha ose nga KM për sipërfaqet mbi 1 ha, mbi pronësinë e sipërfaqes që do shfrytëzohet nga subjektet.

*Menjëherë*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se, leja e ndërtimit nr.56 datë 13.07.2021 e miratuar elektronikisht po në këtë datë, nga Kryetari i Bashkisë z. N.B., bazuar në treguesit e zhvillimit të propozuar, sipërfaqja e ndërtimore mbi tokë të fazës II arrin 1989 m<sup>2</sup>, ndërsa nën tokë, gjelbërime dhe sistemime arrin 550 m<sup>2</sup>.

Vlera e TNI-së llogaritur sipas legjislacionit:

**$TNI = \text{Çmimi shitje/m}^2 \text{ sipas UKM nr. 3 datë 28.12.2016} \times m^2 \times 6\% = 1,989 \times 41,780 \times 6\% = 4,986,025 \text{ lekë.}$**

Sipas autorizimit për pagesë të firmosur, vlera e përlllogaritur dhe e paguar nga subjekti "E.S." SHPK me njoftim debitimin e bankës B. datë 29.06.2021, është **1,560,170 lekë.**

Nisur nga fakti që llogaritja e kësaj takse, i përket vetëm fazës së dytë të ndërtimit, por objekti i ndërtimit është vetëm një, pra Qendra Tregtare Multifunktionale, atëherë është kontrolluar dhe llogaritja e TNI-së sipas fazës së parë.

Faza e parë e dhënies së lejes lidhet me lejen zhvillimore nr.57, datë 09.11.2018 si dhe lejen e ndërtimit nr. 61 (nr. prot 1206) datë 26.06.2019.

Në llogaritjen e TNI-së, është përdorur metoda e llogaritjes mbi bazë preventivi, në kundërshtim me nenin 9 pika 2 e ligjit nr.95/2018 datë 03.12.2018, pasi llogaritja bëhet mbi bazën e çmimit të shitjes.

Duke qenë se në paketën fiskale të vitit 2019, nuk është përcaktuar përqindja mbi objektet e shërbimit (Qendër Tregtare), si llogaritje po marrim si referencë normën minimale të përcaktuar në ligj, pra 4%. Nga rillogaritja e TNI-së, ka rezultuar si më poshtë;

**$TNI = \text{Çmimi shitje/m}^2 \text{ sipas UKM nr. 3 datë 28.12.2016} \times m^2 \times 6\% = 3,606 \text{ m}^2 \times 41,780 \times 4\% = 6,026,347 \text{ lekë.}$**

Nga subjekti "E.S." SHPK me njoftim debitimin e bankës BKT datë 21.06.2019, është **2,336,846 lekë**, me një diferencë prej **3,689,501 lekë** e papaguar nga subjekti zhvillues "E.S." SHPK, për shkak të keq llogaritjes nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.

**Pra në total diferenca e papaguar për dy fazat është 7,115,356 lekë.**

**7.1. Rekomandimi:** Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të bëhet rillogaritje e taksës së ndikimit në infrastrukturë, pasi të jetë rishikuar paketa fiskale, seksioni Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja, ku mbi këtë të fundit të jenë bërë përditësimet me legjislacionin e taksave vendore në fuqi.

*Menjëherë*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i lejes së ndërtimit nr.58 datë 13.07.2021 e miratuar elektronikisht po në këtë datë, nga Kryetari i Bashkisë z. N.B., bazuar në treguesit e zhvillimit të propozuar, sipërfaqja e ndërtimore mbi tokë arrin 2060 m<sup>2</sup>, ndërsa sipërfaqja nën tokë (1 kat) arrin 412 m<sup>2</sup>, pra në total 2,472 m<sup>2</sup>.

Vlera e TNI-së llogaritur sipas legjislacionit:

**$TNI = \text{Çmimi shitje/m}^2 \text{ sipas UKM nr.3 datë 28.12.2016} \times m^2 \times 4\% = 2,472 \times 41,780 \times 4\% = 4,131,206 \text{ lekë.}$**

Sipas autorizimit për pagesë të firmosur, vlera e përlllogaritur dhe e paguar nga subjekti S. B. me njoftim debitimin e bankës OTP datë 01.07.2021, është **1,384,549 lekë.**

Në llogaritjen e TNI-së, është përdorur metoda e llogaritjes mbi bazë preventivi, në kundërshtim me nenin 9 pika 2 e ligjit nr.95/2018 datë 03.12.2018, pasi llogaritja bëhet mbi bazën e çmimit të shitjes.



Duke qenë se në paketën fiskale të vitit 2019, nuk është përcaktuar përqindja mbi objektet e shërbimit (Qendër Tregtare), si llogaritje po marrim si referencë normën minimale të përcaktuar në ligj, pra 4%.

**Pra konstatohet një diferencë e dukshme prej 2,746,657 lekë,** e papaguar nga subjekti zhvillues **z. S.B.**, për shkak të keqlllogaritjes nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.

**8.1. Rekomandimi:** Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të bëhet rilogaritje e taksës së ndikimit në infrastrukturë, pasi të jetë rishikuar paketa fiskale, seksioni Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja, ku mbi këtë të fundit të jenë bërë përditësimet me legjislacionin e taksave vendore në fuqi.

*Menjëherë*

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, pasqyrat përkatëse janë bashkëlidhur Raportit Përfundimtar si Aneksi ZR1, ZR2 dhe ZR3.

## 2.8. Të ndryshme, të dala gjatë auditimit

Me shkresën datë 23.01.2023, protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr. 81, datë 23.01.2023, Operatori Ekonomik “D.B./M.”, Person Fizik, me NUIS L...K, ka paraqitur kërkesë për përmbushjen e detyrimit kontraktor nga Bashkia Prrenjas, konkretisht për likuidimin e faturës tatimore me numër serial 53468950 dhe numër rendor 50, datë 15.01.2019, në vlerën 1,100,560 (një milion e njëqind mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

Ankesa e paraqitur nga Operatori Ekonomik “D.B./M.”, ka këtë përmbajtje:

*D.B., person fizik, i themeluar dhe e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 04.07.2014, me NUIS L...K, me seli ne adresën: Rruga e Kavajës, Pallati Gora, Kati 11, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Administratore Znj. D.B., atësia N., lindur më 11.07.1986 në Fier dhe banuese në Tiranë, pajisur me Nr. personal I65711046P, me adresë: Rruga Tish Daija, Kompleksi KIKA 2, Godina Nr. 5, Kati 4, Ap. 4/D, Tiranë, ka lidhur kontratën me nr. 3287/3 datë 31.12.2018, me Objekt “Organizimi i aktivitetit dhe dekorimi i qytetit për Vitin e Ri”, me Autoritetin Kontraktor Bashkia Prrenjas, me Nr. NIPT K...U, përfaqësuar nga Znj. M.R..*

*Kjo kontratë është realizuar me sukses nga ana jonë sipas të gjitha kushteve dhe specifikimeve të përcaktuara në kontratë. Procesverbali i datës 31.12.2018, i mbajtur nga grupi i punës së ngritur pranë kësaj Bashkie, vërteton përmbushjen 100% të kontratës së përmendur më sipër. Vlera e kësaj kontrate është 1,100,560 (një milion e njëqind mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, që vërtetohet nga fatura tatimore me nr. serie 53468950, datë 15.01.2019 dhe nr. fature 50, faturë e cila është pranuar dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor. Në shkelje të gjitha neneve të kontratës por edhe të legjislacionit Shqiptar për detyrimet kontraktuale, ne nuk jemi likujduar për këtë kontratë nga ana e institucionit Bashkia Prrenjas, edhe pse kanë kaluar disa vite nga përmbushja e të gjitha detyrimeve të garancisë nga ana jonë.*

*Ju lutemi të merrni masa detyruese (shtrënguese) për këtë institucion në mënyrë që të bëjë likuidim të menjëhershëm të detyrimit kontraktor të prapambetur.*

*Bashkangjitur do të gjeni një kopje të kontratës së nënshkruar me institucionin, faturën tatimore të firmosur dhe procesverbalin e përmbushjes së punës me sukses.*

Nga auditimi, u konstatua se në Bashkinë Prrenjas, në lidhje me problemin e paraqitur nga kërkuksi i sipërpërmendur, disponohet dokumentacioni si më poshtë:

1. Dosja e prokurimit, e cila është e numërtuar, e inventarizuar dhe e depozituar në arkivën e institucionit, me dokumentet:

- Kërkesë për dekorimin e qytetit;
  - Preventiv për dekorimin e qytetit;
  - Urdhër nr. 505 i titullarit, për përllogaritjen e fondit limit, me nr. 2979 prot., datë 25.10.2018;
  - Ftesë për ofertë, drejtuar OE S.A.;
  - Ofertë nga OE S.A.;
  - Ofertë nga OE P.V. SHPK;
  - Ofertë nga OE J.P., Person Fizik;
  - Specifikimet teknike;
  - Procesverbal për përllogaritjen e fondit limit, datë 06.11.2018
  - Urdhër prokurimi nr. 3287 prot., datë 20.11.2018;
  - Urdhër për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave, nr. 3286 prot., datë 20.11.2018;
  - Procesverbal për hartimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit, datë 01.04.2018;
  - Deklaratat për mospasje konflikt interesi nga anëtarët e grupit të përllogaritjes së fondit limit, anëtarët e njësisë së prokurimit dhe anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave;
  - Dokumentat standarde të tenderit me nr. REF-95232-11-21-2018, për tenderin me objekt “*Organizimi i aktivitetit dhe dekorimi i qytetit për Vitin e Ri*”, e llojit “*Prokurim elektronik, kërkesë për propozime, shërbim*”;
  - Vendimi nr. 124 i titullarit, për miratimin e DST, me nr. 3296 prot., datë 21.11.2018;
  - Formular i njoftimit të kontratës, me nr. 3287/1 prot, datë 21.11.2018;
  - Njoftimi i pesë OE në sistemin e APP-së, për zhvillimin e tenderit;
  - Faqe 92 dhe 93, për publikimin në Buletinin e APP-së me nr. 47, datë 26.11.2018;
  - Procesverbal i hapjes së ofertave, datë 03.12.2018;
  - Procesverbal i vlerësimit të ofertave, datë 11.12.2018;
  - Renditja përfundimtare e ofertuesve, nga sistemi i APP-së;
  - Raport përmbledhës, datë 26.12.2018;
  - Vendim nr. 137 i titullarit, për miratimin e procedurës së prokurimit, me nr. 3622 prot., datë 26.12.2018;
  - Formular i njoftimit të fituesit, nr. 3287/2 prot., datë 26.12.2018;
  - Faqe 305 dhe 306, për publikimin e njoftimit të fituesit në Buletinin e APP-së me nr. 52, datë 31.12.2018,
  - Kontratë nr. 3287/3 prot., datë 31.12.2018, e lidhur ndërmjet AK Bashkia Prrenjas dhe OE “*D.B./M.*”, me objekt “*Organizimi i aktivitetit dhe dekorimi i qytetit për Vitin e Ri*”, me vlerë 1,320,672 lekë, me TVSH, me afat 15.12.2018-15.01.2019, për shërbimet sipas preventivit bashkëlidhur;
  - Formular i njoftimit të kontratës së lidhur, me nr. 3287/4 prot., datë 31.12.2018;
  - Formulari i sigurimit të kontratës, nga ANSIG, me nr. serie 0011771, datë 31.12.2018, për objektin e kontratës në fjalë, me vlerë 132,067 lekë;
  - Dokumentacioni i operatorit fitues.
2. Kërkesë e OE “*D.B./M.*”, me nr. 2 prot., datë 11.02.2019, drejtuar AK Bashkia Prrenjas për kryerjen e pagesës, protokolluar në Bashkinë Prrenjas me nr. 438, datë 13.02.2019;
  3. Kërkesë e OE “*D.B./M.*”, datë 11.09.2019, drejtuar AK Bashkia Prrenjas për kryerjen e pagesës, protokolluar në Bashkinë Prrenjas me nr. 3274, datë 11.10.2019;
  4. Procesverbali datë 31.12.2018, për marrjen e shërbimit në dorëzim, nënshkruar nga punonjësit e Bashkisë Prrenjas, I.B., O.L. dhe A.H.;
  5. Faturë tatimore me numër serial 53468950 dhe numër rendor 50, datë 15.01.2019, për vlerën 1,320,678 lekë me TVSH, për shërbimet sipas preventivit dhe kontratës në fjalë. Fatura

është nënshkruar për Bashkinë Prrrenjas nga M.B., juriste, e cila për periudhën në fjalë kishte detyrën e Përgjegjëses së sektorit juridik dhe prokurimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, si dhe nga intervistat e zhvilluara me punonjës të Bashkisë Prrrenjas, u konstatua se: Shërbimi i kontraktuar është realizuar; Dokumentacioni autorizues është i plotë; Dokumentacioni vërtetues është i plotë; Mungon dokumentacioni i kontabilitetit, i cili ka ardhur si pasojë e ndryshimeve të administratës së Bashkisë Prrrenjas; Operatori Ekonomik ka bashkëlidhur ankesës kopje të noterizuara të faturës dhe procesverbalit përkatës; Personat përgjegjës nga intervistat e kryera kanë pranuar që shërbimi është kryer dhe kanë nënshkruar rregullisht faturën dhe procesverbalin përkatës.

#### **Konkluzion:**

1. Dokumentacioni i disponueshëm në Bashkinë Prrrenjas, është sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 07.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, kapitulli III, “*Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre*”, nënkapitulli “*Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve*”, pika 35, germa a. “*Dokumenta autorizues*”, germa b. “*Dokumenta vërtetues*”.
2. Nga Bashkia Prrrenjas duhet të kontabilizohet detyrimi ndaj subjektit “*D.B./M.*” person fizik, si dhe të vazhdohet me shlyerjen e plotë të tij, sipas mundësive financiare të Bashkisë Prrrenjas.
3. Bashkia Prrrenjas duhet të shmangë procedurat gjyqësore të cilat mund të krijohen për këtë rast, pasi si pasojë e tyre mund të përballet edhe me kamatëvonesat përkatëse, sipas dispozitave të ligjit nr. 48/2014, “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*”.

**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kërkesës së Operatorit Ekonomik “*D.B./M.*”, Person Fizik, me NUIS L....K, datë 23.01.2023, protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr. 81, datë 23.01.2023, për përmbushjen e detyrimit kontraktor nga Bashkia Prrrenjas, konkretisht për likuidimin e faturës tatimore me numër serial 53468950 dhe numër rendor 50, datë 15.01.2019, në vlerën 1,100,560 lekë pa TVSH, u konstatua se: Shërbimi i kontraktuar është realizuar; Dokumentacioni autorizues është i plotë; Dokumentacioni vërtetues është i plotë; Mungon dokumentacioni i kontabilitetit, i cili ka ardhur si pasojë e ndryshimeve të administratës së Bashkisë Prrrenjas.

1. Operatori Ekonomik ka bashkëlidhur ankesës kopje të noterizuara të faturës dhe procesverbalit përkatës;
2. Personat përgjegjës nga intervistat e zhvilluara kanë pranuar që shërbimi është kryer dhe kanë nënshkruar rregullisht faturën dhe procesverbalin përkatës.

Bashkia Prrrenjas, pavarësisht se problemet kanë ndodhur gjatë ndryshimit të titullarit, nuk ka zbatuar UMF nr. 30, datë 07.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, kapitulli III, “*Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre*”, nënkapitulli “*Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve*”, pika 35, germa a. “*Dokumenta autorizues*”, germa b. “*Dokumenta vërtetues*”, duke rrezikuar të përballet me procedura gjyqësore të cilat mund të lindin për këtë rast dhe rrjedhimisht mund të përballet edhe me kamatëvonesat përkatëse, sipas dispozitave të ligjit nr. 48/2014, “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*”.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.8., faqe 161-163.

**Rekomandimi:** Nga Bashkia Prrrenjas duhet të kontabilizohet detyrimi ndaj subjektit “*D.B./M.*” person fizik, me NUIS L....K, si dhe të vazhdohet me shlyerjen e plotë të tij, sipas mundësive financiare të Bashkisë Prrrenjas.

## IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

### Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

#### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Prrenjas nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke moshartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Për periudhën objekt auditimi, nuk ka takime të dokumentuara të GMS, nuk janë hartuar dhe miratuar gjurmët standarde të auditimit, nuk është hartuar lista (harta)/manuali i proceseve të punës, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar edhe programe trajnimesh në njësinë vendore për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit; Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se 5 vjet, plane dhe raporte vjetore mbi problematikat e hasura dhe zgjidhjen që iu është dhënë gjatë veprimtarisë së njësive publike. Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, 20, 21, 22, nenin 32 të Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 31-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Prrenjas, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen nga menaxhimi dhe nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, të rritjes dhe forcimit të aktivitetit GMS, të koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut, të hartojë dhe të miratojë gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe monitorimit në bashki.

**1.2. Rekomandimi:** GMS të marrë masa për hartimin dhe miratimin e planit strategjik dhe planit vjetor për aktivitetet dhe çështjet që duhet të analizojë dhe grafikun e takimeve që do realizojë, për hartimin e raporteve vjetore, si një rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie, për të arritur objektivat institucionale në shërbim të komunitetit.

**1.3. Rekomandimi:** Nëpunësi Autorizues, Nëpunësi Zbatues dhe GMS të marrin masa për miratimin e një strategjie për menaxhimin e risqeve dhe masave konkrete për minimizimin e tyre për aktivet afatgjata, miratimin e një rregulloreje me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e aktiveve afatgjata të njësive nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

**1.4. Rekomandimi:** Drejtoria Ligjore, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore, të marrë masa për të hartuar programe trajnimi për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësive, të plotësojë dosjet e personelit sipas kërkesave ligjore/nënligjore, të kontribuojë në krijimin e një strukture organizative/organizimare e saj sa më efektive, plotësimin me personel të saj, për të rritur efektivitetin e shërbimeve dhe funksioneve që i atribuon ligji në dobi të komunitetit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi vlerësimin e aktivitetit të Njësive të auditimit të brendshëm në Bashkinë Prrenjas u konstatua se:

**1.** Bashkia Prrenjas ka krijuar NJAB, e cila e ushtron funksionin e vet me dy auditues (1 përgjegjës dhe 1 auditues) në strukturën organizative të saj dhe me një vend vakant, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, “Mbi auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, pika 3, “Manualin e procedurave të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, VKM-në nr. 83 datë 03.02.2016, “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, pikat 3 dhe 6, si dhe Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Prrenjas “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Prrenjas dhe institucioneve në varësi, bazuar në numrin maksimal dhe kategorinë e pagave të miratuara nga Këshilli Bashkiak për vitin 2022”, miratuar edhe me Vendim të Këshillit Bashkiak;

**2.** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se NJAB nuk ka realizuar numrin e auditimeve të planifikuara në planet strategjike dhe vjetorë për 2 vite radhazi (2020 dhe 2021), ndërsa për vitin 2022 ka ndryshim të planit fillestar; Gjithashtu rezultoi se në planifikimin e misionëve auditues strategjike dhe vjetorë, nuk është respektuar raporti 60% me 40% mes sistemeve/fushave me risk të lartë dhe sistemeve/fushave me risk të mesëm/ulët, në moszbatim të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe “Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, Kapitulli III, paragrafi 3, pikat

1.6; 1.7; 3.2; 3.4; 3.5.

3. Nga auditimi mbi rekomandimet e lëna nga NJAB në misionet audituese të realizuara në 3 vitet e fundit, rezultoi se numri i tyre vjen në rritje dhe ai i atyre të zbatuara në rënie; ndërsa rekomandimet e shprehura në vlerë mbeten në statusin “pa zbatuar”.

4. Nga verifikimet e dokumentacionit, analiza e informacionit të pasqyruar në tabela si dhe auditimi i raporteve vjetore të hartuara dhe të miratuara, që NJAB ka dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm rezultoi se: numri i auditimeve të planifikuara për periudhën nën auditim vjen në rënie; nuk është realizuar numri i auditimeve të planifikuara për vitet 2020 e 2021; nuk janë përfshirë në planet strategjike dhe ato vjetore të gjitha njësitë e strukturës së bashkisë me referim koeficientin e riskut, ku ato me risk të lartë auditohen çdo vit, me risk të mesëm në çdo 3 vjet dhe ato me risk të ulët në çdo 5 vjet, të gjitha këto në moszbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe “Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, Kapitulli III, pika 3.1.2;

5. Nga auditimi, rezultoi se dosjet e misioneve audituese kanë mangësi me dokumentet standarde, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe “Manualin e auditimit të brendshëm në sektorin publik”, Kapitulli VI dhe Formatin standard nr. 1;

6. Nga ana e subjekteve të audituara nuk janë hartuar planet e veprimit, të cilat i dërgohen NJAB jo më vonë se 30 ditë pune pas dërgimit të Raportit Përfundimtar, duke mospërbushur detyrimin nr. 5 të skemës finale të auditimit, në moszbatim të kreut 4.1.12, hapi 11 të “Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”;

7. Njësia e auditimit të brendshëm nuk ka ndjekur hapat e procesit të monitorimit, për zbatimin e rekomandimeve nga ana e subjekteve të audituara brenda afateve të përcaktuara, në moszbatim kjo të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe “Manualit për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, Kapitulli 4.1, pikat 13/1, 2, 3; Por nga ana e saj, NJAB në moszbatim të kësaj procedure, ka planifikuar dy misione audituese “për zbatimin e rekomandimeve të lëna në subjektet e audituara” dhe “zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH”, duke mos përdorur me efikasitet burimet (njerëzore, financiare dhe kohën) për ushtrimin e aktivitetit të saj në ato njësi të paudituar, të audituara shumë herët apo asnjëherë, në mos zbatim të përcaktimeve në kreun 4.1.13.1 dhe 2 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit” paragrafi 3 dhe “Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve”, paragrafi 4, të “Manualit për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Përgjegjësi për mosraportim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga misioni auditues i NJAB, kanë edhe subjektet e audituara, në moszbatim të kreut 4.1.13.3 “Përgjegjësitë e njësive për të zbatuar rekomandimet e auditimit të brendshëm”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 31-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Prrenjas, të marrë masa për plotësimin e Njesisë së auditimit të brendshëm me 3 auditues, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin, VKM-ve dhe Manualeve, për të përbushur misionin e saj në arritjen e objektivave.

**2.2. Rekomandimi:** Njësia e auditimit të brendshëm të bëjë një vlerësim real të koeficientit të riskut për fushat/sistemet objekt i misioneve audituese, për të përfshirë në planet strategjike dhe vjetore sektorët e fushave me risk, siç janë: zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, etj., duke respektuar raportin 60/40 mes sistemeve/fushave me koeficient të lartë risku ndaj atyre me koeficient të mesëm/ulët risku në hartimin e planeve strategjike e vjetore të njësisë.

**2.3. Rekomandimi:** Njësia e auditimit të brendshëm, të ndjekë me korrektësi çdo fazë të misionit auditues, duke e plotësuar me praktikën dokumentare përkatëse. Pas dërgimit të Raportit Përfundimtar në subjektin e audituar, t’i kërkojë menaxherit të tij të reagojë në lidhje me rekomandimet e lëna dhe të raportojë periodikisht Njësinë e auditimit të brendshëm sipas afateve të përcaktuara në planin e veprimit.

**2.4. Rekomandimi:** Drejtuesi i Njesisë së auditimit të brendshëm duhet të krijojë dhe mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të rekomanduara për t’ia përcjellë menaxhimit, nëpërmjet raporteve informuese të dhëna mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, sipas Manualit të auditimit të brendshëm.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi, u konstatua se:

1. Gjendja e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene”, në datën 31.12.2022, paraqitet në vlerën 4,918,360 lekë, e pandryshuar nga viti ushtrimor paraardhës. Nga Bashkia Prrenjas nuk është marrë asnjë masë për të inventarizuar, kontabilizuar dhe regjistruar në kadastër tokat, trojet dhe terrenet të cilat i janë transferuar me

VKM-të përkatëse ish-komunave, në kuadër të inventarizimit dhe transferimit të pasurive publike. Për sa më sipër, llogaria 210 *“Toka, Troje, Terrene”*, në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë.

2. Gjendja e llogarisë 211 *“Pyje, Plantacione”* në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 22,928,105 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 24,118,659 lekë, me një shtesë në vlerën 1,190,554 lekë. Në analizën e kësaj llogarie janë paraqitur edhe disa zëra, të cilët i përkasin llogarisë 202 *“Studime dhe kërkime”*, në vlerën 6,701,384 lekë dhe disa zëra, të cilët i përkasin llogarisë 218 *“Inventar ekonomik”*, në vlerën 6,969,028 lekë. Për sa më sipër, llogaria 211 *“Pyje kullota plantacione”* në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë dhe është mbivlerësuar për shumën 13,670,412 lekë.

3. Gjendja e llogarisë 212 *“Ndërtime e konstruksione”*, në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 599,502,327 lekë, e pandryshuar nga viti ushtrimor parardhës. Në analitikun e kësaj llogarie, u konstatua se vlera është 637,614,096 lekë. Nga Bashkia Prrenjas nuk është marrë asnjë masë për të inventarizuar, kontabilizuar dhe regjistruar në kadastër ndërtimet dhe konstruksionet të cilat i janë transferuar me VKM-të përkatëse ish-komunave, në kuadër të inventarizimit dhe transferimit të pasurive publike. Për sa më sipër, llogaria 212 *“Ndërtime e konstruksione”*, në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë.

4. Gjendja e llogarisë 213 *“Rrugë, rrjete, vepra ujore”*, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 962,639,497 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 916,482,044 lekë, me një pakësim në vlerën 46,157,453 lekë. Në analizën e kësaj llogarie janë paraqitur edhe disa zëra, të cilët i përkasin llogarisë 202 *“Studime dhe kërkime”*, në vlerën 6,701,384 lekë. Gjithashtu, u konstatua se në llogarinë 213 *“Rrugë, rrjete vepra ujore”*, ka 40 zëra asetesh, në vlerën totale 717,837,015 lekë, të cilat duhet të kalojnë në administrim të shoqërive aksionare përkatëse për furnizimin me ujë të pijshëm. Nga Bashkia Prrenjas nuk është marrë asnjë masë për të inventarizuar, kontabilizuar dhe regjistruar në kadastër rrugët, rrjetet dhe veprat ujore të cilat i janë transferuar me VKM-të përkatëse ish-komunave, në kuadër të inventarizimit dhe transferimit të pasurive publike. Për sa më sipër, llogaria 213 *“Rrugë, rrjete vepra ujore”* në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë dhe është e mbivlerësuar për shumën 10,064,005 lekë.

5. Gjendja e llogarisë 214 *“Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”*, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 14,099,639 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 10,168,721 lekë, me një pakësim në vlerën 3,930,918 lekë nga amortizimi dhe nxjerrjet jashtë përdorimit. Shtesat në këtë llogari kanë qenë 124,480 lekë, të cilat paraqesin vlerën e investimeve të kryera për instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës. Nga Bashkia Prrenjas, për këtë llogari nuk disponohet analizë dhe një pjesë e zërave përkatës të kësaj llogarie janë kontabilizuar gabim në llogarinë 215 *“Mjete transporti”*, duke e nënvlerësuar këtë llogari për vlerën 23,827,196 lekë. Për sa më sipër, llogaria 214 *“Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”*, në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë dhe është e nënvlerësuar për shumën 23,827,196 lekë.

6. Gjendja e llogarisë 215 *“Mjete transporti”*, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 54,196,396 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 45,266,396 lekë, me një pakësim në vlerën 10,310,000 lekë. Në analizën e kësaj llogarie janë paraqitur edhe disa zëra, të cilët i përkasin llogarisë 214 *“Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”*, në vlerën 23,827,196 lekë, të cilat nuk janë mjete transporti, por makineri. Për sa më sipër, llogaria 215 *“Mjete transporti”*, në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën e vërtetë dhe është e mbivlerësuar për shumën 23,827,196 lekë.

7. Nga auditimi dhe testimi i Aktiveve Afatgjata Materiale, u konstatua se në regjistrat/librat e kontabilitetit të këtyre llogarive, për një pjesë të konsiderueshme të zërave nuk është pasqyruar vlera fillestare e aktiveve, por vetëm vlera e shpenzimeve të mëpasshme, për rikonstruksione ose përmirësimin e gjendjes së këtyre aktiveve. Kryesisht, kjo ka ndodhur për shkak se shumica e këtyre AAM nuk është pajisur me titull pronësie dhe ende nuk janë në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. Gjithashtu, paraqiten problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar e amortizimit, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar e shpenzimeve të mirëmbajtjes, data e daljes nga pronësia, etj. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivitetit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*.

Këto llogari janë mbajtur në bilancin kontabël pa pasur një analizë të detajuar, ku të përcaktohet origjina e vlerës së asetëve. Nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës disponohet informacion vetëm për shtesat

vjetore të llogarive 210, 211, 212, 213, 214 dhe 215. Gjithashtu, fakti që nuk ka një regjistër konlabël për AAM, e vështirëson më tej njohjen dhe verifikimin e saktësisë së vlerave kontabël të këtyre llogarive.

Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, pika 30; UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, Aneksi 1, Pika 2, Klasa 2; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, etj. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 61-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrave të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

**3.2. Rekomandimi:** Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara deri më sot, si dhe saktësimin e aseteve të inventarizuara, përkatësisht për zërat: 210 “Toka, troje terrene”; 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”; 212 “Ndërtime e konstruksione”; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” dhe 215 “Mjete transporti”. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë vlera fillestare dhe kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivitetit përkatës, sipas rastit.

**3.3. Rekomandimi:** Nga Bashkia Prrenjas, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të merren masa për të sistemuar llogaritë 210 “Toka, Troje, Terrene”, 211 “Pyje, Plantacione”, 212 “Ndërtime e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 215 “Mjete transporti”, sipas vlerave të specifikuar më sipër.

### **Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumenteve financiare dhe verifikimi në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe QKB-së, u konstatua se Bashkia Prrenjas, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2022 paraqitet si:

- Aksionare me 42.08% të aksioneve të Shoqërisë U.K.L.P. Sh.A., me NUIS J...V e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm, etj.”. Numri i aksioneve është 415,720 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 415,720,167 lekë, nga e cila vlera 82,652,660 lekë përbën kapitalin e shlyer. Kjo shoqëri është themeluar në datën 16.08.2022. Bashkia Prrenjas zotëron 174,947 aksione, me vlerë nominale 174,947,000 lekë. Këto të drejta, Bashkia Prrenjas i ka trashëguar nga reforma territoriale, në datën 30.05.2016, si përfituese e pasurisë së ish-komunave të cilat janë konsoliduar në Bashkinë e re të Prrenjasit.

- Aksionare me 12.9% të aksioneve të Shoqërisë U.K.P. Sh.A., me NUIS M...U e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm, etj.”. Numri i aksioneve është 100,000 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 10,000,000 lekë, nga e cila vlera 5,100,000 lekë përbën kapitalin e shlyer. Kjo shoqëri është themeluar në datën 26.07.2022. Bashkia Prrenjas zotëron 12,900 aksione, me vlerë nominale 1,290,000 lekë.

- Aksionare me 8% të aksioneve të Shoqërisë E.E. Sh.A., me NUIS M...T e cila është shoqëri aksionare me objekt “Grumbullimi, rehabilitimi dhe përpunimi i mbetjeve të ndryshme, organike, të ngurta, të gjelbërta,..etj.”. Numri i aksioneve është 7 me vlerë nominale 500,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 3,500,000 lekë, e cila përbën kapital të shlyer. Kjo shoqëri është themeluar në datën 18.11.2021. Bashkia Prrenjas zotëron 1 aksion, me vlerë nominale 500,000 lekë.

Vlera totale 176,737,000 lekë nuk është paraqitur në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël për vitin ushtrimor 2022, konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”.

Për sa më sipër, llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” nuk paraqet vlerën reale për shumën 176,737,000 lekë (174,947,000 lekë nga Shoqëria U.K.L.P. Sh.A., 1,290,000 lekë nga Shoqëria U.K.P. Sh.A. dhe 500,000 lekë nga Shoqëria E.E. Sh.A.).

Gjithashtu, u konstatua se në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”, ka 40 zëra asetesh, në vlerën totale 717,837,015 lekë, të cilat duhet të kalojnë në administrim të shoqërive aksionare përkatëse për furnizimin me ujë të pijshëm. Këto zëra asetesh janë paraqitur në Aneksin PF25, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Sa më sipër, është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 61-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Prrrenjas, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të shoqërive: **1.** “U.K.L.P. Sh.A.”, me NUIS J...V, për 42.08% të aksioneve, gjithsej 174,947 aksione, me vlerë nominale 174,947,000 lekë; **2.** “U.K.P. Sh.A.”, me NUIS M...U, për 12.9% të aksioneve, gjithsej 12,900 aksione, me vlerë nominale 1,290,000 lekë; **3.** “E.E. Sh.A.”, me NUIS M...T, për 8% të aksioneve, gjithsej 1 aksion, me vlerë nominale 500,000 lekë, si dhe regjistrimin e kapitalit aksionar të këtyre shoqërive në shumën totale 176,737,000 lekë në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023**

**5. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2021 paraqitet përkatësisht 142,534,635 lekë për llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe 0 lekë për llogarinë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale”. Në datën 31.12.2022 paraqitet përkatësisht 190,742,803 lekë për llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe 0 lekë për llogarinë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale”, me një rritje prej 48,208,168 lekë nga viti i kaluar. Vlera e prokuruar për investimet gjatë vitit 2022 ka qenë 429,060,344 lekë, nga të cilat 337,346,089 lekë me fonde të deleguara dhe 91,714,244 lekë nga të ardhurat e veta.

Për sa më sipër, zëri “Investime në proces”, i përbërë nga llogaritë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, në datën 31.12.2022 nuk paraqet vlerën reale, është nënvlerësuar për shumën 238,317,541 lekë, pasi duhet të pasqyronte vlerën 429,060,344 lekë, e cila përbëhet nga shuma e kontratave të lidhura, të cilat nuk kanë përfunduar dhe nuk janë marrë në dorëzim nga Bashkia Prrrenjas.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kreu II, pikat 6 dhe 15-18, kreu III, pika 33, 36, Aneksi 1, pika 2, “Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël)”, “Aktive afatgjata materiale”, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 61-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike dhe Financës në Bashkinë Prrrenjas, në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, të mbajë në konsideratë që pagesat e vlerave pjesore të AQT, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në vlerën e plotë dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave, t’i kontabilizojë ato në llogaritë e klasave 20-21, sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

**Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023**

**6. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” (nënlllogaria 4662104) në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 44,736,876 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 45,539,778 lekë ose me rritje në vlerën 802,902 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Nga auditimi u konstatua se për objektet e përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Prrrenjas, nuk është bërë zhblllokimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuar në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së



punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria Ekonomike dhe e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

Veprimet dhe mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 61-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Prrenjas në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejojë likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zhbllokimin e fondeve të ngurtësuar.

### ***Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023***

**7. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2022, janë kryer investime në total për 20 objekte, për vlerën totale të kontraktuar 429,060,344 lekë. Likuidimi në periudhat e mëparshme ka qenë në vlerën 229,442,021 lekë. Planifikimi për t’u likuiduar gjatë vitit 2022 ka qenë 190,618,323 lekë.

Me fonde të deleguara nga Qeveria kanë qenë gjithsej 6 objekte, në vlerën totale të kontraktuar 337,346,089 lekë. Likuidimi në periudhat e mëparshme ka qenë për vlerën 239,955,355 lekë dhe realizuar për gjatë vitit 2022 në vlerën 97,390,734 lekë.

Me fondet e veta kanë qenë gjithsej 14 objekte, për vlerë totale të kontraktuar 91,714,255 lekë. Likuidimi në vitin 2022 është realizuar në vlerën 89,160,441 lekë. Vlera e mbetur për t’u financuar ka qenë 2,553,814 lekë. Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera, nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t’u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizimit të aktivitetit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2021 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, ku vlera e tyre e mbetur e palikuiduar nuk është evidentuar në kontabilitet në llogarinë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMF nr. 5, datë 21.2.2022, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Kreu I, “Të përgjithshme”, pika 8, Kreu II, “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pikat 15/a, b, c, 18/a, b dhe Kreu III, “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 32.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 61-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1. Rekomandimi: Me çeljen e fondeve/mbërritjen e shkresës** së dërguar nga MFE për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve, të kryhet veprimi kontabël për shumat përkatëse në debi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe në kredi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”.

**Me konstatimin e shpenzimit**, (mbërritja e faturës shoqëruar me situacion) të bëhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të llogarisë 404 “Furnitorë për investime”.

**Në momentin e pagesave** të faturave, të kryhet kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 “Furnitorë për investime” dhe në kredi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”.

**Në fund të vitit ushtrimor**, për fondet e përdorura për **investimet e papërfunduara/në proces**, të kryhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”, në kredi të llogarisë 720 “Grant korrent i brendshëm” dhe në kredi të llogarisë 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.

**Me përfundimin e investimit,** të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës të bëhet kapitalizmi i aktivitet (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhet prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”.

**Me kapitalizmin e aktivitet,** (për aktivitet e marra në dorëzim), të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”, në kredi llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për fondet buxhetore të përdorura për investime, në kredi të llogarisë 1011 “Shtesa të fondit bazë” dhe në debi të llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për vlerën e aktiveve të blera.

### *Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023*

**8. Gjetje nga auditimi: 1.** Nga auditimi i 36 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2018-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 16 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar.

**2.** Nga auditimi i procedurave të prokurimit për punë publike, u konstatua se në shumicën e tyre është vendosur si kriter për punonjësit, dëshmia e sigurimit teknik, bazuar në Ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike” i ndryshuar, ndërkohë që objekti i punëve publike dhe stafi i nevojshëm për kryerjen e këtyre punimeve, nuk është në kushtet për të qenë i pajisur me këtë dëshmi, pasi nuk ka zëra punimesh që lidhen me objektin e këtij ligji. Pra ky kriter rezulton i paargumentuar dhe nuk lidhet me objektin e kontratës. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, neni 1, 2, 20, si dhe neni 26, pika 5 të VKM-së nr. 914, datë 24.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, të shfuqizuara përkatësisht me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 83-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Prrrenjas, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

**8.2. Rekomandimi:** Specialisti i fushës në Njësinë e Prokurimit të Bashkisë Prrrenjas, të marrë masa për shmangien e kriterëve të paargumentuara dhe të palidhura me objektin e kontratës, të cilat kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit publik.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 36 procedurave të prokurimit publik, të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2018-31.12.2022, u konstatua se në 13 raste, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, shkronjat a), b), d) dhe dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” shkronjat (a), b) dhe c), neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” pika 1 dhe neni 55 “Shqyrtimi i ofertave” pika 3 dhe VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të shfuqizuara përkatësisht me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 83-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Prrrenjas, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të kontratave për punë publike, përkatësisht:

- “Rikonstruktion rrjeti shpërndarës i ujësjellësit Prrrenjas”,
- “Rikonstruktion dhe riveshje me asfaltim i pjesëve të dëmtuara të rrugës “Lapidari Qukës Shkumbin, Mulliri i Belbës, asfaltimi i rrugës në lagjen e Kryeziut, asfaltimi i rrugës në lagjen e Shytit dhe rikonceptimi i qendrës së fshatit Qukës, NjA Qukës”,
- “Rikonstruktion i rrugës Qukës Shkumbin-Stroskë”,
- “Rikonstruktion i rrugës Qukës-Skënderbe”,

- “Ujësjetësi Dritaj-Fanjë - Karkavec (Vazhdim, faza II)”,
- “Ujësjetësi Dritaj-Fanjë-Karkavec (Vazhdim, faza III), FV matësa familjarë”,
- “Rihabilitimi i Skemës Ujitëse Radigoz-Stranik-Bërzeshtë”, rezultoi se:

Autoriteti Kontraktor Bashkia Prrenjas nuk ka kryer oponentin teknik për projektet e zbatimit, për të gjitha ndërtimet publike dhe ndërtimet jopublike. Veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 6.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 83-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1. Rekomandimi:** Bashkia Prrenjas të marrë masa për të pajisur me Oponentin Teknik të gjitha ndërtimet publike dhe ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar mbi 100 milionë lekë, si dhe objektet me akses publik sipas legjislativës në fuqi.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në 2 raste, personat përgjegjës të cilët administrojnë procesin në sistemin “e-leje”, i kanë miratuar ato në mospërbushje të dokumentacionit sektorial të kërkuar për ndërtimin, pasi janë evidentuar mangësi që lidhen me treguesit e lartësisë, distancat ndërmjet ndërtimeve, moslogaritje e saktë e sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit në 1 rast, si dhe mos respektim i KSHT-së dhe intensitetit të ndërtimit, veprime në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, nenet 34, pika 2, 35, 37, 38 pika 2 dhe 39, pika 1, Planin e përgjithshëm vendor të Bashkisë Prrenjas, miratuar me Vendimin nr. 3, datë 14.04.2017 nga Këshilli Kombëtar i Territorit, Pasaporta teknike e njëjësive strukturore 1/31 dhe 1/36 të kësaj bashkie.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 127-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Prrenjas, të marrë masa për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, ku të respektohet legjislativi sektorial në fuqi dhe Plani Rregullues i Bashkisë Prrenjas. Të respektohen parametrat teknikë të ndërtimit lidhur me lartësinë e objekteve si dhe distancat ndërmjet ndërtimeve dhe pronave, kjo për të mundësuar trajtim të barabartë në të ardhmen për secilin subjekt zhvillues, të cilit mund t’i kufizohet e drejta e zhvillimit të pronës për shkak të vendimmarrjeve të gabuara.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi për veprimtarinë e kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e paligjshme, rezultuan mangësi në lidhje me aktivitetin e kësaj njësie, e cila për vitet objekt auditimi, në shumicën e rasteve nuk ka aplikuar masën administrative dënim me gjobë për subjektet kundërvajtëse, nuk ka nxjerrë aktet e pezullimit si dhe vendimet e prishjes për këto ndërtime. Nuk disponohej asnjë akt kontrolli për objektet e ndërtuara me leje ndërtimi, si dhe mungonte korrespondenca me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Veprimet e mësipërme, janë në kundërshtim me nenet 4 dhe 5, geramat a, b, ç, d, f, të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51, “Inspektimi”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 132-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1. Rekomandimi:** Kryeinspektori i IMTV Bashkia Prrenjas, të marrë masa që në të ardhmen, të nxjerrë vendimet e gjobave për të gjitha rastet e konstatimit të ndërtimeve pa leje ose në shkelje të lejes, të kryhet pezullimi i punimeve me aktin përkatës si dhe të nxirren vendimet për prishjen e tyre.

**12.2. Rekomandimi:** IMTV Bashkia Prrenjas, të mbajë akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse, me qëllim zbatimin e ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës, si dhe çdo 3 muaj, të përgatitet në mënyrë periodike informacioni drejtuar IKMT.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**13. Gjetje nga auditimi:** Në mbështetje të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, neni 15, “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronjat “a” dhe “b”, rikërkohet marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht dhe rekomandimet e pazbatuara.

Bashkia Prrenjas ka detyrimin për zbatimin e tyre si më poshtë vijon:

**a.** Janë lënë 18 Rekomandime për “Masa Organizative”, të cilat janë pranuar nga subjekti, për të cilat rikërkohet zbatimi për 4 masa të zbatuara pjesërisht;

**b.** Janë lënë 11 rekomandime në vlerën totale 102,288,902 lekë për “Masa për eliminimin e subjekteve lidhur

me llogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore me efekte në të ardhurat e munguara”, të cilat janë pranuar nga subjekti dhe mbeten për t’u zbatuar, pasi deri tani janë zbatuar pjesërisht 5 masa, në vlerën 14,540,624 lekë, në proces zbatimi 3 masa, në vlerën 61,055,249 lekë dhe janë të pazbatuara 3 masa, në vlerën 26,695,029 lekë;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7., faqe 135-149 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Prrenjas të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 518/18 prot., datë 08.09.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, të hartojë plan pune të veçantë dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre.

*Menjëherë*

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kërkesës së Operatorit Ekonomik “D.B./M.”, Person Fizik, me NUIS L.....K, datë 23.01.2023, protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr. 81, datë 23.01.2023, për përmbushjen e detyrimit kontraktor nga Bashkia Prrenjas, konkretisht për likuidimin e faturës tatimore me numër serial 53468950 dhe numër rendor 50, datë 15.01.2019, në vlerën 1,100,560 lekë pa TVSh, u konstatua se:

1. Shërbimi i kontraktuar është realizuar;
2. Dokumentacioni autorizues është i plotë;
3. Dokumentacioni vërtetues është i plotë;
4. Mungon dokumentacioni i kontabilitetit, i cili ka ardhur si pasojë e ndryshimeve të administratës së Bashkisë Prrenjas.
5. Operatori Ekonomik ka bashkëlidhur ankesës kopje të noterizuara të faturës dhe procesverbalit përkatës;
6. Personat përgjegjës nga intervistat e zhvilluara kanë pranuar që shërbimi është kryer dhe kanë nënshkruar rregullisht faturën dhe procesverbalin përkatës.

Bashkia Prrenjas, pavarësisht se problemet kanë ndodhur gjatë ndryshimit të titullarit, nuk ka zbatuar UMF nr. 30, datë 07.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, nënkapitulli “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”, pika 35, germa a. “Dokumenta autorizues”, germa b. “Dokumenta vërtetues”, duke rrezikuar të përballet me procedura gjyqësore të cilat mund të lindin për këtë rast dhe rrjedhimisht mund të përballet edhe me kamatëvonesat përkatëse, sipas dispozitave të ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8., faqe 149-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Prrenjas duhet të kontabilizohet detyrimi ndaj subjektit “D.B./M.” person fizik, me NUIS L....K, si dhe të vazhdohet me shlyerjen e plotë të tij, sipas mundësive financiare të Bashkisë Prrenjas.

*Brenda datës 01.10.2023*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, shkronjat b dhe c, Ligjin nr. 44, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 98-102, Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 21-33 dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të Bashkisë Prrenjas, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,508,892.39 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion rrjeti shpërndarës i ujësjellësit Prrenjas”, me vlerë 213,998,884.34 lekë me TVSH, fituar nga OE “C.” ShPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera për zërat e punëve: “Furnizimi dhe instalimi i pusëtës së shkarkimit të dhomës së klonimit duke përfshirë furnizimin dhe instalimin e tubacioneve dhe materialeve ndihmëse”; “Kit portativ për matje klori” dhe “Furnizimi dhe instalimi i analizatorit të klorit në rrjetin kryesor, duke përfshirë tubacionet ndihmëse, bateritë, transmetuesin dhe kabinën plastike me themele betoni”, në vlerën **547,304.39 lekë pa TVSH**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1075 prot., datë 19.03.2020, të lidhur ndërmjet Bashkisë Prrenjas dhe OE “C.” ShPK.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 83-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Prrenjas të arkëtojë vlerën **184,133.17 lekë pa TVSh** nga OE “C.” ShPK për punime të pakryera, parashikuar në kontratën nr. 1075 prot., datë 19.03.2020, me objekt “*Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit Prrenjas*”.

**1.2. Rekomandimi:** Bashkia Prrenjas, të marrë masa për të ngritur një grup pune me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin; kolaudatorin e punimeve si dhe Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve Prrenjas, në cilësinë e administratorit të investimit, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, bazuar nga fakti i auditimit në terren ku rezultuan pajisje të pavendosura në objekt.

Dalja e përgjegjësi, realizimi i zërave të punimeve sipas PZ dhe ST në shumën **363,171.22 lekë**, të konfirmohet zyrtarisht nga palët, Autoriteti Kontraktor Bashkia Prrenjas, Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve Sh.A Prrenjas, Sipërmarrësi i punimeve, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit brenda periudhës së garancisë me datë 25.07.2023. Në rast të kundërt, mosvendosja e pajisjeve në objekt, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga personat përgjegjës.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt “*Rikonstruksion dhe riveshje me asfaltim i pjesëve të dëmtuar të rrugës Lapidari Qukës Shkumbin, Mulliri i Belbës, asfaltimi i rrugës në lagjen e Kryeziut, asfaltimi i rrugës në lagjen e Shytit dhe rikonceptimi i qendrës së fshatit Qukës*”, me vlerë 95,540,069 lekë me TVSh, fituar nga BOE “M.” ShPK & “Sh.” ShPK, rezultuan punë të pakryera për zërin e punimeve: “*Zëri: 6 (3.353) Mbushje me material shkëmbor pas mureve*”, në vlerën **299,500 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3954 prot., datë 24.11.2020 të lidhur ndërmjet Bashkisë Prrenjas dhe BOE “M.” ShPK & “Sh.” ShPK.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 83-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Prrenjas të arkëtojë vlerën prej **299,500 lekë pa TVSh** nga shoqëria BOE “M.” ShPK & “Sh.” ShPK, për punime të pakryera, sipas kontratës nr. 3954 prot., datë 24.11.2020, me objekt “*Rikonstruksion dhe riveshje me asfaltim i pjesëve të dëmtuar të rrugës Lapidari Qukës Shkumbin, Mulliri i Belbës, asfaltimi i rrugës në lagjen e Kryeziut, asfaltimi i rrugës në lagjen e Shytit dhe rikonceptimi i qendrës së fshatit Qukës*”.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt “*Rikonstruksion i rrugës Qukës Shkumbin-Stroskë*”, me vlerë 95,540,069 lekë me TVSh, fituar nga BOE “M.” ShPK & “Sh.” ShPK, rezultuan punë të pakryera për zërin e punimeve: “*(An-8/M3). Mbushje me çakëll pas mureve*”, “*(3.183/a). Shtresë zhavorr lumi t=10 cm, për themelin*”, “*(3.653). F.V Tub plastmasi Ø150 mm*”, “*(An-31/M3). Gjeotekstil me gramaturë 180 g/m<sup>2</sup>*”, në vlerën **218,650 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3029 prot., datë 04.11.2022, të lidhur ndërmjet Bashkisë Prrenjas dhe BOE “M.” ShPK & “Sh.” ShPK.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 83-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Prrenjas të arkëtojë vlerën prej **218,650 lekë pa TVSh** nga shoqëria BOE “M.” ShPK & “Sh.” ShPK, për punime të pakryera, sipas kontratës nr. 3029 prot., datë 04.11.2022 me objekt “*Rikonstruksion i rrugës Qukës Shkumbin-Stroskë*”.

*Menjëherë*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “*Rikonstruksion i rrugës Qukës Skënderbe*”, me vlerë 43,200,000 lekë me TVSh, fituar nga OE “Sh.” ShPK, rezultuan punime të kryera me cilësi të dobët për shtresat asfaltike në vlerën **260,610 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3273 prot., datë 07.12.2021, të lidhur ndërmjet Bashkisë Prrenjas dhe OE “Sh.” ShPK.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 83-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Prrenjas, t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve OE “Sh.” ShPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që në objekt të realizohen punimet të cilat i përkasin shumës prej **260,610 lekë pa TVSh**, brenda periudhës së garancisë (datë 07.07.2023), për të garantuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e rrugës. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Prrenjas dhe Mbikëqyrësi i punimeve të objektit. Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas

Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve.

*Menjëherë*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt “*Rehabilitimi Skemës Ujitëse Radigoz-Stranik-Bërzeshtë*”, me vlerë 71,120,899.972 lekë me TVSh, fituar nga OE “E.A.” ShPK, rezultuan punë të pakryera për zërin e punimeve: “(3.46/1) *Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krah, me seksion deri 0.75*”, në vlerën **182,828 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3623 prot., datë 03.11.2020, të lidhur ndërmjet Bashkisë Prrrenjas dhe OE “E.A.” ShPK.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 83-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** Bashkia Prrrenjas të arkëtojë vlerën prej **182,828 lekë pa TVSh** nga shoqëria OE “E.A.” ShPK, për punime të pakryera, sipas kontratës me nr. 3623 prot., datë 03.11.2020 me objekt “*Rehabilitimi Skemës Ujitëse Radigoz-Stranik-Bërzeshtë*”.

*Menjëherë*

## **C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion për vitin 2022, u konstatua se janë krijuar detyrime debitorë progresive të palikuiduara për subjektet fizike/juridike në vlerën 18,312,760 lekë dhe për taksat dhe tarifave familjare në vlerën 45,078,816 lekë, në total 63,391,576 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Prrrenjas. Mosarkëtimi i detyrimeve për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, përveçse është mospërputhje me detyrën funksionale nga punonjësit e Drejtorisë së Taksave e Tarifave Vendore, njëkohësisht krijojnë mungesë financiare në treguesit buxhetorë, me pasojë uljen e nivelit të investimeve dhe të shpenzimeve të tjera që njësia vendore ka parashikuar në shërbim të komunitetit. Këto veprime janë në mospërputhje me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “*Për sistemin e taksave vendore*”, nenet 4, 26, 32 dhe 34; Ligjin nr. 9920 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, Kreu XI, “*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore*”, nenet 70 dhe 91, Ligjin nr. 10926, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, etj.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 51-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Prrrenjas dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për arkëtimin e detyrimeve të palikuiduara nga debitorët progresivë për vitin 2022, nga mospagesa e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara në paketën fiskale nga subjektet ekonomike që ushtrojnë aktivitetet për qëllime biznesi, si dhe nga subjektet familjare, në vlerën totale 63,391,576 lekë.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi, u konstatua se është keqmenaxhuar taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale, për qytetarët të cilët përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit. Për vitin 2022 janë 59 qytetarë debitorë për vlerën 1,790,459 lekë dhe nga vitet e mëparshme deri në vitin 2021 për vlerën 736,441 lekë, në total 2,526,900 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Prrrenjas.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 51-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Urbanistikës të përcjellë listën me subjektet debitorë për taksën e ndikimit në infrastrukturë, si dhe në vijim Bashkia Prrrenjas të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë prej 2,526,900 lekë.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi, rezultoi se nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Prrrenjas, nuk është përlllogaritur dhe aplikuar niveli i penaltetit në masën 0.1%, por jo më shumë se 10% për subjektet të cilat kanë lidhur kontrata qiraje me bashkinë dhe janë debitorë në Bashkinë Prrrenjas, nga ku detyrimi pa penaltitet për kontratat e qerasë për të cilat nuk është paguar detyrimi deri në datën 31.12.2022 rezulton në vlerën 4,566,925 lekë dhe detyrimi me penaltitet për kontratat e qerasë për të cilat nuk është paguar deri në

datën 31.12.2022, rezulton në vlerën 5,023,618 lekë. Vlera e penalitetit nga kontratat e qerasë për vitin 2022 është 456,693 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 51-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Prrenjas, Drejtoria e të Ardhurave e Drejtoria e Financës të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të përlogaritur sa më saktë nivelin e detyrimit me penalitet për kontratat e qerasë për të cila nuk janë paguar deri në datën 31.12.2022, si dhe mbledhjen e detyrimeve e konsideruar e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Prrenjas për vlerën 5,023,618 lekë.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në territorin e Bashkisë Prrenjas kryejnë aktivitet tregtar në fushën minerare subjekte të cilat kanë marrë në përdorim sipërfaqe nga fondi pyjor/kullosor. Nga të dhënat e vëna në dispozicion, rezultoi se Bashkia Prrenjas administron 19 dosje kontratash qeraje të lidhura me subjekte të ndryshme, ku në raportin teknik të vlerësimit (pjesë përbërëse e kontratës) është përlogaritur vlera e qerasë, sipas rastit. Deri në datën 30.12.2022, rezultoi se tarifat e papaguara për Bashkinë Prrenjas nga moszbatimi i kontratave të qerave, përlogaritet në shumën 20,488,050 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Prrenjas, nga subjektet të cilat operojnë në shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore (karriera).

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 51-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Prrenjas, Sektori Juridik, Drejtoria e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të kërkuar likuidimin nga subjektet të cilat ushtrojnë aktivitet për qëllime biznesi në fushën e mineraleve, të pajisur me leje minerare brenda territorit të Bashkisë Prrenjas, për detyrimin e qirasë së papaguar nga kontratat e lidhura për sipërfaqen në përdorim nga fondi pyjor/kullosor, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Prrenjas në vlerën 20,488,050 lekë, si dhe të verifikojnë në terren dhe të administrojnë të gjithë sipërfaqen e fondit pyjor/kullosor, sipas të dhënave në regjistrin e AKBN-së.

**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga informacioni dhe dokumentacioni i disponueshëm në Bashkinë Prrenjas, u konstatua se ushtrojnë aktivitet me autorizim për tregëtimin e lëndëve djegëse me pakicë 4 subjekte. Nga mospagesa e plotë e tarifave nga tre subjekte është krijuar një efekt financiar negativ në vlerën 2,221,083 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Prrenjas, në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 51-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Prrenjas dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për mbledhjen e detyrimeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa paguar plotësisht tarifën për pajisjen me autorizimin e tregëtimin të hidrokarbureve, për vlerën totale 2,221,083 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar në buxhetin e Bashkisë Prrenjas.

**Menjëherë**

**6. Gjetje nga auditimi: 1.** Nga auditimi i lejes së ndërtimit për subjektin L.B. dhe E.B., taksa e ndikimit në infrastrukturë është llogaritur gabim.

Vlera e TNI-së së llogaritur sipas legjislacionit, duhet të jetë 5,456,784 lekë dhe jo 1,286,014 lekë, sa është llogaritur nga punonjësit e Bashkisë Prrenjas sipas autorizimit për pagesë lëshuar për subjektin zhvillues.

Në llogaritjen e TNI-së është përdorur metoda e gabuar e llogaritjes mbi bazë preventivi, në kundërshtim me Ligjin nr. 95/2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore””, i ndryshuar, neni 9, pika 2, pasi llogaritja bëhet mbi bazën e çmimit të shitjes, e cila në paketën fiskale për vitin 2022 është 4% për ambientet për banim dhe 6% për ambientet e dedikuara për biznes. Sipërfaqet e objektit llogariten njëkohësisht me koeficientin e përcaktuar në VKM nr. 168, datë 27.03.2019 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 7.3.2018 të Këshillit të Ministrave”, për të nxjerrë vlerën përfundimtare të taksës që duhet të paguajë zhvilluesi.

Sa më sipër, konstatohet një diferencë prej 4,170,770 lekë, e pallogaritur në mënyrë të saktë, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Prrenjas.

**2.** Nga auditimi i lejes së ndërtimit për subjektin M.P., Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë është llogaritur gabim.

Vlera e TNI-së së llogaritur sipas legjislacionit duhet të jetë 8,056,645 lekë dhe jo 2,179,451 lekë e llogaritur

nga punonjësit e Bashkisë Prrenjas sipas autorizimit për pagesë lëshuar për subjektin zhvillues.

Në llogaritjen e TNI-së është përdorur metoda e gabuar e llogaritjes mbi bazë preventivi, në kundërshtim Ligjin nr. 95/2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 2, pasi llogaritja bëhet mbi bazën e çmimit të shitjes, e cila në paketën fiskale për vitin 2022 është 4% për ambientet për banim dhe 6% për ambientet e dedikuara për biznes. Sipërfaqet e objektit llogariten njëkohësisht me koeficientin e përcaktuar në VKM nr. 168, datë 27.03.2019 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 7.3.2018 të Këshillit të Ministrave”, për të nxjerrë vlerën përfundimtare të taksës që duhet të paguajë zhvilluesi.

Sa më sipër, konstatohet një diferencë prej 5,877,194 lekë, e pallogaritur në mënyrë të saktë, e cila përbën të ardhur të paarkëtuar për Bashkinë Prrenjas.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 132-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Rekomandimi:** Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, personit të ngarkuar për llogaritjen e TNI-së për objektet e reja që kanë tipologjinë e mësipërme, taksa të përlllogaritet bazuar në çmimin e shitjes.

**6.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa për arkëtimin e vlerës prej 10,047,964 lekë ndaj 2 subjekteve për llogaritje të gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë, nga të cilat 4,170,770 lekë për subjektin L.B. dhe E.B., si dhe 5,877,194 lekë për subjektin M.P..

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

## **GRUPI I AUDITIMIT**

1. J.P.
2. S.J.
3. SH.H.
4. K.F.
5. S.M.

## **DREJTORI I DEPARTAMENTIT**

B.D.